



Cikli i tretë i studimeve – Studimet e doktoratës

Tema e disertacionit të doktoratës

KONTEKSTI I SHËRBIMEVE INTELIGJENTE NË POLITIKAT BASHKËKOHORE TË SIGURISË

Kandidati

Mr. Sc. Bahri GASHI

Mentori

Prof. Dr. Fadil Zendeli

Mars, 2019



Cikli i tretë i studimeve – Studimet e doktoratës

Tema e disertacionit të doktoratës

KONTEKSTI I SHËRBIMEVE INTELIGJENTE NË POLITIKAT BASHKËKOHORE TË SIGURISË

Kandidati

Mr.Sc. Bahri GASHI

Mentori

Prof. Dr. Fadil ZENDELI

Tetovë, 02. Mars 2019

*NË EMËR TË KRIJUESIT,
MËSHIRUESIT FUQIPLOTË!
Këtë përpjekje shkencore ia dedikoj ZOTIT,
KOMBIT DHE FAMILJES !*

Dedikim

*Politikave kombëtare të sigurisë dhe inteligjencës, në interes të
shtetit të Republikës së Kosovës, kombit dhe botës akademike.*

Vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi - Bahri Gashi, 2019
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Lektor dhe korrektor
Engjëll I. Berisha

P Ë R M B A J T J A

Parahyrje.....	9
Abstarct.....	10
Абстракт.....	11
Lista e tabelave, organogrameve dhe figurave.....	12
Shkurtesat dhe akronimet.....	13
Mendime autoriale për kapituj.....	18
Lista e autorëve të huaj.....	19
Hyrje.....	20

KAPITULLI I PARË

KËNDVËSHTRIME TEORIKE RRETH ROLIT DHE MISIONIT TË SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS

1.1 Aspekte teorike të përkufizimit dhe zhvillimit të Shërbimeve të Inteligjencës.....	29
1.2 Njohje rreth konceptit dhe praktikave të Shërbimeve Inteligjente	32
1.3 Llojet dhe mënyrat e Shërbimeve Inteligjente.....	35
1.3.1 Shërbimi i brendshëm Inteligjent.....	36
1.3.2 Shërbimi jashtëm i inteligjencës	36
1.3.3 Shërbimi inteligjent i krimeve	36
1.3.4 Shërbimi inteligjent ushtarak	36
1.3.5 Metodologjia e Shërbimeve Inteligjente.....	37
1.3.6 Praktika themelore të funksionimit të Shërbimeve të Inteligjencës.....	38
1.3.7 Legjislacioni që kërkohet për funksionimin e shërbimeve të inteligjencës.....	39
1.3.8 Disiplinat e grumbullimit të inteligjencës.....	43

KAPITULLI I DYTË

KUNDËRINTELIGJENCA E SHËRBIMEVE INTELIGJENTE

2.1 Këndvështrime dhe koncepte teorike.....	45
2.2 Kundër - Inteligjenca në kuptimin etimologjik dhe terminologjik.....	48
2.3 Llojet e Kundërinteligjencës.....	49
2.4 Misioni i Kundërinteligjencës.....	50
2.5 Koncepti i Kundërinteligjencës mbrojtëse / defansive.....	54
2.6 Operacionet e mbrojtjes së burimit të forcës kundërzbuluese / kundërinteligjente.....	55

KAPITULLI I TRETË

NJOHJE E KOMPERATIVE E SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS

Niveli i krahasimit të Shërbimeve të Inteligjencës në kontekstin rajonal

3.1 SHISH, Shërbimi Informativ i Shtetit / Shqipëria.....	59
3.2 BIA, Agjencia e Sigurisë dhe Informacionit / Serbia.....	60
3.3 OSA-OBA, Agjenci për Sigurim dhe Inteligjencë / Bosnjës dhe Hercegovinës.....	62
3.4 SOVA - Agjencia Sllovene për Siguri dhe Inteligjencë / Sllovenia.....	63
3.5 AZ – Agjencia për zbulim / Republika e Maqedonisë.....	64

Niveli i krahasimit të shërbimeve të Inteligjencës në kontekstin global

3.6 CIA Central Intelligence Agency (ShBA).....	67
3.7 FSB Federal'naya Sluzhba Bezopasnosti (Rusia)	70
3.8 SIS Secret Intelligence Service MI6 (Shërbimi Anglez)	71
3.9 BND Bundesnachrichtendienst (Gjermania).....	72
3.10 MOSSAD. Instituti për Inteligjencë dhe Detyra të Veçanta (Izraeli).....	73
3.11 MIT – Organizata Kombëtare e Inteligjencës (Turqi).....	74

KAPITULLI I KATËRT

KUADRI LIGJOR I RREGULLIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË AKI-SË

Këndvështrime mbi sektorët e sigurisë në Kosovë me theks të veçantë:

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë AKI –në

4.1 Aspekte të zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë (baza ligjore dhe sektorët e sigurisë në Kosovë).....	81
4.2 AKI - Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (kapacitetet fillestare dhe sfidat e konsolidimit).....	82
4.3 Rekrutimi dhe operacionalizimi i AKI –së.....	84
4.4 Elaborimi i kompetencave të Drejtorit, zv. Drejtorit dhe Inspektorit të Përgjithshëm.....	86
4.5 Kontrolli i brendshëm; Inspektori i përgjithshëm i AKI-së.....	87
4.6 Fushëveprimi i AKI –së.....	88
4.7 Buxheti i AKI –së.....	89

KAPITULLI I PESTË

SISTEMI I KONTROLLIT DEMOKRATIK TË SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS

5.1 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në SHBA (CIA).....	91
5.2 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në ANGLI (SIS).....	94
5.3 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në GJERMANI (BND).....	96
5.4 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në RUSI (FSB).....	98
5.5 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në IZRAEL (MOSSAD).....	99
5.6 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në KOSOVË (AKI) së (Ligjshmëria e mbikëqyrjes dhe kontrollit të AKI –së).....	101
5.7 Kontrolli i brendshëm i AKI –së	104
5.8 Mbikëqyrja parlamentare e AKI –së.....	105
5.9 Shoqëria civile dhe mediet	109
5.10 Institucionet e pavarura	110
5.11 Roli i Gjyqësorit	111
5.12 Sfidat e fuqizimit të mbikëqyrjes parlamentare të Inteligjencës së AKI –së.....	112

Dy aspekte themelore:

5.13 Aspekti vertikal: që i përgjigjet Institucioneve Qendrore, Qeverisë, Parlamentit dhe Presidencës.....	113
5.14 Aspekti Horizontal: Opinionit publik, si mediet etj	113

KAPITULLI I GJASHTË

INTELIGJENCA DHE SFIDAT NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT

6.1 Origjina dhe fillet e terrorizmit ndërkombëtar.....	115
6.2 Rritja dhe rënia e terrorizmit ndërkombëtar.....	117
6.3 Shqetësimet për të ardhmen.....	120
6.4 Terrorizmi dhe politika e sigurisë ndaj publikut.....	122
6.5 Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit.....	123
6.6. Kostot e terrorizmit.....	124
6.7 Pamjet e terrorizmit.....	126
6.8 Vlerësimi dhe paralajmërimi i kërcënimit.....	127
6.9 Organizatat terroriste.....	128
6.10 Inteligjenca dhe Kiberterrorizmi.....	131
6.11 Bashkëveprimi i institucioneve ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit.....	133
6.12 Roli i agjencive inteligjente në shkëmbimin e informacionit.....	140
6.13 Roli i shërbimeve të specializuar policore	142
6.14 Roli i shërbimeve të specializuara ushtarake	145

KAPITULLI I SHTATË

BASHKËVEPRIMI I SHËRBIMEVE TË SIGURISË DHE INTELIGJENCËS NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT BRENDIA SISTEMIT JURIDIK TË KOSOVËS DHE JURIDIKSIONIT NDËRKOMBËTARË

7.1 Rregullimi ligjor dhe bashkëveprimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në luftën Kundër terrorizmit.....	147
7.2 Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit.....	148
a. Parandalimi b. Ndjekja c. Mbrojtja d. Përgatitja dhe Reagimi	
7.3 Institucionet Republikës së Kosovës në luftën kundër terrorizmit.....	151
7.4 Koordinatori Nacional Kundër Terrorizmit	153
7.5 Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	153
7.6 Përgjimet ligjore (Dhoma Nationale e Interceptimeve).....	154
7.7 Ministria e Punëve të Brendshme	155
7.8 Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	155
7.9 Prokuroria dhe Gjykata	155
Inteligjenca dhe Kundër-inteligjenca, ligjet antiterroriste dhe zbatimi i tyre	
7.10 Legjislacioni i brendshëm- Korniza ligjore.....	155
7.11 Institucione të huaja që trajtojnë aspektet e sundimit të ligjit në Kosovë.....	156
7.12 Dokumente Strategjike të Republikës së Kosovës.....	157

RAPORTI I HULUMTIMIT

ANEKS I- Pyetësi.....	159
ANEKS II - Respondentët	163
ANEKS III- Interpretimi dhe analiza tabelore.....	168
ANEKS IV - Raporti Përfundimtar.....	200

SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE

Konkluzione.....	213
Rekomandime.....	216
LITERATURA	217
Pasdedikim.....	225
Rikapitulim statistikor.....	225

Parahyrje

Ky disertacion ka provuar të sjellë një materie të gjerë specifike, të detajuar dhe krahasimore, duke analizuar me kujdes disa aspekte përmbajtësore, koncepte teorike, aspekte krahasuese të autorëve më me ndikim në fushën e politikave të shërbimeve inteligjente.

Definimi i problemit dhe nevoja për njohje sa më kredibile rreth koncepteve akademike, burimeve, autorëve, institucioneve, analizimin e vëmendshëm të aspekteve përkufizuese, nocioneve, formave dhe koncepteve, llojeve, praktikave, disiplinave e teknikave, që janë të ndërlidhura ngushtë me qasjet dhe metodologjinë e punës së shërbimeve inteligjente janë po ashtu disa nga pjesët thelbësore e këtij studimi.

Shpjegimi i këtyre aspekteve teorike dhe praktikave më të mira që rregullojnë këtë fushë specifike në studimet tona akademike, ka bërë që studimi të marrë formë dhe përmbajtje në nuanca të theksuara të analizës empirike dhe faktmbledhëse, grumbulluese të këtij aktiviteti studimor.

Hulumtimi ynë ka përmbledhë aspekte të atilla, duke u munduar ti analizojë qasjet ekzistuese teorike, praktikat e kaluara dhe ato demokratike, që thyejnë “**teoritë tabu**”, gjithandej të mistershme dhe të paraqes bazë për njohje të reja, përmbledhurazi në këtë studim në fushën më multidisiplinare të njohjes sa më të thellë të kontekstit historik, aspektit teorik dhe praktikave dhe specifikeve brenda fushës.

Anët kërkimore, metodologjia brenda teorive dhe praktikave janë të shumta në kualitet dhe kuantitet, sidomos ato rreth metodologjisë dhe praktikave të specilazuara ndërkombëtare që kanë për qëllim që misionin e Agjencive të Inteligjencës ta bëjnë sa më demokratik.

Ky studim disertacioni, pa dyshim do të ndihmoj që studiuesit e fushës, institucionet dhe të interesuarit e tjerë të zgjerojnë njohuritë e tyre akademike.

Fjalët kyçe:

Emërtimet kyçe më specifike;

Agjenci, Informatë, Inteligjencë, Kundërinteligjencë, Kofidencë, Zbulim, Kundërzbulim, Siguri, Sekret, Shërbim;

Emërtimet kyçe më të përgjithshme;

Demokraci, Politikë, Mbikëqyrje, Llogaridhënie, Kontroll, Media, Shoqëri civile, etj.

Abstract

This dissertation has tried to bring a broad, specific, detailed and comparative subject matter, carefully analyzing some subtle aspects, theoretical concepts, and comparative aspects of the most influential authors in the field of intelligence services.

Defining the problem and the need for more credible recognition of academic concepts, sources, authors, institutions, careful consideration of definitions, notions, forms and concepts, types, practices, disciplines and techniques that are closely related to approaches and methodology of the work of intelligence services are also some of the essential part of this study.

The explanation of these theoretical aspects and the best practices that regulate this specific field in our academic studies has made the study take form and content in pronounced nuances of empirical and factual analysis, gathering of the study activity

Our research has summarized such aspects by trying to analyze existing theoretical approaches, past and democratic practices that break the "taboo theories", all over mysterious and present the basis for new recognitions, summarized in this study in the field multidisciplinary approach to deeper understanding of the historical context, the theoretical aspect and practices and specifications within the field.

Research, methodology within theories and practices are numerous in quality and quantity, especially those about internationally-recognized methodologies and practices that aim to make the Intelligence Agency's mission more democratic.

This dissertation study will unequivocally help field scholars, institutions, and other stakeholders to broaden their academic knowledge.

Keywords:

The most specific key designations;

*Agencies, Information, Intelligence, Counterintelligence, Coexistence, Disclosure,
Counterintelligence, Security, Secret, Service;*

Key more general denominations;

Democracy, Politics, Oversight, Accountability, Control, Media, Civil Society, etc.

Абстракт

Оваа дисертација се обидува да донесе широка, специфична, детална и компаративна анализа, внимателно анализирани некои суптилни аспекти, теоретски концепти и компаративни аспекти на највлијателните автори од областа на разузнавачките служби.

Дефинирањето на проблемите, и потребата на кредибилно познавање на академските концепти, извори, автори, институции, анализирање на дефинираните аспекти, поими, видови, практики, дисциплини и техники кои се тесно поврзани со методологијата на работа на разузнавачките служби, се едни од најважните истражувања во овој научен труд.

Објаснувањето на овие теоретски аспекти и на најдобрите практики, кои ја регулираат оваа специфична област во нашите академски истражувања, го направија овој труд да има форма и содржина со изразените нијанси врз емпириска и фактичка анализа, собирање на студиската активност.

Нашите истражувања ги сумираа таквите аспекти, со обид да ги анализираат постоечките теоретски пристапи, минатите и сегашните демократски практики, кои ги разбиваат "табу теориите", кој секаде се мистериозни, и претставуваат основа за нови признанија, сумирани во оваа студија од областа мултидисциплинарен приод кон подлабоко разбирање на историскиот контекст, теоретски аспект, практики и спецификации во рамките на ова поле на истражување.

Истражувањето и методологијата во рамките на теориите и практиките се бројни по квалитет и квантитет, особено оние кои се меѓународно признати методологии и практики кои имаат за цел да ја направат мисијата на Агенциите за разузнавање подемократска.

Оваа докторска дисертација, недвосмислено ќе им помогне на сите истражувачи од оваа поле на истражување, институции и други засегнати страни, кој сакат да ги прошират своите академски знаења.

Клучни зборови:

Најспецифични клучни зборови:

Агенција, Информација, Интелегенција, Контраразузнавање, Доверливи, Откритие,
Контраразузнавање, Безбедност, Тајна, Служба.

Поопшти клучни зборови:

Демократија, политика, надзор, отчетност, контрола, медиуми, граѓанско општество, итн.

LISTA E TABELAVE, ORGANOGRAMEVE DHE FIGURAVE

- Figura nr. 1 Disiplinat kryesore të inteligjencës.....	34
- Figura nr. 2 Metodatat e shërbimeve inteligjente.....	37
- Tabela nr. 3 Lloje të shërbimeve të inteligjencës në disa vende evropiane	41
- Tabela nr. 4 Lloje të shërbimeve të inteligjencës në disa vende të botës.....	42
- Tabela nr. 5 Disiplinat e grumbullimit të inteligjencës.....	43
- Fig nr. 6 Kërcënimet e “tessoc”	50
- Fig. Nr. 7 Pamje teknike e operacioneve të kundërinteligjencës.....	52
- Nr. 8. Organogrami i Agjencisë për Zbulim në Maqedoni	65
- Nr. 9. Organogrami, struktura organizative e CIA së	69
- Fig. Nr 10. Struktura e agjencisë kombëtare të inteligjencës turke.....	77
- Nr. 11. Organogrami, struktura organizative e AKI – së.....	85
- Figura nr. 12. Paraqet pamjen e terrorizmit.....	126
- Figura nr. 13. Fushëveprimtaria e organizatës “Un- Global” për trajtimin e luftës kundër terrorizmit.....	135
- Fig. Nr 14, Hartë: Sulmet terroriste dhe arrestimet sipas shteteve në BE.....	137
- Fig. Nr. 15. Themelimi i strategjisë kombëtare për ndarjen e informacionit.....	141
- Fig. Nr. 16. Organogrami i (MKMI) i ndarë në dy nivele.....	146

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

- AFI, Air Force Intelligence - Shërbimi Informativ i Forcave Ajrore;
- AI, Army Intelligence - Shërbimi Informativ i Ushtrisë;
- AIM, Agjensioni Informativë i Mbrojtjes “Defense Intelligence Agency” (DIA)
- AJE, Al-Jihad - egjiptiane; Kach - izraelite;
- AKI, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (Kosova)
- ALKN Administrata për Luftë kundër Narkotikëve “Drug Enforcement Administration “(DEA)
- AMIK, Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar;
- ANIK, Agjensioni Nacional për Incizim dhe Kartografi “National Geospatial-Intelligence Agency” (NGA)
- ANO, Organizata Abu Nidal - palestineze;
- ASG, Grupi Abu Sayyaf - filipine;
- ASK, Agjensioni për Sigurim Kombëtarë “National Security Agency” (NSA)
- AUM, Aum Shinrikyo japoneze;
- AZ, Agjencia e Zbulimit (Maqedonia)
- BFH, Byroja Federale e Hulumtimeve “Federal Bureau of Investigation” (FBI)
- BI, Bashkësia Informative;
- BIA, Agjencia e Sigurimit dhe Informacionit (Bezbednosno-Informativna Agencija) (Serbia)
- BND, Shërbimi Federal i Inteligjencës (Bundesnachrichtendienst) (Gjermania)
- CGI, Coast Guard Intelligence - Shërbimi Informativ i Mbrojtjes Detare;
- CIA, Central Intelligence Agency - Agjensioni Qendror Informativ;
- CIC, Instituti Qëndror për Koordinim (Central Institute for Coordination)
- CIG, Central Intelligence Group - Grupi i Inteligjencës Qendrore;
- CNSS, Komiteti i Sistemeve të Sigurisë Kombëtare (Committee on National Security Systems)
- CRS, Congressional Research Service - Shërbimi Hulumtues në nivel Kongresi;
- CSIS, Qendra për Studime Ndërkombëtare dhe Strategjike (Center for International and Strategic Studies)

- DCAF, Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura – Gjenevë;
- DCI, Director of Central Intelligence - Drejtori i Bashkësisë Informative;
- D-CIA, Drejtori i Agjencisë Qendrore e Inteligjencës;
- DE, Departamenti i Energjisë”Department of Energy” (DE)
- DE, Department of Energy - Departamenti i Energjisë;
- DEA, Drug Enforcement Administration - Administrata për Luftë kundër Narkotikëve;
- DELP, Fronti Demokratik për çlirimin e Palestinës - palestineze;
- DI, Drjetoria për Inteligjencë (Directorate of Intelligence)
- DIA, Agjencia Inteligjente e Mbrojtjes (Defense Intelligence Agency)
- DIA, Defense Intelligence Agency - Agjensioni Informativ i Mbrojtjes;
- DNI, Drejtori i Zbulimit Kombëtar (Director of National Intelligence)
- DS&T, Drejtorja për Shkencë dhe Teknologji (The Directorate of Science and Technology)
- DSH, Departamenti i Shtetit “Department of State” (DS)
- DTHSH, Departamenti i Thesarit të Shtetit “Department of the Treasury (DT)
- DHS, Departamenti i Sigurimit të Atdheut (Department of Homeland Security)
- ELA, Përpjekja revolucionare popullore - greke;
- ELN, Armata Nacional Çlirimtare - Kolumbiane;
- ETA, Euzkadi Ta Askatasuna Basque;
- FAK, Forca të Armatosura të Kosovës
- FARC, Forcat e Armatosura revolucionare të Kolumbisë - kolumbiane;
- FBI, Byroja Federale e Hetimeve (Federal Bureau Investigation) (ShBA)
- FCO, Zyrtarëve të lartë për operacione të rëndësishme (officials for significant operations)
- FPMR/D, Fronti i papajtueshëm patriotik i Manuel Rodriguezit - Çile;
- FSB, Shërbimi Federal i Sigurimit (Federal'naya Sluzhba Bezopasnosti) (Rusia)
- GAP, Institutit për Studime të Avancuara;
- GIA, Grupi i armatosur Islamik - Algjeriane;
- HAMAS, Lëvizja e rezistencës Islamike - Palestineze;
- HAZBULLAH, Partia e Zotit - Libaneze;

- HR, Zyra e Resurseve Njerëzore (Human Resources)
- HUA, Harakat Ul-Ansar – pakistane;
- IG, Gama'a al-Islamiyya (grupi islamik) - egjiptjane;
- IHSOP, Instituti për Hulumtime Strategjike të Opinionit Publik
- ISA, Akti për Shërbimet e Inteligjencës (Intelligence Services Act)
- JRA, Armata e Kuqe Japoneze - japoneze;
- KC, Khane Chai - izraelite;
- KGB, Komitet Gosudarstvennoï Bezopasnosti (Committee for State Security)
- KIA, Kosovo Intelligence Agency;
- KKP, - Komisioni i Kontrollit Parlamentar;
- KPMSHI, Komiteti Parlamentar i Mbikëqyrjës së Shërbimeve Inteligjente
- KR, Khmer Rouge - kamboxhiane;
- KSK, Këshilli i Sigurisë i Kosovës;
- LPA, Departamenti i Psikologjisë dhe Propagandës (Psichologit Lohamah) (Izrael)
- LTTE, Tigrët çlirimtar të Tamil Ealamit - Sri Lanka;
- MAPL, Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal;
- MASHT, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;
- MCU, Marrëdhëniet Civile Ushtarake;
- MEK dhe MKO, Muhaxhidinët e Organizatës Khalaq - Iraniane;
- MF, Ministria e Financave;
- MFSK, Ministria për Forcën e Sigurisë;
- MKMI, Mekanizmi Koordinues Monitorues dhe Implementues;
- MOSSAD, Instituti për Inteligjencë dhe Detyra të Veçanta;
- MPB, Ministria e Punëve të Brendshme;
- MRTA, Lëvizja Revolucionare Tupac Amru;
- NATO, Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior;
- NCS, Shërbimi Nacional – Sekret Klandestin (National Clandestine Service)
- NIST, Departamenti i Institutit Kombëtar të Tregtisë të Standarteve dhe Teknologjisë;
- NKVD, Komisariati Popullor për punë të Brendshme;
- NRO, Zyra Kombëtare për Vëzhgim (National Reconnaissance Office)

- NSA, Agjencia Kombëtare e Sigurisë (National Security Agency)
- OGC, Zyra e Këshillit të Përgjithshëm (Office of General Counsel)
- OJQ, Organizatat Joqeveritare;
- OKB, Organizata e Kombeve të Bashkuara;
- ONI, Shërbimi Informativ i Armatës (Offise of Naval Intelligence)
- OR 17 Nëntori, Organizata Revolucionare - greke;
- OSA-OBA, Agjenci për Sigurim dhe Inteligjencë (e formuar si agjenci e përbashkët serbe-muslimano-kroate të shërbimit të fshehtë) (Bosna dhe Hercegovina)
- OSBE, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë;
- OSS, Zyra për Shërbime Strategjike (Office of Strategic Services)
- PELP, Fronti Popullorë për çlirimin e Palestinës - palestineze;
- PFLP/GC, Fronti popullor për çlirimin e Palestinës - palestineze;
- PIJ, Xhihadi Islamik Palestinez - palestineze;
- PK , Policia e Kosovës;
- PKF, Fronti Çlirimtar Palestinez - palestineze;
- PKK, Partia e punës Kurdistane - kurdistanët turq;
- PKP , Paneli i Kontrollit Parlamentar (Gjermani)
- QKSS, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë;
- RDB, Shërbimi i Sigurisë Shtetërore (Resor Drzavne Bezbednosti)
- SIA , Llogaria e Vetme e Inteligjencës (Single Intelligence Account) (Britania e Madhe)
- SIS, Shërbimit Sekret të Zbulimit (Secret Intelligence Service MI6) (Britania e Madhe)
- SL, Rruga e shkëlqyeshme - Peruviane;
- SOVA, Agjencia Sllovene për Siguri dhe Inteligjencë (Sllovenia)
- ShBA, Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- SHIA, Shërbimi Informativ i Armatës “Office of Naval Intelligence” (ONI)
- SHIBD, Shërbimi Informativ i Mbrojtjes Detare “Coast Guard Intelligence” (CGI)
- SHIFA, Shërbimi Informativ i Forcave Ajrore “Air Force Intelligence” (AFI)
- SHIK, Shërbimi Informativ Kombëtar;
- SHIK, Shërbimi Informativ i Kosovës;
- SHIKM, Shërbimi Informativ i Korpusit të Marinës “Marine Corps Intelligence “(MCI)

- SHISH, Shërbimi Informativ i Shtetit (Shqipëria)
- SHIU, Shërbimi Informativ i Ushtrisë ” Army Intelligence” (AI)
- SHKO / C, Partia popullore revolucionare për çlirim - turke;
- TIK – Sistemet e Teknologjisë Informatike;
- UDB, ish Shërbimi sekret Serb në ish Jugosllavi;
- UN, Global Organizatë për trajtimin e luftës kundër terrorizmit;
- ZKV, Zyra Kombëtare për Vëzhgim “National Reconnaissance Office” (NRO)

MENDIME AUTORIALE PËR KAPITUJ

- **“Kush posedon informatën posedon pushtetin”** (*anonime*).....28
- **“Kundërinteligjenca** nënkupton aftësinë e depërtimit të agjentëve special të kundërzbulimit deri në palcë të inteligjencës kundërshtare¹”44
- **“Komperacioni** në mes agjencive rajonale të inteligjencës dhe sidomos atyre ndërkombëtare, është jo vetëm i ndryshëm në pamje strukturore, por edhe në përmasa dhe peshë globale”.....58
- **“Në demokraci** asnjë fushë e veprimtarisë shtetërore nuk duhet të jetë zonë: “ndalohet hyrja” për Parlamentin, përfshirë sektorin e shërbimeve të fshehta të sigurisë dhe informacionit” (*Hans Born dhe Leigh Lan*).....80
- **“Përplasja midis** “Transparencës dhe sekretit” do të jetë prezent për sa kohë të ekzistojnë në njërin anë “demokracia”, që kërkon llogaridhënie dhe natyra e punës së “*shërbimet inteligjente*” që kërkojnë ruajtjen e sekretit shtetërorë”90
- **“Për Agjensitë e Inteligjencës**, sfida në shek XXI do të mbetet të arrijnë të, parandalojnë, kontrollojnë maksimalisht luftën kundër terrorizmit, edhe ta mënjanëjnë tërësisht mundësinë për tu shfaqur.”.....114
- **“Republika e Kosovës**, është shteti i parë në rajon, i cili ka bërë hapa të mëdhenj dhe sfidues përmes inteligjencës në Luftën Kundër Terrorizmit”.....146
- **“Pikëpamja tradicionale** në shkencë dhe metodat inter-disiplinare të hulumtimit janë dy komponentë komplementare të njëra tjetrës. Puna shkencore mbetet e mangët pa këtë korrelacion metodologjik”.....158
- **“Kombi ynë** duhet të forcojë aftësitë inteligjente të shërbimeve tona të specializuara kundërinteligjente, që të mos na përsëritet HISTORIA e dhimbshme qindra vjeçare”.225

¹ **Shënim:** MENDIMET AUTORIALE PËR KAPITUJ i referohen disa autorëve të huaj, me citim poshtë thënjes; Emri – emrat e autorëve, ose (anonim), ndërsa mendimet pa shënim janë autoriale.

LISTA E AUTORËVE TË HUAJ

- Abram N. Shulsky
- Alan Colins
- Albert Jongman
- Alex Schmid
- Ali Khan
- Barry Buzan
- Brian Jenkins
- Christian Hippner
- Christopher Coker
- Duvenage, Petrus
- Ehrman, John
- Elisabet Ivs
- Eraldo Meçalla
- Eric Herring
- Graham Elison
- Uilliam Tobej
- Hal Lindsey
- Hoy Claire
- Hans Born
- Henry Prunckun
- Jan van Helsing
- James Angelton
- Jerome Mellon
- John Gilchrist
- John Sullivan
- Jonathan Matusitz
- Liqen K. Johnson
- Marina Caparini
- Mervin Hiskett
- Michael Warner
- Mirsad Abazoviq
- Muhamed Aziz Shukri
- Peter Gill
- Ramo Masllesha
- Robert A. Morey
- Samuel P. Hungtington
- Sergej Nechayev
- Sherman Kent
- Sten A.Taylor
- Steven Boraz
- Thomas Bruneau
- Viktor Kaparov
- Viktor Ostrovski
- Walter Laqueur

HYRJE

Në këtë punim disertacioni me tezë: ***“Konteksti i shërbimeve Inteligjente në politikat bashkëkohore të Sigurisë”***, paraqitet një shumësi të dhënash të vlefshme lidhur me përmbajtjen e një teze të doktoraturës, dhe elementeve kryesore përmbajtjesore që ka në fokus ky studim.

Teza kryesore e analizës hulumtuese që ka në trajtesë ky disertacion ka të bëjë me fushën e shkencave politike, e posaçërisht me theks të veçantë, njërën nga shtyllat, aspektet e politikave të sigurisë dhe inteligjencës në trendët e njohjes së zhvillimeve të sfidave të sigurisë – shërbimeve të inteligjencës tradicionale dhe transnacionale, përbën thelbin e këtij hulumtimi.

Të trajtosh materie komplekse siç është parimi i nënshtrimit të shërbimeve inteligjente nga demokracia është tejte i vështirë. Është përthyerje midis konceptit të demokracisë që të jesh i hapur dhe transparent, ndërsa logjika e shërbimeve inteligjente në koncept është të jesh i mbyllur dhe sekret.

Shkencat politike, përkatësisht qasja akademike në politikat e sigurisë dhe inteligjencës, nuk fokusohet vetëm në politikat publike, përkatësisht në studimin dhe shpjegimin e rasteve të caktuara, që përbënë vetëm analizën e ngushtë sektoriale, por problematika, sidomos ajo e rolit të shërbimeve inteligjente në kontekstin bashkëkohorë të sigurisë, në trendët e sotme të sfidave dhe zhvillimeve të hovshme teknike dhe teknologjike, lidhur me këto politika të sigurisë nacionale. Konceptet mbi Inteligjencën në sigurinë bashkëkohore, përbënë pothuajse një materie mjaftë komplekse, të patejkalueshme dhe shumë disiplinave.

Mbi këto këndvështrime, i vetëdijshëm për peshën e thellë të kësaj fushe specifike në studimet tona, dhe për faktin e vijimësisë paraprake akademike, jo rastësisht jam fokusuar së vazhduari në hulumtimin dhe plotësimin e kësaj fushe mjaft specifike. Me një zellshmëri i’u kemi rrekur studimit të këtyre fenomeneve sa aq abstrakte po aq edhe konkrete në kontekst të sigurisë nacionale dhe globale në kontekstin bashkëkohorë të sigurisë.

Aspekti i definimit të fenomenit rreth rolit të shërbimeve Inteligjente në kontekst, të koncepteve bashkëkohore të sigurisë, ka të bëjë pikërisht në hulumtimin dhe analizën empirike për të ofruar definime dhe qasje sa më qartësuese.

Tradicionalisht kjo fushë e studimeve është trajtuar me nocione teorike pothuajse mistike për nga qasja reale që është konsideruar dhe që akceptohet si një ndër komponentët më të rëndësishëm të sigurisë për shtetin që në kohët e hershme e posaçërisht në epokën e teknologjisë.

Në këndvështrimet e kohëve moderne, shërbimet inteligjente janë bërë pjesë gjenetike, jetike dhe e pandashme e elitave për politikën e sigurisë kombëtare e ndërkombëtare dhe nevojës ndaj politikave parandaluese të sigurisë. Këto politika kanë vazhduar së evoluuari si në burime njerëzore, përshtatje në ligjshmëri, përsosje në teknik dhe teknologji të lartë në të gjithë hapësirën e komunitetit inteligjent vendor e ndërkombëtare.

QASJA KONCEPTUALE

Kur i referohemi koncepteve bashkëkohore, që ofrojnë qasje konceptuale në kuadër të krahasimit të teorive, që është provuar së shpjeguari prej kohësh këto fenomene të kësaj teze disertacioni, lehtësisht kuptohet për një gamë të gjerë autorësh, aktorësh dhe faktorësh, të jashtëm apo të brendshëm, të koncepteve të ndryshme të politikave nacionale të sigurisë, e që kanë ndodhur si rezultat i tranzicionit të shkuar, të këtyre aktorëve shtetëror dhe jashtë saj në përgjithësi në botë, dhe posaçërisht edhe në shtetin e Kosovës.

Institucioni i AKI –së, si një prej aktorëve më elitarë dhe me më ndikim në fushën e sigurisë nacionale, siç do të trajtohet me mjaftë kujdes në trajtesën time, do ti kushtohet një vëmendje e posaçme empirike. Me këtë koncept pragmatik, me një qasje shkencore kreative, kuptohet një bashkërendim i metodave të studimit, të teorive dhe teknikave tjera përcjellëse, të cilat mëtohet të përdoren gjatë studimit tim të doktoratës.

Fakti, që të kuptohet në vazhdimësi perceptimi i drejtë se edhe shërbimi inteligjent, me theks të veçantë ai i yni, i një shteti të ri dhe në konsolidim të gjithëmbarshtëm; Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), është parakusht i zhvillimit të demokracisë rendit dhe ligjit, ofrimit të sigurisë për shoqërinë dhe shtetin, në tërësi në të gjitha dimensionet politike, të sigurisë, socio-ekonomike, kulturore, fetare e deri te aspektet e kujdesit shëndetësor dhe të ekologjisë etj, të ketë rolin e saj mjaftueshëm të kuptueshëm.

Shteti ynë, Republika e Kosovës me demokracinë më të re parlamentare, tani më ka krijuar bazën ligjore të sektorit të sigurisë, dhe edhe në dokumentet strategjike, e sidomos në ligjet bazike, me prioritet ka vënë rolin e AKI –së në bazë të një ligji modern në përputhshmëri me politikat e sigurisë dhe partnerëve përkatës të zbatimit të saj.

KONTEKSTI KOHOR

Ndërlíkueshmëria e misionit të shërbimeve inteligjente në kontekstin kohorë ka tendencë të ngecë në disa drejtime: E para mosnjohja e mirëfilltë empirike e misionit dhe punës që bëjnë ato; Së dyti elementi i vigjilencës në kushtet e ngjarjeve të pasigurisë në trendët e përshkallëzimit pas 11 shtatorit (të sulmeve terroriste në ShBA), lidhur me parandalimin e hershëm të rreziqeve, dhe elementi i tretë i referohet shkallës së transparencës ligjore lidhur me operacionet e “autorizuara” në aspektin e kontrollueshmërisë së tyre, pra në monitorimin lidhur me mos tejkalimin e kompetencave ligjore. Në princip kjo vlen për të gjitha llojet e shërbimeve inteligjente, sigurisht se vlen më shumë për shërbimet e reja, por edhe tek ato me traditë, ngase edhe përparësitë, por edhe dobësitë ju takojnë veprimeve të tyre, ndërsa edhe te ne nuk mund të përjashtohet mundësia e tejkalimit të autorizimeve ligjore. prandaj Shërbimi ynë inteligjent (AKI) paralelisht ka disa sfida themelore që janë trajtuar në këtë punim dhe që do të nxirren në përfundime rekomandimeve të qëndrueshme në kontekstin teorik të përkufizimit empirik.

Konceptimi i tezës në këtë disertacion është menduar pothuajse në të gjitha dimensionet e shtrimit si problem për hulumtim dhe analizë të kësaj materie. Megjithatë, duket se ka gjasë të jetë shumë më komplekse dhe gjithëpërfshirëse se sa nga pikënisja, i gjerë dhe i thellë për nga tërësia e qasjes teorike dhe praktikave komperative në shoqëritë demokratike.

KOORDINIMI ME MENTORIN

Bashkërisht me mentorin tim të doktoratës; **Prof Dr.sc. Fadil Zendeli**, gjatë fazave të mentorimit ju kemi rrekur me seriozitet punës kërkimore rreth aspekteve teorike për analizën dhe krahasimin, mbi nocionet dhe praktikën, duke ofruar një format të ri empirik, dhe një qasje të thellë studimore, që nuk ka ekzistuar më parë në këtë fushë në gjuhën shqipe.

Një reflektim i shkëlqyeshëm në këtë hulumtim, është edhe bashkëpunimi me mentorët pararendës siç janë; **Prof. Dr. Bejtush Gashi** dhe **Prof. Dr. Bekim Baliqi**, të cilët e kanë përcjell - mentoruar në dy nivelet paraprake rrugëtimin tim akademik mbi këtë fushë studimi.

Një falënderim i posaçëm iu dedikohet edhe profesorëve të nderuar **Prof Dr. Jonuz Abdullahu**, **Prof Dr. Ylber Sela**, **Prof. Dr Ali Pajaziti** dhe **Prof. Dr. Hasan Jashari**, etj për gatishmërinë e bashkëpunimit shkencor dhe ligjëratave gjatë studimeve në Master dhe PhD.

KONTEKSTI PËRMBAJTSOR

Edhe në kontekstin përmbajtjesorë ky studim disertacioni nuk trajton njëtrajtshëm vetëm aspektet teorike dhe praktikën, që esencialisht i atribuohen kësaj fushe të studimit në përgjithësi dhe në veçanti AKI –së si një institucion i rëndësishëm të veçantë në sektorin e sigurisë në Kosovë.

Elaborimi përmbajtjesor dhe ofrimi i argumenteve besoj se do të arrijë të përmbushë këtë zbatim në këtë fushë dhe të plotësojë nevojën e njohës, që sa më për së afërmi të njohim logjikën dhe aspektin ligjor të rolit të shërbimeve inteligjente në shoqëritë demokratike që do të trajtohen në dy nivele të analizës, atë rajonale dhe globale, dhe me theks të veçantë AKI –në.

Natyrisht se për konsolidimin e një teze disertacioni, të kësaj fushe kaq specifike, kërkohet edhe një konsulentë e gjerë mendimesh, titujsh dhe autorësh, një elaborat i thellë njohurish praktike e profesionale, si dhe njohuri të veçanta në fushën e sigurisë dhe të shërbimeve inteligjente. Kjo tezë doktrate, konsideroj të jetë e rëndësishme së veçantë akademike, për shkak të përmasave të njohurive që janë sjell në hulumtim, të dimensioneve dhe ndërlikueshmërisë së trajtimit në të gjithë elementët e saj mjaftë kompleks dhe specifik, të pasqyrimin sa më të qëndrueshmen në aspektin akademik.

Me këtë disertacion është synuar, që të ofrojmë njohuri teorike dhe praktike themelore për mënyrën e përcaktimit të rolit të shërbimeve inteligjente në shoqëritë demokratike në kontekstin bashkëkohorë të politikave të sigurisë, të aspekteve ligjore dhe të llogaridhënies. Në fakt e gjithë rëndësia, pesha e përthyerjeve të interesave kombëtare që kanë padyshim këto shërbime, konsiston në domethënien që këto shërbime të sjellin produkte, analiza analitike inteligjente për konceptin e sigurisë në raport me politikat shtetërore e publike.

Përfitimet konsistojnë në përvojat që ne do të përpiqemi të ofrojmë për praktikën me të mira të krijimit, funksionalizimit dhe operacionalizimit të rolit të shërbimeve inteligjente në zbulim dhe parandalim dhe në ofrimin e analizave të mençura për sigurinë kombëtare dhe tej kombëtare.

ELEMENTET E ORGANIZIMIT / KONTEKSTI STUDIMOR

Përcaktimi dhe formulimi i disertacionit me tezë: *“Konteksti i shërbimeve Inteligjente në politikat bashkëkohore të Sigurisë”*, përkatësisht hulumtimi në sektorin e shërbimeve të inteligjencës dhe komuniteteve të tyre është një fushë relativisht të re në studimet tona në përgjithësi dhe mjaftë sfiduese. Kjo ndodhë për shkak të qasjes së kufizuar, mosnjohjes së peshës dhe mungesa e burimeve empirike. Sa i përket AKI – së, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, si institucion ka ngjallur kureshtje, që edhe kësaj fushe ti qasemi në mënyrë akademike, që studiuesve të ardhshëm dhe vet sektorit të sigurisë ti lëmë një studim të mirëfilltë shkencor, duke u bazuar në të dhëna primare dhe sekondare.

Ky disertacion shkencor, konsideroj se do të jetë me dobi për institucionin, shkencën, studiuesit, dhe të interesuarit e shoqërisë civile. Sikurse mungesa e punimeve hulumtuese, pragmatike, publikimeve empirike dhe literaturës së mangët ndaj këtij problemi në gjuhën shqipe, do të paraqes shtytje dhe referencë për hulumtime të avancuara të së njëjtës fushë.

Mungesa e qasjes studimore ndaj kësaj fushe, sidomos rreth aspektit të kontrollit demokratik, të kontrollueshmërisë së punës së Shërbimeve Inteligjente në kohët e fundit paraqesin domosdoshmërinë për marrjen e masave adekuata siç parashihen në bazë të ligjit themeltarë.

Mendoj që ky disertacion, do të rritë pa dyshim nivelin e të kuptuarit akademik të rolit në kontekstin e shërbimeve inteligjente në politikat bashkëkohore të sigurisë, kontekst ky gjithnjë e më i ndërlikuar midis ruajtjes së sekretit dhe transparencës në shoqëritë tona.

Po ashtu mendojmë që institucionet akademike dhe ato të sigurisë në Republikën e Kosovës, institucionet si: Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (ASHAK), Universiteti i Prishtinës (UP), dhe Kolegjet Private (KP) arsimore, studentët konkretisht, fushat në lëmin e lëndëve të politikave të sigurisë dhe inteligjencës, e po ashtu edhe Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), që në thelb, ky studim doktrate ka trajtuar me mjaft përkushtim do ta mirëpresin këtë punë shkencore dhe do ti referohet rekomandimeve përfundimtare.

FORMA STRUKTURE

Teza e këtij disertacioni në aspektin përmbajtjesorë përbëhet sipas kësaj strukture aplikative: Fillohet me *abstrakt, hyrje, shkurtesa dhe akronike, shtatë pjesë kryesore, nën pjesë plotësuese, një aneks tabelorë, Pyetësor, Shqyrtime përfundimtare, konkluzione - rekomandime si dhe bibliografia e zgjeruar në gjuhën angleze dhe shqipe*. Të gjitha këto trajtesa janë të shkruara me metodologji dhe standarde të kërkuara për shkrimin e një teze të doktoratës.

Lënda e hulumtimit si tërësi ka analizuar së shkruari veç e veç shtatë kapitujt, duke filluar nga njohjet teorike rreth praktikave dhe rolit të shërbimeve inteligjente, pastaj (konteksti historik, konteksti kohor, sfidat, aspekti ligjor, aspektin përkufizues, nocionet, autorët, llojet dhe mënyrat, disiplinat, krahasimet në dy nivele, atë rajonal dhe global etj.

SUPOZIMET THEMELORE - HIPOTEZAT

Ky disertacion ka provuar ti vërteton tri hipoteza kryesore të ngritura:

Hipoteza e parë:

- Zbatimi i ligjshmërisë dhe bashkëpunimi intra- dhe ndërkombëtar rrit mundësinë e perceptimit të jashtëm dhe brendshëm si dhe njohjes së natyrës së veprimeve të shërbimeve inteligjente.
Është arritur të vërtetohet.

Hipoteza e dytë:

- Operacionalizimi funksional i bazuar në selektim profesional dhe ritrajnimit të kuadrit ndikon në zbatimin e plotë të detyrave kushtetuese - ligjore të AKI-së.
Është arritur të vërtetohet.

Hipoteza e tretë:

- Funksionimi demokratik dhe efikas i shërbimeve inteligjente është komponent thelbësor në zbatimin e politikave bashkëkohore të sigurisë.
Është arritur të vërtetohet.

Hipoteza e veçantë:

- Sfidat e luftës kundër terrorizmit dhe specifikisht mbikëqyrja dhe kontrolli demokratik parlamentar i shërbimeve inteligjente, garanton siguri në parandalimin e tejkalimeve të autorizimeve ligjore.
Është arritur të vërtetohet.

Hipoteza ndihmëse;

- Mbikëqyrja parlamentare rrit efikasitetin e shërbimeve inteligjente.
- Mungesa e mbikëqyrjes së mirëfilltë demokratike të shërbimeve inteligjente rrit shkallën e pasigurisë kombëtare.

- Forcimi i masave në parandalimin e tejkalimit të autorizimeve nga zyrtarët – agjentët e shërbimeve inteligjente – optimalizon punën e shërbimeve inteligjente.

Është arritur të vërtetohet.

METODOLOGJIA

Hulumtimi është realizuar sipas aplikimit të disa metodave të metodologjisë të studimit në mënyrë aktive që rezultati i arritur përfundimtarë të jetë sa më i argumentueshëm. Studimi kryesisht është bazuar në vlerësimin e literaturës nga aspekti teorik, botime, raporte dhe të dhëna nga institute dhe agjenci si AKI, SHISH, CIA, MOSAD, SIS, FSB, MIT, SOVA, BIA, OSCE, GAP, KCSS, KIPRED, nga Kosova dhe DICAF nga Gjeneva, Forumi për Studime të Inteligjencës dhe të Sigurisë (versioni elektronik) etj. Gjithashtu janë përdorë mënyra të vazhdueshme të analizës komperative. Gjatë hulumtimit po ashtu janë përdorë edhe teknikat e ndryshme të intervistimit përmes pyetësorëve (versioni elektronik), të bisedave me përfaqësues brenda institucionit dhe jashtë saj. Në rrugën hulumtuese janë përdorë gjithashtu edhe metoda përshkruese, e analizës dhe të sintezës, metoda krahasuese, në të dhënat kryesisht sekondare me metodën e deduksionit dhe induksionit si dhe metodën normative. Me metodën e dytë (sekondare), duke studiuar dhe hulumtuar, literaturë të botuar në gjuhën shqipe dhe angleze si dhe faqe zyrtare të internetit, ekskluzivisht të dedikuara shërbimeve inteligjente ku janë nxjerrë të dhëna të vlefshme për argumentime të qëndrueshme.

“Kush posedon informatën posedon pushtetin”.
(Anonim)

KAPITULLI I PARË

KËNDVËSHTRIME TEORIKE RRETH ROLIT DHE MISIONIT TË SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS

1.1 Aspekte teorike të përkufizimit dhe zhvillimit të Shërbimeve të Inteligjencës	29
1.2 Njohje rreth konceptit dhe praktikave të Shërbimeve Inteligjente	32
1.3 Llojet dhe mënyrat e Shërbimeve Inteligjente.....	35
1.3.1 Shërbimi i brendshëm Inteligjent.....	36
1.3.2 Shërbimi jashtëm i inteligjencës	36
1.3.3 Shërbimi inteligjent i krimeve	36
1.3.4 Shërbimi inteligjent ushtarak	36
1.3.5 Metodologjia e Shërbimeve Inteligjente.....	37
1.3.6 Praktika themelore të funksionimit të Shërbimeve të Inteligjencës.....	38
1.3.7 Legjislacioni që kërkohet për funksionimin e shërbimeve të inteligjencës.....	39
1.3.8 Disiplinat e grumbullimit të inteligjencës.....	43

KAPITULLI I PARË
KËNDVËSHTRIME TEORIKE RRETH ROLIT
DHE MISIONIT TË SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS

1.1.Aspekte teorike të përkufizimit dhe zhvillimit të Shërbimeve të Inteligjencës

Sipas logjikës së zakonshme, dikur kur mendohej për veprimtaritë e shërbimeve të fshehta të Inteligjencës, zakonisht përpara mendimit tonë na paraqiteshin disa grupe apo disa tipa njerëzish të mistershëm, apo organizata fantome që futem fshehurazi kudo dhe në çdo vend dhe frikësojnë gjithandej. Ky mendim shumë herë ka krijuar botëkuptimin jo real rreth përkufizimit negativ ndaj Shërbimeve Inteligjente, nga ku duhet larguar në një distancë sa më të largët prej tyre. Si një botëkuptim abstrakt, ky lloj aktiviteti nga pamja e jashtme edhe mund të duket si i tillë. Në fakt në dukje të parë edhe mund të perceptohet dhe të reflektoj si i tillë, ku parafytyrohet me një mendim jo të mirë në vetvete, ku zakonisht të menduarit e tillë ka kuptim negativ.² Kjo periudhë zakonisht i referohet kohëve klasike, kur mendimi për Shërbimet Inteligjente ka prodhuar frikë dhe pasiguri tek shoqëritë e atëhershme primitive.

Një numër autorësh në vend të parë vejnë domethënien pragmatike dhe pozitive të shërbimeve informative, duke anashkaluar kushtet ekonomikore shoqërore, shfaqjes së tyre dhe organizimit fillestar. Caku i tyre kryesor është i orientuar në prezantimin e të dhënave mbi ekzistimin shumëvjeçar të shërbimeve informative. Në përgjithësi këtë qasje mund ta quajmë historike duke marrë parasysh se gjatë elaborimit të informatave relevante, nuk mund të vërejmë se ato bazohen në premisa shkencore. Kuptimi sekondar është teologjik. Këto ishin tentime që gjeneza e saj ndërlidhet me biblën.³ Në studimin e këtij fenomeni, disa autorë siç është **Sherman Kent**⁴, shërbimin informativ e ndërlidhin në korelacion me informimin, madje edhe ia dedikon atë rol. Pra, detyra është mbledhja e informatave, sistemimi i tyre dhe prezantimi te të interesuarit.⁵

² DCAF, [Online] Marrë nga: www.dcaf.ch/serviceengine/Files/.../Presentation_Kalman_Kocsis.pdf / INTRODUCTION ON THE ROLE OF INTELLIGENCE SERVICES. INFORMATION GATHERING.

³ Ramo Masllesha, Teoritë dhe Sistemet e Sigurisë, versioni PDF, faqe 83

⁴ Sherman Kent and the Profession of Intelligence Analysis, [Online] Marrë nga: <https://www.cia.gov/library/kent-center-occasional-papers/vol1no5.htm>

⁵ Po aty, faqe 83

Sot në botë ekzistojnë shumë përkufizime teorike, autorësh dhe praktika demokratike, që flasin me shumë pozitivitet rreth botës së shërbimeve të inteligjencës. Në këtë aspekt për qëllimet tona të sigurisë dhe inteligjencës ne do të përdorim disa qasje dhe autorë më me ndikim të fushës për të arritur deri tek objektivi ynë i konceptuar për të kuptuar sa më drejt rreth aspekteve përkufizuese, njohjes reale, llojeve, praktikave dhe disiplinave të Shërbimeve Inteligjente.

Sipas një përkufizimi teorik: *“Një sistem është më inteligjent në qoftë se arrin objektivat e saj sa më shpejtë dhe sa më lehtë. Kjo përfshinë aftësinë për të mësuar për ta bërë këtë”*.⁶

Sipas autorëve **Barry Buzan** dhe **Eric Herring**, është rënë dakord në vazhdimësi të synohet që studiues dhe student jo vetëm në studimet strategjike, por domosdoshmërisht për funksionimin e shtetit dhe të shoqërisë të arrihet *Krijimi i Sistemit të Sigurisë Nacionale (KSSN)*, duke iu reflektuar mekanizmave ligjor me të cilat implementohet siguria e brendshme dhe ajo e jashtme.⁷

Në botën moderne akoma ekzistojnë supozime se funksionet, rolet dhe misionet e organizatave të shërbimit të fshehtë nuk janë në pajtueshmëri të plotë me tiparet themelore ndërkombëtare dhe nuk mund të kategorizohen si të tilla. Në fakt studiues të shërbimit të fshehtë, siç është edhe autori **Ligen K. Johnson**, i cili argumenton të kundërtën në këtë pikë, duke thënë se e përbashkëta e tipareve themelore gjenden në të gjitha konceptet e inteligjencës kombëtare.

Sipas **Johnson**, ekzistojnë tre veprimtari themelore të këtyre subjekteve qeveritare, në *Mbledhjen dhe Analizimin; Veprim të fshehtë; dhe Kundërzbulim*.⁸

Ai po ashtu argumenton se këto tre aktivitete gjenden në mënyrë universale në të gjitha sistemet e inteligjencës kombëtare, pa marrë parasysh mjedisin e sigurisë përreth vendit.

Ky pozicion parimesh duken të përmbledhura edhe në veprat e **Marina Caparini**, ku teoricientja mbi reformën në sektorin e sigurisë, thotë; se "Brenda Qeverisë dhe Shërbimit të fshehtë – Inteligjent, përkufizohen katër përbërës, aktivitetet kryesore të së cilës janë: *“Të fshehtën e veprimit në: Mbledhjen, Analizën, Vlerësimet dhe Kundërzbulimin”*.⁹

⁶Intelligent Systems,[Online] Marrë nga:<http://intelligent-systems.com.ar/intsys/whaisint.htm>

⁷**Buzan Barry** and **Herring Eric**, *The Arms dynamic in World Politics*. Lynne Rienner Publishers, London, 1998, preface, page xi

⁸Loch Johnson, “Bricks and Mortar for a Theory of Intelligence,” *Comparative Strategy*. 22, no. 1 (2003)

⁹**Caparini Marina**, “Controlling and Overseeing Intelligence Services in Democratic States,” in *Democratic Control of Intelligence Services: Containing Rogue Elephant*, ed. Hans Born and Marina Caparini (England: Ashgate, 2007)

Sipas një numri autorësh, “Shërbimi Informativ apo Inteligjent, është organ shtetëror, i cili e ka si detyrë themelore që të informon mbi fshehtësitë e kundërshtarit”.¹⁰

Qasja konceptuale të shumica e autorëve modern, tani, është tendencë e përqendrimit në çështjen e mbikëqyrjes, kontrollit demokratik ndaj Shërbimeve Inteligjente, si dhe rëndësinë e pas 9 / 11, është pohimi i **Johnson’s** në aspektin kuantitativ. Pohimi i tij nuk është vetëm sasiorë, por i lirë nga tendencakulturore. Pjesa e ardhshme pason me shqyrtime krahasuese në studimet ekzistuese të inteligjencës, të cilat janë kryesisht cilësore në ambient.¹¹

Në studimet përkufizuese të Inteligjencës ka disa mënyra ekzistuese të studimeve krahasuese të përshkuara në sistemet e ndryshme të shërbimit Inteligjentë. Sipas autorit **Christian Hippner** ekzistojnë tre koncepte themelore; Së pari përshkruan: *Shërbimin e fshehtë në kontekstin e Luftës së Ftohtë, në pjesën e dytë përshkruan shërbimin e fshehtë përmes lentave -Ushtarake në Marrëdhëniet Civile (MCU) si model, dhe pjesën e tretë përshkruan shërbimin e fshehtë nga perspektiva jo-perëndimore*. Këto aspekte të përbashkëta ekzistojnë në të tre konceptet, me një fjalë të gjithë autorët mendojnë të përdorin një format studimi dhe rast për të krahasuar sistemet e shërbimit të fshehtë.¹²

Për të argumentuar më shumë këto tre koncepte po japim një shembull, të shkruar në vitin 1985 nga teoricieni dhe autori i asaj kohe **Walter Laqueur** në veprën e tij me titull “*Një botë e fshehtë në kufijtë e limituar të inteligjencës*”. Autori **Walteri** krahason sistemet e zbulimit në “Shoqëritë e Hapura” Perëndimore dhe në “Shoqëritë e Mbyllura” të izoluara komuniste të Bashkimit Sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë.

Ai i krahason këto subjekte për të identifikuar dallimet midis botës perëndimore dhe bllokut sovjetik. Sipas **Walter** Shërbimet e Fshehta në shoqëritë e hapura kanë tendencë të përqendrohen në marrëdhëniet në mes prodhuesve dhe konsumatorëve si vendet në Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Gjermanisë, dhe Izraelit.¹³

¹⁰ **Abazoviq, Mirsad** SIGURIA NACIONALE/ FSK/S – 05/06, PRISHTINË, 2006, faqe 70

¹¹Department of intelligence studies mercyhurst college erie, Pennsylvania **A study into the size of the world’s intelligence industry** a page 7. Thesis, Submitted to the Faculty of Mercyhurst College In Partial Fulfillment of the Requirements for The Degree of MASTER OF SCIENCE IN APPLIED INTELLIGENCE Submitted By **Christian Hippner** October 2009 Copyright © 2009 by Christian Hippner,

¹²Po aty

¹³**Walter Laqueur**, *A World of Secrets: The Uses and Limits of Intelligence* (New York: Basic Books, 1985), 201-251.

Ekzistojnë edhe dy autorë që trajtojnë pikëpamjet të rregullimit ligjor mbi kontrollin demokratik ndaj Shërbimeve Inteligjente. Sipas këtyre autorëve, **Steven Boraz** dhe **Thomas Bruneau**, koncepti bashkëkohorë konsiston në një mbikëqyrje të preferuar duke përdorur mekanizmat nga organet qeveritare, që është përmbledhje edhe e buxhetit dhe një kontroll civil demokratik, i cili është i mundur duke i dhënë mbikëqyrjen autoriteti ligjor në ekzekutiv, legjislativ, ose degët e pushtetit gjyqësor.¹⁴ Pra gjithnjë sipas këtyre autorëve ekzistojnë praktika të ligjshme mbi tri kategori pushtetesh: *Ekzekutivi, Legjislativi dhe Gjyqësori*.

Duke dashur të përfundojmë me disa nga këto përkufizime për të trajtuar edhe aspektin buxhetor në dimensionet dhe rolin e shërbimeve inteligjente në shoqëritë demokratike po përmendim edhe mendimin e autorit **Michael Warner**, i cili thotë; *"Si brenda dhe jashtë, studiues të ndryshëm kanë kërkuar për të krahasuar disa aspekte të disiplinave të zbulimit dhe të gjitha organizatat kombëtare kanë përvoja të shumta në periudha kohore. Për fat të keq, kjo nuk është ende e mundur për të bërë në mënyrë sistematike"*¹⁵ Me një fjalë sipas **Warner** nuk ka studime gjithëpërfshirëse të analizuara për shpenzimet totale në botë rreth organizatave të shërbimit të fshehtë e që janë të ndryshme dhe jo kredibile.

1.2 Njohje rreth konceptit dhe praktikave të shërbimit Inteligjente

Në vijim do të mundohemi të paraqesim disa praktika , duke iu referuar Qendrës së Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF)¹⁶ për të dhënë njohje pragmatike, nga ku përpqemi të arrihet një shkallë e të mësuarit më shumë lidhur mbi qasjet dhe praktikat e shërbimeve inteligjente. Në këtë aspekt do të mundohemi ti sqarojmë disa aspekte themelore:

¹⁴**Steven Boraz and Thomas Bruneau**, "Best Practices: Balancing Democracy and Effectiveness," in *Reforming Intelligence: Obstacles to Democratic Control and Effectiveness*, ed. Thomas Bruneau and Steven Boraz (Austin, Texas: University of Texas Press, 2007), 331.¹⁴

¹⁵**Michael Warner**, "Sources and Methods for the Study of Intelligence," in *Handbook of Intelligence Studies*, ed. Lock K. Johnson (London and New York: Routledge, 2007), 25.

¹⁶ DCAF,[Online] Marrë nga:www.dcaf.ch Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) promovon qeverisje të mirë dhe reformat të sektorit të sigurisë. Qendra drejton hulumtime në praktika të mira, inkurajon zhvillimin e normave të mirëfillta në nivelet nacionale dhe ndërkombëtare, bene rekomandime të politikave dhe siguron këshillabrendashtetit dhe programe zhvillimi. Partneret e DCAF përfshijnë qeveritë, parlamente, shoqëri civile, organizata ndërkombëtare dhe një vrange i aktoreve të sektorit të sigurisë sikurse policia, gjyqësori, agjencitë e zbulimit, shërbimet e sigurisë kufitare dhe ushtri.

Fillimisht termi **Inteligjencë**¹⁷ i referohet shkallës së vetëdijësimit dhe të kuptuarit që ka një shtet për mjedisin e tij strategjik duke u bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave sekrete apo publike.

Në thelb, qëllimi i *Shërbimeve të Inteligjencës* në kuadër të institucioneve shtetërore, është që të mbledhë, hulumtojë dhe prodhojnë analiza të duhura në fusha relevante që ndërlidhen me sigurinë kombëtare, dhe janë të gatshme gjithnjë të veprojnë;

- ❖ *Të japin paralajmërime të hershme lidhur me krizat e mundshme;*
- ❖ *Të shërbejnë menaxhimit të krizave kombëtare dhe ndërkombëtare duke ndihmuar në qartësimin e qëllimeve të armiqve të tanishëm dhe të atyre potencial;*
- ❖ *Të informojnë me qëllim të planifikimit të mbrojtjes dhe operacioneve ushtarake kombëtare;*
- ❖ *Të mbrojnë sekretet si të burimeve ashtu edhe të aktiviteteve të tyre dhe të agjencive të tjera shtetërore; dhe*
- ❖ *Të mund të veprojnë fshehurazi për të ndikuar në rezultatin e ngjarjeve në të mirë të interesit kombëtar.*

Përgjithësisht aktivitetet e shërbimeve të inteligjencës konsistojnë në qasje të informacionit dhe mbledhjen e të dhënave si dhe analiza e tyre.

Kjo nënkupton përdorimin e burimeve të hapura, dhe burimeve të fshehta siç janë spiunët, agjentët dhe **b a s h k ë p u n ë t o r ë t**. Analiza është skanimi dhe verifikimi i të dhënave dhe shndërrimi i tyre në produkte inteligjente të cilat iu ndihmojnë vendimmarrësve duke iu ofruar atyre informata relevante dhe të vërteta të cilat kanë si qëllim sqarimin e situatave dhe çështjeve komplekset e shërbimeve të inteligjencë në sfondin e **z b u l i m i t** dhe **k u n d ë r z b u l i m i t**¹⁸

Disa vende gjithashtu i praktikojnë edhe veprimet e fshehta. Kjo ka të bëjë më ndikimin e drejtpërdrejtë në **Politikë të Jashtme; Ushtri** apo edhe **kushtet Ekonomike** pa qenë nevoja që ky ndikim të jetë i varur nga shteti. Veprimi i fshehtë është një opsion i kufizuar ushtarak i cili

¹⁷ Ky term përzgjidhet në gjuhën shqipe, përkundërt termit “shërbime sekrete” për ti qëndruar besnik kuptimit parësor të tij në gjuhën angleze, duke qenë të vetëdijshëm për dykuptimësinë e tij në shqip. (Shënim i përkthimit) marrë nga libri i autorit **ALAN COLINS** “Studime bashkëkohore të sigurisë” përkthim nga Enri Hide, kapitulli 14: Roli i shërbimeve të intelegjencës në sigurinë kombëtare, nga Sten A.Taylor.

¹⁸ **Kundërzbulimi**, zakonisht përqendrohet në parandalimin e shërbimeve të huaja të inteligjencës apo të grupeve të huaja të kontrolluara për të bërë spiunim, rebelim dhe sabotim kundër shtetit. Kjo konsiston në masa mbrojtëse, siç janë hetimet, inspektimet, vëzhgimet dhe masat e rrepta si ndërmarrja e operacioneve për të depërtuar në këto organizata, mashtruar, përçarë, si dhe manipuluar ato.[Online] Marrë nga: www.dcaf.ch


ndërmerret për të arritur ato objektiva të cilat nuk mund të arrihen përmes diplomacisë dhe metodave të tjera. Në shumicën e demokracive të cilat kanë agjenci të inteligjencës të ndryshme, veprimet e fshehta bëhen vetëm nga agjencitë e jashtme të inteligjencës.

Sigurimi i të dhënave inteligjente? Inteligjenca arrihet nëpërmes pesë fazave të procesit: planifikimit, mbledhjes së të dhënave, përpunimit, analizës dhe prodhimit, si dhe shpërndarjes.

Planifikimi ka të bëjë me menaxhimin e gjithë përpjekjeve për të prodhuar inteligjencën, duke përfshirë: Kërkesa specifike inteligjente nga ekzekutivi, legjislativi, apo edhe nga vet agjencia; Definimin e të dhënave relevante të nevojshme; Prioritizimin e çështjeve; dhe Identifikimin e akterëve shtetëror dhe jo shtetëror të cilët autorizojnë vëzhgimin.

Mbledhja është grumbullimi i informatave duke përdorur metoda të tilla siç janë: Burimet e hapura inteligjente — mbledhja e informatave që janë të arritshme në mënyrë të hapur, si ato që janë bërë nga mediet apo shkrimet akademike;

FIGURA NR. 1 DISIPLINAT KRYESORE TË INTELIGJENCËS



Në kuadër të punës së Shërbimeve Inteligjente ekzistojnë disa disiplina, prej tyre dy jsnë më tradicionale: **(HUMINT)**¹⁹ **Inteligjenca njerëzore** apo **humane** informatat e mbledhura nga agjentët, të rekrutuarit e infiltruar, diplomatët; apo nga raportet e marruara nga operacionet e kundërzbulimit, marrjet në pyetje, bisedat me personelin e huaj, etj; dhe **(TECHINT)**²⁰ **Inteligjenca teknike** të dhënat dhe informatat e mbledhura përmes kapjes; monitorimit dhe lokalizimit të radios, mikrovalëve, radarit dhe mjeteve të tjera të emetimit elektromagnetik; inteligjencës komunikuese, inteligjencës elektronike; inteligjencës telemetrive; inteligjencës së marrë nga sinjalet e instrumenteve të huaj; inteligjencës së deshifrimit; inteligjencës së matjes dhe nënshkrimeve; inteligjencës përshkruese; inteligjencës fotografike dhe të shfrytëzimit të rrjeteve kompjuterike.

Përpunimi është shndërrimi i informatave të mbledhura në një formë më të përshtatshme për analiza me anë të mjeteve të tilla si deshifrimi dhe përkthimi.

Analiza dhe prodhimi është shndërrimi informatave në produkte të përfunduara inteligjente. Me qëllim që këto produkte të jenë të dobishme, analiza duhet të jetë relevante, në kohë të duhur dhe e saktë. Ato duhet të sqarojnë mënyrën se si janë nxjerrë përfundimet, kur është e mundur duhet të sqarohen edhe burimet e përdorura.

Faktorët primar që mbështesin analizat duhet të jenë të sqaruar sikundër që duhet të jenë edhe rezultatet alternative në rast të ndryshimit të këtyre faktorëve. Inteligjenca efektive gjithashtu e bën të qartë atë që mbetet akoma e panjohur.

Shpërndarja është dhënia e produktit (final) të përfunduar të inteligjencës eprorit apo atij që është i autorizuar, sipas ligjit në fuqi për të marrë vendim si dhe hartuesve të politikave shtetërore.

1.3 Llojet dhe mënyrat e shërbimeve Inteligjente

Në teoritë mbi Inteligjencën dhe praktikën e tyre sipas hulumtimit të bërë, sot në botë ekzistojnë edhe disa lloje të shërbimeve të inteligjencës.

¹⁹**HUMINT** – *Intelegjencë humane*; informacion i mbedhur nga zyrtarët e intelegjencës, të vendosur zakonisht në kombe të huaja. Shih; TABELA 1.3 Diciplinat e Grumbullimit të Inteligjencës

²⁰**TECHINT** – *Intelegjencë teknike*; e referuar fillimisht për të informuarrrreth sistemeve të armatimit, por tanimë përdoret për intelegjencëne grumbullimit nga itercepcioni i një game larmie sinjaleshelektronike nëpërmjet përdorimit të mjeteve teknike të sofistikuara. Po aty

1.3.1 Shërbimi i brendshëm inteligjent

Shërbimet e brendshme apo vendore të inteligjencës, që shpeshherë quhen shërbime të sigurisë, të cilat mbledhin dhe analizojnë të dhëna relevante për sigurinë e brendshme të shtetit dhe ruajtjen e rendit publik dhe të sigurisë. Shërbimet e inteligjencës mandati e të cilave është i përqendruar në çështje apo fusha specifike.

1.3.2 Shërbimi jashtëm i inteligjencës

Shërbimet e jashtme apo të huaja të inteligjencës, janë ato shërbime të cilat mbledhin, analizojnë dhe prodhojnë produkte inteligjente që janë relevante me sigurinë e jashtme të shtetit dhe lajmërojnë për kërcënimet e mundshme nga jashtë.

1.3.3 Shërbimi inteligjent i krimeve

Shërbimet e inteligjencës penale të cilat prodhojnë produkte inteligjente lidhur me krimin e organizuar, korrupsionin dhe aktivitetet kriminale me qëllim që të japin ndihmën e tyre në vendosjen e ligjit.

1.3.4 Shërbimi inteligjent ushtarak

Shërbimet e inteligjencës ushtarake apo të mbrojtjes të cilat përgatisin produkte inteligjente relevante në planifikimin e mbrojtjes dhe përkrahjen e veprimeve ushtarake, Gjithashtu ekzistojnë edhe **Qendrat të specializuar kombëtare** të cilat përqendrohen në çështje të veçanta si *Qendra Kombëtare e Kundër terrorizimit (NCTC) e SHBA-ve*; madje **Çështje të veçanta** - si njësi koordinuese të cilat sjellin së bashku disa akterë të inteligjencës apo të degëve tjera të qeverisë²¹.

Sa i për ketë elementeve dhe metodave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, e sidomos të atyre përmes përdorimit të mjeteve teknologjike, ato mund të shërbejnë si pikënisje për krijimin e agjencive të inteligjencës edhe më të specializuara. Entitete të tilla përfshijnë imazhet, sinjalet dhe agjencitë e shërbimeve e inteligjencës deshifruese në nivel global dhe rajonal²².


²¹Shembuj të kësaj natyre përfshijnë “CT-InfoBox” e Holandës, e cila koordinon përpjekjet antiterroriste të shërbimit të inteligjencës, të policisë kombëtare, shërbimit të emigracionit dhe agjencive të tjera; dhe të Zyrës së SHBA-ve për Terrorizëm dhe Inteligjencë Financiare (INF) të Departamentit të Thesarit.

²²Krahasimi në nivelin global dhe rajonal na paraqiten në shërbimet si: NSA në SHBA, pastaj FAPSI në Rusi dhe GCHQ në Britani të Madhe me siguri janë agjencitë më të mëdha sa i përket personelit dhe buxhetit. Për shtetet më të vogla, posedimi i vetëm një agjencie e inteligjencës të ‘bashkuar’ është një mënyrë për të kursyer burimet dhe për të shmangur dyfishimin e përpjekjeve. CNI në Spanjë, AIDV në Holandë, MIT në Turqi dhe OSA në Bosnje dhe Hercegovinë janë shembuj të përpjekjeve për ta tejkaluar ndarjen tradicionale ndërmjet operacioneve që zhvillohen brenda territorit të një vendi dhe atij të huaj.

1.3.5 Metodologjia e Shërbimeve Inteligjente

Metodologjia e shërbimit informativ paraqet përmbledhje të metodave të përgjithshme dhe specifike me ndihmën e të cilave në punën operativo hulumtuese dhe me përdorimin e mjeteve të posaçme realizon funksionin e vet delikat dhe shumë të përgjegjshëm. Kështu që metodologjia e shërbimit informativ duhet të studioj dhe zhvilloj rrethin e nevojave shkencore dhe njohurive profesionale, që në mënyrë përmbajtjesore t'i analizojë veprimet, mjeteve dhe rrugët e veprimeve informativo-hulumtuese.²³

FIGURA NR. 2 METODAT E SHËRBIMEVE INTELIGJENTE



²³Ramo Masllesha, Teoritë dhe Sistemet e Sigurisë, versioni PDF, faqe 108

Në teoritë shkencore hasim në kuptime divergjente, që kanë të bëjnë me klasifikimin e metodave të shërbimeve informative. Gjatë është mbrojtur qëndrimi, që implikonte klasifikimin në tri grupe:

- **Metoda sekrete e mbledhjes së të dhënave;**
- **Metoda e mbuluar e mbledhjes së të dhënave;**
- **Metoda legale e mbledhjes së të dhënave**

Përveç metodave të cekura mund ta përmendi edhe këtë qasje që implikon dy grupe:

- **Metoda e veprimit informativ**
- **Metoda e veprimit jo informativ**

Mirëpo, në praktikë është e zakonshme ndarja në metoda legale dhe ilegale (sekrete). Në elaborimet e mëtejme do ti përmbahemi klasifikimit primar me kombinimin e metodës së mbuluar të mbledhjes së të dhënave.²⁴

1.3.6 Praktika themelore të funksionimit të Shërbimeve të Inteligjencës

Principet kryesore relevante për punën e shërbimeve informative në kushtet bashkëkohore janë:²⁵

- Gjithë përfshirja në punë;
- Kontinuiteti dhe intensiteti i punës;
- Udhëheqje dhe përgjegjësi e centralizuar e punës informative dhe kundër informative;
- Autonomi relative në punë;
- Fshtësi në punët informative;
- Operativimi dhe koha e qëlluar e punës;
- Ofanziva dhe infiltrimi në punë
- Specializimi në punë;
- Kreativiteti dhe origjinaliteti

²⁴Ramo Masllesha, Teoritë dhe Sistemet e Sigurisë, versioni PDF, faqe110

²⁵Ramo Masllesha, Teoritë dhe Sistemet e Sigurisë, versioni PDF, faqe 97

Në vijim do ti analizojmë disa praktika kur bëhet themelimi ose reformimi i një organizate të zbulimit, gjithsesi sugjerohen se do të ishte ideale që t'u përmbaheshin praktikave më të mira.²⁶

Për shtete më të mëdha me shërbime të shumta të inteligjencës, mandatet e agjencive të inteligjencës ndonjëherë janë të paqarta. Kjo paqartësi mund të ketë për pasojë konkurrencë të dobishme ndërmjet agjencive nëse një gjë e tillë arrin të vë në pah ndryshimet në mendime dhe të vë në dyshim hipotezat e panevojshme. Por, një gjë e tillë mund të jetë edhe humbje kohe, kur merret parasysh nevoja për bashkëpunim të ngushtë ndërmjet agjencive.

1.3.7 Legjislacioni që kërkohet për funksionimin e shërbimeve të inteligjencës

Shërbimet e inteligjencës janë legjitime vetëm atëherë kur kompetencat e tyre të jashtëzakonshme burojnë nga një legjislacion adekuat. Ligjet të cilat rregullojnë shërbimet e inteligjencës duhet të qartësojnë në mënyrë të qartë dhe specifike mandatin duke përfshirë: Hapsirat gjeografike të përgjegjësisë; Subjektet e hulumtimit; *Kufijtë e kompetencave dhe kufizimet e imponuara në aktivitete; Marrëdhëniet ndërmjet shërbimeve që punojnë brenda komunitetit të inteligjencës dhe koordinimin e tyre; Mjetet të cilat shërbimet i bëjnë të përgjegjshme, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit ekzekutiv, mbikëqyrjen legjislative dhe shqyrtimin gjyqësor; dhe Mjetet ligjore për tu ballafaquar me ankesat në rastet kur është bërë ndonjë shkelje nga agjencia.*

Qëllimet dhe objektivat e shërbimeve të inteligjencës, si të jashtme ashtu edhe të brendshme, dallojnë ashtu siç dallon edhe rreziku që lidhet me to. Është e rëndësishme që menaxhimi, kontrolli dhe marrëveshjet për llogaridhënie t'i reflektojnë këto ndryshime. Korniza ligjore duhet të kërkojë që shërbimet e inteligjencës t'iu përmbahen standardeve dhe normave demokratike.

Por shtrohet pyetja se cilat janë ato standarde demokratike me të cilat duhet të udhëhiqen shërbimet e inteligjencës?

²⁶**Jerome Mellon** Zbulimi në Kosovë, Vështrimi përpara mars 2007, doracak elektronik. Këto udhëzime të përgjithshme janë frymëzuar drejtpërdrejt nga disa prej 84 praktikave më të mira të parashtruara në hollësinë **Born H** dhe **Leigh I**, Të Bërit e Lëmit të Zbulimit të Përgjegjshëm: Standardet Ligjore dhe Praktikrat më të Mira për Mbikëqyrjen e Angjencivetë Zbulimit, (Shtëpia e Shtypit e Parlamentit të Norvegjisë, 2005). [**Born H** and **Leigh I**, *Making Intelligence Accountable: Legal Standards and BestPractice for Oversight of Intelligence Agencies*, (Publishing House of the Parliament of Norway, 2005)].

Një pjesë e madhe e punës së shërbimeve të inteligjencës është sekrete; zbulimi i burimeve, metodave, mjeteve apo sukseseve në mënyrë serioze mund ta rrezikojnë efikasitetin e tyre. Kjo do të thotë se ato nuk mund të jenë aq transparente siç janë entitetet tjera qeveritare dhe se nevojiten mekanizma të veçantë për mbikëqyrjen e tyre. (Për informata plotësuese në këtë çështje dhe çështje të tjera në fushën e Inteligjencës, ofrohen në *Përmbledhjen e DCAF-it për Mbikëqyrjen parlamentare të shërbimeve të inteligjencës*)²⁷

Kontrolli demokratik i shërbimeve të inteligjencës fillon me një kornizë ligjore të përcaktuar qartë e cila përcakton se komuniteti i inteligjencës duhet të respektoj respektimin e rendit dhe ligjit dhe të drejtave fundamentale njerëzore të qytetarëve.

Ky ligj duhet të krijoj bazën për të gjitha inspektimet e inteligjencës, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit të brendshëm (siç janë Inspektorët e përgjithshëm apo Ombudspersoni), kontroll të qartë ekzekutiv nëpërmes zyrtarëve adekuat apo ministrive, një bazë të fortë për rishikim juridik dhe mekanizma adekuat për mbikëqyrje parlamentare.

Shërbimet e inteligjencës duhet të jenë gjithashtu edhe subjekt i të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë më të dhëna personale dhe komunikim të gjërave private. Në rast se rrethanat specifike kërkojnë që të bëhet një monitorim sekret i komunikimeve, atëherë ligji duhet të mundësoj krijimin e një mekanizmi juridik bashkë me personelin përgjegjës të cilët janë të autorizuar për të rishikuar veprimet e tilla. Me qëllim të operimit adekuat të shërbimeve të inteligjencës, ato kanë nevojë për detyra inteligjente nga ana e ekzekutivit, të përkrahur nga një sistem i menaxhimit efektiv i cili siguron drejtimin e përgjegjshëm. Ndonjëherë bëhet një ndarje ndërmjet sjelljes së shërbimeve të inteligjencës në një vend, ku atyre iu kërkohet që të respektojnë ligjet e atij vendi, dhe natyrës së parregulluar të sjelljeve të tyre jashtë vendit. Në mjedisin sotëm ndërkombëtar, përgjegjshmëria për veprime jashtë vendit duhet të **r i f u q i z o h e t**²⁸.

²⁷**Informata shitesë. Çështje të Ndërlidhura** • Sfidat bashkohore për komunitetin e inteligjencës • Inteligjencat komplekse dhe koordinimi • Mbikëqyrja parlamentare dhe shërbimet e inteligjencës. Mbikëqyrja dhe udhëheqja: Relevanca e mbikëqyrjes parlamentare për sektorin e sigurisë dhe reforma e tij (Oversight and Guidance: The Relevance of Parliamentary Oversight for the Security Sector and Its Reform Born, Fluri dhe Lunn (eds.)), 2003.[Online] Marrë nga:www.dcaf.ch/docs/dcaf_doc4.pdf
Reformimi i inteligjencës: Sfidat e kontrollit në demokracitë e reja (Reforming Intelligence: The Challenge of Control In New Democracies Bruneau dhe Dombroski)[Online] Marrë nga:www.ccmr.org/public/library_file_proxy.cfm/?id/5258

²⁸ Për shembull, në rast të veprimeve të fshehta, legjislacioni kombëtar duhet të kërkojë që të ketë një zinxhirë komandues të qartë midis veprimeve të agjentëve në terren dhe niveleve më të larta në degën ekzekutive. Kjo është esenciale nëse kërkohet të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur.

Shërbimet e inteligjencës duhet të jenë profesionale dhe politikisht të paanshme; ato duhet të jenë në gjendje ti shërbejnë kombit në mënyrë efektive pavarësisht ndryshimeve të qeverisë apo politikës dhe duhet të kenë shtrirje sipas llojeve të veprimit. Shih disa shtrirje të shërbimeve të inteligjencës sipas llojeve:

TABELA Nr. 3 DISA LLOJE TË SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS NË DISA VENDE EUROPIANE ²⁹

Shteti	Bashkuar	Jashtëm	Brendshëm	Kriminal	Ushtarak	Sinjalet
Austria			X	X	X	X
Belgjika			X		X	X
Bullgaria		X	X	X	X	X
Rep. Çekisë		X	X		X	X
Danimarka			X		X	
Estonia			X			
Finlanda			X		X	
Franca		X	X	X	X	X
Gjermania		X	X		X	X
Greqia			X			
Hungaria		X	X		X	X
Irlanda					X	
Italia			X		X	
Luksemburgu			X		X	
Holanda	X				X	
Norvegjia			X		X	
Polonia		X	X		X	
Portugalia			X		X	
Romania		X	X	X	X	
Serbia	X					
Sllovakia	X				X	
Sllovenia		X			X	
Spanja	X				X	
Suedia			X		X	X
Zvicra		X	X		X	X
Ukraina	X				X	
Mbretëria e Bashkuar		X	X	X	X	X

²⁹ Një 'X' tregon një apo më shumë agjenci të ndara të përkushtuara ndaj këtyre juridiksioneve, qëllimeve apo metodave. Mungesa e shenjës së kontrollit (X) nuk do të thotë se këto vende nuk kryejnë funksione në këtë zonë, por kjo më tepër do të thotë se ato nuk kanë një agjenci të veçantë e cila merret me atë subjekt. DDIS i Danimarkës për shembull, është kryesisht një shërbim i inteligjencës por ai gjithashtu i ndjek edhe lëvizjet e grupeve ekstremiste jashtë vendit, një gjë e cila në vendet e tjera është një funksion i shërbimit të jashtëm të inteligjencës. Burimi: shtetet individuale dhe faqet e agjencive.

TABELA Nr. 4 DISA LLOJE TË SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS NË DISA VENDE TË BOTËS³⁰

Vendet	Shërbimet Informative të Vendet	Shërbimi informative i Jashtëm	Shërbimi Informativ Penal	Shërbimi Informativ Ushtarak
AUSTRIA	Drejtoria e Përgjithshme për Siguri Publike	X	Shërbimi Informativ Penal (BK)	Shërbimi Informativ Ushtarak (HNA)
KANADAJA	Shërbimi Informativ Kanadez i Sigurisë (ECIC)	Enti i Sigurisë së Komunikimeve (CSE)	Policia Mbretërore Kanadeze (RCMP)	Drejtori i Përgjithshëm i Divizionit Informativ (J2GD Int)
REPUBLIKA E ÇEKISË		Zyra për marrëdhënie me jashtë dhe Informata (UZSI)	X	Agjencia Informative Ushtarake e Mbrojtjes
FRANCA	Drejtoria e Sigurisë Territoriale (DST)	Drejtoria e Përgjithshme për Siguri të Jashtme	Drejtoria Qendrore e Policisë Gjyqësore (DCPJ)	Drejtoria e Shërbimit Informativ Ushtarak (DRM)
GREÇIA	Shërbimi Informativ Kombëtar (EYP)	X	X	X
SLLOVENIA	X	Agjencia Sllovene Informative dhe e Sigurisë (SOVA)	X	Shërbimi Informativ dhe i Sigurisë (VOMD)
MBRETËRIA E BASHKUAR		Shërbimi Informativ Sekret (SIS)	Agjencia e krimeve Serioze të Organizuara (SOCA)	Shërbimi Informativ i Mbrojtjes (DIS)
SHTETET E TË BASHKUARA AMERIKËS	Departamenti i Sigurisë Brendshme (DHA)	Agjencia Qendrore e Zbulimit (CIA)	Byroja Federale e Hetimeve (FBI)	Agjencia Informative e Mbrojtjes (DIA)

³⁰Jérôme Mellon Të kuptuarit e SHËRBIMEVE INFORMATIVENjë mjet referimipër ata që dëshirojnë të mësojnë më shumë për natyrën dhe rolin e shërbimeve informativë në kontekstin evropian të shekullit 21. Dhjetor 2006

1.3.8 Diciplinat e grumbullimit të inteligjencës

Sipas autorit Collins³¹, në praktikat e shërbimeve inteligjente ekzistojnë shumë metoda dhe çdo metodë është e ndryshme në grumbullimin e informacionit dhe i referohet një disipline të caktuar të inteligjencës. Këto disiplina ndahen, zakonisht në dy lloje të përgjithshme – në grumbullimin e inteligjencës njerëzore (ose ‘humint’ në zhargonin e inteligjencës) dhe në atë të inteligjencës teknike (‘techint’)³² për më tepër shih tabelën në vijim:

TABELA Nr. 5 DISIPLINAT E GRUMBULLIMIT TË INTELIGJENCËS

HUMINT – <i>Inteligjencë humane</i> ; informacion i mbledhur nga zyrtarët e intelegjencës, të vendosur zakonisht në kombe të huaja.
TECHINT – <i>Inteligjencë teknike</i> ; e referuar fillimisht për të informuar rreth sistemeve të armatimit, por tanimë përdoret për inteligjencë në grumbullimin nga interceptioni i një game larmie sinjalesh elektronike nëpërmjet përdorimit të mjeteve teknike të sofistikuara.
SIGINT – <i>Inteligjenca e sinjaleve</i> ; të gjitha llojet e informacioneve të grumbulluara me anë të aparateve të ndryshme elektronike, përfshirë nën disiplinat e më poshtme
IMINT - <i>Inteligjenca e imazhit</i> ; imazhet fotografike ose digjitale të grumbulluara nga sisteme orbitale (satelitë) ose me bazë tokësore (aeroplanët ose mjete ajrore të pakomanduara.
PHOTINT – <i>Inteligjenca fotografike</i> ; një term më i hershëm për IMINT. E përdorur gjerësisht për të përshkruar fotografitë në film dhe ato digjitale të marra nga satelitët.
COMINT – <i>Inteligjenca e komunikimeve</i> ; interceptimi i komunikimeve midis dy ose më shumë palëve.
TELING – <i>Inteligjenca telemetrike (lartsimetrike)</i> ; interceptimi i të dhënave të transmetuara gjatë testimit të llojeve të ndryshme të sistemeve të armatimit.
ELINT – <i>Inteligjenca elektronike</i> ; intreceptimi i dërgesave elektronike të lëshuara prej armëve dhe sistemeve të gjurmimit.
MASINT – <i>Inteligjenca e masave dhe e nënshkrimeve</i> ; një formë më e re e SIGINT, e cila përdor aparate më të sofistikuara që mund të dallojnë materialin e përdorur në lloje të ndryshme armësh moderne.
RADINT – Informacioni që buron nga përdorimi i sinjaleve të radiove të lëshuar prej satelitëve orbitalë, avionëve ose burimeve me bazë tokësore.
OSINT – <i>Inteligjenca e burimit të hapur</i> ; grumbullimi i informacionit të inteligjencës nga një larmi e gjerë burimesh publikisht të disponueshëm (të tilla si; mediet, informacion qeveritar, publikime akademike, etj.)
Adaptuar nga Lowenthal (2003), Kapitulli 5.

³¹ Për më tepër biografi shih: [Online] Marrë nga: <http://www.adelaide.edu.au/directory/alan.collins> [Qasja 20 Maj 2016]

³² **COLINSALAN** / Sten A.Taylor “Studime bashkëkohore të sigurisë” përkthim nga Enri Hide, kapitulli 14: Roli i shërbimeve të intelegjencës në sigurinë kombëtare. Tirnaë, faqe 318

*“Kundër-inteligjenca nënkupton aftësinë e depërtimit të
agjentëve special të kundërzbulimit deri në palcë të inteligjencës
kundërshtare”*

KAPITULLI I DYTË

KUNDËRINTELIGJENCA E SHËRBIMEVE INTELIGJENTE

2.1 Këndvështrime dhe koncepte teorike.....	45
2.2 Kundër - Inteligjenca në kuptimin etimologjik dhe terminologjik.....	48
2.3 Llojet e Kundërinteligjencës.....	49
2.4 Misioni i Kundërinteligjencës.....	50
2.5 Koncepti i Kundërinteligjencës mbrojtëse / defensive.....	54
2.6 Operacionet e mbrojtjes së burimit të forcës kundërzbuluese / kundërinteligjente.....	55

KUNDËR-INTELIGJENCA E SHËRBIMEVE INTELIGJENTE

2.1 Këndvështrime dhe koncepte teorike

Gjatë këtij studimi të kësaj materie mbi kundërinteligjencën, kemi për qëllim të elaborojmë aspekte të ndërlukuara teorike të autorëve më me ndikim në fushën e kundërinteligjencës, të cilët vlerësojnë se kundërzbulimi është ajo veprimtari komplekse dhe tejet specifike që ka për qëllim primar të mbrojë shtetin dhe sekretet e tij nga shërbimet e zbulimit të shteteve të tjera.

Ky koncept bëhet akoma më i qartë dhe i drejtpërdrejt nga **James Angelton**³³, për një kohë të gjatë drejtuesi i kundërinteligjencës në CIA, me aksiomën e tij **“Labirinti i pasqyrave”** (The wilderness of mirror), ku përcakton se: *“detektorët janë fals, gënjeshttrat janë të vërteta, e vërteta është gënjeshtër dhe ky pasqyrim ju lë juve të verbuar dhe konfuzë”*.

Ndërsa studiuesi universitar **Abram N. Shulsky**³⁴ e përcakton: *“Në kuptimin e saj të përgjithshëm, kundërinteligjenca i referohet informacionit të mbledhur dhe të analizuar si dhe veprimtarisë së ndërmarrë në mbrojtje të një kombi (përfshirë këtu edhe veprimtarinë e shërbimeve të inteligjencës) nga një veprimtari e një shërbimi inteligjence kundërshtar. Në këtë përcaktim, qëllimi i kundërinteligjencës në vetvete, është po aq i gjerë sa dhe i vetë inteligjencës, pra është një veprimtari mbrojtëse nga të gjitha teknikat e aktivitetet e shërbimeve të inteligjencës kundërshtar”*.

Profesori **Abraham Shulsky**, si shumica e autorëve amerikanë që kanë shkruar për inteligjencën, veprimtarinë e kundërinteligjencës lidhë kryesisht me masat e marra kundër kërcënimeve të huaja ndaj sigurisë kombëtare.

³³**James Jesus Angleton** (December 9, 1917 – May 11, 1987) was chief of the Central Intelligence Agency's Counterintelligence Staff from 1954 to 1975. His official position within the organization was "Associate Deputy Director of Operations for Counterintelligence (ADDOCI)".

³⁴**Abram Shulsky** (born August 15, 1942) is a neoconservative scholar who has worked for U.S. government, RAND Corporation, and the Hudson Institute. Shulsky served as Director of the Office of Special Plans, a unit whose function has been compared to the 1970s Team B exercise. In the run-up to the 2003 invasion of Iraq, Shulsky approved OSP memos with talking points about Iraq and weapons of mass destruction and terrorism. Shulsky is critical of the traditional intelligence analysis, which is based upon the social-scientific method, and of independent intelligence agencies. Shulsky favors a military intelligence model which can be used support policy as, in Shulsky's words, "truth is not the goal" of intelligence operations, but "victory". Shulsky signed a letter to the Clinton White House on Iraq

Edhe pse në veprimtaritë specifike të **kundërzbulimit**, kuptimi varion në kompleksitetin e vet, në përdorimin e përditshëm, termi **“kundërinteligjencë”** përdoret edhe për ato veprimtari informative me qëllimin e kundërvënies dhe mbrojtjes nga kërcënimet e brendshme.

Sipas **studiueseve britanikë**, ermin **“Security Intelligence”** (*Inteligjencë Sigurie*) preferojnë ta përdorin për të përcaktuar misionin e shërbimeve të inteligjencës që kanë për detyrë mbrojtjen nga kërcënimet e brendshme.

Ndërsa profesori dhe studiuesi britanik **Peter Gill**³⁵ e përkufizon inteligjencën në fushën e sigurisë si një *“mbledhje të informacioneve nga ana e shtetit për mbrojtjen nga kërcënimet që cenojnë sigurinë e tij dhe kryesisht nga spiunazhi, sabotimi, influenza e veprimtarive të huaja, dhuna politike dhe subversioni”*.

Përkufizimi i frazës **“wilderness of mirrors”** është marrë nga poema **“Gerontion”**³⁶ e T. S. Eliotit që u botua për herë të parë më 1920. Shumë komentatorë besojnë se **James Jesus Angelton** e kishte marrë këtë frazë nga kjo poemë, kur ai kishte përshkruar konfuzionin midis **spiunazhit** dhe **kundërinteligjencës** si **“labirinti i pasqyrave”**.

Sipas autorit **Dr Henry (Hank) Prunckun**³⁷, në këtë këndvështrim ka shumë përkufizime të kundërzbulimit, ku Ehrman (2009)³⁸ liston një numër të këtyre në studimin e tij. Pa debatuar pikat kryesore të këtyre dhe pa dyshim përkufizime të tjera, është e arsyeshme të shikohen

³⁵**Dr Peter Gill** is Honorary Senior Research Fellow at the University of Liverpool, UK. He was previously Research Professor in Intelligence Studies at the University of Salford. He is the author of *Policing Politics* (London: Cass, 1994) and *Rounding Up the Usual Suspects?* (Aldershot: Ashgate, 2000) and is co-author of *Intelligence in an Insecure World* (Cambridge: Polity, 2nd edition 2012). He is co-editor of the *PSI Handbook of Global Security and Intelligence: National Approaches*, 2 volumes (Westport: Praeger, 2008) and *Intelligence Theory: key questions and debates* (London: Routledge, 2009). His current research is into the democratisation of intelligence in former authoritarian regimes, for which he was awarded a Leverhulme Emeritus Fellowship in 2010.

³⁶**“Gerontion”** is a poem by T. S. Eliot that was first published in 1920. The work relates the opinions and impressions of a gerontic, or elderly man, through a dramatic monologue which describes Europe after World War I through the eyes of a man who has lived the majority of his life in the 19th century.

³⁷**Dr Henry (Hank) Prunckun** është profesor i asociuar i Analizës së Inteligjencës në Shkollën Australiane të Punësimit dhe Sigurisë. Ai specializohet në studimin e krimit ndërkombëtar - spiunazhit, terrorizmit, drogës dhe trafikimit të armëve, si dhe krimit kibernetik. Ai është autor i përmbledhjeve të shumta, artikujve, kapitujve dhe librave. Ai është fitues i dy çmimeve të letërsisë dhe një çmim profesional i shërbimit nga Shoqata Ndërkombëtare e Analistëve të Inteligjencës të Zbatimit të Ligjit. Ai ka shërbyer në një numër të hulumtimeve strategjike dhe kapaciteteve të inteligjencës taktike brenda sistemit të drejtësisë penale gjatë karrierës së tij operacionale njëzet e tetë vjeçare, duke përfshirë pothuajse pesë vjet si një analist i lartë i politikës kundër terrorizmit gjatë Luftës Globale mbi Terrorin. Përveç kësaj, ai ka mbajtur një numër të postimeve operacionale në hetim dhe siguri.

³⁸**Ehrman, John (2009)** “Toward a Theory of Counterintelligence: What are We Talking About When We Talk About Counterintelligence?” in *Studies in Intelligence*, Vol. 53, No. 2.

përkufizimet e Kundër Inteligjencës si kontekst specifik. Për shembull, ato të cituara nga Ehrman (2009) duket se trajtojnë Kundër Inteligjencën, sikur të zbatohen vetëm për inteligjencën e politikës së jashtme ose çështjet e sigurisë kombëtare. Sidoqoftë, përvoja ka treguar, për shembull, një aktor jo shtetëror ose një organizatë kriminale transnacionale, nuk ka dallim të vogël midis asaj që mund të përbëjë një çështje të sigurisë kombëtare dhe, për shembull, një problemi të zbatimit të ligjit. Autorët, apo objektivat e interesit, që bien në këto lloje të kategorive si "agjentë kërcënues" kalojnë një "ekran radar" të numrit të agjencive funksionale.³⁹

Së këndejmi kjo fushë e inteligjencës, si më e ndërlikuar, shfaqet edhe me karakter negativ, si në materialet e botuara të shumë autorëve, specialistëve me eksperiencë në fushën e inteligjencës por edhe në botimet e studiuesve të kësaj fushe për studentët e inteligjencës theksohet se kundërinteligenca dhe veprimtaritë e sigurisë kanë një ndikim të madh negativ për arsye të mbikëqyrjes së fshehtë ndaj qytetarëve të vendit të tyre.⁴⁰

Në fund mendohet se këto implikime janë shumë më evidente për demokracitë dhe veçanërisht në vendet e sapo hyra në këtë proces, ku si do përshkruajmë në vijim, kundërinteligenca dhe siguria ishin funksionet kryesore të shërbimeve të inteligjencës në regjimet e vjetra.

Këto shërbime të kthyera në vegla dhune të regjimit kërkonin të gjenin armiqtë realë dhe imagjinarë të shtetit, që kryesisht rezultonin të ishin kundërshtarët politikë të tij, dhe ushtronin represion ndaj tyre.⁴¹

³⁹Dr Henry (Hank) Prunckun is Associate Professor of Intelligence Analysis at the Australian Graduate School of Policing and Security. Salus Journal Issue 2, Number 2, 2014 31, Research Article, EXTENDING THE THEORETICAL STRUCTURE OF INTELLIGENCE TO COUNTERINTELLIGENCE

⁴⁰Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Çështje të Sigurisë K14, Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë, Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë, Tiranë, Dhjetor 2009,fq.143.

⁴¹ IDN, Po aty.

2.2 Kundër - Inteligjenca në kuptimin etimologjik dhe terminologjik

Kuptimi i esencës së fjalës “**Kundër-inteligjencë** apo **Kundër-zbulim**, në aspektin etimologjik nënkupton ndërmarrjen me veprimtari specifike, që merret me identifikimin e rrezeve të sigurisë kombëtare dhe kundërveprimin ndaj tyre, të cilat vijnë nga shërbimet e huaja të inteligjencës, organizata ose individë të përfshirë në pas kategori të veprimtarisë së natyrës së shërbimeve sekrete dhe shpërfaqjes së krimit si: *spiunazh, sabotazh, subversion, terrorizëm ose krimin e organizuar*.

*Nocioni terminologjik i Kundërzbulimit*⁴²ose **Kunderinteligjencës (KI)**, i referohet shkallës së masave të marra nga organizatat e inteligjencës për të parandaluar grumbullimin e informacioneve që cenojnë sigurinë kombëtare nga shërbimet inteligjente armiqësore ose organizatat e inteligjencës të kundërshtarit. Programet kombëtare të inteligjencës, dhe, masat mbrojtëse të shteteve janë target për tu sulmuar nga shërbimet inteligjente kundërshtarë.

Është roli i ciklit të sigurisë së inteligjencës për të mbrojtur procesin e mishëruar në ciklin e inteligjencës.⁴³

Në këtë kontekst të nevojës së përshkrimit të detyrave, ekzistojnë një numër i disiplinave të kundërinteligjencës të cilat shkojnë në mbrojtjen e ciklit të inteligjencës. Një nga sfidat është gama e gjerë e kërcënimeve të mundshme, kështu që vlerësimi i kërcënimit nga kundër inteligjenca, është një detyrë shumë komplekse dhe vështirë.

Sipas një autori tjetër, **Duvenage, Petrus**⁴⁴ ekziston një konfuzion midis sigurisë dhe kundërzbulimit, kështu që kuptohet se ky konfuzion shtrihet në marrëdhëniet midis kundërzbulimit dhe funksioneve të tjera të inteligjencës, të tilla si kundër peshkimi.

⁴²**Kundërzbulim** m. 1. Veprimtaria që zhvillohet për zbulimin e agentëve të huaj ose të zbuluesve armiq në një vend. Organizimi i kundërzbulimit. 2. Organ shtetëror që ka për detyrë të ndjekë e të zbulojë veprimtarinë e agentëve ose të zbuluesve të huaj. Agent i kundërzbulimit të huaj. Shefi i kundërzbulimit. [Online] Marrë nga: <http://www.fjalori.shkenca.org/>[Qasja, 20. Korrik, 2016].

⁴³Doktrina e NATO-s për Kunderinteligjencen. Standard: NATO - AJP-2Allied joint doctrine for intelligence, counterintelligence and security[Online] Marrë nga:<http://standards.globalspec.com/std/9994887/nato-ajp-2> [Qasja, Korrik, 2016].

⁴⁴**Duvenage, Petrus** C. (2013). “Counterintelligence,” in Prunckun, Hank (ed.), *Intelligence and Private Investigation: Developing Sophisticated Methods for Conducting Inquiries*. Springfield, IL: Charles C Thomas Publisher Ltd.

Kundërzbulimi shpesh senzacionalizohet dhe keqinterpretohet në media të njohura, natyrisht që është shtrembëruar si trillim. Kundërzbulimi po ashtu është portretizuar me spiunë që dalin nga spiunë. Ky është, natyrisht, nuk është rasti. Kundërzbulimi nganjëherë ka edhe konotacionet më të zakonshme për të qenë kryesisht në lidhje me fjalëkalimet kompjuterike, kufizimet në përdorimin e pajisjeve informatike, rojet e sigurisë, kontrollin e qasjes, qentë roje dhe të ngjashme. Kjo është gjithashtu një pikëpamje e shtrembëruar.⁴⁵

Shumë shtete, përkatësisht qeveri, organizojnë agjencitë e kundërzbulimit të ndara dhe të dallueshme nga koleksioni i shërbimeve të tyre të inteligjencës për qëllime të specializuara. Në shumicën e vendeve misioni i kundërzbulimit është i përhapur në organizata të shumta, edhe pse ai zakonisht mbizotëron. Shërbimet e kundërinteligjencës si të tilla nuk duhet të kenë kompetenca të drejtpërdrejta policore, por ato zakonisht punojnë ngushtë me organet e zbatimit të ligjit.⁴⁶

2.3 Llojet e Kundërinteligjencës

Në natyrën e shërbimeve të kundërzbulimit, shtetet e mëdha e ndajnë kundërinteligjencën e përgjithshme në dy lloje:

- 1- Kundërinteligjencë **mbrojtese** (defensive)
- 2- Kundërinteligjencë **sulmuese** (ofensive).

Shtetet e vogla⁴⁷ dhe me ndikim të minimizuar në skenën ndërkombëtare, zakonisht këto dy lloje i kanë të sistemuara brenda një agjencie Kundërinteligjence dhe i aplikojnë te dyja në të njëjtën kohë.

⁴⁵Dr Henry (Hank) Prunckun is Associate Professor of Intelligence Analysis at the Australian Graduate School of Policing and Security. Salus Journal Issue 2, Number 2, 2014 31, Research Article, EXTENDING THE THEORETICAL STRUCTURE OF INTELLIGENCE TO COUNTERINTELLIGENCE, Faqe,34

⁴⁶ Po aty

⁴⁷ Shtetet si: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia etj, i takojnë grupit të shteteve të vogla që kanë ndikim të zvogëluar në kompleksitetin e sfidave specifike të kundërinteligjencës globale.

Po ashtu organizatat ushtarake kanë forcat e veta të kundërzbulimit, të aftë për kryerjen e operacioneve mbrojtëse në vendin e tyre si dhe mbrojtjen e trupave ushtarake që janë të dislokuara jashtë vendit.

Në varësi të vendit, nuk mund ketë përzierje të ndryshme civile dhe ushtarake në operacionet e kunderinteligjences në vendet e huaja. Për shembull: Shtetet e Bashkuara, **kundërzbulimin ofensiv** ja kanë lënë si mision **Shërbimit Kombëtar Klandestin të Central Intelligence Agency(CIA)**, ndërsa **Kundërzbulimi Mbrojtës** është një mision i **Shërbimit Diplomatik Amerikan të Sigurisë (DSS)**, i cili punon për mbrojtjen dhe sigurinë e personelit diplomatik dhe misioneve të ndryshme kombëtare në ambasadat jashtë vendit të tyre.⁴⁸

2.4 Misioni i Kundërinteligjencës

Kush janë kërcënimet kryesore të cilat janë objekt i punës së Kundërinteligjencës?



FIG.NR.6 KËRCËNIMET E “TESSOC”

Pesë kërcënimet kryesore të cilat janë objekt i punës së Kundërinteligjencës për të cilat Kundërinteligjenca ndërton veprimtarinë informativo-operative janë kërcënimet e njohura të TESSOC -ut.

Pesë kërcënimet e TESSOC⁴⁹ janë:

- 1- *Terrorism (Terrorizmi)*
- 2- *Espionage (Spiunazhi)*
- 3- *Sabotage (Sabotazhi)*
- 4- *Subversion (Përmbyrje)*
- 5- *Organized Crime (Krimi i Organizuar).*

⁴⁸Allied joint doctrine for intelligence, counterintelligence and security, [Online] Marrë nga: <http://standards.globalspec.com/std/9994887/nato-ajp-> {Qasja, Nëntor 2016}

⁴⁹ TESSOC – Shkurtesat e kërcënimet e terrorizmit dhe format e saj

Në disa shtete kryesisht, në ato të mëdha, kërcënimi i Krimit të Organizuar nuk përbën objekt pune për KundërInteligjencën. Ky kërcënim zakonisht është objekt i punës së organeve të zbatimit të ligjit.

Kundërinteligjenca si në kohë lufte, poashtu dhe në kohë paqeje organizon këto lloje të operacioneve komplekse:

- 1) Operacione Kundërzbulim – kundërinteligjencë **mbrojtëse**.
- 2) Operacione Kundërzbulim – kundërinteligjencë **sulmuese**.
- 3) Operacione Kundërzbulim- kundërinteligjencë **mbrojtëse të shërbimit Inteligjent**
- 4) Operacione Kundërzbulim-kundërinteligjencë për **mbrojtjen e burimeve dhe operacioneve**.

Operacionet e kundërzbulimit - kundërinteligjencës mbrojtës janë:

- 1- Kundër burimeve njerëzore të kundërshtarit, HUMINT⁵⁰
- 2- Kundër inteligjencës sinjalore të kundërshtarit SIGINT⁵¹
- 3- Kundër Inteligjencës Imazheve IMINT⁵²
- 4- Kundër inteligjencës së burimeve të hapura (Gazeta, media) OSINT⁵³

Operacionet e kundërzbulimit – kundër-inteligjencës sulmuese janë:

Nocioni **kundër-spiunazh** përdoret në vecanti për operacionet e kundërinteligjencës kundër burimeve njerëzore HUMINT të kundërshtarit.

Tipet e operacioneve të kundërspiunazhit sulmues janë:

- 1- Me anë të informatorit **Mole** ose **Urith** (rekrutimi i një oficeri kundërshtar me qëllim shkatërrimin nga brenda të shërbimit kundërshtar)

⁵⁰HUMINT – *Inteligjencë humane*; informacion i mbedhur nga zyrtarët e inteligjencës, të vendosur zakonisht në kombe të huaja.

⁵¹SIGINT – *Inteligjenca e sinjaleve*; të gjitha lojet e informacioneve të grumbulluara me anë të aparateve të ndryshme elektronike, përfshirë nëndisciplinat e më poshtme

⁵²IMINT- *Inteligjenca e imazhit*; imazhet fotografike ose digjitale të grumbulluara nga sisteme orbitale (satelitë) ose me bazë tokësore (aeroplanët ose mjete ajrore të pakomanduara).

⁵³OSINT – *Inteligjenca e burimit të hapur*; grumbullimi i informacionit të inteligjencës nga një larmi i gjerë burimesh publikisht të disponueshëm (të tilla si; mediat, informacion qeveritar, publikime akademike, etj.)

- 2- Me anë të informatorit **Penetrues me flamur fallso** (Person i cili paraqitet si tradhtar i shërbimit të tij.
- 3- Informator shkatërrues, i cili dezinformon kundërshtarin dhe saboton operacionet e tij.



FIG. NR. 7 PAMJE TEKNIKE E OPERACIONEVE TË KUNDËR-INTELIGJENCËS

- **4-Agjent i dyfishtë, të cilët i kemi të katërfishuar në keto lloje:**
- 4.1- Agjent i dyfishtë në vend
- 4.2-Agjent i dyfishtë provokator aktiv
- 4.3-Agjent i dyfishtë provokator pasiv
- 4.4- Poli agjent ose agjent i shumëfishtë.⁵⁴

Fig. (Accession Number: 63- 1457- 47) *Fotografi e teknikëve civil të ulur (në pjesën e pasme në xhip) që punojnë për trupat e Kundër-Inteligjencës, duke vëzhguar gjatë një pike ushtarake kontrolli në Potsdam, Gjermani (korrik 14 1945).*⁵⁵

- Operacionet dhe masat mbrojtëse të kundërzbulimit për sigurinë e burimeve dhe instalimeve janë:

1. **Analiza defensive** e cila është një praktikë për identifikimin e dobësive të vetë organizatës inteligjente si dhe në mbylljen e vrimave të zbuluara që paraqesin rrezik.

⁵⁴Allied joint doctrine for intelligence, counterintelligence and security[Online] Marrë nga: <http://standards.globalspec.com/std/9994887/nato-ajp-> {Qasja, Nëntor 2016}

⁵⁵Civilian photo technicians (in back of jeep) working for Counter Intelligence Corps are accounted for at a checkpoint in Potsdam, Germany (July 14, 1945). [Online] Marrë nga: <https://www.trumanlibrary.org/photographs/view.php?id=13352> [Qasja: 20, korrik 2016]

2. **Operacione që kryhen me anë të burimeve njerëzore.** Këto operacione zhvillohen jashtë vendit për të plotësuar mangësitë me informacion si dhe për të mbrojtur kapacitetet dhe resurset shtetërore ose të organizatës – agjencisë nga sulmet terroriste dhe nga shërbimet inteligjente kundërshtarë.

3. **Kundërzbulimi është pjesë e ciklit të inteligjencës sigurisë,** e cila, nga ana tjetër, është pjesë e ciklit të menaxhimit të inteligjencës. Një shumëllojshmëri të disiplinave të sigurisë gjithashtu bien nën menaxhimin e sigurisë së zbulimit dhe kundërzbulimit të komplementit, duke përfshirë tri aktivitete kryesore⁵⁶:

1. Mbrojtja e informacionit kundër spiunazhit
2. Mbrojtja e personelit ndaj dekonspirimit
3. Mbrojtja e instalimeve dhe materialeve kundër sabotimit.

Disiplinat e përfshira në "**sigurinë pozitive**", janë masa me të cilën shoqëria mbledh informacion mbi sigurinë e saj aktuale apo potenciale, në mënyrë që të plotësojë sigurinë e saj. Për shembull, kur komunikimet (SIGINT) të inteligjencës identifikojnë një radio transmetues të veçantë, e cila përdoret vetëm nga një vend i veçantë, ata i raportojnë kundër-inteligjencës që ky radiotransmetues - pajisje tregon praninë e një zbuluesi kundërshtar si dhe i sugjerojnë kundër-inteligjencës që këtë zbulues ta kthejë në objekt trajtimi të menjëhershëm.

Operacionet Kundërzbulim- Kundër-inteligjencës për mbrojtjen e burimeve dhe operacioneve:

Organizatat dhe agjencitë e inteligjencës janë përgjegjëse për sigurinë e tyre jashtë dhe brenda vendit kur janë në operacione kundërzbulimi.

Këto agjenci të zbulimit e kanë detyrë që të mbrojnë tre gjera:

- 1) *Personelin e tyre.*
- 2) *Instalimet – pajisjet e tyre dhe,*
- 3) *Operacionet e tyre.*

⁵⁶Counterintelligence, Three activity of CI: [Online] Marrë nga: <https://www.scribd.com/document/148504731/Counter-Intelligence-2> [Qasja: 20, korrik 2016].

Pra, siguria dhe ruajtja e burimeve njerëzore dhe pajisjet e përdorura në operacione, mbetet prioritet dhe kompleksitet, po aq sa edhe vet rezultati i operacionit kundërzblulues.

2.5 Koncepti i Kundër-inteligjencës mbrojtëse - defensive

Koncepti i kundërzbulimit mbrojtës zakonisht fillon duke identifikuar vendet dhe pikat e dobëta të organizatës apo agjencisë së saj, të cilat mund të jenë lehtësisht të cenueshme nga Shërbimet e Inteligjencës së kundërshtarit, nga grupet terroriste. Këtë identifikim kundër-inteligjenca e bënë në përmes vlerësimeve të kërcënimit periodikë.

Analistet e Kundërzbulimit dhe kundër terrorizmit bëjnë vlerësime strategjike të shërbimeve inteligjente kundërshtarë si dhe grupeve terroriste dhe përgatisin opsionet taktike për operacionet në vazhdim dhe hetimet e pandërprera. Kundërspiunazhi mund të përfshijë veprime pro aktive kundër shërbimeve të huaja të zbulimit, të tilla si agjentë të dyfishtë, mashtrimit, apo rekrutimin e oficerëve të shërbimeve të inteligjencës kundërshtarë.

Ndërsa burimet njerëzore klandestine **HUMINT**⁵⁷ mund të japin një pasqyrë më të madhe sesi shërbimi kundërshtar mendon. Para se ti besohet këtyre agjenteve (*të cilët janë pjesë e shërbimeve kundërshtarë, por që janë rekrutuar nga Kundër-Inteligjenca Jonë*) nuk duhet harruar se njerëz të tillë janë rekrutuar fillimisht nga shërbimi i tyre si besnik ndaj shtetit të tyre kjo gjë duhet vlerësuar me kujdes pasi këta lloje agjentësh mund të jenë ende besnik ndaj vendit të tyre dhe mund të na jenë servuar nga vetë kundërshtari me qëllim dezinformimi. Mbi këta lloje agjentësh duhet të ushtrohen masa të rrepta kontrolli.

Specialistët më të mëdhenj të Kundër-inteligjencës dhe praktika ka treguar se mbrojtja dhe mënyra më e mirë për parandalimin e sulmeve dhe infiltrimeve nga shërbimet inteligjente kundërshtarë është masa aktive kundër këtyre shërbimeve armiqësore.

Kjo masë taktike është quajtur shpesh Kundërspiunazhi me të cilin kuptohet: Masat e marra për të zbuluar spiunazhin armik ose fizik, sulmet kundër shërbimeve të inteligjencës miqësore, për të

⁵⁷*Intelegjencë humane; nënkupton informacion të mbedhur nga zyrtarët e intelegjencës, të vendosur zakonisht në kombe të huaja.*

parandaluar dëmtimin dhe humbjen e informacionit, dhe, ku është e mundur, për ta kthyer në përpjekjen përsëri kundër autorit të saj.

Kundërspiunazhi shkon përtej të qenit aktiv pasi përpiket të përmbysë shërbimet të inteligjencës kundërshtarë, duke rekrutuar agjentë në shërbimet e tyre, duke diskretituar oficerët e tyre besnik, si dhe duke marrë ose dëmtuar resurset e dobishme të shërbimit kundërshtar.

Po ashtu kundërspiunazhi është një set teknikash dhe taktikash, që minimalisht identifikon dhe neutralizon agjentet e shërbimeve kundërshtarë, të cilët mund ti arrestojë ose nëse ata janë me imunitet diplomatik, i shpallë persona “non grata”. Përtej këtyre veprimeve kundërspiunazhi, gjithashtu kryen operacione për manipulimin e agjenteve kundërshtarë, dezinformimin e tyre si dhe rekruton agjentët kundërshtarë dhe i detyron që të punojnë kundër organizatës së tyre për ta dëmtuar atë.⁵⁸

Në bazë të parimeve dhe jo praktikave, veprimet e kundërspiunazhit ndalohen për tu përdorur brenda vendit si dhe ndaj organizatave të tjera kombëtare të sigurisë.

2.6 Operacionet e mbrojtjes së burimit të forcës kundër-zbuluese – kundër-inteligjente

Operacionet e mbrojtjes së Burimit të Forcës së Kundërzbulimit janë ato operacione të burimeve njerëzore, që normalisht klandestine në natyrë, të kryera jashtë vendit, që janë të destinuara për të mbushur zbrazëtirën ekzistuese në mbulimin në nivel kombëtar, si dhe për të përmbushur kërkesat e komandantit ndërluftues të inteligjencës.

Policia Ushtarake dhe Patrullat e tjera ushtarake që shoqërohen me njerëzit lokal në zonën e operacionit mundet me të vërtetë të jenë burime të vlefshme HUMINT për ndërgjegjësimin e kundërzbulimit, por këto burime nuk mund të kryejnë vetë rolin e kundërinteligjencës por thjeshtë quhen burime të Kunderinteligjencës.⁵⁹

Kundërmasa aktive, qoftë për mbrojtjen e forcës dhe trupave, mbrojtjen e shërbimeve të inteligjencës, apo mbrojtjen e interesave të sigurisë kombëtare, janë të prira për të përfshirë disiplina të burimeve njerëzore (HUMINT), me qëllim zbulimin e agjentëve të shërbimeve

⁵⁸Doktrina e NATO-s për Kundërinteligjencën. Standard: NATO - AJP-2 Allied joint doctrine for intelligence, counterintelligence and security[Online] Marrë nga: <http://standards.globalspec.com/std/9994887/nato-ajp>{Qasja, Nëntor 2016}

⁵⁹ Doktrina e NATO-s për Kundërinteligjencën. Standard: NATO - AJP-2 Allied joint doctrine for intelligence, counterintelligence and security, [Online] Marrë nga <http://standards.globalspec.com/std/9994887/nato-ajp> {Qasja, Nëntor 2016}

kundërshtare, që përfshijnë shqyrtimin dhe informimet e burimeve njerëzore jo të ngarkuara me detyrë, por të quajtur si burime të rastësishëm apo aksidentale të tilla si:

1. **Walk-ins and write-ins**⁶⁰ (individë që dalin vullnetarë për informacion).
2. Burimet e paqëllimtë (çdo individ që i siguron informacion të dobishëm kundërzbulimit, të cilët në procesin e zbulimit të një informacioni të tillë mund të mos jenë në dijeni të faktit se ata janë të ndihmuar një hetim)
3. Dezertorët dhe të burgosurit e luftës
4. Popullatat e refugjatëve dhe emigrantëve
5. Të intervistuarit (individë të kontaktuar në rrjedhën e një hetimi)
6. Burime zyrtare ndërlidhëse.

Forca Mbrojtëse Kunderinteligjente⁶¹ (FMK-I), të cilat janë të dislokuara në vendet pritëse me njësi dhe asistencë ushtarake dhe këshillimore, i lejon agjentët e saj për të ndërtuar marrëdhënie me agjencitë e zbatimit të ligjit dhe agjencitë e zbulimit të vendit pritës, në mënyrë që të njohin mjediset lokale, dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore. (FMK- I) ka nevojë për aftësitë e brendshme të agjencive të zbatimit të ligjit për t'u marrë me kërcënimet e terrorizmit vendas. Si përfundim të kësaj pjesë mund të themi se veprimtaria kundërzbuluese, në themelet e saj duhet të jetë edhe ofensive, dhe duke pasur parasysh këtë, kryhet në territorin nacional ose jashtënational. Në këtë rastin e dytë, tentohet të depërtohet në institucionet informative të vendeve tjera dhe në këtë mënyrë të sigurohet territori i vet nga aktiviteti informativ i jashtëm, gjithashtu edhe aktiviteti jashtë shtetit.⁶²

Në fund fare mund të thuhet se fokusi parësor është se me veprimtarinë kundërzbuluese ekskluzivisht merren shërbimet kundërzbuluese, Shërbimi kundërzbulues janë pra veprimtaria, organizimi dhe organet të cilët, në kuadër të shërbimit informativ, grumbullojnë, rregullojnë, përpunojnë dhe në mënyrë gjegjëse i përdorin këto shënime mbi 109 shërbimet informative,

⁶⁰John Dr. Sullivan, Artikulli, "How to Recruit Walk-ins and Why 'We're Hiring' Banners Don't Work", June 22, 2015, ERE- Recruiting Intelligence: [Online] Marrë nga <http://www.ere-media.com/ere/how-to-recruit-walk-ins-and-why-were-hiring-banners-dont-work> {Qasja, Nëntor 2016}

⁶¹ FMK – Forca Mbrojtëse Kunderinteligjente, i referohet njësisë së specializuar të Kundërinteligjencës pritëse e cila zakonisht ka për detyrë të siguroj pritjen dhe mjedisin e sigurisë.

⁶²Abazović, Mirsad, Siguria Nacionale, Doracak pedagogjik, FSK/S – 05/06, faqe, 108

qëllimeve dhe aksioneve të shteteve tjera dhe veçanërisht të atyre vendeve të cilat nuk janë mike, të cilat paraqesin armikun e vërtetë ose të mundshëm.⁶³

Shikuar edhe nga këndvështrimi shkencor, pra, ndërlikueshmëria e marrëdhënieve shoqërore dhe ndërkombëtare, si dhe përballimi më efikas kundërzbulues, ndaj veprimtarisë informative, kontribuuan që veprimi informativ të zgjerohet (në kuptimin e shfrytëzimit të mundësive legale) dhe gjatë kësaj pesha të bartet në metodat shkencore-hulumtuese⁶⁴.

⁶³ Po aty, faqe, 109

⁶⁴ Po aty, faqe 60

“Komperacioni në mes agjencive rajonale të inteligjencës dhe sidomos atyre ndërkombëtare, është jo vetëm i ndryshëm në pamje strukturore, por edhe në përmasa dhe peshë globale”

KAPITULLI I TRETË

NJOHJE E KOMPERATIVE E SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS

Niveli i krahasimit të Shërbimeve të Inteligjencës në kontekstin rajonal

3.1 SHISH, Shërbimi Informativ i Shtetit / Shqipëria.....	59
3.2 BIA, Agjencia e Sigurisë dhe Informacionit / Serbia.....	60
3.3 OSA-OBA , Agjenci për Sigurim dhe Inteligjencë / Bosnjës dhe Hercegovinës.....	62
3.4 SOVA - Agjencia Sllovene për Siguri dhe Inteligjencë / Sllovenia.....	63
3.5 AZ – Agjencia për zbulim / Republika e Maqedonisë.....	64

Niveli i krahasimit të shërbimeve të Inteligjencës në kontekstin global

3.6 CIA Central Intelligence Agency (ShBA).....	67
3.7 FSB Federal'naya Sluzhba Bezopasnosti (Rusia)	70
3.8 SIS Secret Intelligence Service MI6 (Shërbimi Anglez)	71
3.9 BND Bundesnachrichtendienst (Gjermania).....	72
3.10 MOSSAD. Instituti për Inteligjencë dhe Detyra të Veçanta (Izraeli).....	73
3.11 MIT – Organizata Kombëtare e Inteligjencës (Turqi).....	74

NJOHJE KOMPERATIVE E SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS

Njohje e shërbimeve të inteligjencës në nivel rajonal

Niveli rajonal, krahasimi i Shërbimeve të Inteligjencës

Niveli rajonal mbi këndvështrimet rreth shërbimeve apo agjencive të inteligjencës siç janë trajtuar shërbimet; SHISH-ku⁶⁵ (Shqipëri), pastaj BIA⁶⁶, (Serbi), OSA – OBA⁶⁷, (Bosnje Hercegovinë) dhe SOVA⁶⁸, (Slloveni). Këto shërbime do të trajtohen për nga, aspekti ligjor, forma organike, dhe struktura përmes krahasimit reciprok për dy nga shërbimet më të pa kontrolluara si ajo e SHIK⁶⁹ –ut e transformuar në SHISH dhe trashëgimtarja e UDB⁷⁰ – së BIA, si dhe krijimin e shërbimit më kontraverze të trinisë (trikuptmësisë) boshnjake e formuar si agjenci e përbashkët serbe-muslimano-kroate e shërbimit të fshehtë. Gjithashtu do të trajtohet edhe shërbimi i Sllovenisë SOVA që në qasje të parë të vizitës elektronike të krijon përshtypjen e një shërbimi vërtetë inteligjent. Në fund të këtij kapitulli është përfshirë edhe Agjencia e zbulimit AZ në Maqedoni.⁷¹

3.1 SHISH, Shërbimi Informativ i Shtetit / Shqipëria

Historiku i Shërbimit Sekret të shtetit shqiptarë daton që nga viti 1912, kur Shqipëria u shpall shtet i lirë dhe i pavarur duke deklaruar shkëputjen e çdo lloj lidhjeje me Perandorinë Osmane të asaj kohe, data më e vjetër e krijimit të Shërbimit Sekret të shtetit shqiptar është 17 dhjetori i vitit 1912.⁷² Gjithashtu ky lloj shërbimi sekret ka vazhduar rrugëtimin e vet në të gjitha fazat politike në të cilat ka kaluar Shqipëria deri te kalimi i fundit nga përkufizimi i emrit SHIK⁷³ –u në SHISH.

⁶⁵ Sqarimet lidhur me shkurtesat e shërbimeve Inteligjente do të gjeni në listën e akronimeve dhe shkurtesave në shqip, megjithatë edhe në këtë kapitull do të gjeni më emërtimin e plotë: SHISH (Shërbimi Informativ i Shtetit),

⁶⁶ BIA (Bezbednosno-Informativna Agencija) Agjencia e Sigurisë dhe Informacionit.

⁶⁷ OSA – OBA Agjenci për Sigurim dhe Inteligjencë (e formuar si agjenci e përbashkët serbe-muslimano-kroate të shërbimit të fshehtë)

⁶⁸ SOVA (Slovenska Obveščevalno-Varnostna Agencija) Agjencia Sllovene për Siguri dhe Inteligjencë

⁶⁹ SHIK (ish Shërbimi Informativ kombëtar i Shqipërisë që i ka paraprirë SHISH -it)

⁷⁰ UDB (ish Shërbimi sekret Serb në ish Jugosllavi, gjithashtu i ka paraprirë BIA – s)

⁷¹ ”Agjencia e zbulimit” AZ, është emri zyrtarë i shërbimit të inteligjencës në Maqedoni.

⁷² Vështrim i shpejtë mbi krijimin dhe ndryshimin e shërbimit sekret të shtetit shqiptarë prej shpalljes së pavarësisë në vitin 1912 [Online] Marrë nga: <http://www.shish.gov.al/historik.html>

⁷³ Në vitin 1999 me vendimin nr. 61, datë 22.11.1999 të Gjykatës Kushtetuese të RSH, SHIK ndryshon emërtimin nga Shërbimi Informativ Kombëtar në SHISH Shërbimi Informativ i Shtetit.

Në aspektin legjislativ edhe SHISH – i është modifikuar dhe së fundi ai bazohet në një kornizë ligjore⁷⁴, ku drejtori e zëvendësdrejtori i SHISH emërohen e shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

Shërbimi Informativ i Shtetit në funksion të realizimit të detyrave⁷⁵ të tij mund të bashkëpunojë me shërbimet informative të vendeve të tjera. SHISH bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore në zbatim të këtij ligji, duke u dhënë informacion deri në atë masë që lejon mbrojtja e burimeve dhe e metodave të punës. SHISH po kështu bashkëpunon edhe me entitetet të tjera informative shtetërore apo të huaja në zbatim të ligjeve dhe urdhrave ekzekutivë me qëllim të kontribuojë natyrshëm në ruajtjen dhe forcimin e sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare.⁷⁶

Për SHISH, ligjshmëria, objektiviteti dhe sekreti janë parimet bazë të punës së këtij institucioni. Megjithatë sa përket aspekteve si organizimi i brendshëm përveç tri shtyllave kryesore që janë publike si drejtori, zv. drejtori dhe inspektori i përgjithshëm, pastaj operacionet nuk kemi hasur në të dhëna lidhur as me numrin e personelit apo organogramin, gjithashtu një jo-objektivitet të tillë e kemi pasur edhe me buxhetin.

3.2 BIA, Agjencia e Sigurisë dhe Informacionit (Serbia)

Si ish trashëgimtare e UDB –s ish jugosllave, më vonë RDB –ja, BIA ka filluar të funksionoj si e tillë në verë të vitit 2002, Kuvendi i Serbisë miratoi një ligj që ndan Shërbimi i Sigurisë Shtetërore (*Resor Drzavne Bezbednosti* - RDB) nga Ministria serbe e Punëve të Brendshme (MPB) dhe transformimin e saj në një agjenci e re civile e kontrolluar dhe emëruar si Agjencia e Sigurimit dhe Informacionit (Bezbednosno- Informativna Agencija - BIA).⁷⁷

⁷⁴ Po aty; **Baza ligjore dhe fushat e veprimtarisë së SHISH** Për ushtrimin e aktivitetit të tij, SHISH zbaton Ligjin Nr.8391, datë 28.10.1998 "PER SHERBIMIN INFORMATIV KOMBETAR" i ndryshuar me ligjin Nr.8479, datë 29.4.1999 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8391" datë 28.10.1998 "PËR SHËRBIMIN INFORMATIV KOMBËTAR." [Online] Marrë nga: http://www.shish.gov.al/baza_ligjore.html/

⁷⁵ Sipas nenit 3 të tij saktësohet që: "Shërbimi Informativ Shtetëror mbledh informacion nga jashtë në funksion të sigurimit kombëtar, kryen veprimtari kundërzbulimi për ruajtjen e integritetit, të pavarësisë e të rendit kushtetues, mbledh informacion për terrorizmin, për prodhimin dhe trafikun e narkotikëve, për prodhimin e armëve të dëmtimit në masë, për krimet kundër mjedisit, mbledh informacion për krimin e organizuar, që cenon sigurinë kombëtare".

⁷⁶ Po aty

⁷⁷ Serbia Intelligence and Security Agencies [Online] Marrë nga: <http://www.fas.org/irp/world/serbia/index.html/>

Gjithashtu, ligji për Agjencinë e Sigurisë dhe Informacionit dhe akteve nënligjore të tjera që rregullojnë sferën e aktiviteteve të Agjencisë. Asambleja Kombëtare e Republikës së Serbisë e hyrjën në fuqi të Ligjit për Agjencinë e informacionit të Sigurimit, në takim, të mbajtur më 18 korrik, 2002, në sesion të jashtëzakonshëm të Kuvendit të pestë kombëtar të Republikës së Serbisë në vitin 2002.⁷⁸

"Agjencia kryen detyrat në lidhje me: mbrojtjen e sigurisë së Republikës së Serbisë, zbulimin dhe parandalimin e veprimtarive që kërcënojnë të minojnë apo prishin rendin kushtetues të Republikës së Serbisë, mbledhjen, përpunimin dhe analizën e fshehta të sigurisë dhe informacionit detyra të rëndësishme për sigurinë e Republikës së Serbisë, informimin e autoriteteve kompetente të shtetit në lidhje me të dhënat e tilla, dhe të tjera të përcaktuara me ligj."⁷⁹

Në sferën e aktiviteteve të Agjencisë BIA-s përfshihen:

a) *Aktivitetet e Kundërzbulimit*; Mbledhja, analizimi, përpunimin dhe vlerësimin e informacionit mbi aktivitetet e shërbimeve të huaja të zbulimit, individëve, grupet dhe organizatat në territorin e Republikës së Serbisë, drejtuar kundër sigurisë shtetërore.

b) *Aktivitetet e Inteligjencës*; Nëpërmjet aktiviteteve të kryera jashtë vendit dhe në shtëpi në mbledhjen, analizimin, përpunimin dhe vlerësimin e informacionit politik, ekonomik, të sigurisë dhe të natyrës ushtarake, të cilat u referohen në vende të huaja, politike, ushtarake dhe ekonomike shoqatat dhe organizatat e të cilat tregojnë për qëllimet dhe mundësitë të punës së fshehtë të drejtuar ndaj sigurisë së Republikës së Serbisë. Dhe,

c) Aktivitetet e tjera të sigurisë për parandalimin e aktiviteteve të drejtuara drejt kryerjes së krimit të organizuar, veprave penale me elemente të, të brendshëm dhe ndërkombëtar kundër terrorizmit të huaj, si dhe të rënda penale vepron më kundër njerëzimit, E drejta ndërkombëtare dhe të rendit kushtetues.⁸⁰

⁷⁸Ligji u botua në Gazetën Zyrtare "të Republikës së Serbisë", nr 42/2002 të datës 19 korrik 2002.<http://www.bia.gov.rs/zakonski-okviri-eng.htm>

⁷⁹Po aty, (neni 2 të Ligjit për BIA).[Online] Marrë nga: <http://www.bia.gov.rs/delokrug-rada-eng.htm>

⁸⁰Po aty, The sphere of the Agency's activities includes

3.3 OSA-OBA , Agjenci për Sigurim dhe Inteligjencë / Bosnjës dhe Hercegovinës

Më 22 mars 2004 në bazë të nenit IV. 4.a të Kushtetutës së Bosnje-Hercegovinës, Kuvendi i Parlamentit të Bosnje-Hercegovinës, në seancën e Dhomës së Përfaqësuesit dhe Shtëpisë së Popullit, miratoi Ligjin e Agjencisë së Sigurimit dhe Inteligjencës të Bosnjë-Hercegovinës.⁸¹

Sikurse çdo agjenci e bazuar në ligj edhe Agjencia **OSA-OBA , Agjenci për Sigurim dhe Inteligjencë** është përgjegjës për mbledhjen e informacionit lidhur me kërcënimet kundër sigurisë së Bosnje-Hercegovinës, jo vetëm brenda, por edhe jashtë shtetit. Kërcënimet për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës janë të përcaktuara qartë. Në këtë kontekst, kërcënimet janë konsideruar si një kërcënim për sovranitetin, integritetin territorial, rendit kushtetues dhe bazat e stabilitetit ekonomik të Bosnje-Hercegovinës, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale të cilat janë të dëmshme për Bosnje dhe Hercegovinën (dhe gjithashtu për rajonin, BE-së dhe Botës në përgjithësi).⁸²

Agjencia gjithashtu do të jetë përgjegjës për mbledhjen e inteligjencës si brenda ashtu edhe jashtë Bosnjë-Hercegovinës në lidhje me kërcënimet për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës, duke analizuar të zbulimit të tilla, dhe në përhapjen e zbulimit të tilla të zyrtarëve dhe të trupave të përmendur në nenin 6, paragrafi 5 të këtij ligji, si mbledhjen dhe, analizimin dhe shpërndarjen e inteligjencës për qëllim të sigurimit të ndihmës për zyrtarët e autorizuar të përcaktuar në kodet e procedurës penale në Bosnje-Hercegovinë dhe organet tjera kompetente në Bosnje-Hercegovinë, ku është e nevojshme për të parandaluar kërcënimet për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës.⁸³

Agjencia gjithashtu duhet të bashkëpunojë me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, ndër të tjera, duke siguruar informacion Tribunalit në lidhje me personat përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare në territorin e ish Jugosllavisë që nga viti 1991 (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Ndërkombëtare).⁸⁴ Edhe këtë Agjenci e përbëjnë tri

⁸¹Ky ligj hyri në fuqi ditën e tetë pas është publikuar në Gazetën Zyrtare të Bosnje-Hercegovinës, numri 12 nga 14 prill 2004, dhe Agjencia filluar të punojë më 01 qershor 2004. Marrë në faqen zyrtare të OSA-OBA të Bosnje Hercegovinës, [Online] Marrë nga: <http://www.osa-oba.gov.ba/osaobaeng.htm>

⁸²Po aty, faqja zyrtare; COMPETENCE OF INTELLIGENCE AND SECURITY AGENCY OF BOSNIA AND HERZEGOVINA

⁸³Ligji për Agjencia e Zbulimit dhe Sigurimit të Bosnje-Hercegovinës, DISPOZITAT E PËRGJITHSHME Nenin 6, paragrafi 5 i këtij ligji.

⁸⁴Po aty, Neni 6

shtylla të kontrollit dhe drejtimit; Drejtori i Përgjithshëm, zv. Drejtori dhe Inspektori i Përgjithshëm.⁸⁵ Po ashtu mbikëqyrja Agjencisë është e rregulluar me ligj të kontrollohet nga Dhoma e Përfaqësuesve dhe Dhoma e Popujve të Asamblesë Parlamentare të Bosnjë-Hercegovinës ku së bashku do të krijojnë një komitet të sigurimit të Inteligjencës për mbikëqyrjen e Agjencisë.⁸⁶ Agjencia **OSA-OBA , Agjenci për Sigurim dhe Inteligjencë** ka juridiksion të gjithë territorin e Bosnje-Hercegovinës. Selia e Agjencisë është në Sarajevë.⁸⁷

3.4 SOVA - Agjencia Sllovene për Siguri dhe Inteligjencë / Sllovenia

Agjencia Sllovene për Siguri dhe Inteligjencë (Sova), u themelua pas njohjes ndërkombëtare të shtetit të pavarur e sovran të Sllovenisë dhe është agjenci civile qendrore e zbulimit dhe shërbimit të sigurimit. **Sova** ka një qeverisje të shërbimit të pavarur, të bazuar në parimin se vendi ka nevojë për një efektiv dhe organizatë profesionale, të aftë në ofrimin e organeve të autorizuara me mbështetjen në marrjen e vendimeve të rëndësishme për sigurinë kombëtare. Për të përmbushur misionin e saj, Sova ofron zbulimit nga jashtë, të rëndësishme për mbrojtjen e sigurisë të vendit, politike, si dhe interesat ekonomike. Struktura e saj organizative është hartuar në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e misionit të vet.⁸⁸

Bazë për veprimtarinë e Sova - është Akti i miratuar në prill 1999 dhe ndryshuar në nëntor 2003. Akti përcakton ti transferojë Agjencisë dhe autorizimet, si dhe format e bashkëpunimit me organe të tjera shtetërore. Prioritetet e punës të Sova – s janë të përcaktuara nga Qeveria në bazë të Programit për Sigurinë Kombëtare, të miratuar nga Asambleja Kombëtare.⁸⁹

⁸⁵ Kapitulli IV - Drejtimi i brendshëm dhe i kontrollit të agjencisë (a) të drejtat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm, për më shumë shih: Nenin 24,25,26,27,28,29,30 dhe 31 për kompetencat e Drejtorit Gjeneral dhe Zv. Drejtorit Gjeneral, kurse për Inspektorin e përgjithshëm, përgjegjësitë janë të përshkruara në nenet; 32,33,34,35 të këtij ligji.

⁸⁶ Po aty, neni 18 / Mbikqyrja Parlamentare

⁸⁷ Po aty, Address: Mehmeda Spahe 7, 71000 Sarajevo Phone: +387 (0) 33 22 33 44 e-mail: [Online] Marrë nga: osa_ob@bih.net.ba

⁸⁸ Faqja zyrtare e SOVA –s [Online] Marrë nga: http://www.sova.gov.si/en/index845c.html?sv_path=1102,1107

⁸⁹ Po aty. SLOVENE INTELLIGENCE AND SECURITY AGENCY ACT Consolidated version (ZSOVA-UPB2) (RS Official Gazette No. 81/06)

Në sistemet demokratike, puna e agjencive të sigurisë dhe shërbimeve të fshehta është nën mbikëqyrje të vazhdueshme, veçanërisht për sa i përket respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore është i shqetësuar. Megjithatë Republika e Sllovenisë është një nga anëtarët e komunitetit të vendeve demokratike, në punën e zbulimit të tij dhe shërbimet e sigurisë është e kontrolluar nga disa institucione. Në ushtrimin e punës së saj, Sova mbikëqyrret nga Qeveria, mbikëqyrjes parlamentare Komisionit, Gjykata e Qarkut përkatës, Avokati i Popullit, Gjykata e Auditimit të Buxhetit dhe Zyra e Mbikëqyrjes pran Ministrisë së Financave dhe publiku. Përveç mbikëqyrja nga jashtë, Agjencia mbikëqyrret edhe nga brenda.⁹⁰

3.5 AZ – Agjencia për zbulim / Republika e Maqedonisë

Agjencia për zbulim është formuar si organ i posaçëm në administratën shtetërore, me Ligjin për Agjencinë për zbulim i miratuar në prill të vitit 1995.⁹¹

Kompetencat e Agjencisë për zbulim janë definuar në nenin 2 dhe nenin 6 në Ligjin për Agjencinë për zbulim.¹ Bën grumbullimin e të dhënave dhe informatave domethënëse për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë, interesat ekonomike, politike dhe interesat e tjera të shtetit. 2. Kryen analiza dhe hulumtime të të dhënave dhe informatave dhe detyrimisht i raporton Kryetarit të Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe organeve tjera shtetërore për çështje të rëndësishme në fushëveprimin e tyre. 3. Bashkëpunon me organet shtetërore për çështjet me interes të përbashkët. Në realizimin e bashkëpunimit të ndërsjellë, Agjencia dhe organet shtetërore janë të detyruar reciprokisht t'i dorëzojnë të dhëna, njoftime, informata dhe t'i koordinojnë aksionet në kompetencë të Agjencisë.⁹²


⁹⁰ Po aty. [Online] Marrë nga: http://www.sova.gov.si/en/index42bd.html?sv_path=1102,1108, shikuar për herë të fundit me 02.04.2010)

⁹¹ Gazeta Zyrtare / Ligji për Agjencinë për zbulim të Republikës së Maqedonisë është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më vitin 1995. [Online] Marrë nga: http://www.ia.gov.mk/alban/ar_a.htm

⁹² Ligji për Agjencinë për zbulim të Republikës së Maqedonisë është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më vitin 1995. [Online] Marrë nga: http://www.ia.gov.mk/alban/ar_a.htm

TABELA NR. 8 ORGANOGRAMI I AGJENCISË PËR ZBULIM NË MAQEDONI

Struktura Organizative e Agjencisë për zbulim AZ



Me Agjencinë për zbulim udhëheq drejtori⁹³ të cilin e emëron dhe e shkarkon Kryetari i Republikës së Maqedonisë. Drejtori emërohet me mandat katër vjeçar. Për punën e tij dhe punën e Agjencisë drejtori i përgjigjet Kryetarit të Maqedonisë.

Drejtori i Agjencisë është anëtarë i Këshillit të sigurisë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund të kërkojë përgjegjësi nga Drejtori për punën e Agjencisë për zbulim. Drejtori i Agjencisë miraton akte për organizimin dhe punën si dhe për sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci pasi të ketë marrë pëlqim nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.⁹⁴

⁹³ z.Naqe Çulev është emëruar u.d i drejtorit me 27. 03 .2012, përkatësia kombëtare Maqedonas, i lindur më 26 Korrik 1972 në Kavadarë.

⁹⁴ Po aty Faqja elektronike e Agjencisë për Zbulim[Online] Marrë nga: http://www.ia.gov.mk/alban/ar_a.htm

Mbikëqyrja dhe kontrolli parlamentar për punën e Agjencisë për Zbulim

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë mbikëqyrë punën e Agjencisë për zbulim përmes Komisionit përkatës. Komisioni dorëzon raport deri tek Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për punën e kryer, më së paku një herë në vit. Drejtori është i obliguar të mundësojë njoftim rreth punës së bërë dhe t'i jap të gjitha raportet dhe të dhënat nga sfera e punës së Komisionit.⁹⁵

Konkludimet në lidhje me raportin e Komisionit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i dorëzon deri tek Kryetari i Republikës së Maqedonisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

- *Kryetari i Republikës së Maqedonisë*
- *Kuvendi i Republikës së Maqedonisë*
- *Qeveria e Republikës së Maqedonisë*
- *Ministria për Financa*
- *Gjyqësori*
- *Avokati i popullit*
- *Opinionit*

Kontakti fizik, telefonik dhe elektronik me Agjencinë për Zbulim në Maqedoni

Adresa rr. Brigada e tretë maqedonase p.n. 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë tel: ++ 389 2 2442 2 faks: ++ 389 2 3294 098e-mail: ia@ia.gov.mk⁹⁶

⁹⁵ Po aty Faqja elektronike e Agjencisë për zbulim [Online] Marrë nga: http://www.ia.gov.mk/alban/ar_a.htm

⁹⁶ Faqja zyrtare e Agjencisë për zbulim është: [Online] Marrë nga: <http://www.ia.gov.mk/>

Njohje e shërbimeve të inteligjencës në nivel global

Niveli global, krahasimi i shërbimeve të Inteligjencës

Sa i përket kualitetit gjithëpërfshirës të krahasimit të shërbimeve të Inteligjencës duke filluar nga Amerikanët në drejtime të ndryshme e sidomos kundër Sovjetikëve dhe komunizmit të cilët edhe pse e kishin humbur Luftën e Ftohtë, gjithmonë ka pasur shërbime të efektshme Inteligjente. Për CIA – n nuk mund të bëhej më fjalë që të kufizohej me mbledhjen e informacioneve dhe agjencia e fshehtë u hodh në betejë për të vërshtuar kudo që ekspansioni komunist kërcënonte interesat e Shteteve të Bashkuara.⁹⁷ Krahasimi në mes KGB –së dhe CIA –s, Rusëve dhe Amerikanëve s’është i vështirë për shkak se Rusët kishin HUMINT⁹⁸ të mirë, ndërsa Amerika ua kalonte në SIGINT⁹⁹ dhe ELINT¹⁰⁰ (inteligjencës elektronike) Pra, mund të thuhet se top lista e 5 – vendeve si Rusia (HUMINT më të mirë), SHBA (më të mirë SIGINT dhe ELINT), Kina (2 HUMINT më të mirë dhe efikas të rrjetit global), Izraeli (më të mirë kundër terrorit), ndërsa Mbretëria e Bashkuar (MI5 dhe MI6) akoma më e mira në Evropë)¹⁰¹.

3.6 CIA Central Intelligence Agency (ShBA)

Agjencia Qendrore e Inteligjencës (CIA) u krijua zyrtarisht nga presidenti Harry S. Truman, kur ai nënshkroi Aktin e Sigurimit Kombëtar 1947. Ky akt edhe caktoi zyrtarisht e drejtorin e zbulimit qendror për të shërbyer si kreu i komunitetit të zbulimit të SHBA-s dhe të veprojë si këshilltar i presidentit kryesor për çështjet e zbulimit në lidhje me sigurinë kombëtare¹⁰²

Sot në ShBA, janë themeluar 16 organizata që merren me ofrimin e shërbimeve inteligjente të zbulimit dhe kundërzbulimit, në mesin e të cilave është edhe CIA, për të cilën shkurtimisht do njihemi në vijim. Çuditërisht ka mendime, sipas autorit **William Cooper** se CIA është themeluar me qëllim që të fshehë

⁹⁷**DAVID C. MARTINKGB** kundër CIA, Mizoria e Pasqyrave, Shtëpia Botuese ONURFI, Botim i dytë 2007 përktheu Ardian Klosi, Kreu i parë, Pafajësia e Humbur, faqe 14

⁹⁸“HUMINT”(Human Intelligence) foma më e vjetër e mbledhjes së informatave. <http://arifi9.spaces.live.com/IntelligenceCommunity>” dhe roli i tyre në shoqëri.

⁹⁹ “SIGINT“(Signals Intelligence) është një formë teknike, e shpikur gjatë Luftës së I dhe II-të botërore. SIGINT- mbledh dhe analizon komunikimet teknike si p.sh; përgjimet e bisedave telefonike, ushtarake etj.

¹⁰⁰ ELINT (electromagnetic intelligence), Interceptim në zënie dhe analiza e sinjaleve elektromagnetike të vendeve të tjera duke përfshirë radarëve, radio, telefonisë, dhe transmetimet mikrovalë. Ajo mund të kryhet në mënyrë efektive duke përdorur satelitët. ELINT është një nën-kategori të SIGINT (sinjale të shërbimit të fshehtë). [Online] Marrë nga: <http://www.daviddarling.info/encyclopedia/E/ELINT.html>

¹⁰¹**Soylent Green** RE: What is best intelligence ... another angel on the head of a pin. 6/14/2003 8:07:27 AM[Online] Marrë nga: <http://www.strategypage.com/militaryforums/13-99.aspx>

¹⁰²**Wagner, Heather Lehr.** The Central Intelligence Agency Chelsea HouseAn imprint of Infobase Publishing132 West 31st StreetNew York, NY 10001Copyright ©2007 by Infobase Publishing INTELLIGENCE IN AMERICA, version pdf faqe 13

problemin e jashtokësorëve.¹⁰³ Organizata e parë e shërbimit Inteligjent me strukturë formale organizative, është themeluar në qershor të vitit 1942, e quajtur (Office of Strategic Services OSS), “Zyra e Shërbimeve Strategjike”, si paraardhëse e CIA-së. Hirearkia më e lartë në strukturën organizative të CIA-së është Drejtori i CIA-së¹⁰⁴

Drejtori i CIA-së *Director of the Central Intelligence Agency(D-CIA)*, **Zyra për Punët Publike** *The Office of Public Affairs (OPA)*, **Zyra e Resurseve Humane** “*Human Resources (HR)*”, **Zyra e Këshillit të Përgjithshëm** *Office of General Counsel (OGC)* dhe gjithashtu i ka edhe katër drejori ekzekutive¹⁰⁵. Qendra kryesore e CIA gjendet në bashkinë e [Langley \(Langlit\)](#) të [Virginia \(Virgjinias\)](#) në [Washington, D.C \(Uashington D.C.\)](#). AQI (*Agjencia Qendrore e Inteligjencës*) është pjesë e Bashkësisë së Zbulimit Amerikan dhe udhëhiqet tani nga Drejtori i Zbulimit Kombëtar (*Director of National Intelligence*, shkurt DNI).¹⁰⁶

Shpenzimet vjetore në buxhet dhe personel që bartin me vete këtë agjenci sipas ranglistës prijnë:

Zyra nacionale e zbulimit (përgjegjës për satelitë), shpenzime vjetore 6.2 miliardë dollarë.

Agjencia kombëtare e Sigurisë (National Security Agency) NSA, shpenzime vjetore \$ 3,7 bilion dhe personel 38 000.

Agjencia Qendrore e Inteligjencës (Central Intelligence Agency) CIA, shpenzime vjetore \$ 3,1 bilion dhe personel 17 000.

Agjencia Inteligjente e Mbrojtjes (Defense Intelligence Agency) DIA, shpenzime vjetore \$ 2 bilion dhe personel 11 000¹⁰⁷

¹⁰³ Helsing van JAN, Shoqëritë Sekrete dhe fuqia e tyre botërore, përktheu, Enkelajd Musabelliu, Plejad, faqe 246


¹⁰⁴Faqja zyrtare e CIA –së[Online] Marrë nga: (<https://www.cia.gov/offices-of-cia>)

¹⁰⁵**Shërbimi Nacional – Sekret Klandestin***National Clandestine Service (NCS), Drejtoria e Inteligjencës Directorate of Intelligence(DI), Drejtoria për Shkencë dhe Teknologji The Directorate of Science and Technology (DS&T) dhe Drejtoria për Mbështetje Directorate of Support (DS).* Po aty.

¹⁰⁶Nga Wikipedia, Enciklopedia e Lirë; Central Intelligence Agency (CIA) (sq: *Agjencia Qendrore e Inteligjencës*).

¹⁰⁷ Political Control over Civilian Intelligence Organizations in the Age of Internet / Dissertation for the award of educational and scientific degree “Doctor” in political science cipher 05:11:02 Academic supervisor: Professor Alexander Tomov Sofia, 2010, page 120.

TABELA NR . 9 STRUKTURA ORGANIZATIVE E CIA SË¹⁰⁸



¹⁰⁸ Struktura Organizative e CIA-së [Online] Marrë nga: www.cia.gov/offices-of-cia , [Qasja e fundit, Shtator 2015]

3.7 FSB Federal'naya Sluzhba Bezopasnosti (Rusia)

Historiku i FSB – s fillon me shpërndarjen e KGB –s në dhjetor 1991, vetëm pak para shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, për ta ndërruar fytyrën e re të shërbimit sekret e që ishte KGB –ja, si e tillë ajo kishte disa organizata si: *Shërbimet Federale vendas të sigurimit, Shërbimit e Jashtëm të Inteligjencës, Shërbimin e Rojeve kufitare Federal, dhe Agjencia e Komunikacionit* Ekziston edhe një degë e inteligjencës - Inteligjencës kryesore që është quajtur *Drejtoria e Shtabit të Përgjithshëm* - që është drejtuar nga ushtria.¹⁰⁹

FSB-ja udhëhiqet në punën e vet me Kushtetutën e Federatës Ruse, ligjet federale kushtetuese, ligjet federale, dhe direktivat e Presidentit të Federatës Ruse, dekreteve dhe

direktivave të Qeverisë së Federatës Ruse, marrëveshjet ndërkombëtare të Federatës Ruse, dhe me këtë Statut.¹¹⁰

FSB –jasi (pasardhëse) e **KGB**-së. Shërbimi i Sigurimit Federal të Federatës Ruse (FSB) është agjencia kryesore e brendshme të sigurisë të Federatës Ruse dhe agjencia kryesore trashëgimtare të periudhës sovjetike Cheka, NKVD dhe KGB. Funkcioni i FSB – s është e përfshirë në misionet të kundër-zbulimit dhe sigurimit të kufijve të brendshëm, kundër terrorizmit. Selia e FSB –së është në rrugën *Lubyanka Square*, në qendër të qytetit Moskë, vendin e njëjtë të ish-selia e KGB.¹¹¹

¹⁰⁹New York Times, December 14, 2000 A Web Site That Came in From the Cold to Unveil Russian Secrets By SALLY Mc GRANE [Online] Marrë nga: <http://www.fas.org/sgp/news/2000/12/nyt121400.html>

¹¹⁰*Description of Source: Moscow Rossiyskaya Gazeta in Russian -- Government daily newspaper.*) Approved by Presidential Edict No 960 of 11 August 2003, signed by V. Putin, President of Russian Federation published in Rossiyskaya Gazeta, 15 August 2003. Miratuar nga dekret presidencial nr 960 e 11 gusht 2003, i nënshkruar nga V. Putin, President i Federatës Ruse të botuar në Rossiyskaya Gazeta, 15 gusht 2003

¹¹¹Për të dhëna më specifike shih: Federal security service, the FSB, [Online] Marrë nga: <http://www.agentura.ru/english/dosie/fsb/>

3.8 SIS Secret Intelligence Service MI6 (Shërbimi Anglez)

Historiku, zanafilla dhe fillet e Shërbimit Informativ Sekret (SIS), qëndron pikërisht në vendimin e marrë nga Komiteti Perandorak i Mbrojtjes në 1909 për të krijuar një Shërbim Sekret të Byrosë. Kjo datë shënon herën e parë kur Britania kishte themeluar zyrtarisht dhe për herë të parë shërbimin e përhershëm të zbulimit. Por historia e organizatave të shërbimit të fshehtë britanik, të angazhuar në mbledhjen e informacioneve të huaja të zbulimit si dhe në zënien e mesazhe nga postat, shkon prapa të paktën për gjysmën e dytë të shekullit të 15.¹¹²

Legjislacioni dhe Përgjegjësit; Shërbimit Informativ Sekret SIS- si britanik, sikurse edhe agjencitë e tjera të zbulimit dhe sigurisë, është subjekt parlamentar, ministror, dhe nën mbikëqyrjen gjyqësore dhe financiare. Mbikëqyrja është e bazuar në dy pjesë kryesore e legjislacionit në Mbretërinë e Bashkuar, Akti për Shërbimet e Inteligjencës 1994 (ISA) *Intelligence Services Act* dhe Rregulloren e Fuqisë Hetuese, Akti 2000 (Ripa) *Regulation of Investigatory Powers Act*.¹¹³

Mbikëqyrja Ministrore; SIS është përgjegjës për veprimet e saj ndaj Sekretarit të Jashtëm. Sekretari i Jashtëm është përgjegjës për SIS –in dhe mund të delegoj zyrtarët e lartë të jashtëm dhe të Commonwealth-it. Si pjesë e procesit të llogaridhënies, SIS kërkon lejen e Sekretarit të Jashtëm, ose i caktuar FCO (*officials for significant operations*) zyrtarëve të lartë për operacione të rëndësishme.¹¹⁴

Mbikëqyrja Financiare: Financimi dhe kontrollet financiare; Format e buxhetit të SIS-it janë pjesë e llogarisë së vetme të inteligjencës (SIA) *Single Intelligence Account*, e cila përfshinë buxhetin për SIS -in dhe për dy agjensitë e inteligjencës të sigurisë. Zyrtari i kontabilitetit për (SIA) është Këshilltar i Kryeministrit për Siguri dhe Shefi i Inteligjencës për siguri dhe elasticitet

¹¹²A **HISTORY OF SIS**, Historiku i krijimit të Shërbimit Informativ Sekret (SIS) [Online] Marrë nga: <http://www.mi6.gov.uk/output/history-of-sis.html>

¹¹³/ Intelligence Services Act 1994/1994 CHAPTER 13 ARRANGEMENT OF SECTIONS/ Akti për Shërbimet e Inteligjencës 1994 1994 KAPITULLI 13 and Regulation of Investigatory Powers Act 2000/2000, CHAPTER 23, ARRANGEMENT OF SECTIONS .[Online] Marrë nga: http://www.opsi.gov.uk/acts/acts1994/UKpga_19940013_en_1.htm

¹¹⁴Po aty; Ministerial Oversight , Mbikëqyrja Ministrore. [Online] Marrë nga: <http://www.mi6.gov.uk/output/ministerial-oversight.html/>

aktualisht, Hannigan Robert. Fondet bugjetore të caktuara SIS -it drejtpërdrejtë reflektojnë politikën e qeverisë dhe prioritetet për inteligjencën.¹¹⁵

Shërbimit Sekret i Zbulimit (SIS), i njohur shpesh si MI6, mbledh të informacione të zbulimit nga jashtë për Britaninë. Lokacioni i shërbimit është në Vauxhall Cross¹¹⁶ në Londer. Shefi i saj është John Sawers. SIS ofron me një aftësi të madhe të informacionet e fshehta globale për të promovuar dhe mbrojtur sigurinë kombëtare dhe mirëqenien ekonomike të Mbretërisë së Bashkuar.

3.9 BND Bundesnachrichtendienst, Shërbimi Informativ Federal (Gjermani)

Historiku i Shërbimit Informativ Federal (BND) –s daton që në prill të vitit 1956 kur kontrollin e Organizatës e kishte marrë Gehlen në Republikën Perëndimore Federale Gjermane e sapo e pavarur si BND -ja. Gehlen kishte drejtuar BND deri në vitin 1968, kur ai u pasua nga të Drejtori i Përgjithshëm Wessel, një specialist për çështjet sovjetike dhe të organizatave.¹¹⁷

Aspekti legjislativ; BND –ja është e mbikëqyrur nga Komisioni i Kontrollit Parlamentar (KKP) për shërbimet e zbulimit. Ligji mbi luftimin e krimit, i cili u miratua në 1994, i cili e autorizon BND -n të përgjojë linjat të telekomunikacionit vetëm për mbledhjen e inteligjencës së huaj. Megjithatë ligji e autorizon BND -n për t'ia kaluar prokurorisë informatat e marra nga përgjimi i thirrjeve ndërkombëtare me telefon në lidhje me krime të rënda të caktuara që kanë të bëjnë si armë, trafikut të drogës, apo të terrorizmit. Sigurimi i lejes fillimisht siç ishte e planifikuar se shërbimi i inteligjencës mund të jetë i përfshirë në hetimet me kërkesë të autoriteteve të prokurorisë nuk ishte përfshirë në legjislacionin e fundit¹¹⁸

BND -ja, e cila ka operativët (agjentët zbulues) në më shumë se 100 vende kanë të bëjnë me marrjen e informacionit. Në të shumtën e rasteve, ata janë të maskuar si punonjës të ambasadës

¹¹⁵Po aty; *Financial Oversight: Funding and Financial Controls / Mbikëqyrja Financiare: Financimi dhe kontrollet financiare* [Online] Marrë nga: <http://www.mi6.gov.uk/output/financial-oversight.html>

¹¹⁶Sqarim, Vauxhall Cross, është një zonë e brendshme të qytetit në Jug të Londrës, Vauxhall Cross është menjëherë në jug-lindje të Vauxhall Bridge, ku konvergojnë gjashtë rrugët kryesore, Vauxhall Cross u përshkrua si një nga nyjet rrugore më të pakëndshme në jug të Londrës, Vauxhall Bridge është selia qendrore e Shërbimit Sekret të Zbulimit britanik (e njohur si më shpesh si SIS - MI6)

¹¹⁷Histroy, Federal Intelligence Service , Historiku i BND –së, Shërbimit Fedearl të inteligjencës.[Online] Marrë nga: <http://ftp.fas.org/irp/world/germany/bnd/index.html>,

¹¹⁸Po aty, BND Legislative Authority

dhe kanë adresën e tyre në emër të "oficerit të dytë politik. Rreth 1000 "cruising monitoron" agjentë (krehër valësh) gjatë tërë kohës hetojnë të gjitha bisedat telefonike të radios, teleksit dhe trafikut të fax –it si prioritete të rëndësishme, përtej raportimit të krizave aktuale, që përfshijnë trafikun e armëve dhe të drogës, kontrabandës së plutoniumit, armatimit, apo organizata terroriste dhe kërcënimet ndaj rrugëve ndërkombëtare të trafikut.¹¹⁹ BND –ja gjithashtu ka qenë e përfshirë në një përpjekje të bashkërenduar evropiane për të ndaluar marrëveshjet e armëve dhe kontrabandën. BND -ja ka vendosur asokohe agjentët e vet midis aktivistëve islamikë në qytete të ndryshme gjermane, si dhe ka intensifikuar aktivitetet e mbikqyrjes e saj në Evropën Qendrore.¹²⁰

Sa i përket kostos së personelit përllogaritet për gati 70 për qind të buxhetit BND. Shërbimi Informativ Federal (BND) ka pasur një plan të reduktojë¹²¹ stafin e vet nga 6300 punonjës e ka reduktuar në 4500 sish . Niveli i stafit aktiv rreth 7.600 gjatë Luftës së Ftohtë, ndërsa 6000 punonjës gjendet në selinë qendrore dhe 1500 në degët dhe në lokacione jashtë shtetit. Gjysma e stafit përbëhet nga civilët që punojnë nën kontratë, një e treta janë të nëpunësve të përhershëm civilë, dhe një në çdo 10 -të është një njeri i shërbimit ushtarak.

3.10 Mossad. Instituti për Inteligjencë dhe Detyra të Veçanta (Izrael)

Historia e Mossad fillon pothuajse menjëherë pas krijimit të Shtetit të Izraelit. Në vitin 1949 „Instituti Qëndror për Koordinim” *Central Institute for Coordination*’ (*CIC*) u ngrit për përmirësimin e koordinimit në mes të Shabak, Aman dhe departamentit politik të zyrës së jashtme. Ajo ishte nën kontrollin e Ministrisë së Jashtme. Më 1 prill 1951 krijimi i Mossad-it¹²² dhe (CIC) *Central Institute for Coordination*’ u zëvendësua nga Mossad nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit.¹²³

Misioni i Mossad-t ¹²⁴ ka përgjegjësi për mbledhjen e inteligjencës njerëzore, veprim të fshehtë, si dhe të antiterrorizmit. Fokusi i saj është në vendet arabe dhe të organizatave të gjithë botën. Mossad

¹¹⁹Po aty, <http://ftp.fas.org/irp/world/germany/bnd/ops.htm> BND Operations

¹²⁰Po aty

¹²¹Po aty; **BND Budget and Personnel** Sqarim i të dhënave deri në vitin 2000; Një reduktim i mëtejshëm i 15 për qind është planifikuar deri pas vitit 2000. Fillimisht, reduktimi është dashur të jetë më i shpejtë, por kjo do të ketë rritur shpenzimet për shkak të pagesave për pensionim të parakohshëm. Gjithshtu BND-ja nëpunësit civilë dhe personelin ushtarak të punësuar në BND kur ata të arrijnë moshën e daljes në pension, postet e tyre nuk do të janë të mbushura. Edhe pse rreth 1100 pozicione duhet të eliminohet, jo më shumë se 180 njerëz janë planifikuar të dalin në pension deri në vitin 2000.

¹²² ALDO MUSCI / MARCO MINICANGELI, Të fshehtat e MOSADIT (Historia e një prej shërbimeve sekrete më të frukshme të botës), Shtëpia botuese, Bota Shqiptare, Tiranë 2005, Kronologjia e ngjarjeve të treguara faqe 181

¹²³[Online] Marrë nga: <http://www.topspysecrets.com/mossad-history.html> /History of Mossad

¹²⁴Fjala; Mossad hebraisht do të thotë "institut" shih; [Online] Marrë nga: <http://ftp.fas.org/irp/world/israel/mossad/index.html>

gjithashtu është përgjegjës për lëvizjen e fshehtë e refugjatëve hebrejë nga Sirisë, Iranit, dhe në Etiopi. Agjentë të Mossad-it janë aktive në vendet ish-komuniste, në Perëndim, dhe në OKB. Mossad – i e ka selinë në Tel Aviv.

Stafi i Mossadi-t është vlerësuar gjatë viteve 1980 në numër nga 1500 në 2000 agjentë, kurse në vlerësimet më të fundit vendosja e stafit është përkufizuar rreth 1200 sish.¹²⁵

Mossad –i përbëhet prej tetë departamenteve, edhe pse disa të dhëna për organizimin e brendshëm të agjencisë mbeten të panjohura. Koleksioni i Departamentit është më i madhi, me përgjegjësinë për operacionet e spiunazhit, me zyrat diplomatike jashtë vendit, pastaj Departamenti i veprimit politik dhe ndërlidhjes, Dega e Operacioneve Speciale, *LPA (Psichologit Lohamah)* Departamenti i Psikologjisë dhe Propagandës, Departamenti i Kërkimeve dhe Departamenti i Teknologjisë etj.¹²⁶

Sipas autorëve: Viktor Ostrovski dhe Claire Hoy MOSAD-i ka gjithësej 1200 punonjës së basku me sekretaret dhe pastruesit, që e kanë marrë urdhër që kur të pyeten të thonë se punojnë në Ministrinë e Mbrojtjes. Mosadi ka rreth 35.000 agjent të rekrutuar në gjithë botën, prej tyre 20.000 në veprim dhe 15.000 në gjendje gatishmërie.¹²⁷

3.11 MIT – Organizata Kombëtare e Inteligjencës (Turqi)

Edhe MIT, sikurse të gjitha organizatat, apo agjencitë e inteligjencës, varësisht nga emërtimi dhe specifikat shtetërore është themeluar me qëllim të ruajtjes së sigurisë kombëtare të Republikës së Turqisë.

Organizata Kombëtare e Inteligjencës (Turkish: Millî İstihbarat Teşkilatı, MİT) është organizata qeveritare e inteligjencës e Turqisë. Është themeluar në vitin 1965 për të zëvendësuar Shërbimin e Sigurisë Kombëtare.¹²⁸

¹²⁵ Po aty; Mossad The Institute for Intelligence and Special Tasks [ha-Mossad le-Modiin ule-Tafkidim Meyuhadim]

¹²⁶ Po aty / Mossad has a total of eight departments, though some details of the internal organization of the agency remain obscure. <http://ftp.fas.org/irp/world/israel/mossad/index.html>

¹²⁷ Ostrovski Viktor dhe Hoy Claire, Në rrjetën e Mosadit, përktheu; Robert Kosova dhe Xhilda Roko, Plejad, Tiranë, faqe 341

¹²⁸ [Online] Marrë nga: <https://www.mit.gov.tr/eng/tarihce.html>

Sipas ish-drejtorit të Operacioneve të Jashtme, Yavuz Ataç, prania ushtarake në organizatë është e papërfillshme.¹²⁹ Ky është një zhvillim i kohëve të fundit, pasi organizata ka një trashëgimi ushtarake. Në vitin 1990, pjesa e personelit ushtarak ishte 35%. Sot ajo ka rënë në 4.5% në nivelet më të ulëta.

Përgjegjësitë e MIT –it

Organizata Kombëtare e Inteligjencës MİT, ekziston për të shërbyer në Republikën e Turqisë dhe është e pajisur me detyra dhe përgjegjësi në përputhje me këtë qëllim, është përgjegjës për mbledhjen e inteligjencës së sigurisë në nivel kombëtar mbi kërcënimet ekzistuese dhe potenciale nga burimet e brendshme dhe të jashtme të paraqitura ndaj territorit, njerëzve dhe integritetit, ekzistencën, pavarësinë, sigurinë dhe të gjitha elementët e tjerë që përbëjnë rendin kushtetues dhe fuqinë kombëtare të Republikës së Turqisë. MTI është përgjegjëse për komunikimin e inteligjencës së mbledhur për Presidentin, Kryeministrin, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe organizata të tjera shtetërore përkatëse sipas nevojës¹³⁰.

Siguria kombëtare përmes Kundërzbulimit dhe platformës Kibernetike “Kufiri i pestë”

MİT është përgjegjëse për aktivitetet e kundërzbulimit në Turqi. MTI –it nuk mund t'i jepet asnjë detyrë tjetër dhe nuk mund të drejtohet në ndonjë fushë tjetër të veprimtarisë sesa mbledhja e shërbimit të fshehtë në lidhje me sigurinë e Republikës.

MİT –i, specifikisht angazhohet në një program proaktiv të mbrojtjes kibernetike për Turqinë dhe përdorimin e virusit kibernetike si një platformë për sulmin. Ministria turke e Mbrojtjes Kombëtare e konsideron sigurinë kibernetike si "kufiri i pestë" i vendit pas tokës, ajrit, detit dhe hapësirës. MİT përdor zgjidhjet lokale të sigurisë kibernetike të zhvilluara kryesisht nga kompanitë Havelsan¹³¹ dhe Tübitak¹³².

¹²⁹ Ünlü, Ferhat (2007-07-16). "İngiliz general Apo'nun başına beş milyon sterlin istedi". Sabah (in Turkish). Retrieved 2008-12-18. Ataç, ordu kökenlilerin oranının hiçbir zaman yüzde dördü geçmediğini belirttiği MİT'te, sivilleşme olgusu ve asker-sivil sorunsalının yanlış ele alındığı görüşünde.

¹³⁰[Online] Marrë nga: National_Intelligence_Organization_(Turkey)#Organizational_structure "National Intelligence Organization". mit.gov.tr. Retrieved 2017-02-25.

¹³¹ Kompani e specializuar e sistemeve të radarëve në Turqi [Online] Marrë nga:<http://www.htr.com.tr/>

¹³²Këshilli Shkencor dhe Teknologjik i Kërkimeve të Turqisë[Online] Marrë nga:<https://www.tubitak.gov.tr/>

Struktura ligjore dhe organizative

Edhe MIT, sikurse agjencitë e tjera të inteligjencës, është krijuar për të siguruar ruajtjen e sekretit në kryerjen e detyrës dhe aktiviteteve që është përgjegjës. Kjo për MTI-in është padyshim e një rëndësie të madhe. Baza dhe struktura ligjore e Organizatës mund të gjendet në Ligjin nr. 2937, Ligjin për Shërbimet e Informacionit Shtetëror dhe Organizatën Kombëtare të Inteligjencës Turke, si dhe disa ligje të tjera.¹³³

Duke u nisur nga kjo pikëpamje e ruajtjes së SEKRETIT, për MIT –in është e një rëndësie tejjet e posaçme, përndryshe do të ishte e pamundur që shërbimet e inteligjencës të përmbushen misionin në nivelin e kërkuar. Fshtësia e të dhënave dhe informatave lidhur me detyrat dhe aktivitetet e MTI-t janë të zbatuara me një klauzolë penale të përfshirë në Ligjin e Themelimit Organizativ. Nën nenin e 27-të, do të ballafaqohet me dënim me burgim në rastet e marrjes së shënimeve dhe informatave në lidhje me detyrat dhe veprimtaritë e MTI-së, duke zbuluar këto shënime dhe informata për neglizhencë dhe duke shkaktuar këto të dhëna dhe informata për t'u marrë nga persona të paautorizuar.¹³⁴

MIT –i ka pësuar një reformë strukturore rrënjësore duke u mbështetur në praktikën e SHBA –ve, rrjedhimisht të agjencive të specializuara të sigurisë dhe inteligjencës që sot i ka 16 sish funksionale SHBA –ja¹³⁵, në fuqizimin e departamenteve të specializuara, duke iu krijuar edhe logot e veçanta dhe fuqinë e operacioneve kritike multifunksionale.

¹³³"National Intelligence Organization". mit.gov.tr. Retrieved 2017-02-25. [Online] Marrë nga: <https://www.mit.gov.tr/eng/gorev.html>

¹³⁴"Post-coup shake-up at Turkey's intelligence agency". 6 November 2016.

¹³⁵ Koncepti i organizimit të Agjencie të Inteligjencës në SHBA është i strukturuar nën "Bashkësia e Inteligjencës" apo e njohur edhe si "Komuniteti i Inteligjencës" i bazuar në aktet ligjore si: Section 102 (d) (5), Nacional Security Act of 1947.P.L.80-253; hercafter cited as Nacional Security Act of 1947. [Online] Marrë nga: <https://www.dni.gov/index.php/ic-legal-reference-book/national-security-act-of-1947>

Në MIT ekzistojë gjatë Drejtori “Başkanlığı” të specializuara që janë shtylla të organizatës

Bazuar në modelin "Komuniteti i Inteligjencës" nga Shtetet e Bashkuara, i cili, siç u theksua edhe më lartë ka 16 organizata të veçanta të specializuara në fusha të ndryshme në vend të një shërbimi të vetëm të inteligjencës. Në këtë funksion MIT ka themeluar gjashtë Başkanlığı¹³⁶ të Inteligjencës, duke i strukturuar mire dhe shpërndarë sipas kapaciteteve operationale:

FIG.NR 10 STRUKTURA E AGJENCISË KOMBËTARE TË INTELIGJENCËS TURKE



“UNAZA PËRRETH BOTËS”

1. Drejtoria e Analizës Strategjike¹³⁷

Logoja e Drejtorisë së Analizës Strategjike përfshinë unazat që rrethojnë botën. E mbështetur në idenë analitike, theksohet se analiza e zhvillimeve në botë është bërë me këto unaza.

¹³⁶ Fjala “Başkanlığı” ka kuptim të Kryetarit apo Presidencës, por ka edhe kuptime të tjera si: “kryesuar”, “drejtues”, pra varësisht nga konteksti që vë në fjali. Në një kuptim pak më specifik, sidomos tek Inteligjenca në rastin tonë, bazuar edhe në praktikën e agjencive të tjera, kjo fjalë, edhe në punimin tonë është përshtatur si formulim tematik “Drejtori” për të dhënë kuptim funksional trajtimit të emërtimeve në Shqipëri të gjashtë shtyllave të MIT –it. [Online] Marrë nga: <https://sq.glosbe.com/tr/sq/Ba%C5%9Fkanl%C4%B1%C4%9F%C4%B1>

¹³⁷ Versioni në Gjuhën Turke: Stratejik Analiz Başkanlığı

“MESAZHI I HUAJ”

2. **Drejtoria e Rezistencës së Inteligjencës**¹³⁸

Logoja e Presidencës së Shpëtimit të Inteligjencës shpjegojnë se aktivitetet e agjencive të huaja të inteligjencës do të jenë të pakonsiderueshme. Peshqit e delfinit mund të gjejnë udhëzime edhe nëse janë të mbuluara me ujë nga sensorë të ngjashëm me radarët.

“KREU I SHQIPONJËS”

3. **Drejtoria e Operacioneve të Jashtme**¹³⁹,

nënkupton se kërcënimet që mund të drejtohen nga fqinjët janë nën vëzhgim të përhershëm.

“NËN KRAHËT E BOTËS”

4. **“Drejtoria e Inteligjencës së Sigurisë”**¹⁴⁰ Turqia mbështetët se shifrat në botë simbolizon dhe një shqiponjë nga zona nën krahët e botës.

“SYRI I SHQIPONJËS”

5. **“Drejtoria e Inteligjencës Elektronike dhe Teknike”**¹⁴¹ Shifrat e shqiponjës në emblemën simbolizon dhe siguron se të gjitha rrjetet e inteligjencës të botës janë nën kontroll. Në syrin e shqiponjës, ka katër herë më shumë nerva sesa syri i njeriut, kështu që duket i mprehtë.

“ÇDO LLOJ SINJALI NËN KONTROLL”

6. **“Drejtoria e Inteligjencës së Shenjave”**¹⁴² Logoja ka një shifër sinjalesh të përhapur nga e gjithë bota. Departamenti i Inteligjencës së Sinjalit është në gjendje të zbulojë dhe të ndjekë çdo lloj sinjali.

Bazuar në kompleksitetin e fushëveprimtarisë së Kundër-Inteligjencës MIT –it, sidomos pas tentimit për grusht shtet të 15 - 16 Korrikut 2016 në Turqi, MIT, kishte ndërmarrë shumë operacione gjithandej në vendet të ndryshme të botës për të rikthyer pjesëtarët e një organizate të quajtur nga shteti Turk si Terroriste e njohur me shkurtesën FETO¹⁴³

¹³⁸ Versioni në Gjuhën Turke; İstihbarata Karşı Koyma Başkanlığı

¹³⁹ Versioni në Gjuhën Turke: Dış Operasyonlar Başkanlığı'nın

¹⁴⁰ Versioni në Gjuhën Turke: Güvenlik İstihbaratı Başkanlığı

¹⁴¹ Versioni në Gjuhën Turke: Elektronik ve Teknik İstihbarat Başkanlığı

¹⁴² Versioni në Gjuhën Turke: Sinyal İstihbaratı Başkanlığı

¹⁴³ National Intelligence Agency Crisis [Online] Marrë nga; <http://fetofacts.com/en/feto-deepstate/national-intelligence-agency-crisis/>; Parë për herë të fundit / 06. Prill, 2018

MIT- kishte arrit të futej në Kosovë, përmes një linje të kamufluar ajrore në Aeroportin “Adem Jashari” në Sllatinë – Prishtinë dhe në bashkërendim me AKI –në kishe ndërmarrë, paligjshëm ushtrimin e ndikimit dhe tejkalimit të masave ligjore kundrejt gjashtë shtetasve Turq me rastin e arrestimit dhe depërtimit drejt Turqisë. Gjithçka ishte provuar që të kryhej në TOP SEKRET nga te dyja Agjencitë, derisa skandali u publikua ende pa u depërtuar dhe morri përmasa të sëmbimeve të debateve nga Presidenti i Turqisë Erdogan, kundrejt Kryeministrit të Kosovës Ramush Haradinajt, pasi ky i fundit si masën daj tejkalimeve ligjore, shkarkoi drejtorin e AKI-së¹⁴⁴ dhe Ministrin e MPB –së¹⁴⁵ për shkak të mos raportimit dhe vënien në dijeni të Kryeministrit, ashtu siç është paraparë me ligj.

¹⁴⁴ Driton Gashi

¹⁴⁵ Flamur Sefaj

“Në demokraci asnjë fushë e veprimtarisë shtetërore nuk duhet të jetë zonë: “ndalohej hyrja” për Parlamentin, përfshirë sektorin e shërbimeve të fshehta të sigurisë dhe informacionit”
(Hans Born dhe Leigh Lan)

KAPITULLI I KATËRT

KUADRI LIGJOR I RREGULLIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË AKI-SË

Këndvështrime mbi sektorët e sigurisë në Kosovë me theks të veçantë:

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë AKI –në

4.1 Aspekte të zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë (baza ligjore dhe sektorët e sigurisë në Kosovë).....	81
4.2 AKI - Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (kapacitetet fillestare dhe sfidat e konsolidimit).....	82
4.3 Rekrutimi dhe operacionalizimi i AKI –së.....	84
4.4 Elaborimi i kompetencave të Drejtorit, zv. Drejtorit dhe Inspektorit të Përgjithshëm.....	86
4.5 Kontrolli i brendshëm; Inspektori i përgjithshëm i AKI-së.....	87
4.6 Fushëveprimi i AKI –së.....	88
4.7 Buxheti i AKI –së.....	89

KUADRI LIGJOR I RREGULLIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË AKI-SË

Këndvështrime mbi zhvillimin e sektorëve të sigurisë në Kosovë me theks të veçantë Agjencia e Kosovës për Inteligjencë AKI –në (Rast studimi)

4.1 Aspekte të zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë, baza ligjore dhe sektorët e sigurisë në Kosovë

Edhe pas katër vjet të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008, sektori i sigurisë në përgjithësi tani më i kompletuar po i nënshtrohet një rishikimit të përgjithshëm. Vite më parë menjëherë pas miratimit të kushtetutës u shtua nevoja emergjente e krijimit të kapaciteteve të plota të sektorit të Sigurisë si shtet dhe natyrisht edhe ligji për AKI –në. Aso kohe kishte komente dhe mendime të ndryshme. Bazuar në momentin aktual, thuhej dhe shumë të ndjeshëm në të cilin gjendet Republika e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së saj, çështjet e sigurisë domosdoshmërisht shtohen si prioritare.¹⁴⁶ Në ndërtimin e një sektori të mirëfilltë të sigurisë duhet të hartohet një strategji kombëtare e sigurisë e cila duhet të vjen si rezultat jo i punës së një grupi por si rezultat i një studimi strategjik të sektorit të sigurisë.¹⁴⁷ Një domosdoshmëri e tillë një ditë do të ndodhë. Sepse barra e përgjegjësisë për mbrojtje herët a vonë do të na përket neve. Mbetet të shihet se në ç’masë në ç’mënyrë dhe në ç’kohë do të ndodhë.¹⁴⁸

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës aspektet e zhvillimit të sektorit të sigurisë, mund të cilësohen për nga ana legjislative si të përfunduara duke u përfshirë në Nenin 125 Parimet e Përgjithshme¹⁴⁹; Neni 126 Forca e Sigurisë e Kosovës, Neni 127 Këshilli i Sigurisë i Kosovës, Neni 128 Policia e Kosovës, Neni 129 Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Neni 130 Autoriteti Civil i Aviacionit dhe Neni 131 Gjendja e Jashtëzakonshme. Në këtë kontekst një theks i veçantë iu është kushtuar edhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë AKI –së. Me 21 maj 2008 në Kuvendin e Kosovës është aprovuar ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë i cili ka hyrë

¹⁴⁶KCSS, ”Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë” Vlerësimi i sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës, Prespektiva e shoqërisë civile, faqe 10

¹⁴⁷Po aty, faqe 6

¹⁴⁸Qehaja Ramadan, Çështjet e Sigurisë Nacionale të Kosovës, Tema; Funksionet e mbrojtës nga vendorët, (Prishtinë, Vatra, 2004) faqe 99

¹⁴⁹[Kushtetuta e Republikës së Kosovës](#), Prishtinë, 2008 Kapitulli XI (Sektori i Sigurisë) faqe 51

në fuqi 15 ditë më vonë.¹⁵⁰ Edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit në fjalë me një vonesë të theksuar më tepër se një vit u arrit më në fund që të kemi shtyllën e parë AKI –së, emërimin e drejtorit.¹⁵¹

4.2 AKI - Agjencia e Kosovës për Inteligjencë

(Formimi, kapacitetet fillestare dhe sfidat e konsolidimit)

Baza ligjore e krijimit të AKI-së¹⁵², parashihet në kreun e parë, respektivisht me Dispozitat e Përgjithshme nga neni 1 për Themelimin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Neni 1.1 **Agjencia e Kosovës për Inteligjencë**(në vijim **AKI**) themelohet me ligj si agjenci për siguri dhe inteligjencë në Kosovë.¹⁵³

Krijimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe kundër-inteligjencë, AKI është krijuar për herë të parë me bazë ligjore¹⁵⁴ (nën mbikëqyrje parlamentare dhe kontroll demokratike), konsiderohet arritje fundamentale për sigurinë dhe shoqërinë e Kosovës. Formimi i AKI-së, përfundimisht ka bërë të pa nevojshme funksionimin e shërbimeve të mëparshme¹⁵⁵ që vepronin nën ombrellën e partive politike, gjë që garanton themelimin dhe funksionimin e këtij sektori për siguri dhe inteligjencë.

¹⁵⁰KCSS, "Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë" Vlerësimi i sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës, Prespektiva e shoqërisë civile, faqe 161

¹⁵¹**Prishtinë, 4 shkurt '09** - Presidenti Fatmir Sejdiu dhe kryeministri Hashim Thaçi, kanë emëruar Bashkim Smakajn drejtor të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, gjë që shënon edhe fillimin e procesit të krijimit të shërbimit sekret të Kosovës. <http://www.mpb-ks.org/index.php?page=1,46,142>

¹⁵² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008, Kapitulli XI (Sektori i Sigurisë) Neni 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] faqe 53

¹⁵³**Ligji Nr. 03/L-063. LIGJI PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË**, Dispozitat e përgjithshme, Neni 1 Themelimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë,.

¹⁵⁴**Ligji Nr. 03/L-063. LIGJI PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË**, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Në bazë të neneve 65(1) dhe 129 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Hyrja në fuqi, Ligji Nr. 03/ L-063 më 21 maj 2008. Numri: Ligji Nr. 03/L-063 Vendi dhe Koha: I miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 21.05.2008 / **Gazeta Zyrtare**. Shpallur: Më 15.06.2008 Faqe: 17-29 www.gazetazyrtare.com/

¹⁵⁵ Organizata, siç është Instituti për Hulumtime Strategjike të Opinionit Publik (**IHSOP**) dhe Shërbimi Informativ i Kosovës (**SHIK**), kanë operuar në atë mënyrë që ka ngjashmëri me shërbimet informative. Mirëpo, pasi që ato kanë vepruar në atë mënyrë pa mandat legjislativ dhe pa kontroll dhe mbikëqyrje parlamentare, në fakt këto organizata janë ndërmarrje private dhe si rrjedhojë nuk mund të konsiderohen si shërbime informative legjitime zyrtare, me një fjalë pas krijimit të (**AKI**) –së ato si të tilla janë shuajtur.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencës është krijuar ashtu sikurse e parasheh ligji, me njerëz profesionistë, thuhet në ligj¹⁵⁶, çka duhet të ndodhë dhe të hedh poshtë çdo mundësi të implikimeve partiake në këtë aspekt dhe¹⁵⁷, por që qeveriset në bazë të ligjit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.¹⁵⁸

Ekzistojnë edhe dallime përkufizuese në aspektin terminologjik të fjalëve (AKI / kundërinteligjencë – SHISH / kundërzbulim) **AKI** Përkufizimet; *Informacion, inteligjencë, kundërintelegjencë*.

SHISH / *Përkufizimet; Informacion dhe kundërzbulim*. Në nenin 3 të tij saktësohet që:” SHISH / Shërbimi Informativ Shtetëror mbledh informacion nga jashtë në funksion të sigurimit kombëtar, kryen veprimtari **kundërzbulimi**¹⁵⁹ për ruajtjen e integritetit, të pavarësisë e të rendit kushtetues, mbledh informacion për terrorizmin, për prodhimin dhe trafikun e narkotikëve, për prodhimin e armëve të dëmtimit në masë, për krimet kundër mjedisit, mbledh informacion për krimin e organizuar, që cenon sigurinë kombëtare”¹⁶⁰

Duke njohur se nevoja për informacion me kohë dhe të saktë për **inteligjencë, kundërinteligjencë**, kërcënime nga brenda dhe jashtë, terrorizmin ndërkombëtar apo vendor, prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, krimin e organizuar, krimin ekonomik, sabotazhin dhe të gjitha çështjet tjera të inteligjencës të lidhura me sigurinë e Kosovës është esenciale për popullin e Kosovës etj;¹⁶¹ AKI mbledhë informacion në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës. Në çdo rast kërcënim ndaj sigurisë së Kosovës konsiderohet kërcënimi ndaj integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale në dëm të Kosovës, duke përfshirë:¹⁶²

¹⁵⁶**Neni 15** Kualifikimet për punësim në AKI, të kenë kualifikime të duhura arsimore dhe profesionale ashtu siç përcaktohet me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm

¹⁵⁷**Neni 17/** 17.1 Punonjësit e AKI-së nuk mund të jenë anëtarë të partive politike apo marrin udhëzime prej partive, organizatave apo lëvizjeve politike, apo individëve jashtë AKI-së.

¹⁵⁸**Neni 1.2** AKI qeveriset në bazë të këtij ligji në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të gjitha ligjet tjera në fuqi në Kosovë.

¹⁵⁹**Kundërzbulimi** përqendrohet në parandalimin e shërbimeve të huaja të inteligjencës apo të grupeve të huaja të kontrolluara për të bërë spiunim, rebelim dhe sabotim kundër shtetit. Kjo konsiston në masa mbrojtëse, siç janë hetimet, inspektimet, vëzhgimet dhe masat e rrepta si ndërmarrja e operacioneve për të depërtuar në këto organizata, mashtruar, përçarë, si dhe manipuluar ato. [Online] Marrë nga: www.dcaf.ch

¹⁶⁰ Për ushtrimin e aktivitetit të tij, SHISH zbaton Ligjin Nr.8391, datë 28.10.1998 "PER SHERBIMIN INFORMATIV KOMBETAR" i ndryshuar me ligjin Nr.8479, datë 29.4.1999 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8391" datë 28.10.1998 "PËR SHËRBIMIN INFORMATIV KOMBËTAR."

¹⁶¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Në bazë të neneve 65(1) dhe 129 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Miraton këtë **LIGJIN PËR AGJENCINË E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË**

¹⁶² Terrorizmin; nxitjen, ndihmën dhe shtytjen ose përkrahjen e terrorizmit; spiunazhin kundër Kosovës apo në dëm të sigurisë së Kosovës; sabotazhin drejtuar kundër infrastrukturës vitale të Kosovës; krimin e organizuar kundër Kosovës apo në dëm të sigurisë së Kosovës në cilëndomënyrë, duke përfshirë larjen e parave; nxitjen e pakënaqësisë në strukturat e sigurisë; trafikimin e substancave ilegale, armëve apo qenieve njerëzore; prodhimin ilegal apo transportin e armëve të shkatërrimit në masë, ose të komponentëve të tyre, si dhe materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për prodhimin e tyre; trafikimin ilegal të prodhimeve dhe teknologjive nën Kontrollin Ndërkombëtar; aktivitetet që bien ndesh me të drejtën humanitare ndërkombëtare; aktet e dhunës së organizuar apo të frikësimit kundër grupeve etnike apo fetare në Kosovë, dhe çështjet që kanë të bëjnë me kërcënime serioze ndaj shëndetit apo sigurisë publike.

AKI –ja ka objektin e vet në lokacionin e ri: Rruga Lidhja e Pejës (M9) 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, info@aki-rks.org, Numri kontaktues: 038/260 250, dhe posedon edhe faqe zyrtare në internet¹⁶³

4.3 Rekrutimi dhe operacionalizimi i AKI –së.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), ka hyrë në fazën e fundit të kompletimit të stafit të saj. Pas zgjedhjes së stafit menaxhues, së fundi Agjencia ka hapur konkursin edhe për zyrtarë të agjencisë. Përveç stafit që do të punojnë në administratën e AKI-së, me këtë konkurs do të punësohet edhe ajo pjesë e zyrtarëve, të cilët do të angazhohen në mbledhjen e informatave për nevojat e Agjencisë.¹⁶⁴ AKI –ja nuk ka bërë publik numrin¹⁶⁵ e personelit (agjentëve) që do të punësohen, pasi këtë të drejtë organike e llogaritet si të dhënë që nuk duhet pasur qasje opinioni, por thuhet se do të punësohet aq personel, sa ka nevojë Agjencia për të përmbushur rolin dhe misionin e saj. Edhe pse rishtazi është themeluar AKI-ja sikurse që thuhet në deklaratën e fundit të drejtorit z. Smakaj ku konsideron, citoj; “ *AKI pothuajse ka përmbyllë të gjitha fazat e konsolidimit dhe aktualisht janë në rrjedha normale të funksionimit*”¹⁶⁶. Po ashtu Platforma e veprimit të AKI është e ndërtuar në departamente - Analitike, Operative etj¹⁶⁷

¹⁶³ AKI, [Online] Marrë nga: <http://aki-rks.org/index.html>, [Qasja e fundit, Shkurt 2018]


¹⁶⁴ <http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=104855>

¹⁶⁵ Shih; Qarkorja Buxhetore 2010/03 MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE, drejtuar Udhëheqësit e Organizatave Buxhetore Zyrtarët e Buxhetit të Organizatave Buxhetore Lëshimi i kufijve final buxhetor për vitin 2010 ka lejuar bugjet për paga dhe meditje në vlerë prej 500,000 euro për numër deri në 90 persona staf të AKI –së për vitin 2010

¹⁶⁶ Burim i hapur, E marte 16:43 / 27.03.2012 (Shefi i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës (AKI), Bashkim Smakaj, në një intervistë për radion Evropa e Lirë) [Online] Marrë nga: <http://www.telegrafi.com/lajme/aki-eshte-kudo-2-21262.html>

¹⁶⁷ Shih; Prishtinë, 14 dhjetor 2009, Në fund të vitit 2010 kompletohet AKI Agjencia Kosovare e Inteligjencës (AKI) do të ngrejë kapacitetet në nivelin e kënaqshëm. Kështu ka thënë të hënën drejtori i AKI, Bashkim Smakaj. <http://zhurnal.mk/al/cont.asp?k=21208120405&s=27209153635&ID=141209161052>

Nr. 11 ORGANOGRAMI, STRUKTURA ORGANIZATIVE E AKI-SË¹⁶⁸



¹⁶⁸ Strukturë organizative, ky organogram si i tillë është punuar ekskluzivisht për qëllime akademike në kuadër të hulumtimit të studimeve të doktoratës dhe si e tillë nuk ekziston në faqen zyrtare të AKI-së.

4.4 Elaborimi i kompetencave të Drejtorit, zv. Drejtorit dhe Inspektorit të Përgjithshëm etj.
Hierarkia e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë është e ndërtuar në tri shtylla: Drejtori, Zëvendësdrejtori dhe Inspektori i Përgjithshëm.

Drejtori i AKI-së;¹⁶⁹ Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë shërben si këshilltar i Presidentit dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës për çështje të inteligjencës që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës. Njofton Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës për aktivitetet e AKI-së, ofron informata për Presidentin dhe Kryeministrin sa i përket sigurisë, është përgjegjës për mbledhjen, analizën, prodhimin dhe shpërndarjen e informatave dhe siguron se kjo bëhet me kohë dhe në mënyrë objektive dhe të pandikuar nga arsyet politike, përgjigjet ndaj ankesave të individëve që besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga ana e AKI-së, dhe shumë detyra e përgjegjësi tjera. Kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorit të AKI –së janë të rregulluara sipas nenit 5 / 5.7 ¹⁷⁰ Drejtori i parë dhe aktualisht i AKI –së ishte ish oficeri i lartë i SHPK-së Bashkim Smakaj¹⁷¹

¹⁶⁹Ligji i AKI –së KREU II ORGANIZIMI I ADMINISTRIMI I AKI-së Neni 5 Drejtori i AKI-së 5.1 Drejtori i AKI-së, në pajtueshmëri me këtë Ligj, Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm dhe ligjet tjera në fuqi, është përgjegjës për të gjitha aspektet e menaxhimit të AKI-së. Drejtori i AKI-së do t'i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeministrit.

¹⁷⁰**Neni 5.7 Drejtori i AKI-së:**(i) shërben si këshilltar i Presidentit dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës për çështje të inteligjencës që kanë të bëjnë me sigurinë e Kosovës; (ii) njofton Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës për aktivitetet e AKI-së; (iii) ofron informata për Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës sa i përket sigurisë; (iv) është përgjegjës për mbledhjen, analizën, prodhimin dhe shpërndarjen e informatave dhe siguron se kjo bëhet me kohë dhe në mënyrë objektive dhe të pandikuar nga arsyet politike; (v) mbron burimet e inteligjencës dhe metodat e veprimit si dhe informacionin tjetër të klasifikuar nga shpalosja e pa autorizuar; (vi) ka pushtet ekskluziv të emërojë Punonjësit në AKI, që do të bëhet sipas parimeve të parashtruara në Kapitullin IV të këtij Ligji, dhe në Rregulloren e Organizimit të Brendshëm; (vii) vendosë dhe koordinon marrëdhëniet me agjencitë e inteligjencës dhe sigurisë të qeverive të huaja për çështje që kanë të bëjnë me inteligjencën; (viii) siguron se AKI-ja nuk ndërmerr asnjë veprim që mund të krijojë dyshim të arsyeshëm se AKI-ja është e angazhuar në avancimin, mbrojtjen apo dëmtimin e interesave të cilido komunitet apo cilëndo parti apo organizatë politike; (ix) siguron se AKI-ja nuk ndërmerr asnjë veprim me qëllim të ndikimit në procese politike, opinion publik, politika dhe media në Kosovë; (x) propozon buxhetin vjetor të bazuar në udhëzimet nga Platforma e Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë dhe dorëzon propozimin bashkë me mendimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë për përfshirje në buxhetin vjetor të Kosovës; (xi) përgatitë raporte dhe propozojë plane dhe programe të AKI-së, duke përfshirë mes tjerash, Programin Vjetor të Aktivitetit dhe Raportin Vjetor të Aktivitetit; (xii) përgatitë propozimin e Platformës Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë; (xiii) inicion dhe nënshkruan Memorandume të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit me institucione dhe organe tjera; (xiv) raporton para Komisionit parlamentar mbikëqyrës sipas kërkesës; dhe, (xv) përgjigjet ndaj ankesave të individëve që besojnë se të drejtat e tyre janë shkelur nga ana e AKI-së.

¹⁷¹Presidenti Sejdiu tha se vendimi u mor pas analizave dhe bisedimeve të shumanshme. “Duke u mbështetur në nenin 84 pika 1, nenin 94 pika 8, nenin 129 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të nenin 5 pika 3, të Ligjit për AKI-në, presidenti dhe kryeministri i Republikës së Kosovës marrin vendim që të emërojnë **Bashkim Smakajn**, drejtor të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë”, tha Presidenti. Ai është Bashkim Smakaj, një nënkolonel i Policisë së Kosovës. Presidenti dhe Kryeministri, në një konferencë për media, thanë se kanë bërë përzgjedhjen e duhur për këtë pozitë, kyçe për sigurinë e shtetit të ri.

Zëvendës drejtori i AKI – së;¹⁷² Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë emërohet për një mandat pesëvjeçar, me mundësi vazhdimi për një mandat të dytë, ndërsa është i obliguar që të ushtrojë të drejtat dhe përgjegjësitë e veta në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.¹⁷³

Kompetencat dhe përgjegjësitë e zëvendës drejtorit të AKI –së janë të rregulluara sipas nenit 6 mbi zëvendës drejtorin e AKI-së¹⁷⁴ Aktualisht, Zëvendës Drejtor i AKI –së është ish oficeri i lartë SHPK –së Latif Merovci.¹⁷⁵

4.5 Kontrolli i brendshëm; Inspektori i Përgjithshëm i AKI-së

Inspektori i Përgjithshëm i AKI –së;¹⁷⁶ Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë emërohet për një mandat katërvjeçar, me mundësi vazhdimi për një mandat të dytë. Inspektori i Përgjithshëm i AKI-së ushtron të drejtat dhe kryen përgjegjësitë e veta në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të përgjithshëm janë të rregulluara sipas nenit 9 mbi Emërimin dhe mandatin i inspektorit të përgjithshëm,¹⁷⁷

¹⁷²**Ligji i AKI – së** Neni 6 Zëvendës drejtori i AKI-së 6.1 Zëvendës drejtori i AKI-së ndihmon drejtorin e AKI-së dhe drejton aktivitetet operacionale të njësive organizative të AKI-së nën mbikëqyrjen e drejtorit të AKI-së.

¹⁷³ <http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=104855>

¹⁷⁴**Neni 6 Zëvendës drejtori i AKI-së** 6.1 Zëvendës drejtori i AKI-së ndihmon drejtorin e AKI-së dhe drejton aktivitetet operacionale të njësive organizative të AKI-së nën mbikëqyrjen e drejtorit të AKI-së. 6.2 Zëvendës drejtori i AKI-së duhet të ketë arsimim universitar dhe emërohet mbi baza të profesionalizmit dhe përvojës së dëshmuar dhe pa marr parasysh përkatësinë politike, për një mandat pesëvjeçar (5), cili mund të përtërihet dhe do të rrjedhë pavarësisht nga mandati idrejtorit të AKI-së. 6.3 Presidenti i Republikës së Kosovës së bashku me Kryeministrin, emërojnë zëvendës Drejtorin e AKI-së brenda njëzet (20) ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë. 6.4 Zëvendës drejtori i AKI-së shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar. 6.6 Zëvendës drejtori i AKI-së përkohësisht kryen dhe ushtron përgjegjësitë e drejtorit të AKI-së gjatë mungesës apo paafësisë të drejtorit. Në rast të paafësisë të përhershme, zëvendës drejtori i AKI-së kryen dhe ushtron përgjegjësitë e drejtorit të AKI-së deri në kohëkur zëvendësimi i Drejtorit të KIA-s emërohet në mënyrë formale.

¹⁷⁵ Vendimi për emërimin e zëvendës drejtorit të AKI-së, sipas një kumtesë, thuhet se është marrë në bazë të nenit 84, pika 21, nenit 94 pika 8 dhe nenit 129, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të nenit 6, pika 3 të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. (Kosovalive)

¹⁷⁶**Ligji i AKI –së** KREU III INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM Neni 9 Emërimi dhe mandati i inspektorit të përgjithshëm Neni 9.1 Presidenti i Republikës së Kosovës së bashku me Kryeministrin, emëron Inspektorin e Përgjithshëm të AKI-së brenda njëzet (20) ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë.

¹⁷⁷**Neni 9.1** Presidenti i Republikës së Kosovës së bashku me Kryeministrin, emëron Inspektorin e Përgjithshëm të AKI-së brenda njëzet (20) ditësh pune nga dita kur pozita mbetet e lirë. 9.2 Inspektori i përgjithshëm shërben për një mandat (4) katërvjeçar, që mund të përtërihet dhe për një mandat katërvjeçar. 9.3 Inspektori përgjithshëm shkarkohet nëpërmjet procesit të njëjtë me të cilin është emëruar. 9.4 Emërimi i inspektorit të përgjithshëm bëhet mbi baza të integritetit, përputhjes ndaj standardeve të sigurisë së AKI-së, dhe përvojës në lëmi të sigurisë apo administrimit qeveritar në Kosovë. 9.5 Inspektori i përgjithshëm i raporton drejtpërdrejt kryeministrin. 9.6 Inspektori i përgjithshëm i raporton organit mbikëqyrës parlamentar të paktën çdo gjashtë (6) muaj dhe me kërkesë specifike me shkrim të Komisionit Mbikëqyrës Parlamentar.

Neni 10 Përgjegjësia e inspektorit të përgjithshëm¹⁷⁸ dhe Neni 11 Ndihma inspektorit të përgjithshëm.¹⁷⁹ Aktualisht, Inspektor i Përgjithshëm i AKI –së është Agron Selimaj¹⁸⁰

4.6 Fushëveprimi i AKI –së

Neni 2 përcakton fushën e veprimit 2.1 AKI mbledhë informacion në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës. Në çdo rast kërcënimi ndaj sigurisë së Kosovës konsiderohet kërcënimi ndaj integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale në dëm të Kosovës, duke përfshirë:¹⁸¹ Po ashtu në nenin 2.2 Për të avancuar aktivitetet e AKI-së të paraqitura në Nenin 2.1 më lartë, dhe në pajtim me nenet 28 dhe 30 të këtij ligji, AKI ka mundësitë e veta për mbledhjen e informacionit, që përfshijnë; (i) përgjimin mobil dhe statik; (ii) personelin e fshehtë për mbledhjen e informacioneve; (iii) përgjimin teknik, siç janë pajisjet për dëgjim, përgjim dhe përcjellje; (iv) agjentët e fshehtë; (v) mbledhjen e të dhënave konfidenciale, si nga bankat, portet dhe telefonin. Në nenin 2.3 përcakton prioritetet strategjike të AKI-së të cilat parashtrihen në

¹⁷⁸**Neni 10.1 Inspektori i përgjithshëm** inspekton aktivitetet e AKI-së. 10.2 Është përgjegjësi e inspektorit të përgjithshëm të ndihmojë drejtorin të jetë informuar në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme për problemet potenciale në aktivitetet e AKI-së, me qëllim të promovimit të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, dhe evitimit të çfarëdo shkeljeje ligjore. 10.3 Inspektori i përgjithshëm i rekomandon Drejtorit të AKI-së veprime korrektuese dhe monitoron progresin e secilit veprim korrektues të urdhëruar nga drejtori i AKI-së. 10.4 Përgjegjësia e inspektorit të përgjithshëm përfshin auditimet financiare të aktiviteteve të AKI-së. Përveç drejtorit të AKI-së, rezultatet e këtyre auditimeve do t'i vihen në dispozicion dhe kryeministrit. 10.5 Pas njoftimit të drejtorit të AKI-së, inspektori i përgjithshëm ka të drejtë të marrë nëpyetje Punonjësit e AKI-së dhe të ketë qasje në objektet dhe të dhënat e AKI-së sipas nevojës, me qëllim të hetimit, inspektimit apo auditimit të brendshëm. 10.6 Drejtori i AKI-së mund t'i ndalojë inspektorit të përgjithshëm të iniciojë, kryejë apo përfundojë cilindo inspektim apo auditim nëse drejtori përcakton se është e nevojshme të mbrohen interesat vitale të sigurisë së Kosovës. Nëse drejtori ushtron këtë të drejtë, ai apo ajodo t'ia raportojë këtë veprim kryeministrit dhe Presidentit të Republikës së Kosovës brendashtatë (7) ditëve kalendarike. 10.7 Inspektori i përgjithshëm është përgjegjës për ofrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm në AKI duke shqyrtuar aktivitetet e AKI-së, iniciuar inspektime, auditime dhe hetime, hetuar ankesat në lidhje me aktivitetet e AKI-së apo të bëra nga personat në Kosovë. 10.8 Inspektori i përgjithshëm është përgjegjës për të mbështetur hetimet e Ombudspersonit të Kosovës

¹⁷⁹**Neni 11** Nëse e miraton drejtori i AKI-së, inspektori i përgjithshëm bënë zgjedhjen e individëve për t'ndihmuar atë në kryerjen e funksioneve të veta, duke përfshirë individë të kualifikuar për të kryer auditime financiare.

¹⁸⁰ **Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë** emërohet për një mandat katërvjeçar, me mundësi vazhdimi për një mandat të dytë. Inspektori i Përgjithshëm i AKI-së ushtron të drejtat dhe kryen përgjegjësitë e veta në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. (Kosovalive)

¹⁸¹ **Fushëveprimi në;** (i) terrorizmin; (ii) nxitjen, ndihmën dhe shtytjen ose përkrahjen e terrorizmit; (iii) spiunazhin kundër Kosovës apo në dëm të sigurisë së Kosovës; (iv) sabotazhin drejtuar kundër infrastrukturës vitale të Kosovës; (v) krimin e organizuar kundër Kosovës apo në dëm të sigurisë së Kosovës në cilëndo mënyrë, duke përfshirë larjen e parave; (vi) nxitjen e pakënaqësisë në strukturat e sigurisë; (vii) trafikimin e substancave ilegale, armëve apo qenieve njerëzore; (viii) prodhimin ilegal apo transportin e armëve të shkatërrimit në masë, ose të komponentëve të tyre, si dhe materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për prodhimin e tyre; (ix) trafikimin ilegal të prodhimeve dhe teknologjive nën Kontrollin Ndërkombëtar; (x) aktivitetet që bien ndesh me të drejtën humanitare ndërkombëtare; (xi) aktet e dhunës së organizuar apo të frikësimit kundër grupeve etnike apo fetare në Kosovë, dhe (xii) çështjet që kanë të bëjnë me kërcënime serioze ndaj shëndetit apo sigurisë publike.

Platformën Vjetore të Politikës së Inteligjencës dhe Sigurisë (në vijim PVPIS), e cila përmban udhëzimet e përgjithshme për punën e AKI-së.

4.7 Buxheti i AKI –së.

Si çdo agjenci tjetër brenda sistemit buxhetor të Republikës së Kosovës edhe buxheti i AKI –së është i paraparë dhe i planifikuar në planin buxhetor që nga viti 2009.

Sipas Institutit GAP, Qeveria i ndan buxhet Agjencisë për Inteligjencë¹⁸². Me 29 prill, Qeveria e Kosovës mori vendimin 05/62, me të cilin miratoi buxhetin e AKI-së për vitin 2009. Në vendim nuk ceket shuma e mjeteve, mirëpo pas hulumtimit tonë është kuptuar se AKI-së i është ndarë buxhet në vlerë prej 1.170.900 euro. Kjo shumë e mjeteve pritet të shpenzohet në këtë mënyrë: 500.000 euro janë destinuar të shpenzohen për paga dhe mëditje për 90 punëtorët¹⁸³ që pritet të ketë ky agjencion; 234.000 euro për mallra dhe shërbime; 16.900 euro për komunal; 20.000 euro për subvencione dhe transfere; dhe 400.000 euro për shpenzime kapitale. Ndërsa për vitin 2010 deri 2012 AKI –së i është ndarë dhe planifikuar buxhet në vlerën prej 1,070,900 (2010) 3,613,736 (2011) 3,658,285 (2012)¹⁸⁴

Buxheti i AKI- së për vitin kalendarik 2012 është 5,620,000 euro. Mënyra e shpenzimeve është ndarë: Të punësuar në vitin 2012, 90 punëtor; Paga dhe mëditje, 2,700,000; Mallra dhe Shpenzime, 890,000; shpenzime 80,000; Subvencione dhe Transfere, 850,000; Shpenzime Kapitale, 1,300,000 – totali 5,620,000 euro¹⁸⁵.

Në vitin kalendarik buxhetor 2018 AKI kishte një rritje të konsiderueshme buxhetore në vlerë prej 8,093,966 euro, me trend të rritjen edhe për dy vitet në vijim siq parashihet në Projekt për pozimin e buxhetit për vitin 2019 me 8,295,974 euro dhe virin 2020 me shumën prej 8,561, 382 euro.¹⁸⁶

¹⁸² GAP Monitor është publikim i përmuajshëm i Institutit për Studime të Avancuara GAP. Ky numër është përgatitur nga: Agron Demi, agron@institutigap.org; Rudina Heroi, rudina@institutigap.org; Shemsedin Aliu, shemsedin@institutigap.org; Florina Hajdini, florina@institutigap.org dhe Kreshnik Berisha, keka@institutigap.org. Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare. Rr. Nëna Terezë 41/29, 10000 Prishtinë, Kosovë | +381 38 224 145 monitor@institutigap.org | www.institutigap.org

¹⁸³ Shih Gazeta e përditshme “Kosova Sot, e hënë 19 prill.2010 me temë AKI – ja drejt funksionalizimit, titulli i artikullit “ Kosova me afër 400 - 500 agjentë brenda vitit”. Mendoj se kalkulimet në shifra objektive të stafit punonjës të AKI –së si duket do të mbetet i pa njohur.

¹⁸⁴ Shih; Qarkorja Buxhetore, Draft buxheti 2010 dhe vlersimet për 2011-2012 Niveli Qendror

¹⁸⁵ Skema e Buxhetit për AKI –në Shih; [Online] Marrë nga:<http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiendrore.aspx>

¹⁸⁶ Skema buxhetore: [Online] Marrë nga:<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf> {Qasja e fundit 20.mars 2018}

“Përplasja midis “Transparencës dhe sekretit” do të jetë prezent për sa kohë të ekzistojnë në njërin anë “demokracia”, që kërkon llogaridhënie dhe natyra e punës së “shërbimet inteligjente” që kërkojnë ruajtjen e sekretit shtetërorë”

KAPITULLI I PESTË

SISTEMI I KONTROLLIT DEMOKRATIK TË SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS

5.1 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në SHBA (CIA).....	91
5.2 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në ANGLI (SIS).....	94
5.3 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në GJERMANI (BND).....	96
5.4 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në RUSI (FSB).....	98
5.5 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në IZRAEL (MOSSAD).....	99
5.6 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënies në KOSOVË (AKI) së (Ligjshmëria e mbikëqyrjes dhe kontrollit të AKI –së).....	101
5.7 Kontrolli i brendshëm i AKI –së	104
5.8 Mbikëqyrja parlamentare e AKI –së.....	105
5.9 Shoqëria civile dhe mediet	109
5.10 Institucionet e pavarura	110
5.11 Roli i Gjyqësorit	111
5.12 Sfidat e fuqizimit të mbikëqyrjes parlamentare të Inteligjencës së AKI –së.....	112

Dy aspekte themelore:

5.13 Aspekti vertikal: që i përgjigjet Institucioneve Qendrore, Qeverisë, Parlamentit dhe Presidencës.....	113
5.14 Aspekti Horizontal: Opinioni publik, si mediet etj	113

KAPITULLI I PESTË

SISTEMI I KONTROLLIT DEMOKRATIK TË SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS

5.1 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënia në SHBA (CIA)

Fillimisht dua të ritheksoj një konstatim interesant të një ish-drejtor të CIA-as i cili ka thënë që shërbimi inteligjent sekret me demokracinë nuk shkon, sepse demokracia është e hapur, transparente dhe nxjerr në pah përgjegjësinë që kemi për detyrën që bëjmë. Kurse ato janë të fshehta, por që shteti ka nevojë dhe për to dhe siç thashë edhe në fillim, ne jemi midis tyre dhe popullit dhe sa më kërkues që të jemi ne karshi tyre, më të qetë janë zgjedhësit dhe shoqëria në përgjithësi.¹⁸⁷

Shërbimet informative paraqesin komponentin kyç të çdo shteti i cili siguron analizë të pavarur të informatave të cilat janë relevante për sigurinë e shtetit dhe shoqërisë dhe për mbrojtjen e interesave vitale të saj. Ndonëse këto varen nga ekzekutivi, parlamenti megjithatë e ka rolin themelor në përcjelljen e këtyre aktiviteteve.¹⁸⁸

Parimisht ekzistojnë disa teori dhe praktika se si të manifestohet mbikëqyrja demokratike dhe llogaridhënia e një shërbimi inteligjent në një shtet të caktuar demokratik. Megjithatë kjo çështje trajtohet varësisht nga rregullimi i sistemit politik sipas modelit të ndarjeve të pushteteve edhe është e rregulluar në bazë të ligjeve të veçanta.

Në shoqëritë bashkëkohore ekzistojnë disa standarde mbi të cilat rregullohet pothuajse në një formë apo një tjetër kjo materie ku roli dhe kompetencat e mbikëqyrjes dhe kontrollit demokratik pothuajse janë sistematizuar në pesë nivele të kontrollit dhe mbikëqyrjes apo monitorimit demokratik.

Sipas standardeve ndërkombëtare, praktika më e mirë ligjore është e krijuar në pesë nivele, ku katër nivele, specifikohen ligjërisht për mbikëqyrjen e shërbimeve të fshehta të sigurisë dhe informacionit.

¹⁸⁷ Hulumtim i mentoruar nga Prof dr. Kolë Krasniqi, niveli master, punuar nga studenti Sefedin Kuqi , Universiteti FAMA me temë: "Kontrolli dhe mbikëqyrja e shërbimeve informative", faqe 24

¹⁸⁸ Prof.dr. Ramo Masleša, Bazat e Sigurisë, faqe 67

Secili prej tyre mund të konsiderohet si një shtresë e mbikëqyrjes demokratike që përfshihet në shtresën tjetër:

Pra sipas renditjes praktika më e mirë demokratike nënkupton:

- **Kontrolli i brendshëm në nivelin e agjencisë**
- **Kontrolli nga ana e ekzekutivit**
- **Mbikëqyrja parlamentare**
- **Mbikëqyrja nga ana e organeve të pavarura të mbikëqyrjes.**
- **Mbikëqyrjen e jashtme** që nënkupton mediet dhe shoqërinë civile - roli i tyre në promovimin e debateve publike për aktivitetet e shërbimeve të zbulimit dhe përgjegjësisë së zyrtarëve.¹⁸⁹

Cilat janë disa nga sfidat kryesore të mbikëqyrjes së shërbimeve të inteligjencës?

Fillimisht duhet pasur parasysh disa attribute të personelit të caktuar brenda sistemit demokratik të një shteti i cili duhet të funksionalizoj dhe normalizoj si vijon:

Autoriteti:

Mandati i komiteteve parlamentare të mbikëqyrjes së shërbimeve inteligjente - KPMSHI-ve¹⁹⁰ dhe i organeve të tjera të mbikëqyrjes që mund të shfaqen pengesa në sensin e përjashtimit të mundësisë nga shërbimet të caktuara të inteligjencës lidhur me financat ose nga dhënia e informacionit aktorëve privat përkitazi me ato lloj detyra të cilat tradicionalisht janë përmbushur nga shërbimet e zbulimit. Përveç kësaj, shtimi i bashkëpunimit ndërkombëtarë në fushat si kundër-terrorizmi mund të komplikojnë mbikëqyrjen e disa aktiviteteve të jashtme të inteligjencës.

Aftësia:

Mbikëqyrja e shërbimeve të inteligjencës kërkon të kuptuar mirë rolin e shërbimeve të inteligjencës në sistemin vendor të inteligjencës.¹⁹¹ Po ashtu, KPMSHI-të duhet të kenë qasje në fonde të mjaftueshme dhe personel me përvojë për të ndërmarrë kërkimet dhe hetimet.

¹⁸⁹Për më tepër shih; **DCAF 03/ 2006** Mbikqyrja Parlamentare e Shërbimeve të Inteligjencës

¹⁹⁰KPMSHI (Komiteti Parlamentar i Mbikëqyrjs së Shërbimeve Inteligjente)

¹⁹¹Shih Përmbledhjen e DCAF-it për shërbimet e inteligjencës.

Qëndrimi:

Duhet të ekzistoj vullnet i mirëfilltë në anën e KPMSHI-ve dhe të parlamentit si tërësi për të pasur qasje aktive ndaj mbikëqyrjes së inteligjencës duke përfshirë masa si kërkimi i të dhënave dhe inicimi i hetimeve të sjelljeve të dyshimta dhe të diskutueshme.

Fshehtësia kundrejt transparencës: Mbikëqyrja e shërbimeve të inteligjencës duhet t'u përmbahet strikt normave demokratike njëkohësisht me ruajtjen e nivelit të duhur të fshehtësisë, posaçërisht kur kjo lidhet me çështjet operative. Kjo, po ashtu është e rëndësishme nëse agjencitë e inteligjencës dëshirojnë të jenë të sigurta se parlamentet e tyre në mënyrë të besueshme do të merren me çështje të ndjeshme.

CIA Central Intelligence Agency

Në bazë të sistemit politik të organizimit dhe funksionimit të Bashkësisë Informative në ShBA në krye me CIA-së sot, me Ligjin mbi Sigurinë Kombëtare të vitit 1947, u krijua edhe struktura ligjore dhe struktura e plotë menaxheriale e Bashkësisë Informative të SHBA-ve, duke përfshirë këtu edhe CIA-an dhe pozitën e Drejtorit të Bashkësisë Informative¹⁹².

Në vijim do të shohim se si praktikisht si është e rregulluar mbikëqyrja demokratike dhe llogaridhënia në SHBA ?. Pra në ShBA ekzistojnë shumë Agjenci që merren dhe ofrojnë shërbime inteligjente, por më të theksuarat Padyshim se janë:

Departamenti i Sigurisë Brendshme (DHA) Agjencia Qendrore e Zbulimit (CIA) Byroja Federale e Hetimeve (FBI) dhe Agjencia Informative e Mbrojtjes (DIA)

Praktikisht në ShBA mbikëqyrja dhe kontrolli demokratik është i rregulluar përmes dy dhomave:

Dhoma e Përhershme dhe **Senati** zgjedhin **Komisionin për Zbulim** (dy komisione) dhe në këtë përbërje funksionon i tërë sistemi i kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike si përcaktohet sipas niveleve si vijon:

- Në ShBA, fillimisht përcaktohet **Mandati** (i fuqishëm) që përbënë **Kompetencat e Shqyrtimit**, përkatësisht ligjshmërinë e veprimeve dhe efektshmërinë e të gjitha agjencive të inteligjencës.

¹⁹² Nacional Security Act of 1947.P.L.80-253: Section 102 (d) (5), hercafter cited as Nacional Security Act of 1947.

- Aspekti i dytë, - ka të bëjë me **legjislacionin**, ku të dyja KPSHI-të iniciojnë dhe shqyrtojnë ligje.
- Së treti, -përcaktohen **emërimet, ku** Komisioni i Senatit aprovon emërimet e larta të shërbimeve të inteligjencës.
- Së katërti numri, - i **anëtarësimit, ku** Anëtarët e secilës dhomë të caktuar nga udhëheqësit e Dhomës dhe Senatit.
- Së pesti, - vijnë **Kompetencat e Hetimit, Qasja në Informata**. Të dy KPSHI-të kanë qasje totale në të gjitha informatat relevante. Të dy KPSHI-të janë të pajisura me kompetenca të thirrjeve gjyqësore. Me autorizimin e veprimeve të maskuara, Kryetari duhet të informoj të dy KPSHI-të, duke i respektuar konsideratat operative.
- Dhe së gjashti, - vije çështja e kontrollit të **Buxhetit**. Të dyja KPMSHI-të mbajnë autorizim dhe fuqi të përvetësimit. Të dyja KPMSHI-të i bëjnë rekomandime komisionit buxhetore.

5.2 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënia në Angli (SIS)

Edhe Mbretëria e Bashkuar e ka të rregulluar pothuajse ngjashëm me rregullat unike që kanë për qëllim vënien nën kontroll demokratik një shërbim inteligjent të caktuar.¹⁹³

Sipas renditjes dhe nivelit të përgjegjësisë në sistemin politik të Mbretërisë së bashkuar kjo materie është e rregulluar fillimisht me **Komisionin për Inteligjencë dhe Siguri**, si organ parlamentar i mbikëqyrjes.

Po ashtu ekzistojnë edhe disa organe tjera relevante në sistemin e kontrollit në Mbretërinë e Bashkuar si: **Komisionari i Shërbimeve të Informative; Komisionari i Përgjimit të Komunikimeve dhe Tribunali i Autorizimeve Hetuese**. Numri i anëtarëve është i përbërë nga **9 deputetë** nga secila dhomë e parlamentit; Anëtarët e këtyre dhomave nuk mund të jenë ministra (pra anëtarë të ekzekutivit) Po ashtu anëtarët emërohen nga kryeministri në konsultim me liderin e partisë më të madhe opozitare. **Mandati i parlamentit** është që të hulumtojë shpenzimet,

¹⁹³Parliamentary Oversight of Intelligence Services, DCAF Backgrounder,2006,fq.30

administrimin dhe politikat e shërbimeve të inteligjencës. **Fuqia hetuese** i referohet shkallës së autorizimeve ku mund të kërkojë nga ministrat dhe zyrtarët tjerë të dëshmojnë.

Gjithashtu **Qasja ndaj informatave të klasifikuara** është në kompetencë të **Ministrit përgjegjës**, i cili mund të kufizojë qasjen e komisionit ndaj informatave të ndjeshme qëdo të mund të zbulonin hollësi të operacioneve, apo burimeve dhe metodave të shërbimeve inteligjente.

Aspekti i **Inicimit të hetimeve** mund të bëhet në mënyrë vetanake me kërkesë të **Ministrit Përgjegjës**. Dhe në fund kërkohet **Raporti obligativ vjetor**; Ministri përgjegjës mund të lëshojë raporte mbi çështje të caktuara; Të gjitha raportet i dërgohen më së pari kryeministrit, i cili pastaj i dorëzon në parlament; Kryeministri vendos cilat informata duhen hequr nga versioni publik i raportit.

Mbikëqyrja Ministrore; SIS është përgjegjës për veprimet e saj ndaj Sekretarit të Jashtëm. Sekretari i Jashtëm është përgjegjësishë për SIS –in dhe mund të delegoj zyrtarët e lartë të jashtëm dhe të Commonwealth-it. Si pjesë e procesit të llogaridhënies, SIS kërkon lejen e Sekretarit të Jashtëm, ose i caktuar FCO (*officials for significant operations*) zyrtarëve të lartë për operacione të rëndësishme.¹⁹⁴

Mbikëqyrja Financiare: *Financimi dhe kontrollet financiare*; Format e buxhetit të SIS-it janë pjesë e llogarisë së vetme të inteligjencës (SIA) *Single Intelligence Account*, e cila përfshinë buxhetin për SIS -in dhe për dy agjencitë e inteligjencës të sigurisë. Zyrtari i kontabilitetit për (SIA) është Këshilltar i Kryeministrit për Siguri dhe Shefi i Inteligjencës për siguri dhe elasticitet aktualisht, Hannigan Robert. Fondet buxhetore të caktuara SIS -it drejtpërdrejtë reflektojnë politikën e qeverisë dhe prioritetet për inteligjencën.¹⁹⁵

¹⁹⁴Po aty;[Online] Marrë nga;<http://www.mi6.gov.uk/output/ministerial-oversight.html> /Ministerial Oversight , Mbikëqyrja Ministrore.

¹⁹⁵ Po aty; [Online] Marrë nga:<http://www.mi6.gov.uk/output/financial-oversight.html>**Financial Oversight: Funding and Financial Controls / Mbikëqyrja Financiare: Financimi dhe kontrollet financiare**

5.3 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënia në Gjermani (BND)

Paneli i Kontrollit Parlamentar (PKP) ¹⁹⁶

Mbikëqyrja parlamentare në Gjermani u themelua në vitin 1956, fillimisht me një kontroll të dobët mbi BND. Sistemi i mbikëqyrjes ndryshoi pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001. Tani Bundesttagu luan një rol më të madh në kontrollin e BND –së.¹⁹⁷

Megjithatë sfidë jo vetëm e sistemit të kontrollit të Gjermanisë, por edhe e sistemeve të tjera të shteteve, përgjithësisht mbetet që saktësisht të qartësohet shkalla e mbikëqyrjes dhe kontrollit, pra deri në çfarë masash duhet të mbikëqyret dhe të kontrollohet.

Edhe te BND –ja, respektivisht tek mbikëqyrja parlamentare, pjesa më e dobët e sistemit është që stafi i komisionit të mbikëqyrjes që është kompetent në Bundesttag nuk iu është lejuar për të parë dokumente sekrete.¹⁹⁸

Në parim mbikëqyrja parlamentare e shërbimeve të informative organizohet në mënyra të ndryshme. Në disa shtete, komisionet parlamentare për mbrojtje apo për punë të brendshme mund të jenë përgjegjëse për mbikëqyrjen e informative. Megjithatë, një numër përditë e më i madh i shteteve janë duke themeluar komisione speciale parlamentare për mbikëqyrjen e shërbimeve të informative. Gjithashtu, parlamenti ka rol më indirekt në mbikëqyrjen e shërbimeve të informative. Ai mund të mandatojë një organ të jashtëm profesional për të ndërmarrë mbikëqyrjen e përditshme të shërbimeve të informative. Parlamenti mund të luajë rol në emërimin e organeve profesionale të mbikëqyrjes. Në shumë shtete demokratike, ato organe i raportojnë parlamentit, i cili pastaj mund të ndërmarrë veprime për të siguruar që gjetjet dhe rekomandimet e atij organi mbikëqyrës të adresohen. Përfundimisht, parlamentet mbikëqyrin shërbimet e informative duke bërë hetime të ngjarjeve apo aktiviteteve të caktuara që kanë të bëjnë me shërbimet e informative.¹⁹⁹

¹⁹⁶ Shkurtesë dhe Akronim; **(PKP)** Paneli i Kontrollit Parlamentar

¹⁹⁷[Online] Marrë nga:[http://www.kas.de/israel/en/publications/18450/INTELLIGENCE & DEMOCRACIES IN CONFLICT AND PEACE](http://www.kas.de/israel/en/publications/18450/INTELLIGENCE%20&%20DEMOCRACIES%20IN%20CONFLICT%20AND%20PEACE)KAS/BESA INTERNATIONAL CONFERENCE BAR-ILAN UNIVERSITY, OCTOBER 18–19, 2009 Prof. Wolfgang Krieger: German intelligence and Parliamentary oversight

¹⁹⁸ Po aty.

¹⁹⁹ Parliamentary Oversight of Intelligence Services, DCAF Backgrounder, 2006

Edhe sistemi politik i Gjermanisë e ka të rregulluar këtë materie mbi bazën e disa kompetencave që i kanë dhënë Bundestagut - parlamentit, respektivisht (PKP) **Panelit të Kontrollit Parlamentar**.

Fillimisht është i përcaktuar **Mandati** me kompetenca të plota dhe konsiderohet i fuqishëm në autorizime

Kompetencat e Shqyrtimit

Ligjshmëria e veprimeve dhe efektshmëria e të gjitha agjencive të inteligjencës

Legjislacioni

Iniciojnë dhe shqyrtojnë ligje

Emërimet

Asnjë

Anëtarësimi

Përfaqësuesit e Bundestagut të caktuar nga Bundestagu

Kompetencat e Hetimit, Qasja në Informata

Heton ankesat e qytetarëve Mund të kërkoj informata nga qeveria dhe shërbimet e zbulimit Ka fuqi të thirrjes Ka të drejtë të kërkoj prova dhe të bëjë vizita në terren.

Ligji gjerman zbaton kontrolle të rrepta për përdorimin e të dhënave personale nga Zyra Federale për Mbrojtjen e Kushtetutës (Shërbimi vendor i Gjermanisë për inteligjencë). Këto dy pjesë nga ligjet gjermane janë shembuj të mirë për praktikën e mira në mbledhjen, ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave personale. Në Gjermani të gjitha këto aktivitete monitorohen nga Komisioni G10, një organ i pavarur mbikëqyrës i cili ka qasje në informacionin që mbajnë shërbimet e inteligjencës.²⁰⁰

Aspekti buxhetit

Legjislativi emëron komision të veçantë që aprovon plane buxhetore, konsultohet me komisionet e veçanta buxhetore, Komisioni i veçantë dëgjon dëshmi për bugjet shtesë etj²⁰¹

²⁰⁰ Pakoja e Instrumenteve – Ligjvënja për sektorin e sigurisë. Udhëzues Të kuptuarit e mbikëqyrjes së inteligjencës Aidan Wills Geneva Centre for the Democratic Control of DCAF Armed Forces (DCAF)

²⁰¹ Po aty

5.4 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënia në Rusi (FSB)

Sipas ligjit, aktiviteti dhe Mbikëqyrja e FSB –s është kryesisht e koncentruar tek Duma Ruse²⁰², megjithatë s’është i përcaktuar vetëm me ligj, por ajo si e tillë realizohet edhe me udhëzime të veçanta nga Presidenti Rus sipas dekretit 2004/7/9.²⁰³

Komiteti i sigurisë përgjithësisht është i rregulluar përmes Dumes shtetërore dhe komisioneve të saj me anëtarë të opozitës. Brenda Dumes shtetërore ekzistojnë komitetet e Dumës për kontroll dhe hetim për shërbimin inteligjent FSB –në. Kryeministri ka të drejtë të krijoj edhe komisione apo organe të veçanta për ndonjë hetim specifik apo shkelje që ka bërë agjencia në një rast të caktuar.²⁰⁴ Baza ligjore për veprimtarinë e shërbimeve sekrete ruse është ligji i shkurtit të vitit 2006“ Për neutralizimin të terrorizmit“.“ Për veprimimtarinë operacionale të kërkimit të sanksionuar me ligj më 05.07.1995 dhe elegji për sigurinë i vitit 1995/3/5 i aplikuar për të gjitha shërbimet e veçanta.

Ekzistojnë ligje të veçanta për secilin nga shërbimet e veçanta që ka sot Federata Ruse.²⁰⁵ Poashtu Këshilli i Sigurimit i Federatës Ruse është organ konsultativ i Presidentit që punon nga vendimet e presidentit për sigurinë kombëtare. Autoriteti kryesor i kontrollit të plotë për FSB –në është në kompetencë të plotë të Kolegjiut Rus²⁰⁶ Ku autoritet merret me emërimin e Drejtorit të FSB –se i njohur edhe si Kolegjiut i emëruar nga Presidenti. Në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë së Federatës Ruse, e cila ka të rregulluar objektivat strategjike deri në vitin 2020, Kryeministri i Rusisë merr një rol më proaktiv karshi Presidentit.²⁰⁷

Në këtë rrafsh të kontrollit dhe mbikëqyrjes pra një rol kyç luan Kolegjiut rus i FSB –së. Zakonisht vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të tij dhe pas votimit zyrtarizohet për veprim.

Në raste të mosmarrëveshjeve në mes Kolegjiut dhe drejtorit të FSB –së, drejtori do të zbatoj vendimin e tij dhe do ta njoftoj Presidentin për mosmarrëveshjet që kanë lindur. Po ashtu

²⁰²[Online] Marrë nga:[Spies Without Cloaks: The Kgb's Successors](#) The Duma’s Role - [Page 221](#)

²⁰³[Online] Marrë nga:<http://www.agentura.ru/english/dosie/>Legal frameworks, paragrafi i fundit.

²⁰⁴<http://www.agentura.ru/english/dossier/gd/> The Security Committee at the State Duma, paragrafi i fundit I versionit elektronik.

²⁰⁵ Po aty, [Online] Marrë nga:<http://www.agentura.ru/english/dosie/>

²⁰⁶http://www.fas.org/irp/world/russia/docs/edict_806.htm

²⁰⁷ Po aty, [Online] Marrë nga:http://www.fas.org/irp/world/russia/docs/edict_806.htm Më 12. maj 2009 Presidenti Medvedev nënshkroi një dekret për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë së Federatës Ruse, ku zëvendëson kompetencat e sigurisë midis Presidentit dhe Kryeministrit.

edhe anëtarët e Kolegjiumit mund të raportojnë tek presidenti për mendimin dhe mospajtimin e tyre. Vendimet e marra në mbledhjet e përbashkëta të Kolegjiumit rus të FSB –se dhe organet e tjera federale të pushtetit ekzekutiv, do të zyrtarizohen si urdhra për zbatim për FSB –në. Ngjashëm do të ndodhë edhe për personelin e organeve civile dhe ushtarake. Aspektin e buxhetit federal që do tu vihet në dispozicion agjencisë së FSB –së. Vendimet përgjithësisht merren në përputhje me legjislacionin federal në të gjitha situatat edhe kur ka të bëjë me udhëtimin e personelit jashtë kufijve të Rusisë, apo edhe me çështjet e kredive të akorduara nga buxheti federal për financimin e organeve të FSB –së.²⁰⁸

Gjithashtu ekzistojnë edhe format dhe procedurat standarde të shpenzimeve të mjeteve financiare për shërbimet e kryera nga FSB –ja, masat operative të organeve të kundërzbulimit, operacionet e ndërlikuara, aktivitetet hetimore të zbulimit etj. FSB –ja merr vendime për pjesëmarrje në shtetet e huaja për shërbime të veçanta, ku dërgon delegacione brenda kufijve të fondeve të akorduara nga buxheti federal etj.

5.5 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënia në Izrael (MOSSAD)

Ky përshkrim i shkurtër përfshinë elementet më të rëndësishme për Mossad –in, i cili si duket nuk bënë pjesë në rendin juridik, sipas rregullave ndërkombëtare të mbikëqyrjes demokratike që njohim ne. Për Mossad-in ky rregull nuk vlen. Fillimisht ky argument mbështetet në deklaratën e ish drejtorit Halevy; citoj: “Nuk ka ndonjë ligj që rregullon Mossa-din, nuk ka komitet të mbikëqyrjes parlamentare siç ekziston në shoqëritë tjera perëndimore.”²⁰⁹

Në këtë kontekst nuk është arritur që specifikisht , përveç aspektit historik, të mësohet shumë edhe për mbikëqyrjen parlamentare, që shoqëritë demokratike ndahet sipas një rregulli të krijimit të komisioneve apo dhomave, që janë ngarkuar si dhe numrit të anëtarëve nëpër komisione apo nën komisione, që kanë rolin kryesorë të mbikëqyrjes dhe monitorimin e disa fushëveprimeve të shërbimeve inteligjente.

²⁰⁸ Po aty[Online] Marrë nga:http://www.fas.org/irp/world/russia/docs/edict_806.htm

²⁰⁹[Online] Marrë nga:http://www.jewishpostandnews.com/index.php?option=com_content&view=article&id=699%3Aformer-mossad-director-has-surprising-views-&catid=45%3Arokmicronews-fp-1&Itemid=70&lang=en (But, Halevy said, “there is no law that governs the Mossad.” There are no committees of oversight such as exist in other Western democracies.)

Përgjithësisht mbikëqyrja mbështetur në këto rregulla tek Mossa-di nuk ka procedura të qarta. Megjithatë ekzistojnë disa nën komisione me personel të caktuar, por që nuk i kanë të saktësuar në detaje detyrat kryesore që përshkruhen për vendin e punës së tyre si nën komisione. Pra mbikëqyrja dhe kontrolli demokratik edhe për Mossad-in mund të thuhet se është i rregulluar me nën komisione apo nën komitete. Po ashtu ekziston edhe një nën komision special për buxhet dhe financa që miraton buxhetin për çdo vit. Po thuajse deri në fund të vitit 2004 nuk ka pasur procedura të qarta për nën komisionet. Kryesisht para kësaj periudhe disa nën komisione kanë ekzistuar vetëm në letër pa asnjë anëtarë dhe kompetencë.²¹⁰

Aspekti i kontrollit dhe llogaridhënia për organizatat e komunitetit të inteligjencës së Izraelit, në këtë rast edhe për Mossad-in janë në vartësi të katër zyrave të kontrollit:

Zyra e kryeministrit;

Ministria e Mbrojtjes

Ministria e Punëve të Jashtme, dhe

Ministri për Shërbimet Sekrete.

Shërbimet si Shabak dhe Mossad janë direkt në vartësi të kryeministrit dhe nga ky kundërshtim, kryeministri shërben si një ministri për shërbimet sekrete.²¹¹

Karakteristikë tjetër është edhe bashkëpunimi i kufizuar ndërmjet krerëve të komunitetit të inteligjencës. Kjo formë e bashkëpunimit nuk është e sanksionuar me ligj. Ajo është bazuar në vullnetin e lirë dhe nuk është e obligueshme.²¹²

Sipas disa të dhënave, shërbimet inteligjente të Izraelit nuk kanë asnjë mekanizëm qendror i cili planifikon dhe mbikëqyrë veprimtarinë e tyre. Ndarazi secila organizatë menaxhon vetën. Përgjithësisht komuniteti inteligjent nuk ka asnjë plan të përbashkët të punës lidhur me buxhetin dhe kontrollin.²¹³

²¹⁰[Online] Marrë nga: <http://www.fas.org/irp/world/israel/ha122804.html> Ha'aretz December 28, 2004 Talking about a secrecy revolution The Foreign Affairs and Defense Committee is pushing for an overhaul of Knesset confidentiality measures By Gideon Alon

²¹¹[Online] Marrë nga: http://www.transbordertviolence.net/&files/Political_Control_over_Civilian_Intelligence_Organizations.pdf

Political Control over Civilian Intelligence Organizations in the Age of Internet
Dissertation for the award of educational and scientific degree "Doctor" in political science
cipher 05:11:02 Academic supervisor: Professor Alexander Tomov Sofia, 2010

²¹² Po aty

²¹³ Po aty

Mossad, i cili përbëhet prej tetë departamenteve, edhe pse disa të dhëna për organizimin e brendshëm të agjencisë mbeten të panjohura.²¹⁴ Ato gjithsesi janë të organizuara sipas rregullimit të brendshëm kushtetues ku kontrolli i brendshëm i agjencisë kryhet nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit.²¹⁵ Pra kompetencë e plotë në çdo aspekt mbetet Kryeministri si posti kryesor me peshë në Kushtetutën e Izraelit.

5.6 Sistemi i kontrollit dhe llogaridhënia në KOSOVË, (AKI)

(Ligjshmëria e mbikëqyrjes dhe kontrollit të AKI –së)

Aspekti i ligjshmërisë për mbikëqyrje dhe kontroll demokratik dhe llogaridhënia është e rregulluar në ligjin përkatës të AKI-së, gjetjet dhe rekomandimet që janë sugjeruar nga ky publikim në dobi të plotësimi në të ardhme të ligjit.

Mbikëqyrja parlamentare (Neni 35 rregullon këtë çështje në mënyrë precize dhe strukturore, por lë të hapur mundësinë edhe të ndërhyrjes dhe pengimit të kontrollit parlamentar, ngase dispozitat në disa raste e ndalojnë qasjen parlamentare. Më poshtë do të sqarojmë dy raste veç e veç të ndërhyrjes dhe pengimit.

Aspekte të rregullimit sipas niveleve të kontrollit demokratik në bazë të Ligjit për AKI – në. Ligji aktual ka prodhuar dhe përshtatur disa nivele të kontrollit demokrati ndaj AKI –duke filluar nga Emërtimi në bazë të ligjit të AKI – së përcakton Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, pastaj sipas llojit ky komision është Organ parlamentar i mbikëqyrjes²¹⁶, po ashtu Organ tjetër i kontrollit të brendshëm është i përcaktuar me ligj edhe shtylla e Inspektorit të Përgjithshëm për kontroll të brendshëm.²¹⁷

²¹⁴ Mossad has a total of eight departments, though some details of the internal organization of the agency remain obscure. <http://ftp.fas.org/irp/world/israel/mossad/index.html>

²¹⁵ History of Mossad, [Online] Marrë nga: <http://www.topspysecrets.com/mossad-history.html/>

²¹⁶ Ligji nr. 03/L-063 mbi Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, neni 35.

²¹⁷ Po aty, neni 10.7

Përbërja sipas subjekteve politike është, aktualisht ka 9 deputetë. Kryetari nga opozita. Përbërja e tij përcaktohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës.²¹⁸ Po ashtu edhe Çështja e emërimit të anëtarëve; Emërohen nga parlamenti përmes përfaqësimit proporcional, si dhe në bazë të emërimeve nga partitë.

Por cili është realisht Mandati i parlamentit për AKI –në gjithnjë në bazë të ligjit për AKI –në. Ligji parimisht zgjeron kompetencat e parlamentit, siç thuhet; Të Mbikëqyrë ligjshmërinë e punës së AKI-së; Të Shqyrtojë raportet e kryeministrit në lidhje me çështjet brenda kompetencave, të cilat përfshijnë veprime të ndërmarra për të korrigjuar çfarëdo problemesh në AKI të bëra të ditura nëpërmjet inspektimit, auditimit apo hetimit;

Të Shqyrtojë raportet e drejtorit të AKI-së në lidhje me operacionet dhe shpenzimet e AKI-së; Të Shqyrtojë raportet e inspektorit të përgjithshëm; Të ofrojë një mendim për propozimin e detajizuar të buxhetit për AKI-në; Të Kryejë hetime në lidhje me punën e AKI-së.²¹⁹

Komisionet parlamentare dhe profesionale të mbikëqyrjes mund të kërkojnë raporte shtesë nga shërbimet informative. Në rastin e Kosovës, drejtori i AKI-së njofton Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës për aktivitetet e AKI-së, ofron informata për Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës sa i përket sigurisë, përgatitë raporte dhe propozojë plane dhe programe të AKI-së, duke përfshirë mes tjerash, Programin Vjetor të Aktivitetit dhe Raportin Vjetor të Aktivitetit.²²⁰

²¹⁸ Kuvendi i Kosovës,[Online] Marrë nga:www.assembly-kosova.org/?cid=1,110,107 [Qasja e fundit, Korrik, 2016]

²¹⁹ Ligji nr. 03/L-063 mbi Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, neni 36.6

²²⁰ Ligji nr. 03/L-063, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, neni 5.7 pika 2, 3, 11

Po ashtu dispozitat tek Kompetencat hetuese të Komisionit Parlamentar i është dhënë një komoditet ligjor komisionit që në tre aspekte që të ketë ingerenca:

- 1. Të Mund të marrë në pyetje Punonjësit e AKI-së dhe të ketë qasje në dokumentet relevante të AKI-së;*
- 2. Të Mund të ftojë kryeministrin të ndërmarrë masat e nevojshme dhe të iniciojë shqyrtimin e përgjegjësisë; mund të kërkojë informacion nga kryeministri, drejtori i AKI-së, ose cilido Punonjës i AKI-së.*
- 3. Të Mund të urdhërojë drejtorin e AKI-së të paraqitet para tij në mënyrë që drejtori i AKI-së të japë raport gojor në lidhje me aktivitetet e AKI-së.²²¹*

Tani shtrohet çështja e sipërpërmendur tek kufizimi, mundësia e ndërhyrjes apo pengimi në Kompetencat e Komisionit në qasjen në informatat e klasifikuara dhe ndërmarrja e hetimeve të brendshme.

Në bazë të ligjit, citoj: Gjatë mbikëqyrjes parlamentare të ushtruar nga komisioni mbikëqyrës parlamentar, do të vihet në dispozicion informacion i klasifikuar përveç nëse shpalosja e tij do të kërcënonte interesat vitale të sigurisë kombëtare të lidhura me mbrojtjen e burimeve dhe metodave në një rast specifik. Po ashtu thuhet se: Nëse Kryeministri apo drejtori i AKI-së vendosin të mos i ofrojnë informacion komisionit mbikëqyrës parlamentar në bazë të Nenit 36.5 më lartë, ai do të informojë menjëherë me shkrim komisionin mbikëqyrës parlamentar me shpjegimin për mos ofrimin e atij informacioni²²²

Ligji në vijim ka përcaktuar qartë edhe aspektin hetimor siç thuhet: Hetimet parlamentare janë të mbyllura për opinionin përveç nëse caktohet ndryshe nga kryesuesi i organit mbikëqyrës parlamentar, në bazë të diskrecionit të tij apo saj, ose pas rekomandimit dhe votimit të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të komisioni mbikëqyrës parlamentar. Nëse komisioni mbikëqyrës parlamentar konstaton se operacioni i AKI-së është i paligjshëm, ai mund të ftojë kryeministrin të ndërmarrë masat e nevojshme dhe të iniciojë shqyrtimin e përgjegjësisë.²²³

²²¹ Po aty, neni 37

²²² Po aty, neni 37.6 dhe 37.7

²²³ Po aty, 37.1,2,3

Në tjetër element shumë i rëndësishëm dhe thuajse përfundimtarë, ndonëse praktikisht i përvitshëm, sipas nevojës apo kërkesave urgjente për raportim ndaj punës së AKI –së është edhe aspekti i raportimit. Edhe kjo çështje është e rregulluar si katër drejtim me, tri të vijës së raportimit dhe një aspekti të brendshëm nga propozimet, hartimet e raportit finale etj: Pra; Njofton Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës për aktivitetet e AKI-së. Ofron informata për Presidentin dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës sa i përket sigurisë. Përgatitë raporte dhe propozon plane dhe programe të AKI-së, duke përfshirë mes tjerash, Programin Vjetor të Aktivitetit dhe Raportin Vjetor të Aktivitetit; dhe Raporton para Komisionit parlamentar mbikëqyrës sipas kërkesës ²²⁴

5.7 Kontrolli i brendshëm i AKI –së

Kapitulli i III-të i Ligjit për AKI, specifikisht përshkruan në detaje fuqitë dhe përgjegjësitë e **Inspektorit të Përgjithshëm** i cili është emëruar bashkërisht nga Presidenti dhe Kryeministri.²²⁵ Fakti se Inspektori i Përgjithshëm emërohet direkt nga Presidenti dhe Kryeministri e bënë atë më të fuqishëm në ushtrimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm e që nuk është rast unik karshi vendeve tjera të rajonit. Inspektori i Përgjithshëm emërohet në një mandat katër vjeçar me mundësi të vazhdimit edhe për katër të tjera.²²⁶ Inspektori i Përgjithshëm është i mandatuara t'i raportoj vetëm Kryeministrin dhe komisionit relevant parlamentar lidhur me aktivitetet e AKI-së.

Mund të iniciojë hetime të brendshme, të bëjë auditimin financiar si dhe të rekomandojë përmirësime të gjendjes.²²⁷ Në këtë kontekst mendohet se ligji në fjalë lë hapësirë sa i përket çështjeve të hetimeve dhe krijon dy kuptimësi dhe interpretime të ndryshme, sikurse shprehimisht thuhet se: Drejtori i AKI –së e ka të drejtën e ndalimit të hetimeve nga Inspektori i Përgjithshëm nëse Drejtori konsideron se kjo është në dobi të mbrojtjes së interesave vitale të sigurisë”.²²⁸

²²⁴ Po aty, neni 5.7

²²⁵ Ligji për AKI, Neni 9.1

²²⁶ Ligji për AKI, Neni 9.2

²²⁷ Po aty, Neni 9.2

²²⁸ Ligji për AKI-në, Neni 10.6

5.8 Mbikëqyrja parlamentare e AKI –së

Vështirë se mund të ketë kohë më të përshtatshme se për të trajtuar çështjen e shërbimeve të fshehta të sigurisë dhe informacionit. Në vazhden e 11 shtatorit, luftës së dytë në Irak dhe 11 marsit (sulmeve terroriste që u kryen në Madrid më 11 mars 2004), shumë prej personave të ngarkuar me mbikëqyrjen e shërbimeve të fshehta, si në parlament ashtu edhe në ekzekutiv, aktualisht po shqyrtojnë punën e shërbimeve të fshehta dhe mënyrën si e trajtojnë krerët politik shërbimin e fshehtë.²²⁹ Mbikëqyrja parlamentare e shërbimeve të inteligjencës është njëri prej elementeve të procesit pesë-shkallësh të mbikëqyrjes së shërbimeve të inteligjencës.²³⁰

Edhe pse ka tendenca që parlamentet të kenë pak kompetenca për çështjet operacionale, ata kanë pushtet të mjaftueshëm për të përcaktuar mandatin dhe buxhetin e shërbimeve të inteligjencës, si dhe në vëzhgimin e sjelljeve të tyre pas fakteve. Në disa raste parlamenti, ose së paku anëtarë të caktuar të parlamentit, duhen të informohen ose të autorizojnë çështje të caktuara operacionale.²³¹

Edhe AKI –ja e ka të përcaktuar mënyrën e mbikëqyrjes parlamentare. Kreu VII Mbikëqyrja parlamentare Neni 35 Mbikëqyrja parlamentare. Mbikëqyrja e KIA-s²³² kryhet nga komisioni mbikëqyrës parlamentar, mandati i të cilit përshkruhet me këtë ligj. Përbërja e tij përcaktohet me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës.²³³ Po ashtu neni 36 përcakton

²²⁹ **Born Hans** dhe **Leigh Ian**, Kontrollueshmëria e shërbimeve të fshehta, Kapitulli 1, Përlufizimi i mbikëqyrjes demokratike të shërbimeve të fshehta të sigurisë dhe informacionit, faqe 13

²³⁰ **Pesë nivelet e mbikëqyrjes së shërbimeve të inteligjencës.** Vëzhgimi i shërbimeve të zbulimit është term i përgjithshëm për kontrollin dhe vlerësimin e aktiviteteve të shërbimeve të zbulimit. Përveç **mbikëqyrjes parlamentare** kjo përfshinë:

- **Kontrollin e brendshëm** – autoriteti dhe përgjegjësitë përkatëse të zyrtarëve udhëheqës për veprimet e vartësve të tyre (përfshirë këtu mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të zyrtarëve dhe disiplinimi i individëve brenda agjencisë)
- **Kontrollin ekzekutiv** – përgjegjësia e zyrtarëve relevant ekzekutiv dhe/ose ministritë përgjegjëse për shërbimet e inteligjencës.
- **Shqyrtimin gjyqësor** – roli i gjyqësisë në autorizimin e aktiviteteve të caktuara të zbulimit dhe gjykimi i shkeljeve të ligjit; dhe
- **Mbikëqyrjen e jashtme** nga mediat dhe shoqëria civile - roli i tyre në promovimin e debateve publike për aktivitetet e shërbimeve të zbulimit dhe përgjegjësisë së zyrtarëve. Për më tepër shih; **DCAF 03/ 2006** Mbikqyrja Parlamentare e Shërbimeve të Inteligjencës.

²³¹ **DCAF 03/ 2006** Mbikqyrja Parlamentare e Shërbimeve të Inteligjencës. Ky dokument është pjesë e përmbledhjeve serike të DCAF-it që ofrojnë informata të sakta për ushtruesit në çështje të ndryshmetë cilat lidhen me qeverisjen dhe reformën në sektorin e sigurisë. Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) promovon qeverisje të mirë dhe reforme të sektorit të sigurisë. Qendra drejton hulumtime në praktika të mira, inkurajon zhvillimin e normave të mirëfillta në nivelet nacionale dhe ndërkombëtare, bene rekomandime të politikave dhe siguron këshilla brenda-shtetit dhe programe zhvillimi. Partneret e DCAF përfshijnë qeveritë, parlamente, shoqëri civile, organizata ndërkombëtare dhe një vrange i aktoreve të sektorit të sigurisë sikurse policia, gjyqësori, agjencitë e zbulimit, shërbimet e sigurisë kufitare dhe ushtri. Na vizitoni në www.dcaf.ch

²³² Në këtë nen akronimi për AKI –në është në versionin e gjuhën angleze KIA.

²³³ Shih: Ligji i AKI –së KREU VII MBIKËQYRJA PARLAMENTARE Neni 35 Mbikëqyrja parlamentare.

veprimet dhe përgjegjësitë e organit mbikëqyrës parlamentar dhe neni 37 rregullon fushën e hetimeve parlamentare. Gjithashtu neni 38 Obligimi i ruajtjes së fshehtësisë nga komisioni mbikëqyrës parlamentar dhe 38.1 anëtarët e komisionit mbikëqyrës parlamentar janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë në mënyrë të lidhur me informacionin që ka të bëjë me sekretet zyrtare²³⁴

Për më tepër shih një nga mbledhjet e mbajtura të komisionit parlamentar të AKI -së²³⁵

Pra kontrollin dhe mbikëqyrjen parlamentare e rregullon kapitulli i VII-të i Ligjit për AKI -në ku i kërkohet Kuvendit të Kosovës të themelojë një “komision mbikëqyrës parlamentar” me mandatin kryesor për të “mbikëqyrur legalitetin e punës së AKI”³⁰ ²³⁶ Mandati i këtij komisioni po ashtu përfshinë shqyrtimin e raporteve lidhur me operacionet dhe shpenzimet e AKI. Bazuar në këtë obligim ligjor, në nëntor të vitit 2009 Kuvendi i Kosovës formoi Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e AKI. ²³⁷ Ligji për AKI fuqizon rolin e komisionit në iniciimin e seancave në rast se ekzistojnë dyshime se “AKI është duke performuar në mënyrë të paligjshme, papërshtatshme apo joprofesionale”.²³⁸

Përbërja e parë komisionit për mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë AKI ishte në këtë përbërje në grupet parlamentare: Kryetar Grupi Florin Krasniqi Grupi i Vetëvendosjes; Zëvendëskryetar i parë Grupit, Fadil Demaku PDK; Zëvendëskryetar i dytë Grupi Boban Todorović SLS; Anëtarët Grupi Bekim Haxhiu PDK, Haki Demolli LDK, Imri Ahmeti

²³⁴ Po aty.

²³⁵ Nga Mbledhja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës / E Hënë, 14.12.2009 <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,2761>

Në mbledhjen e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës, nën kryesimin e Gani Gecit, kryetar, ku ishte i pranishëm edhe Drejtori i Agjencionit Kosovar të Inteligjencës (AKI), Bashkim Smakaj, Latif Merofci zëvendës drejtor dhe Agron Selimaj Inspektor i përgjithshëm i AKI-së, u bë prezantimi i punës së deri tashme të këtij Agjencioni. Me këtë rast, Smakaj informoi anëtarët e Komisionit për punën e deri tashme të AKI-së, si dhe objektivat që synon të realizoj në të ardhmen ky Agjencion. Planifikimi dhe ndarja e buxhetit për vitin 2009, bashkëpunimi intensiv me Forcën e Sigurisë së Kosovës, Doganat, si dhe Policinë e Kosovës, kanë qenë punë permanente e AKI-së, theksoi Smakaj.

Platforma e veprimit të AKI-së është e ndërtuar në departamente (Analitike, Operative etj), ndërsa, procesi i rekrutimit ka filluar duke iu përshtat konkursit të publikuar sipas nevojave të AKI-së, me ç'rast interesimi ka qenë shumë i madh, theksoi Smakaj. Në vazhdim ai shprehu bindjen se deri në fund të viti që vjen, AKI do të ngris kapacitetin në nivelin e kënaqshëm, duke funksionuar si Agjencion me nivel të lartë të profesionalizmit. Në vazhdim anëtarët e Komisionit u shprehën se, Komisioni do të jetë gjithëherë në mbështetje të këtij Agjencioni, me synim që të ndërtohet në mënyrën më të mirë të mundshme si nevojë imediate e vendit.

²³⁶ Ligji për AKI-në, Neni 36.6

²³⁷ HULUMTIM PERIODIK NGA QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS) ME TEMË: QEVERISJA E AGJENCISË SË INTELIGJENCËS NË KOSOVË / FLORIAN QEHAJA / QKSS, PRISHTINË / 03. PRILL 2012, faqe 15

²³⁸ Ligji për AKI -në, Neni 37.1

LDK, Burim Ramadani AAK, Ukë Rugova KKR, dhe Duda Balje Grupi 6+.²³⁹ Në kuadër të komisionit mbikëqyrjes ekziston edhe një koordinator.²⁴⁰

Aktualisht pra komisioni parlamentar është i përbërë nga nëntë anëtarë, shumica e të cilëve i takon përbërjes aktuale të qeverisë. Mirëpo specifikisht, kryetari i komisionit nuk duhet t'i takoj pozitës qeverisëse.²⁴¹ Përderisa i është kushtuar vëmendje përfshirjes së minoriteteve në komision, megjithatë nuk kishte vëmendje për përfshirje gjinore. Për momentin, vetëm një anëtarë e komisionit është femër, gjë që reflekton interes të kufizuar të partive politike në pozicionimin e gruas në komisionet e sferës së sigurisë (gratë përbëjnë 1/3 e Kuvendit të Kosovës).²⁴²

Informacionet e ofruara nga zyrtarët e komisionit tregojnë një qasje proaktive të këtij komisioni në vitin e parë të funksionimit të tij. 33 Gjatë vitit të parë të funksionimit (2010), komisioni u takua 12 herë apo thënë më ndryshe një herë në muaj. Gjatë këtyre takimeve, deputetët miratuan raportin vjetor si dhe shtruan 39 çështje për diskutim dhe morën 3 vendime. Në përgjithësi, aktiviteti i madh i këtij komisioni e bënë atë një ndër organin më të rëndësishëm për mbikëqyrjen e AKI-së në Kosovë. Edhe pse kontaktet e shpeshta ndërmjet medieve dhe deputetëve të këtij komisioni kanë ndihmuar procesin e mbikëqyrjes, qasja e gazetarëve ka qenë e kufizuar si rezultat i sesioneve të mbyllura të këtij komisioni.²⁴³

Një çështje që mbetet tejet e rëndësishme dhe akoma nuk ka përfunduar mbetet Verifikimi i Sigurisë për deputetët në komisionin për mbikëqyrjen e AKI –aë

Në mënyrë që të kryejnë funksionet e tyre mbikëqyrëse, anëtarëve të komisionit i duhet qasje në informacionet e klasifikuara. Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë²⁴⁴, me përjashtim të Presidentit, Kryeministrit dhe Kryetarit të Parlamentit, kërkon nga secili, përfshirë dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i nënshtrohen verifikimit të besueshmërisë,

²³⁹ Kuvendi i Kosovës, [Online] Marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,107>, [kontrolluar sëfundmi herë 29.05.2012]

²⁴⁰ Aktualisht koordinator i komisionit për mbikëqyrje parlamentare të AKI –së është Nur Çeku

²⁴¹ Ligji për AKI-në, Neni 36.2

²⁴² Hulumtim periodik nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) me temë: qeverisja e agjencisë së inteligjencës në Kosovë / Florian Qehaja / QKSS, Prishtinë / Prill 2012, faqe 16

²⁴³ Hulumtim periodik nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) me temë: qeverisja e agjencisë së inteligjencës në Kosovë / Florian Qehaja / QKSS, Prishtinë / Prill 2012, faqe 15/ 16

²⁴⁴ Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, është zbatuar nga një Departament brenda AKI –së për Verifikimin e Sigurisë, por qeveria ka nisë hartimin e standartizuar sipas BE –së përmes një Projektligji të ri, cili i bartë autorizimet AKI –së, në Agjencinë për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK)

në mënyrë që të kenë qasje në informacionet e klasifikuara. Kjo e len të hapur mundësinë që deputetit mund t'i refuzohet kërkesa për qasje në informacion të klasifikuar. Hartuesit e ligjit në fjalë kishin parasysh papjekurinë e demokracisë kosovare si dhe sistemin e dobët elektoral që ka rezultuar në disa raste në zgjedhjen e dyshimtë të deputetëve.²⁴⁵ Për më tepër, edhe në rast të verifikimit të besueshmërisë së deputetëve atyre mund ti'u ndalohe qasja në informacione të klasifikuara nëse "hapja e këtyre informacioneve rrezikon interesat vitale të sigurisë nacionale që ndërlidhen me mbrojtjen e një burimi apo metode të rasteve specifike"²⁴⁶.

Përveç Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të AKI-së, komisionet tjera që kanë mandat të mbikëqyrin AKI-në përfshinë: Komisioni për Buxhet dhe Financa që aprovon buxhetin vjetor të AKI-së; Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike që shqyrton shpenzimet buxhetore të AKI dhe raportet e auditimit si dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, mandati i së cilës është mbikëqyrja e të drejtave të minoriteteve në rast të shkeljeve të mundshme.²⁴⁷

Një nga takimet i fundit të komisionit për AKI –në që ishte mbajtur me 23 Maj 2012, ditë e mërkure, ku për veç tjerash është kërkuar nga Kuvendi krijimi i një Dhome të Veçantë të Sigurisë, kur përveç tjerash ishte kërkuar Inspektorit të Përgjithshëm të raportojë me shkrim për shpenzimet e AKI –së.²⁴⁸

Komisioni aktual parlamentar për Mbikëqyrjen e AKI-së, është në këtë përbërje:

Kryetar i Komisionit Haxhi Shala nga NISMA Zëvendëskryetare e parë Ganimete Musliu
Grupi: PDK Zëvendëskryetar i dytë Bahrim Šabani Grupi:6+; Arbër Rexhaj - Lëvizja
Vetëvendosje; Anton Quni - LDK; Teuta Rugova - LDK; Xhevahire Izmaqu - PDK; Slavko
Simić - Lista Serbe; Bekë Berisha - AAK; Shemsi Syla - Lëvizja Vetëvendosje.²⁴⁹

²⁴⁵Po aty

²⁴⁶ Ligji për AKI –në, Neni 36.2

²⁴⁷ HULUMTIM PERIODIK NGA QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS) ME TEMË: QEVERISJA E AGJENCISË SË INTELIGJENCËS NË KOSOVË / FLORIAN QEHAJA / QKSS, PRISHTINË / PRILL 2012, faqe 17

²⁴⁸Portal, Kosovapress, [Online] Marrë nga:<http://kosovapress.com/?cid=1,92,147642>, Prishtinë, 23 Maj 2012 17:34

²⁴⁹ Kuvendi i Kosovës, Faqe zyrtare [online] <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110,149>, (Parë për herë të fundit, shkurt 2018)

5.9 Shoqëria civile dhe mediet

Në demokracitë liberale mbikëqyrja nga media dhe shoqëria civile përmes informimit dhe debatit publik mbi ligjshmërinë dhe performancën është një mekanizëm tjetër i llogaridhënies dhe kontrollit të shërbimeve informative. Informacioni që këta aktorë kanë në lidhje me veprimtaritë e shërbimeve informative dhe të sigurisë normalisht është i kufizuar, por vetë qeveritë bëjnë publik informacion sekret në bazë të legjislacionit mbi aksesin ndaj informacionit publik dhe legjislacionit mbi deklasifikimin. Forma të tjera të mbikëqyrjes publike përfshijnë informacionin e përftuar nëpërmjet gazetarisë investigative mbi keq bërje të mundshme të shërbimeve informative. Të gjitha këto forma ndihmojnë që publikut të mbahet i informuar mbi çështjet e sigurisë shtetërore, por nga ana tjetër i lejojnë qeveritë që të informohet mbi pikëpamjet e opinionit publik dhe preferencat mbi politikat që ato ndërmarrin. Në shumë shtete demokratike, individët dhe organizatat e shoqërisë civile janë në gjendje të kërkojnë informata mbi secilën agjenci qeveritare. Qasja e fituar në këto informata mund t'i mundësojë shoqërisë të mbikëqyr aktivitetet e qeverisë, duke përfshirë shërbimet e saj informative.²⁵⁰

Në literaturën bashkëkohore shpesh hasim në përkufizime si: “ Shërbimet Inteligjente, mbikëqyrja demokratike - media dhe shoqëria civile” apo “Roli i Medieve dhe Shoqërisë Civile rritë shkallën e transparencës së Shërbimeve të Inteligjencës” etj. Kjo çështje si e tillë nuk është e trajtuar specifikisht në asnjë nen në Ligjin e AKI –së, sikurse askund as kalimthi nuk përmendet nevoja për komunikim me media dhe shoqërinë civile. Sipas kësaj praktike të krijohet përshtypja sikur gjithnjë e më shumë shtohet ideja për vigjilencë dhe kujdes, ndonëse nganjëherë edhe friga mes medieve dhe shërbimit inteligjent, specifikisht ndaj medieve shënohet heshturazi një **“perde e hekurt”** apo mbyllje hermetike, por jo edhe armiqësie të dukshme. Ndërsa rasti me shoqëritë civile edhe te ne shënon një stad të ri të komunikimit publik në vazhden e debateve, publikimeve akademike etj. Si p.sh: subjekte të OJQ – ve të ndryshme, që janë të profilizuara dhe që kanë për mision monitorimin dhe vlerësimin profesional siç po bënë edhe QKSS – ja ofrojnë orientime serioze dhe shumë efikase për të rritë nivelin e përgjegjshmërisë në raport me detyrimet ligjore

²⁵⁰ Hulumtim i mentoruar nga Prof dr. Kolë Krasniqi, niveli master, punuar nga studenti Sefedin Kuqi , Universiteti FAMA me temë:”Kontrolli dhe mbikëqyrja e shërbimeve informative”, faqe 22

dhe publikun, në këtë rast, që ka AKI –ja, por edhe i tërë sektori i sigurisë në Republikën e Kosovës.

Megjithatë, edhe pse mendohet në një lloj mospërshtatje ligjore në rastin e parë, apo thënë ndryshe një lloj mbyllje në heshtje ndaj medieve nuk nënkupton minim të përpjekjeve për transparencë kur kihet parasysh natyra specifike e punës së AKI –së dhe të mendohet se vë në pikëpyetje konsolidimin e mëtejme si shoqëri demokratike në një vend të caktuar, në rastin tonë Kosova. Kjo nuk duhet kuptuar ashtu, ngase shumë praktika ligjore e kanë të rregulluar këtë çështje pothuajse ngjashëm, sikurse që e parasheh edhe ligji për AKI –në, sa që të krijohet përshtypja se ligji në fjalë është modifikim nga jashtë siç edhe konstatohet nga edhe publikimi me dyshimin nga kritikët se ligji është shkruan në gj. angleze²⁵¹ me një përkthim tejet të dobët në gjuhën shqipe dhe me mangësinë e kontrollit të pestë.

5.10 Institucionet e pavarura

Roli i organizatave të shoqërisë civile dhe medieve në mbikëqyrjen e AKI-së është relativisht i dobët. Vetëm disa organizata jo-qeveritare bëjnë hulumtime apo monitorojnë performancën e kësaj agjencie dhe se vetëm disa raporte janë fokusuar në qeverisjen e mirë të AKI-së. Krahësimisht, media ka pasur një rol më të madh në përcjelljen e ngjarjeve lidhur me zhvillimin institucional të AKI-së. Siç është elaboruar më lartë, mediet kanë ngritur shqetësimet për implikime politike në këtë agjenci dhe kanë monitoruar performancën e AKI-së si dhe funksionimin e komisionit relevant parlamentar duke bërë intervista të shpeshta me deputetët. Raportimi i medieve do të ishte edhe më informativ nëse AKI nuk do të i rezistonte ngritjes së nivelit të transparencës ndaj publikut. Përveç disa informimeve të shkurtra nga gazetarët, AKI ka qenë e heshtur ngase nuk ka publikuar

as një komunikatë për media apo raport.²⁵²

²⁵¹Sqarim: Neni 35 MP (Mbikëqyrja e KIA-s kryhet nga komisioni mbikëqyrës parlamentar, mandati i të cilit përshkruhet me këtë ligj, faqe 19).

²⁵² QKSS, Funksionet e Kontrollit të Institucioneve të Pavarura të Shtetit në Sektorin e Sigurisë në Kosovë, faqe. 34

5.11 Roli i Gjyqësorit

Një mekanizëm tjetër i rëndësishëm i llogaridhënies të shërbimeve informative është gjyqësori. Asnjë shërbim informativ nuk është mbi ligjin prandaj shërbimet informative duhet të ju nënshtrohen ligjeve të vendeve përkatëse. Për këtë gjyqësori në shoqëritë demokratike luan një rol mjaftë të rëndësishëm. Gjyqësori gjykon në mënyrë përfundimtare nëse shërbimet informative e kryejnë aktivitetin e tyre në mënyrë të ligjshme dhe jep dënime për veprime antiligjore të kryera nga punonjës të tyre. Në shumë shtete, gjyqësori autorizon dhe mbikëqyr përdorimin e autorizimeve të veçanta të shërbimeve informative. Gjyqësori gjithashtu zgjidhin ankesat që parashtrohen kundër shërbimeve informative, si dhe nëse kërkohet, vendosin mjetet juridike ndaj keqpërdorimeve të ndryshme. Në rastin e Kosovës, personat e ndikuar nga veprimet e ndërmarra të AKI mund t'i adresojnë ankesat e tyre te Avokati i Popullit dhe në të njëjtën kohë të ngrisin padi në gjyq kundër AKI-së.²⁵³

Në rrethana normale, gjyqësori do të mund të luante një rol të rëndësishëm që të sigurohet legaliteti i operacioneve të agjencisë së inteligjencës. Mirëpo, fakti se gjyqësori në Kosovë është i dobët është vështirë të pritet që gjyqtarët të ushtrojnë kontroll të duhur në një të ardhme të afërt.²⁵⁴

Ligji për AKI-në në mënyrë eksplicite kërkon miratimin e gjyqtarit të Gjykatës Supreme para se AKI të filloj përdorimin e masave speciale investigative siç janë survejimi në vendet jopublike apo edhe përgjimet e telekomunikimeve.²⁵⁵

Përmes vendimeve të tyre, gjyqësori vendos standardet për kontrollimin e sjelljeve të ardhshme të shërbimeve informative. Gjithashtu, gjyqësori vendosin mbi çështjet në lidhje me qasjen në apo zbulimin e informatave në lidhje me shërbimet informative. Gjyqësorit mund t'iu kërkohet të gjykojnë mbi ato pretendime në lidhje me informatat për apo të mbajtura nga shërbimet informative. Ato vendime merren në bazë të ligjeve për qasje në informata/liri të informimit. Përveç këtyre, gjykatat mund të obligohen të gjykojnë lëndët që parashtrohen kundër personave të akuzuar për zbulim të paligjshëm të informatave të klasifikuara që mbahen nga shërbimet informative. Përfundimisht, në shtetet demokratike ekzekutivi mund të kërkojë nga gjyqtarët

²⁵³ Ligji nr. 03/L-063 mbi Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, neni 39.2.

²⁵⁴ Hulumtim periodik nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) me temë: Qeverisja e Agjencisë së Inteligjencës në Kosovë / Florian Qehaja / QKSS, Prishtinë / Prill 2012, faqe 18

²⁵⁵ Ligji për AKI - në, Neni 28.1

aktual apo të mëhershëm që të bëjnë hetime gjyqësore të rasteve apo aktiviteteve të kaluara në lidhje me shërbimet e informative.²⁵⁶

5.12 Sfidat e fuqizimit të mbikëqyrjes parlamentare të Inteligjencës së AKI –së

S'ka dyshim se fuqizimi i mbikëqyrjes parlamentare të inteligjencës në Kosovë është i domosdoshëm për të përmbushur një element të rëndësishëm të demokracisë. Si e tillë mundë të përmbushet nëse kihen parasysh disa rekomandime të dobishme që janë nxjerrë në tryezën me temë: “Qeverisja e Agjencisë së Inteligjencës në Kosovës” të organizuar nga DCAF dhe QSSK në Prishtinë.²⁵⁷ Në këtë takim, ndër shumë trajtesa lidhur me këtë temë janë nxjerrë edhe sfidat që duhet tejkaluar për tu përballur me fuqizimin e mbikëqyrjes parlamentare sa më të efektshme të AKI –së.

Sipas këtij hulumtimi duhet që Komisioni relevant parlamentar t'i kushtoj rëndësi konsistencës në kryerjen e detyrave të saj mbikëqyrëse; Kuvendi duhet të rris numrin e stafit mbështetës për komisionet relevante parlamentare duke përfshirë edhe ekspertët e shoqërisë civile që do të mund të këshillonin komisionin në kontrollin dhe mbikëqyrjen e punës së inteligjencës; Komisioni relevant e sidomos AKI duhet të jenë më shumë transparent në mënyrë që publiku të jetë më shumë i informuar. AKI, duhet të krijojë web-faqën e saj që do të publikonte informacione lidhur me mandatin e saj në mënyrë që të ndërtojë besimin e publikut; Roli i Inspektorit të Përgjithshëm duhet të jetë më i theksuar si dhe neni që ia mundëson drejtorit të AKI-së të ndaloj iniciimin e hetimeve nga Inspektori i Përgjithshëm duhet të modifikohet; AKI dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të angazhohen bashkërisht lidhur me çështjet strategjike në sferën e inteligjencës. Diskutimet në tryeza që përfshijnë AKI-së dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe ekspertët e pavarur dhe përfaqësuesit e jetës akademike, mund të shërbejnë si një platformë efektive e komunikimit.

²⁵⁶ Hulumtim i mentoruar nga Prof dr. Kolë Krasniqi, niveli master, punuar nga studenti Sefedin Kuqi , Universiteti FAMA me temë:”Kontrolli dhe mbikëqyrja e shërbimeve informative”, faqe 13

²⁵⁷ Tryeza është mbajtur me 03. prill 2012 .

Dy aspekte themelore :

Në teoritë bashkëkohore ekzistojnë dy lloje të kontrollit dhe monitorimit të shërbimeve të inteligjencës; Aspekti vertikal dhe aspekti horizontal;

5.13 Aspekti vertikal: zakonisht i përgjigjet Institucioneve Qendrore, si p.sh.; Qeverisë, Parlamentit dhe Presidencës. Sikurse që janë të krijuara nga institucionet qendrore ato edhe i përgjigjen këtyre institucioneve dhe deponojnë informacione, Pra edhe AKI – ja e ka të rregulluar me ligj komunikimin me institucionet qendrore të vendit.

5.14 Aspekti Horizontal: zakonisht i referohet mbikëqyrjes së jashtme si p.sh; spektrit të shoqërisë civile, opinionit publik, si medieve, promovimit të formave të debatit etj .²⁵⁸

Çështja e dy aspekteve themelore me të vërtetë konsiderohet thelbësore në raportet në mes të komunitetit të inteligjencës dhe partnerëve të rregulluara me ligj. Kurse për aspektin horizontal konsiderohet sfida e së tashmes dhe së ardhmes ku shoqëria civile në përgjithësi dhe mediet në veçanti do të kenë fushëbetë të tyre mediatike në komunikimin ndërmjet shërbimeve të inteligjencës dhe opinionit publik si një nga çështjet parësore në këtë këndvështrim dy konceptual.

²⁵⁸ Për më tepër shih; DCAF 03/ 2006 Mbikëqyrjes së Jashtme e Shërbimeve të Inteligjencës.

“Për Agjencitë e Inteligjencës, sfidë në shek XIX, do të mbetet të arrijnë të, parandalojnë, kontrollojnë maksimalisht luftën kundër terrorizmit, edhe ta mënjanojnë tërësisht mundësinë për tu shfaqur.”

KAPITULLI I GJASHTË

INTELIGJENCA DHE SFIDAT NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT

6.1 Origjina dhe fillet e terrorizmit ndërkombëtar.....	115
6.2 Rritja dhe rënia e terrorizmit ndërkombëtar.....	117
6.3 Shqetësimet për të ardhmen.....	120
6.4 Terrorizmi dhe politika e sigurisë ndaj publikut.....	122
6.5 Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit.....	123
6.6. Kostot e terrorizmit.....	124
6.7 Pamjet e terrorizmit.....	126
6.8 Vlerësimi dhe paralajmërimi i kërcënimit.....	127
6.9 Organizatat terroriste.....	128
6.10 Inteligjenca dhe Kiberterrorizmi.....	131
6.11 Bashkëveprimi i institucioneve ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit.....	133
6.12 Roli i agjencive inteligjente në shkëmbimin e informacionit.....	140
6.13 Roli i shërbimeve të specializuara policore	142
6.14 Roli i shërbimeve të specializuara ushtarake	145

INTELIGJENCA DHE SFIDAT NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT

6.1 Origjina dhe fillet e terrorizmit ndërkombëtar

Natyrisht se një nga sfidat për të mëdha me të cilën po ballafaqohet sot bota në dekadën e dytë të shekullit XI, është pa mëdyshje edhe trendi gjithnjë e më i madh i shfaqjes së terrorizmit në përmasa globale.

Organizata terroriste më me ndikim në botë, si kjo e fundit **ISIS**²⁵⁹, e cila është shndërruar në xhelat kundër jobesimtarëve dhe besimtarëve, pa dallim që nuk ndjekin rrugën e tyre, duke kryer disa qindra veprime të terrorizmit gjithandej në Lindje të Mesme, Irak dhe Siri, Evropë dhe Ballkan dhe kudo që arrin të rekrutojnë njerëz “besimtarë” të komunitetit islam, konsiderohet si një nga organizimet terroriste më të tmerrshmet që ka njohur bota përgjatë shek XX e deri më tani.

Por si u shfaq dhe si po rritet terrorizmi ndërkombëtarë, cili është roli i agjencive të inteligjencës dhe kundër inteligjencës në tërë këtë katrohurë të rendit të ri ndërkombëtarë, si në pikëpamje të parandalimit, shtytjes dhe të shumë pikëpyetje të tjera që ndërlidhen me fushëveprimtarinë e terrorizmit dhe shërbimeve të zbulimit.?

Shumë autorë që trajtojnë këtë fushë siq janë, **Alex Schmid & Albert Jongman**²⁶⁰, pastaj autorët **Brian Jenkins**²⁶¹ dhe **Ali Khan**²⁶² etj, pajtohen në mendimet sa përket “definimit” se historia e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe vetë njerëzimi e kanë njohur shumë herët fenomenin e terrorizmit dhe aktivitetëve terroriste se sa në kohën tone. Sipas këtyre mendimeve, del se shumë dekada me radhë terrorizmi ka krijuar shqetësime dhe probleme të mëdha për sigurinë dhe paqen kombëtare e ndërkombëtare të shteteve.

²⁵⁹Në kuptimn përmbajtësor, **ISIS**, në përkthim do të thotë “Shteti Islamik i Irakut dhe Shamit”, është organizata që përfaqëson një grup luftëtarësh xhihadistë, të cilët kanë vepruar në Irak e Siri. Qëllimi kryesor i tyre, ndryshe nga grupet e tjera rebele është krijimi i shtetit islamik.

²⁶⁰Autorët, Alex Schmid & Albert Jongman, “Political Terrorism: A New Guide to Actors, Authors, Concepts, Data Bases, Theories and Literatures” US, 2005

²⁶¹ Autori, Brian Jenkins, “The Study of Terrorism: Definitional Problems”, RAND Corporation, December 1980.

²⁶² Autori, Ali Khan, “A Theory of International Terrorism: Understanding Islamic Militancy”, “Developments in International Law. 2006

Terrorizmi duhet konceptuar si kërcënim ose përdorim dhune fizike përkundrejt personave ose pasurive të ndryshme nga persona ose grupe personash pjesëtar të organizatave terroriste, me qëllim arritjen e objektivave politike, fetare, ideologjike të drejtuara kundër një shteti ose disa shtetesh.²⁶³

Nocioni terrorizëm²⁶⁴ në kuptim real, është dhunë e paramenduar ndaj masës jo luftuese me qëllim ndikimin e opinionit publik për të arritur më pas në goditjen e objektivave me natyrë politike, ushtarake apo ideologjike. Për rrjedhojë marrin kuptimet e tyre fjalët terrorist dhe terrorizoj.²⁶⁵

Nocioni i shprehur si “*Terror cimbricus*” ishte një panik dhe gjendja e jashtëzakonshme në Romë në përgjigje të afrimit të luftëtarëve të fisit Cimbri në 105 para Krishtit. Jakobinët e përdorën këtë precedent, kur vendosën një regjim terrori gjatë Revolucionit Francez²⁶⁶. Pas humbjes së pushtetit nga Jakobinët, fjala "terrorist" u bë një term i abuzimit. Edhe pse "terrorizmi" fillimisht i referohej akteve të kryera nga një qeveri, aktualisht ajo zakonisht i referohet vrasjes së njerëzve të pafajshëm për qëllime politike në mënyrë të tillë që të krijojë një spektakël mediatik.²⁶⁷

Ky kuptim të çon shumë kohë përpara edhe tek **Sergej Nechayev**²⁶⁸, i cili e përshkronte veten si një "terrorist". Nechayev themeloi grupin terrorist "Hakmarrja e Popullit" rusisht (Народная расправа) në vitin 1869. Këto fakte flasin për fillet e emërimit me shprehjen “terror”. Në nëntor të vitit 2004, një raport i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara e përshkruante terrorizmin si çdo “akt” që ka për qëllim të shkaktojë vdekje ose lëndime të rënda

²⁶³Burim i hapur,nga Eraldo Meçalla, Një vështrim rreth terrorizmit ndërkombëtarë, artikull[Online] Marrë nga:<http://www.tiranaobserver.al/nje-veshtrim-rreth-terrorizmit-nderkombetar>, [Parë për herë të fundit, qershor, 2016].

²⁶⁴Në kuptimin gjuhësor, "Terrorizmi" vjen nga fjala franceze *terrorisme*, dhe në fillim i referohej në mënyrë specifike terrorizmit shtetëror siç u praktikua nga qeveria franceze gjatë Mbretërimit të Terrorit 1793-1794. Fjala franceze *terrorisme* nga ana e saj rrjedh nga folja latine *terreo* që do të thotë "frikësoj".

²⁶⁵Muhamet Aziz Shukri, “The International Terrorism A legal critique”, Vermont 1991, faqe 21

²⁶⁶Në kontekstin historik; Bazuar në kronologjinë historike, politike, fetare, ideologjike dhe psikologjike terrorizmi ka pasur një rrugëtim të gjatë. Veprimtaria më hershme terroriste është ajo e “Romës së lashtë”, ku grupe të quajtura Sicari dhe Zealtots kryenin vrasje përkundrejt romakëve, grekëve, hebrenjve duke i terrorizuar dhe detyruar të bashkëpunonin. Për sa i përket origjinës së fjalës terrorizëm ajo vjen nga “regime de la terreur”, në periudhën 1793–1794 në Francë, përgjatë Revolucionit Francez.

²⁶⁷Portal Informativ, Artikull,[Online] Marrë nga:<http://www.tiranaobserver.al/dhjete-sulmet-me-vdekjeprurese-terroriste-ne-bote/>

²⁶⁸ Shënim për autorin; Sergey Gennadiyevich Nechayev (or Nyechayev; Russian: Сергей Геннадиевич Нечаев) (October 2, 1847 – November 21 or December 3, 1882) was a Russian revolutionary associated with the Nihilist movement and known for his single-minded pursuit of revolution by any means necessary, including terrorism. He was the author of the radical *Catechism of a Revolutionary*.

trupore ndaj civilëve apo jo luftëtarëve me qëllim të frikësimit të popullatës apo për ti imponuar një qeverie apo një organizate ndërkombëtare për të bërë ose për të mos bërë ndonjë akt".²⁶⁹

Sipas shumë të dhënave, më shumë se 600 libra, artikuj dhe ese dedikuar terrorizmit janë publikuar gjatë 20 vjetëve të fundit. Edhe sipas autorit **AlexSchmid**, janë regjistruar 5831 tituj deri në vitin 1987. Fjala "Terror" rrjedh nga latinishtja dhe bie në drejtimin e gjuhëve romake, gjegjësisht gjuhëve evropiane: terrorist, terrorizëm, akt terrorizmi, anti-terrorizëm, etj.

6.2 Rritja dhe rënia e terrorizmit ndërkombëtar

Fenomeni i terrorizmit ndërkombëtar ka pasur disa rënie dhe ngritje. Varësisht nga rrethanat dhe kohët në të cilat kanë kaluar shtetet në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në vitet 1960-1970, përveç grupeve nacionaliste u formuan edhe grupe të motivuara etnikisht dhe ideologjikisht si: 1.) Organizata për Çlirimin e Palestinës. 2.) Grupi Bask, ETA. 3.) Ushtria Republikane Irlandeze Paraushtrake. 4.) Ushtria e Kuqe. 5.) Brigada e Kuqe në Itali.²⁷⁰

Në fakt "Terrorizmi ndërkombëtar" realisht përbën një nga kërcënimet më serioze për shtetet sepse kapërcen çdo kufi gjeografik, pra nuk ka një "shtëpi" dhe kjo sigurisht që përbën një vështirësi për reagimin e strukturave të sigurisë ndërkombëtare. Kjo është një nga çështjet më të diskutuara dhe shqetësuese për qeveritë në vitin 2015, në një botë tërësisht të globalizuar, në të cilën fenomeni i terrorizmit ndërkombëtar është universal për të gjithë globin. Fenomeni i terrorizmit ndërkombëtar ka filluar të dominojë studimet e marrëdhënieve ndërkombëtare që nga vitet 1970–1980, por sot në shekullin e 21 është kthyer në çështjen më të diskutuar nga shtetet për sa i përket kërcënimit që përbën për sigurinë dhe paqen e sistemit ndërkombëtar.²⁷¹

Një nga aktet e para terroriste ndërkombëtare ishte ai i "Grupit Palestinez", të cilët rrëmbyen një avion udhëtarësh dhe vranë atletët izraelitë në Lojërat Olimpike të vitit 1972. Në vitin 1980, fenomeni u zhvillua së tepërmi dhe shkak për këtë ishte politika anti-amerikane dhe anti-evropiane në Lindjen e Mesme.

²⁶⁹Shih më shumë; The Making of a Suicide Bomber, [Online] Marrë nga: <http://www.criterion-quarterly.com/the-making-of-a-suicide-bomber/>

²⁷⁰ Burim i hapur, Artikull nga Eraldo Meçalla, Një vështrim rreth terrorizmit ndërkombëtar, [Online] Marrë nga: <http://www.tiranaobserver.al/nje-veshtrim-rreth-terrorizmit-nderkombetar>, [Qasja, Qerrshor, 2016]

²⁷¹ ibid

Shtetet që e kanë sponsorizuar dhe mbështetur më shumë terrorizmin ndërkombëtar janë ato të Lindjes së Mesme si Irani, Iraku, Libia, Siria të cilët e gjejnë frymëzimin tek besimi dhe feja radikale, që përbën një nga problemet më serioze dhe thelbësore sot në ngjarjet politike dhe marrëdhëniet-ndërkombëtare.²⁷²

Akti terrorist ndërkombëtar i 11 shtatorit 2001, që me anë të aeroplanëve goditi “Kullat Binjake” dhe Pentagonin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës krijoi ndjenjë terrori dhe pasigurie për të gjithë botën. Lufta kundër terrorizmit ndërkombëtar duhet bazuar në pengimin dhe moslejimin e organizatave terroriste që të zotërojnë dhe më pas të përdorin armë të shkatërrimit në masë si armët bërthamore, biologjike dhe kimike, ky fakt do të ishte tejet i rrezikshëm për ekzistencën e njerëzimit.²⁷³

Një rol postulat këtu luajnë agjencitë e zbulimit dhe të kundërzbulimit²⁷⁴, në përpjekjet e tyre, me veprime operative inteligjente dhe kundërinteligjente, për të pas qasje të pakufizuar dhe mundësi, që në fazat e hershme të parandalimit dhe ofrimit qeverive përkatëse njoftimet e duhura lidhur me zhvillimet e përhapjes së terrorizmit ndërkombëtarë. Terrorizmi ndërkombëtar, sot mund të përkufizohet me elementët si: dhunën, terrorin dhe vrasjet masive më të përgjakshme në të gjithë hapësirën gjeografike të botës. Aktet e panumërta terroriste organizohen, planifikohen, financohen dhe kryen nga “Organizatat Terroriste Ndërkombëtare”, të cilat qëllimin e përbashkët e gjejnë tek destabilizimi i Rendit Ndërkombëtar.

Shumë autorë sot janë përfshirë në diskutime dhe mendime lidhur me këtë shpërfaqje kaq të shpjegjet të terrorizmit ndërkombëtar. Në librin me titull: “*International Terrorism: A New Mode of Conflict*”, studiuesi **Brain M. Jenkins**²⁷⁵ thekson: “Terrorizmi ndërkombëtar mund të krahasohet me fillimin e një Lufte të III Botërore”.

²⁷² Po aty

²⁷³ Po aty

²⁷⁴Kuptimi më gjerësisht; Zbulimi dhe kundërzbulimi nënkupton përdorimin e burimeve të hapura, dhe burimevetë fshehta siç janë spiunët, agjentët dhebashkëpunëtorët, përkatësishtanaliza dhe verifikimi i të dhënave dhe shndërrimi i tyre në produkte inteligjente të cilat iu ndihmojnë vendimmarrësve duke iu ofruaratyre informata relevante, të vërteta të cilat kanë si qëllim sqarimin e situatave dhe çështjeve komplekse të shërbimeve të inteligjencë në sfondin e **zbulimit** dhe **kundërzbulimit**, i cili sot në luftën kundër terrorizmit mbetet i jashtëzakonshëm.

²⁷⁵Për autorin, **Brian Michael Jenkins**, born in 1942 in Chicago, is an expert on terrorism and transportation security. During his nearly four decades of analysis, Jenkins has advised governments, private corporations, the Catholic Church, and the Church of England on terrorist threats.

Sipas Departamentit të Shtetit të ShBA –ve dhe Byrosë së Kundërzbulimit²⁷⁶ organizatat terroriste më me ndikim në botë janë:

- 1.) **ISIS**, (Shteti Islamik i Irakut dhe Levant), vepron në Siri, Irak, Libi, Liban dhe Nigeri është një nga organizatat terroriste më të rrezikshme për sigurinë dhe paqen ndërkombëtare në momentin që jetojmë.
- 2.) **Al-Kaeda**, është organizata terroriste më e njohur në botë e krijuar nga Osama Bin Laden në fund të viteve 1980 dhe është e përhapur në Afganistan, Pakistan, Iran dhe Indonezi.
- 3.) **Hamas**, (Lëvizja e Rezistencës Islamike) e përhapur në Izrael, Bregun Perëndimor, Rripin e Gazë.
- 4.) **Hesbollah**, (Partia e Zotit) është e vendosur në Liban dhe me celula në Afrikë, Azi dhe Europë.
- 5.) **ETA** (Atdhe dhe Liri Baske) e përhapur në Spanjë në rajonet autonome në veri të vendit.
- 6.) **FARC** (Forcat e Armatosura Revolucionare të Kolumbisë), me veprimtari në Kolumbi, Brazil, Venezuelë dhe Panama.
- 7.) **Boko-Haram**, i përhapur në Nigeri, Kamerun, Niger dhe Çad.
- 8.) **Al-Nusra Front**, e përhapur në Siri dhe Liban. Sulmet terroriste më 7 janar 2015 në Paris në “**Charlie Hebdo**” nga Al-Kaeda e solli edhe njëherë vëmendjen e jashtëzakonshme për bashkëpunim ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit.

Aktet terroriste dhe sulmet që i përkasin kohëve të fundit nga organizatat terroriste ndërkombëtare të ISIS dhe Al-Kaeda në Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme, shtuan rrezikun e “Terrorizmit Ekstremist Islamik”. Përhapja e ISIS (Shtetit Islamik të Irakut dhe Levant) në Siri, Irak, Liban, Libi dhe Nigeri shihen si rrezik potencial për Evropën dhe Amerikën.²⁷⁷

Në luftën kundër terrorizmit, aspekti më i rëndësishëm i Inteligjencës dhe kundërzbulimit, është futja në operacionet klasike, ato teknike dhe kibernetike, konsiderohet pjesa më me rëndësi që na intereson të dimë në hollësi për grupet terroriste, dhe në bazë të kësaj fushëveprimtare operacionale gjithëpërfshirëse, ne mund të përcaktojmë mënyrën dhe vendosjen e terroristëve. Në

²⁷⁶Më shumë informacion shih, [Online] Marrë nga: <http://www.state.gov/j/ct/index.htm> [Qasja; 17 Gusht, 2016].

²⁷⁷Eraldo Meçalla, Një vështrim rreth terrorizmit ndërkombëtarë, Artikull, [Online] Marrë nga: <http://www.tiranaobserver.al/nje-veshtrim-rreth-terrorizmit-nderkombetar>, [Qasja: 01 Prill 2016]

këtë luftë agjesitë e zbulimit dhe kundërzbulimit, kanë marrë rol dhe kanë detyrë parësore për ta fituar këtë luftë të shekullit.

6.3 Shqetësimet për të ardhmen

Nga pikëpamja e një sulmi masiv me armë bërthamore ka shumë pak gjasa të ndodhë, i ashtu-quajtur i “bombës së pistë” nuk është jashtë diskutimit në kuluaret e inteligjencës dhe në çdo dokument strategjik duhet ta parashih si mundësi dhe sfidë të së ardhmes. Në kuptimin e mundësisë për shqetësim ekzistojnë shumë faktor që tregojnë se rreziku është i përhershëm dhe masat kundër një apokalipsi duhet të jenë gjithnjë një krye të detyrës parandaluese. Shteti Islamik dëshiron që ne të besojmë se terroristët së shpejti do të jenë të pajisur me armë bërthamore²⁷⁸.

Të përballur me këtë kërcënim, ekspertët këshillojnë sensin e përbashkët. Për shembull ata shpërfillin mundësinë që terroristët të arrijnë të grabisin ndonjë raketë bërthamore ekzistuese, duke pasur parasysh se sa komplekse është qasja dhe përdorimi i këtyre armëve.

Ata nuk besojnë as edhe që grupet terroriste mund të prodhojnë ndonjë armë në shkallë ushtarake – të paktën jo pa ndihmën e një shteti. “Nëse ju jeni tipi i gotës gjysmë-plot, mund të ngushëlloheni disi duke ditur se skenari më i rëndë, është edhe më pak i mundshmi”- shkruan **Elisabet Ivs**, kolumniste në Buletinën e Shkencëtarëve Atomikë. Po sa i përket një sulmi të mundshëm në ndonjë stacion nuklear? “Ky rrezik është real”- kanë shkruar specialistët amerikanë **Graham Ellison** dhe **Uilliam Tobej** në një artikull të publikuar muajin e shkurt nga “The New York Times”.²⁷⁹

Në fakt një sulm i tillë “nuk do të shkaktojë një re gjigante në formë kërpudhe, apo vrasë qindra mijëra njerëz”- shpjeguan ata. “Por do të shkaktojë rrjedhjen në atmosferë të sasive të mëdha të rrezatimit, duke ndezur një panik masiv dhe bërë të pabanueshme sipërfaqe të mëdha të tokës”.

²⁷⁸Më specifikisht, Autoritetet e Sigurisë Bërthamore në Uashington, ku së fundmi janë mbajtur 4 samite mbi sigurinë bërthamore, kanë shprehur shqetësim mbi situatën në Siri dhe Irak. Dhe shërbimet e inteligjencës perëndimore, e dinë se xhihadistët janë duke u përpjekur të shtojnë në duar materiale radioaktive. Megjithatë nuk ekziston ndonjë precedent serioz i terrorizmit bërthamor.

²⁷⁹Natali Giber, Terrorizmi bërthamor dhe ISIS-i: Sa të frikësuar duhet të jemi?[Online] Marrë nga: <http://www.bota.al/2016/05/terrorizmi-berthamor-dhe-isis-i-sa-te-frikesuar-duhet-te-jemi/>, [Qasja: 19 Maj 2016]

Si duket një kërcënim edhe më i besueshëm, paralajmërojnë ekspertët, është e ashtuquajtura **“bombë e pistë”**, e përbërë nga komponentët radioaktivë që përdoren në beteja kontekste civile. Pajisja mund të kombinojë eksplozivë dhe materiale të mbledhura nga reaktorët kërkimorë, laboratorët mjekësore apo fabrikat industriale.

Sipas një studiuesi, “Ky është një nga shqetësimet më të mëdha, edhe nëse në analizë të fundit mundësia e përdorimit të tyre është shumë e ulët”- thotë **Benxhamin Hotkyvertyr**, studiues në Fondacionin për Kërkime Strategjike, një thik-tank me qendër në Paris. Në rast se ndodh një sulm i tillë “ai kryesisht do të çojë në një reagim paniku, në një zonë të kufizuar, por jo në shkatërrime në masë”- shton ai. “Dëmi në njerëz do të jetë më pak i rëndësishëm se sa ajo që mund të shkaktojë kallashnikovët apo një bombë konvencionale”. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (IAEA)²⁸⁰ shqyrton me imtësi çdo incident, kriminal apo i ndonjë lloji tjetër, në lidhje me trajtimin apo transportin e materialit radioaktiv.

Duket se ekspertët bërthamor, po ashtu besojnë se ky lloj i trafikimit, nuk është i nxitur aq shumë nga kërkesa e organizuar, sesa nga interesat e ofertuesit. Në fakt, thonë ekspertët, dhjetëra kilogramë do të jenë të nevojshëm – shumë më tepër sesa madhësia e një “molle” që Presidenti Barak Obama përmendi së fundmi në samitin e Uashingtonit. “Sasia më e vogël e plutoniumit – thuajse sa pesha e një kokrrë mollë, mund të vrasë dhe plagosë qindra e mijëra individë të pafajshëm”.

Në samitin e mbajtur në Prill 2016²⁸¹ në Uashington, Obama tha se përpjekjet globale për të përmirësuar sigurinë bërthamore, kanë hequr nga qarkullimi një sasi materiali që është e barabartë me 150 armë bërthamore, duke e ruajtur atë nga ekstremistët. “Ky është material që nuk do të bjerë kurrë në duart e terroristëve”- përfundoi presidenti Obama²⁸².

Përfundimisht, shqetësimet e terrorizmit, po ashtu mbetet, pasiguria, frika dhe miliona refugjat që kanë braktisur vendet e tyre. Evropa, posaçërisht do të përjetoj valën më të madhe të refugjatëve. Poashtu, uria dhe sëmundjet dhe vuajtjet e tmerrshme, paraqesin shqetësim në të tashmen dhe në të ardhmen.

²⁸⁰ Më konkretisht, (IAEA) Lista është alarmante në gjatësinë e saj: 2.734 raste të theksuara ndërmjet viteve 1993-2014. Gjithësesi nga këto, vetëm 442 janë konsideruar vepra penale që përfshijnë zotërimin apo lëvizjet e dyshimta në përgatitjen për trafikim të lëndëve bërthamore dhe radioaktive. Për shembull, rastet vërtet shqetësuese, që përfshinin uraniumin shumë të pasuruar (13 incidente) apo plutoniumin (3 incidenteve), ishin akoma më pak.

²⁸¹ Shih,[Online] Marrë nga:<http://edition.cnn.com/2016/03/29/politics/obama-nuclear-summit-world-leaders/>

²⁸² Më gjerësisht shih,[Online] Marrë nga:<http://www.nss2016.org/newsroom/statements-and-speeches/> [Qasja; 13, korrik 2016]

6.4 Terrorizmi dhe politika e sigurisë ndaj publikut

Siç ka thënë njohësja e politikave të mbrojtjes në Francë **Michelle Alliot - Marie**²⁸³ “*Siguria është detyrimi i parë i një Shteti*”, nuk ka dilemë se shteti është ai mekanizmi kryesor që duhet të kujdeset në të gjitha aspektet sa i përket krijimit dhe zbatimit të politikave publike të sigurisë.

Gjithnjë e më shumë po bëhet e domosdoshme nevoja për të krijuar politika të sigurisë dhe mbrojtjes që do të jenë të afta dhe në gjendje të përballojnë cilëndo situatë që paraqitet në aspektin e akteve dhe sulmeve terroriste ndaj infrastrukturës shtetërore dhe asaj publike kudo në Botë dhe tek ne në Kosovë. Krijimi dhe zbatimi i këtyre masave, nismave dhe politikave të sigurisë nënkupton seriozitetin e një vendi për tu përballë dhe për të qenë në gjendje të menaxhoj në raste të krizave.

Politikave të sigurisë ndaj publikut, duhet kushtuar vëmendje të vazhdueshme, përfshi, vetëdijesimin, me anë të sistemit arsimor, të trajnimeve, të fushatave të multidisciplinare, lidhur me aspekte të ndryshme që ndërlidhen me mundësinë e edukimit rreth parandalimit të terrorizmit dhe informimin e drejtë të publikut, përfshi edhe rolin e medieve, të shoqërisë civile, komuniteteve fetare, etj. Zakonisht politikat e tilla duhet të jenë në funksion të shtetit dhe publikut të gjerë, por gjithnjë duhet pasur përsyshë këtë koncepte, që politika ti ketë përmbushur për publikun dhe sigurinë e shtetit.

Ekzistojnë pesë arsye pse shtetet duhet të kenë një politikë gjithëpërfshirëse të sigurisë kombëtare:

- që të sigurojë që qeveria do t’i trajtojë të gjithë rreziqet në mënyrë gjithëpërfshirëse,
- që të rrisë efikasitetin e sektorit të sigurisë duke optimizuar kontributet e të gjithë aktorëve të sigurisë,
- që të drejtoj zbatimin e politikës,
- që të ndërtoj konsensusin e brendshëm të vendit,
- që të rrisë besimin dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.²⁸⁴

²⁸³Michèle Alliot-Marie, Politikbërëse dhe njohëse e politikave të mbrojtjes dhe të sigurisë në Francë.

²⁸⁴ Më gjerësisht, [Online] Marrë nga: <http://shtetiweb.org/politika-e-sigurise-kombetare/> [Qasja: 15, korrik 2016].

6.5 Bashkëpunimi në luftën kundër terrorizmit

Organizatave dhe institucionet ndërkombëtare përbëjnë elementin thelbësor të bashkëpunimit në marrëdhëniet ndërkombëtare për të luftuar kërcënimin e shfaqur nga terrorizmi ndërkombëtar. Roli i traktateve në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacia ndërmjet shteteve në momente krizash, luftërash është jetik sepse bashkëpunimi ndërkombëtar i ndërsjellët në aspektin politik, ekonomik, shoqëror, kulturor, humanitar ruajnë dhe përforcojnë sigurinë, paqen, humanizmin dhe prosperitetin e rendit ndërkombëtar.²⁸⁵

Për përballimin, izolimin, kontrollin dhe eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar duhet:

1.) Bashkëpunim ndërmjet shteteve, organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare në miratimin dhe respektimin e konventave, marrëveshjeve, ligjeve ndërkombëtare anti-terrorizëm.

2.) Luftimi i drejtpërdrejtë ushtarak nga ajri, toka, deti i organizatave terroriste në vendet e origjinës.

3.) Mbështetje politike, ekonomike, financiare për shtetet e vogla, të dobëta dhe të rrezikuara nga propaganda e veprimet terroriste që të drejtohen drejt rrugës perëndimore.

4.) Vigjilencë maksimale në të gjithë territoret e shteteve aleatë në luftën kundër terrorizmit duke shfrytëzuar agjencitë e inteligjencës dhe kundërinteligjencës të shteteve të fuqishme për të marrë informacione mbi sulmet e mundshme terroriste.

5.) Kujdes dhe kontroll maksimal në teknologji, informacion dhe luftën përkundrejt “terrorizmit kibernetik”.

6.) Bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet Organizatave të Sigurisë si Interpoli, Europol dhe institucioneve të tjera të sigurisë dhe mbrojtjes.

7.) Zbatimi dhe respektimi i Konventave dhe Protokolleve kundër-terrorizmit të OKB-së që janë në fuqi, negociimi dhe implementimi i Konventave të reja anti-terrorizëm dhe sigurisht miratimi dhe respektimi i Rezolutave të Këshillit të Sigurimit për përmirësim të sigurisë ndërkombëtare.

²⁸⁵**Burim i hapur**, Artikull nga Eraldo Meçalla_Një vështrim rreth terrorizmit ndërkombëtarë, [Online] Marrë nga: <http://www.tiranaobserver.al/nje-veshtrim-rreth-terrorizmit-nderkombetar>

Si përfundim, strategjia e luftës kundër-terrorizmit duhet të bazohet tek mjetet diplomatike si arbitrazhi, negociatat, sanksionet diplomatike, embargot ekonomike të cilat do të ndihmonin më shumë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, ndoshta më shumë se çdo veprimtari ushtarake. Në marrëdhëniet ndërkombëtare lufta kundër së “keqes” së përgjithshme fitohet me partneritet, bashkëpunim ndërkombëtar ndërmjet organizatave ndërkombëtare si OKB, BE, NATO, OSBE dhe ndërmjet shteteve të fuqishme të botës si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rusia, Britania e Madhe, Gjermania, Italia, Franca etj. Qytetërimet botërore ndryshojnë nga njëri-tjetri në bazë të historisë, kulturës, fesë, traditës, politikës, ekonomisë, sigurisht këto ndryshime sjellin edhe konfliktet dhe fenomenin e terrorizmit ndërkombëtar. Lufta përkundrejt terrorizmit ndërkombëtar nuk do të fitohet në kohë afatshkurtër, por mund të parandalohet dhe mbahet nën kontroll në aspektin afatgjatë.²⁸⁶

6.6. Kostot e terrorizmit

I emërtuar si “dënimi i terrorizmit mbi botën” bota sot pagunë miliarda dollarë pasoja, pa përfshi humbjen e qindra mijëra jetë njerëzore. Ndikimi ekonomik është i jashtëzakonshëm, sikurse edhe ai psikologjik, i tej jashtëzakonshëm.

Bota po llogarit koston e terrorizmit tani, më shumë se kurrë më parë, sidomos për sa i përket ndikimit të tij ekonomik dhe jetët e humbura. Një studimi i ri, shkruan Bloomberg²⁸⁷, zbulon si Evropa vazhdon të lëkundet, nga sulmi më i keq i ndodhur në një kohë paqeje, pikërisht në zemër të Evropës, Paris.²⁸⁸

Ndikimi ekonomik i terrorizmit në të gjithë globin ka arritur të kapë shifrën e 52.9 mld dollarëve në vitin 2014, shifër 60 për qind më e lartë se në vitin e kaluar dhe dhjetë -fish e rritur që nga fillimi i shekullit, sipas shifrave të raportit më të fundit të Indeksit Global të Terrorizmit.

²⁸⁶Burim i hapur, Artikull nga Eraldo Meçalla, Një vështrim rreth terrorizmit ndërkombëtarë, [Online] Marrë nga: <http://www.tiranaobserver.al/nje-veshtrim-rreth-terrorizmit-nderkombetar>

²⁸⁷ Shih më tepër, rrjeti informativ, [Online] Marrë nga: <http://www.bloomberg.com/europe>

²⁸⁸Portali Monitor, [Online] Marrë nga: <http://www.monitor.al/denimi-ekonomik-nga-terrorizmi-arrin-52-9-mld-dollar-ne-te-gjithe-boten/>, Artikull.

Shifra janë akoma më të larta, që prej të paktën 2001, kur ajo ishte llogaritur në 51.5 mld dollarë pas sulmit të 11 shtatorit në Qendrën Botërore të Tregtisë në Nju Jork.

Numri i vdekjeve të shkaktuara nga sulmet terroriste arriti 32,658 në 2014, një rritje rekord prej 80 për qind krahasuar me vitin 2013 dhe një rritje nëntë -fish që nga viti 2000. Shifrat, hartuar nga Instituti për Ekonominë dhe Paqen, marrin parasysh kostot e drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga humbja e jetës, shkatërrimit të pronës dhe shpërblim i pagesave, përveç shpenzimeve të tilla si rritjen e sigurisë.

Vendet më të prekura nga terrorizmi, sipas raportit janë: Iraku, Afganistani dhe Nigeria, Pakistani dhe Siria, ku më shumë se tre të katërtat e vdekjeve dhe më shumë se gjysma e të gjitha sulmeve bartin barrën më të madhe të kostove me terrorizmin dhe që ndikojnë zhvillimin ekonomik dhe investimet e huaja. Megjithatë, shifrat tregojnë se Mbretëria e Bashkuar përjetoi një numër më të madh të incidenteve terroriste se çdo shtet tjetër anëtar i BE-së në vitin 2014, duke u renditur e 28 në botë e 162 vendeve të listuara, e ndjekur nga Greqia dhe Franca. Kostoja e programeve kundër – terrorizmit në Britani të Madhe është llogaritur në 40 dollarë për frymë \$ 40, ndërsa humbjet nga terrorizmi u vunë në 15 cent /person. Kostoja e terrorizmit është ende 32 herë më e vogël se sa për krimin e dhunës dhe vrasjes, por ” shpenzimet e rëndësishme në luftën kundër terrorizmit nënvizojnë ndikimin që frika nga terrorizmi ka për popullatën e përgjithshme, ” tha raporti.²⁸⁹

Edhe masat e marra për parandalimin e terrorizmit janë të mëdha. Të gjitha shtetet e prekura, më pak të prekura, apo atë që gjinden në listë të organizatave terroriste, kanë ndërmarrë një varg hapash financiar për të fuqizuar organet e tyre të sigurisë në parandalimin e sulmeve të tilla. Për shembull, po rikujtojmë vetëm një rast për të parë se çfarë kosto buxhetore ndërmarrin vendet e zhvilluara për parandalim. Franca pas 3 sulmeve terroriste, ndërmori masa urgjente financiare, në vlerë 940 milion²⁹⁰, për të rritë të gjitha kapacitetet e sigurisë dhe inteligjencës, deri te përdorimi i ushtrisë.

²⁸⁹ Marrë [Online] Marrë nga: <http://www.monitor.al/denimi-ekonomik-nga-terrorizmi-arrin-52-9-mld-dollare-ne-te-gjithe-boten/>

²⁹⁰ Më konkretisht, [Online] Marrë nga: <http://europeanpost.co/one-billion-euro-to-counter-terrorism-in-france/> [Qasja: 25, Korrik 2016].

6.7 Pamjet e terrorizmit

Zakonisht kur paraqytyrojmë idenë rreth pamjeve të terrorizmit, nuk ka dilemë se përpara nesh na paraqiten pamjet gjakut, të trupit të njeriut të shkapërderdhur, objekte të shkatërruara, turma njerëzish, situata dramatike, duke ikur në panik për të shpëtuar, makthin e çka jo tjetër. Ato janë të neveritshme dhe tronditëse. Nevoja për ti ç'rrënjos këto pamje është e domosdoshme, që bota të ketë sa më pak të tilla pamje dhe njerëzit të kenë mundësi të jetojnë të pa kërcënuar për sigurinë e tyre për jetë.



FIGURA NR 12 PARAQETË PAMJEN E TERRORIZMIT

Terrorizmi sot ka mbërthyer të gjitha mediet botërore, ekranet e TV-ve, portalet dhe gjithandej botën elektronike, prej tyre disa më të veçuarat, CNN, BCC, Reuters, VOA, DW, The Time, etj, të cilat vazhdimisht paraqesin pamjet e terrorizmit që po ndodhë gjithandej në botë.

Ekzistojnë disa aplikacione që monitorojnë vazhdimisht terrorizmin në nivel global:

Google maps terrorist attacks, paraqet hartën botërore të sulmeve terroriste.²⁹¹

Baza e të dhënave të terrorizmit në nivel global²⁹²

Ekrani global i terrorizmit dhe ngjarjeve të tjera të dyshimta²⁹³

Fotografite e terrorizmit global²⁹⁴

²⁹¹Më gjerësisht, [Online] Marrë

nga: https://www.google.com/maps/d/viewer?mid=1XPgyplQ8yX6nKa_2AsepoAW6AVQ&hl=en

²⁹²Më gjerësisht, [Online] Marrë nga: <https://www.start.umd.edu/gtd/>

²⁹³ Monitorim 24 orë, më gjerësisht shih ekranin, [Online] Marrë nga: <http://www.globalincidentmap.com/>

²⁹⁴ Shumë më gjerësisht, pafund, shih, [Online] Marrë nga: <http://www.shutterstock.com/s/terrorist/search.html>
[Qasja:05, gusht 2016]

6.8 Vlerësimi dhe paralajmërimi i kërcënimit

Vlerësimi dhe paralajmërimi i kërcënimit nga terrorizmi dhe aktet pasuese terroriste ,është detyrë primare e agjencive të inteligjencës dhe sigurisë kombëtare. Ato para sëgjithash, kryejnë aktivitete që bëjnë vlerësimin e vazhdueshëm duke përcjellë dhe monitoruar të gjitha situatat që ndërlidhen me fenomenin e terrorizmit.

Pra, shteti ka detyrimin dhe mbart përgjegjësinë kryesore për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, si edhe për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Megjithatë, shteti ka nevojë të sigurojë mbështetjen e shoqërisë në përgjithësi, duke përfshirë shoqërinë civile dhe bizneset, për ta luftuar këtë fenomen me sukses.²⁹⁵

Institucionet e Sigurisë dhe Inteligjencës duhet të jenë në nivel të ndërmarrin veprime në rastin tonë, që: **Gatishmëria për reagim dhe menaxhim të situatave me qëllim të minimizimit të pasojave në rast të ndonjë sulmi të mundshëm terrorist.**

Të jenë në gjendje për,

- *Hartimin i planeve për mbrojtje dhe skenarëve për reagim të infrastrukturës kritike dhe objekteve të rëndësisë së veçantë.*
- *Ngritja e gatishmërisë për rreziqet me efekt më të lartë goditës në Vlerësimin Kombëtar të Rreziqeve.*
- *Vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve gjeneruese për të reaguar dhe rimëkëmbur nga gama e gjerë e emergjencave terroriste dhe emergjencave tjera civile.*
- *Menaxhimi dhe eliminimi i pasojave të shkaktuara nga sulmet e mundshme terroriste.*
- *Ngritja e partneritetit me komunitetin, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional, rajonal, ndërkombëtar si dhe organizatave ndërkombëtare.*
- *Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të Institucioneve të Republikës së Kosovës për menaxhim dhe reagim.*²⁹⁶

²⁹⁵ Shih më tepër, udhërrëfyesi, Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: Qasja e policimit në komunitet, Departamenti i kërcënimeve ndërkombëse Sekretariati i OSBE-së Wallnerstrasse 6, A-1010 Vjenë, Austri. [Online] Marrë nga: <http://www.osce.org/atu> Botim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Vjenë, mars 2014, fq 20

²⁹⁶ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit, Prishtinë, Qerrosht, 2012.

6.9 Organizatat terroriste

Kur analizohen me vëmendje tipologjia e organizatave ekstremiste dhe terroriste dhe ndërlidhja e tyre me fenë, bota seriozisht ka shqetësim real rreth ekstremizmit fetar që shpie deri terrorizmi, e i cili po shndërrohet në një të keqe të madhe për botën siç e ka kapluar botën terrori nga ISIS si dhe nga organizata të tjera ne prirje ideologji fetare ekzistojnë shumë të tilla në Botë dhe janë marrë masa dhe janë sanksionuar nga SHBA²⁹⁷

²⁹⁷ Listimi i organizatave terroriste, më gjerësisht; Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vendosur të bëjnë ilegale çdo përkrahje morale apo ndihmë financiare për 30 grupet ekstremiste. Këto grupe - sipas saj - janë organizata terroriste, prandaj duhet të mbesin jashtë çdo përkrahje a ndihmese. Grupet e akuzuara për grupe terroriste janë:

- (1) Organizata Abu Nidal "ANO" - palestineze;
- (2) Grupi Abu Sayyaf "ASG" - filipine;
- (3) Grupi i armatosur Islamik "GIA" - algjeriane;
- (4) Aum Shinrikyo "AUM" japoneze;
- (5) Euzkadi Ta Askatasuna "ETA" basque;
- (6) Fronti Demokratik për çlirim e Palestinës "DFLP" - palestineze;
- (7) Lëvizja e rezistencës Islamike "HAMAS" - palestineze;
- (8) Harakat Ul-Ansar "HUA" - pakistaneze;
- (9) Partia e Zotit "HAZBULLAH" - libaneze;
- (10) Gama'a al-Islamiyya (grupi islamik "IG") - egjiptjane;
- (11) Armata e Kuqe Japoneze "JRA" - japoneze;
- (12) Al-Jihad - egjiptjane; (13) Kach - izraelite;
- (14) Khmer Rouge - kamboxhiane;
- (15) Khane Chai - izraelite;
- (16) Partia e Punës Kurde "PKK"; - kurdistan;
- (17) Tigrët çlirimtar të Tamil Ealamit "LTTE" - Sri Lanka;
- (18) Fronti i papajtuësëm patriotik i Manuel Rodriguezit "FPMR/D" -Çile;
- (19) Muhaxhidinët e Organizatës Khalaq "MEK dhe MKO" - iraniane;
- (20) Armata Nacional Çlirimtare "ELN" - kolumbiane;
- (21) Xhihadi Islamik Palestinez "PIJ" - palestineze;
- (22) Fronti Çlirimtar Palestinez "PLF" - palestineze;
- (23) Fronti Popullorë për çlirim e Palestinës "PFLP" - palestineze;
- (24) Fronti popullr për çlirim e Palestinës "PFLP/GC" - palestineze;
- (25) Forcat e Armatosura revolucionare të Kolumbisë "FARC" - kolumbiane;
- (26) Organizata Revolucionare "17 Nëntori" - greke;
- (27) Partia popullore revolucionare për çlirim "DHKP/C" - turke;
- (28) Përpjekja revolucionare popullore "ELA" - greke;
- (29) Rruga e shkëlqyeshme "SL" - peruviane;
- (30) Lëvizja Revolucionare Tupac Amru "MRTA" - peruviane.

Në këtë pikëpamje shumë autorë kanë vështrimet e tyre rreth shfaqjes së terrorizmit me bindje fetare:

Një tjetër mendim na shfaqet nga autori i librit "Some to Mecca turn to Pray" **Mervin Hiskett**²⁹⁸ është shumë mirë i "njohur" me Islamin dhe me jetën Islame, shkruan: "... Unë personalisht asnjëherë nuk mund të bindem se Islami ka ndonjë alternativë të dëshirueshme për kulturën Evro-prendimore apo për stilin e jetës..."

Së këndejmi, autori më ndikim për mendimin e tij **Samuel P. Huntington**²⁹⁹, i cili në vitin 1996, botoi librin: "The Clash of Civilization and the Remaking of World Order" në të cilin shkruan: *"Jo vetëm fundamentalizmi Islam, por vetë Islami është problem që shkakton konflikte luftarake ndërmjet civilizimeve në konceptin e Zotit... Civilizimi Islam është i ndryshëm prej atij Perëndimorë me të cilën është mësuar ky popull, prandaj konflikti i këtyre civilizimeve do të vazhdojë edhe në të ardhmen sikur katërmëdhjetë shekuj më parë...Madje edhe tani është e qartë se ndodhemi para një lufte të ashpër ndërmjet tyre... Është ndoshta e çuditshme të thuhet se Revolucioni Iranian i vitit 1979 ka qenë luftë e haptë e zhvilluar në mes Perëndimit e Islamit... Gjatë viteve 1980-1995, akorduar sipas Ministrisë Amerikane të Mbrojtjes, SHBA-të kanë qenë të angazhuara me shtatë operacione Ushtarake në Lindjen e Mesme, të gjitha këto kundër myslimanëve. Asnjë operacion ushtarak kundër ndonjë feje a kombi tjetër... Sipas sekretarit të NATO-s, Willy Claes, në fillimin e vitit 1995 në një Konferencë në Gjermani, publikisht deklaroi se "Fundamentalizmi islamik është më i rrezikshëm se Komunizmi".*³⁰⁰

²⁹⁸ Shih më gjerësisht autorin, **Mervin Hiskett**, [Online] Marrë nga: <http://www.org.uib.no/smi/sa/05/5Hiskett.pdf>, [[Për here të fundit, dhjetor 2017]

²⁹⁹ Autori, **Samuel Huntington** (April 18, 1927 – December 24, 2008) was an American political scientist, adviser and academic. He spent more than half a century at Harvard University, where he was director of Harvard's Center for International Affairs and the Albert J. Weatherhead III University Professor. During the Carter administration, Huntington was the White House Coordinator of Security Planning for the National Security Council. He is most well known by his 1993 theory, "The Clash of Civilizations", of a post-Cold War new world order. He argued that future wars would be fought not between countries, but between cultures, and that Islamic extremism would become the biggest threat to Western world domination. Huntington is credited with helping to shape U.S. views on civilian-military relations, political development, and comparative government

³⁰⁰ Shih të plotë deklaratën: [Online] Marrë nga: http://articles.chicagotribune.com/1995-02-12/news/9502120298_1_fundamentalism-islamic-world-islamic-salvation-front

Edhe autori, **Christopher Coker**³⁰¹ publikoi librin për fëmijë me titull "Terrorism" në të cilin zë vend një kaptinë me titull "Terrorizmi Islamik". Në këtë kaptinë, edhe aktet terroriste të organizuara nga jomyslimanët, provon t'i ndërlidhë në ndonjë farë mënyre me mysliimanët.

Ndërsa autori, **Hal Lindsey**³⁰² në librin "The Final Battle" përmes interpretimeve biblike, mundohet të "shpjegojë" ardhjen e një lufte të madhe nukleare në mes të mysliimanëve dhe perëndimit. Sipas tij, mysliimanët do të pësojnë disfatë, ndërsa Islami do të pushojë së ekzistuari si religjion. *"Ne - thotë ai - nuk duhet të frikësohemi prej askujt më shumë se prej Islamit, sepse Islami është më i rrezikshëm se Nazizmi e Komunizmi. Për këtë arsye mendoj unë se Amerika duhet të përkrahë më shumë Izraelin..."*

Gjithashtu, **John Gilchrist**³⁰³, një udhëheqës shpirtërorë në Afrikën e Jugut, i cili për t'ju kundërvënë shkrimeve dhe debateve të Ahmed Deedat, ishte shumë i zëshëm gjatë gjithë kësaj periudhe. Sipas librit: "The Islamic Invasion" të autorit **Robert A. Morey**³⁰⁴, duke cituar Deedat, i cili jep sqarime lidhur me emrin "Allah" edhe sipas kuptimit në gjuhët hebreje dhe biblike, etj...
...Po ashtu nga Deedat shkëpusim mendimet se: *"Trupëzimi pa proces, përdorimi i torturave, vrasjet publike, prerja e duarve, këmbëve, veshëve, gjuhëve, kokave si dhe nxjerrja e syve - të gjitha këto janë pjesë e ligjit Islam sot, sepse janë pjesë e kulturës arabe të shekullit të shtatë. Prapaskena historike (e z. Gilchrist) në lidhje me origjinën e emrit Allah, revelon se ky Allah, nuk mund të jetë Zot i patriarkut biblik, as të hebrenjve apo të kristianëve"*.³⁰⁵

Terrorizmi mbi baza jo fetare lidhet me ideologjinë marksiste, revolucionet në Itali, kryengritjet përkundërt Carit në Rusi dhe me radikalët e anarkistët. Në fundin e shekullit të 19 dhe fillimin e shekullit të 20, kishte akte dhe sulme të shumta terroriste në SHBA, Indi, Japoni, Perandorinë Otomane. Viti 1914 solli aktivizimin e grupeve "terroriste serbe", që çuan në vrasjen e Arkidukës Franz Ferdinand më 28 qershor 1914 në Sarajevë e kryer nga "Boshnjakët e Rinj", vrasje që shkaktoi fillimin e Luftës së I-rë Botërore. Ndërsa si Gjermania naziste, Italia fashiste dhe Bashkimi Sovjetik Stalinist, përdorën vrasjet masive, spastrimet etnike, gjenocidet si forma të

³⁰¹Shih, Profesori, **Christopher Coker** [Online] Marrë

nga: <http://www.lse.ac.uk/IDEAS/people/bios/cokerChristopher.aspx>

³⁰²Shih më gjerësisht, Misionari biblik, **Hal Lindsey**, [Online] Marrë nga: <http://www.hallindsey.com/>

³⁰³Më konkretisht lidhur me debatin e zhvilluar të **John Gilchrist**, [Online] Marrë

nga: <http://www.ccel.us/islamdebate.toc.html>

³⁰⁴Robert A. Morey, PhD, "The Islamic Invasion, Christian Scholars Press, 2011, faqe 255

³⁰⁵Forum, [Online] Marrë nga: <http://www.islambosna.ba/forum/shqipe/artikuj-dhe-tekste/185/?wap2>

terrorizmit shtetëror. Këto fenomene terroriste shtetërore vazhduan edhe përgjatë Luftës së Ftohtë me diktatura ushtarake në Amerikën Latine, Afrikë të cilat përdornin metoda terroriste. Në Lindjen e Mesme, Azi dhe Afrikë lindën lëvizje nacionaliste kundër ish-vendeve koloniale si Britania e Madhe, Franca dhe gjithashtu luftë guerile në Indokinë, Algjeri, Kenia, Malajzi, Palestinë, Izrael, Qipro.³⁰⁶

6.10 Inteligjenca dhe Kiberterrorizmi

Inteligjenca kibernetike, sot në trendet e zhvillimit teknologjik dhe arritjeve të përditshme në super zhvillimin e hovshëm të teknologjisë kompjuterike po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për agjencitë e specializuara të inteligjencës në luftimin e kiberterrorizmit.

Kiberterrorizmi si fenomen sot në botën e globalizuar, është akti i terrorizmit në internet, përmes aktiviteteve terroriste, përfshirë aktet e qëllimshme, në shkallë të gjerë, ndërprerjen e rrjeteve kompjuterike, sidomos të kompjuterëve personal, bashkangjitur në internet, me anë të mjeteve të tilla si viruset kompjuterike.

Ka pasur disa pengesa për krijimin e një përkufizim të qartë dhe të qëndrueshëm të termit "Cyberterrorism." Së pari, siç u përmend vetëm, pjesa më e madhe e diskutimit të Cyberterrorism është kryer në media të njohura, ku gazetarët zakonisht përpiqen për dramë dhe ndjesi më tepër se për përkufizimet mira operative të kushteve të reja.³⁰⁷

Po ashtu "Cyberterrorism" është një term i diskutueshëm. Disa autorë kanë dhënë një përkufizim shumë të ngushtë, në lidhje me vendosjen e trupave, nga organizatat e njohura terroriste, si sulme të ndërhyrjes ndaj sistemeve të informacionit për qëllimin fillestar të krijimit alarm dhe panik. Me këtë përkufizim të ngushtë, është e vështirë për të identifikuar ndonjë rast të Cyberterrorism.³⁰⁸

Termi "Cyberterrorism" mund të përkufizohet edhe si përdorim i qëllimshëm i kompjuterit, rrjeteve, internetit, komunikimit publik, duke shkaktojë shkatërrim dhe dëm për

³⁰⁶Burim i hapur, Artikull nga Eraldo Meçalla, Një vështrim rreth terrorizmit ndërkombëtarë, [Online] Marrë nga: <http://www.tiranaobserver.al/nje-veshtrim-rreth-terrorizmit-nderkombetar>, [Parë për herë të fundit, Qershor, 2016]

³⁰⁷ What Is Cyberterrorism?, [Online] Marrë nga: <https://www.usip.org/sites/default/files/sr119.pdf>, faqe 4

³⁰⁸ Po aty

objektivat personale.³⁰⁹ Zakonisht ekzistojnë dy lloje të objektivave, e që mund të jenë politike apo ideologjike, pasi kjo mund të shihet si një formë e terrorizmit.³¹⁰

Në kuadër të luftës kundër terrorizmit dhe “krimit kibernetik”³¹¹, e rëndësishme është krijimi “politikave dinamike” dhe përdorimi i një plani strategjik kundër-komunikimi që përfshin masa në zbatim të ligjit, arritje ushtarake gjithëpërfshirëse dhe masa politike, diplomatike, sociale-ekonomike. Këto masa dhe ky plan kundër-komunikimi duhet të ndodh në të gjitha nivelet e qeverisë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar për të harmonizuar arritjet ndërkombëtare brenda një strategjie kryesore.³¹²

Në aspektin e përpjekjeve për të arrit gjithnjë e më shumë krijimin e strategjive kombëtare, lidhur me sigurinë ndaj kiberrrorizmit, organizata të ndryshme botërore kanë vënë në gatishmëri kapacitetet për të krijuar sa më parë hartën e strategjisë kibernetike.

Edhe Qendra për Studime Ndërkombëtare dhe Strategjike (CSIS) dhe Dokumenti i Rishikimit të Politikave të Presidentit për Hapësirën Kibernetike, pranojnë rëndësinë e krijimit të modeleve ndërkombëtare të hapësirës kibernetike.³¹³

Konceptet e krijimit të politikave të luftimit përmes inteligjencës dhe Kiberterrorizmit, thuajse se sot në botë më së mire të zhvilluara i kanë superfuqitë, siç janë SHBA –të.

Mbi këto koncepte janë kanë zhvilluar Sistemet e Teknologjisë Informatike, (TIK), që janë të lidhura me sigurinë kombëtare, ato kanë qenë të menaxhuara nga politika të ndryshme dhe institucione të sigurisë kombëtare të informacionit. Zyra e Menaxhimit dhe e Buxhetit (OMB) dhe Departamenti i Institutit Kombëtar të Tregtisë të Standardeve dhe Teknologjisë (NIST) krijuan politika dhe direktiva për sistemet e sigurisë civile jo kombëtare, ndërsa organizata të tjera, si Komiteti i Sistemeve të Sigurisë Kombëtare (CNSS), Departamenti i Mbrojtjes (DOD) dhe

³⁰⁹ Më gjerësisht, Matusitz, Jonathan (April 2005). "Cyberterrorism:" . American Foreign Policy Interests 2: 137–147.

³¹⁰ Për më shumë, India Quarterly: a Journal of International Affairs". 42-43. Indian Council of World Affairs. 1986: 122. The difficulty of defining terrorism has led to the cliché that one man's terrorist is another man's freedom fighter

³¹¹ Sqarim: Kosova e ka funksionalizuar ligjin dhe ka formuar institucionin me emrin: KOS-CERT, www.kos-cert.org Njësia Nacioanle për Siguri Kibernetike, bazuar në ligjin për komunikimet elektronik, Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plan i Veprimit 2016, dhe Rregullorja Standarde Teknike dhe Sigurisë e Rrjeteve dhe Shkëmbimeve të (KE) –së, ofron shërbime në funksion të Sigurisë Kibernetike.

³¹² Revistë Ushtarake, periodike, 2010, fq.19

³¹³ Më gjerësisht shih, [Online] Marrë nga: <https://www.csis.org/>

Shërbimi i Inteligjencës Amerikane (CIA) kanë zhvilluar politika me direktiva për sistemet e sigurisë kombëtare.³¹⁴

Me një fjali mund të themi se të gjitha angazhimet e ndërmarra nga organizatat e jashtme dhe ato brenda shtetërore, si agjencitë e inteligjencës, sektorët e tyre të IT –së, që trajtojnë këto situata, fokusin kryesor e kanë, që të arrijnë rezultate sa më të mira në krijimin e të gjitha kapaciteteve, përfshi, bazën ligjore, burimet e specializuara njerëzore, pajisjet e sofistikuara të komunikimit kompjuterik etj, në mënyrë që të arrijnë ta kontrollojnë dhe të luftojnë Krimin kibernetik dhe Kiberterrorizmin.

6.11 Bashkëveprimi i institucioneve ndërkombëtare në luftën kundër terrorizmit

Mendimi i të gjithë autorëve dhe ekspertëve ndërlidhet në një pike, duke pohuar se, që nga sulmet e 11 Shtatorit të vitit 2001, që kanë të bëjnë me kërcënimin e terrorizmit, është bërë një dallim dhe prioritet i lartë në politikë. Aktorët lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, pothuajse janë të sfiduar të gjithë për të identifikuar dhe për të minimizuar rrezikun që aktorët terroristë, paraqesin për popullsinë dhe institucioneve të tyre. Duke e parë këtë situatë, Këshilli i Evropës, i cili ka një histori në zhvillimin e masave për të trajtuar kërcënimet terroriste me të cilat përballen shtetet anëtare të saj.³¹⁵

Dy vjet më vonë, na paraqitet dokumenti i njohur si Protokolli që ndryshon Konventën Evropiane për Ndalimin e Terrorizmit, i vitit 1977, i cili u plotësua pas miratimit të udhëzimeve në vitin 2003. Këshilli i Evropës ra dakord për të ndryshuar dhe plotësuar.

³¹⁴ Më gjerësisht shih raportin, GAO-10916 – USGAO, Information Security, Progress Made on Harmonizing Policies and Guidance for National Security and Non-National Security Systems, September, 2010, fq. 1

³¹⁵ Më gjerësiht, [Online] Marrë nga: <http://www.qcea.org/wp-content/uploads/2011/04/bp-terror12-coerponses-en-2007.pdf>

Konventa e nënshkruar në vitin 1977 e Protokollit që amandaton Konventën Evropiane mbi të drejtën e "Shtypjes së Terrorizmit"³¹⁶ Ky protokoll, i hartuar në maj të vitit 2003, dëshironte për "të forcuar luftën kundër terrorizmit duke respektuar të drejtat e njeriut".³¹⁷

Tani më pas fillimit të "luftës kundër terrorizmit", pas sulmeve të 11 shtatorit 2001, kritikët kanë akuzuar qeverinë e Shteteve të Bashkuara (US), në veçanti Agjencia e Inteligjencës Qendrore (CIA), dhe individët, për pasqyrim të dyshuar për përfshirje në veprimtari terroriste për vendet e treta, ku ata mund të përballen me tortura. Me këtë rast Këshilli i Evropës dhe Parlamenti Evropian kanë prodhuar raporte ku tregohet transportimi dhe mënyrat e paligjshme hetimit gjatë paraburgimit.³¹⁸

Një tjetër organizatë ndërkombëtare e njohur si **Center Global për Siguri dhe Bashkëpunim**, punon me qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile për të zhvilluar dhe zbatuar përgjigjet gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për sfidat komplekse të sigurisë ndërkombëtare nëpërmjet kërkimit bashkëpunues politikave, context-sensitive programimit, si dhe zhvillimin e kapaciteteve. Në bashkëpunim me një rrjet global të praktikuesve të ekspertëve dhe organizatave partnere, Qendra Global nxit partneritete më të forta shumëpalëshe dhe mbledhet aktorët kryesorë për të mbështetur politikat e integruara dhe gjithëpërfshirëse të sigurisë në të gjithë nivelet kombëtare, rajonale dhe globale.³¹⁹

Edhe organizata tjetër me karakter global **UN Global**, e njohur për trajtminin e luftës kundër terrorizmit, si organizatë globale ka bërë rishikimin e pestë të Strategjisë Globale së

Kombeve të Bashkuara, kundër terrorizmit, e cila u zhvillu më 1 korrik të vitit 2016.³²⁰

Asambleja e Përgjithshme, shqyrtoi raportin e Sekretarit të Përgjithshëm (A / 70/826) për zbatimin e Strategjisë Kundër Terrorizmit, të UN Global mbi Dekadat e kaluara. Ai gjithashtu i dha shqyrtim të mëtejshëm planit të Sekretarit të Përgjithshëm për veprimet në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (A / 70/674-A / 70/675), e cila u prezantua nga Sekretari i Përgjithshëm në Asamblenë e

³¹⁶ Communication from the Council of Europe: Council of Europe, Protocol amending the European Convention on the Suppression of Terrorism, ETS No. 190 (Strasbourg, May 2003), p.1. Available at, [Online] Marrë nga: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/190.htm>

³¹⁷ Protokollit, po aty, [Online] Marrë nga: <http://www.qcea.org/wp-content/uploads/2011/04/bp-terror12-coeresponses-en-2007.pdf>

³¹⁸ Po aty

³¹⁹ Për më tepër shih, [Online] Marrë nga: <http://www.globalcenter.org/>

³²⁰ Gjithshtu, [Online] Marrë nga: <https://www.un.org/counterterrorism/ctitf/un-global-counter-terrorism-strategy>

Përgjithshme në janar të vitit 2016. Asambleja e Përgjithshme miratoi rezolutën (A / 70 / L.50) me konsensus të plotë.³²¹

**FIGURA NR.13 FUSHVEPRIMTARIA E ORGANIZATËS “UN- GLOBAL”
PËR TRAJTIMIN E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT**

UN GLOBAL COUNTER-TERRORISM STRATEGY



Kjo strategji parasheh zhvillimin në katër shtylla;

1. Adresimi i kushteve të favorshme për përhapjen e terrorizmit;
2. Masat për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin;
3. Masat për të ndërtuar kapacitetet e shteteve për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin dhe për të forcuar rolin e sistemit të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim;
4. Masa për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut për të gjithë dhe sundimit të ligjit si bazë themelore për luftën kundër terrorizmit.

Edhe NATO si një organizatë politiko ushtarake me ndikim të madh ushtarak ndërkombëtarë, ka të specializuar sektor që merren me analizën e këtyre problematikave që ndërlidhen me inteligjencën dhe luftën kundër terrorizmit në kundër të bashkëpunimit ndërkombëtarë.

³²¹Poashtu, [Online] Marrë nga: <http://www.un.org/en/counterterrorism/index.shtml>

Terrorizmi përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë e qytetarëve të vendeve të NATO-s, dhe për stabilitetin dhe prosperitetin ndërkombëtarë. Kjo është një kërcënim i vazhdueshëm global që nuk njihet kufi, kombe apo besim, dhe është një sfidë që bashkësia ndërkombëtare duhet të merret duke bashkëpunuar së bashku. Puna e NATO-s në luftën kundër terrorizmit përqendrohet në përmirësimin e vetëdijes së kërcënimit, zhvillimin e aftësive për të përgatitur dhe për t'iu përgjigjur, dhe rritjen e angazhimit me vendet partnere dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë.³²²

Pikat kryesore me të cilat NATO merret për të luftuar terrorizmin janë:

1. NATO thirret në klauzolën e vet të Mbrojtjes Kolektive (neni 5) për reaguesi si jo e vetme në përgjigje të sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara.
2. NATO Kundër-terrorizmit, paraqet Udhëzimet; Politika e NATO-s përqendrohen në përpjekjet e Aleancës në tri fusha kryesore: ndërgjegjësimi, aftësitë dhe angazhimi.
3. NATO zhvillon aftësitë e reja dhe teknologjive të trajtuar kërcënimin terrorist dhe për të menaxhuar pasojat e një sulmi terrorist.
4. NATO bashkëpunon me partnerët dhe organizatat ndërkombëtare për të vlerësuar potencialin e plotë të secilit aktor të angazhuar në përpjekjet globale kundër terrorizmit.³²³

Karakter tjetër të bashkëveprimit dhe komunikimit ndërkombëtarë dhe gjithëpërfshirës, çiftë nga organizatat shtetërore, të inteligjencës, asaj civile dhe ushtarake, çiftë edhe të atyre organizatave internacionale, janë edhe; OSCE³²⁴, INTERPOL³²⁵ dhe EUROPOL³²⁶,

³²² Shif më konkretisht,[Online] Marrë nga:http://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_77646.htm

³²³ Po aty

³²⁴ OSCE,[Online] Marrë nga:<http://www.osce.org/>[Qasja e fundit, Nëntor 2017]

³²⁵ www.interpol.int/About-INTERPOL/Overview

³²⁶ <https://www.europol.europa.eu/>

FIG. NR 14, HARTË SHPJEGUESE: SULMET TERRORISTE DHE ARRESTIMET SIPAS SHTETVE NË BE-se
(RAPORTI I UE –SË (TE-SAT) TERRORIZMI SIPAS TRENDIT TË SULMEVE DHE ARRESTIMEVE - 2015,³²⁷



Figure 2: Terrorist attacks and arrests in the EU in 2015

³²⁷Më gjerësisht shih të plotë raportin për vitin 2016, 2017 file:///C:/Users/Bahri.Gashi/Downloads/europol_tesat_2016.pdf dhe faqja zyrtare, https://www.europol.europa.eu/latest_publications/37

Bashkëveprimi i CIA-së me agjencitë tjera të Bashkësisë Informative (BI) në SHBA

Që kur është themeluar Bashkësia Informative (BI) në vitin 1947³²⁸ e SHBA-ve, ka arritur të realizojë informata të shumta kualitative për realizmin dhe mbrojtjen e infrastrukturës vitale, interesave kombëtare, interesave humanitare dhe interesave tjera strategjike e publike, të parapara me strategjinë e sigurisë së SHBA -ve. Bashkësia Informative përbëhet prej gjashtëmbëdhjetë (16) organizatash, të cilat detyrat dhe përgjegjësitë i ushtrojnë në kuadër të kompetencave të dhëna sipas ligjit në fjalë.

Agjencitë, apo organizatat anëtare të BI, janë:

1. Agjensioni Qendror i Inteligjencës “Central Intelligence Agency (CIA)”³²⁹;
2. Shërbimi Informativ i Forcave Ajrore “Air Force Intelligence (AFI)”³³⁰;
3. Shërbimi Informativ i Ushtrisë ” Army Intelligence (AI)”³³¹;
4. Shërbimi Informative i Mbrojtjes Detare “Coast Guard Intelligence (CGI)”³³²;
5. Agjensioni Informativë i Mbrojtjes “Defense Intelligence Agency (DIA)”³³³;
6. Departamenti i Energjisë”Department of Energy (DE)”³³⁴;
7. Departamenti i Sigurimit të Atdheut ”Department of Homeland Security (DHS)”³³⁵;
8. Departamenti i Shtetit “Department of State (DS)”³³⁶;
9. Departamenti i Thesarit të Shtetit “Department of the Treasury (DT)”³³⁷;
10. Administrata për Luftë kundër Narkotikëve “Drug Enforcement Administration (DEA)”³³⁸;

³²⁸ Section 102 (d) (5), Nacional Security Act of 1947.P.L.80-253; hercafter cited as Nacional Security Act of 1947.

³²⁹[Online] Marrë nga:<https://www.cia.gov/index.html>

³³⁰<https://www.airforce.com/>

³³¹<http://www.goarmy.com/>

³³²<http://www.gocoastguard.com/>

³³³<http://www.dia.mil/>

³³⁴<http://energy.gov/>

³³⁵<https://www.dhs.gov/>

³³⁶<http://www.state.gov/>

³³⁷<https://www.treasury.gov/Pages/default.aspx>

³³⁸<https://www.dea.gov/index.shtml>

11. Byroja Federale e Hulumtimeve “Federal Bureau of Investigation (FBI)”³³⁹;
12. Shërbimi Informativ i Korpunit të Marinës “Marine Corps Intelligence (MCI)”³⁴⁰;
13. Agjensioni Nacional për Incizim dhe Kartografi “National Geospatial-Intelligence Agency (NGA)”³⁴¹;
14. Zyra Kombëtare për Vëzhgim “National Reconnaissance Office (NRO)”³⁴²;
15. Agjensioni për Sigurim Kombëtarë “National Security Agency (NSA)”³⁴³;
16. Shërbimi Informativ i Armatës “Office of Naval Intelligence (ONI)”³⁴⁴.

Pra, sipas kësaj renditje të institucioneve dhe zyrave të agjencive të zbulimit në SHBA, të gjitha agjensionet tjera të BI-së bashkëveprojnë në mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare të SHBA-ve, varësisht, sipas kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara me ligj. Në fakt CIA bashkëpunim më të ngushtë gjatë kryerjes së aktiviteteve të saja ka me Zyrën Kombëtare për Vëzhgim (NRO), me Agjencinë për Sigurim Kombëtarë (NSA), Agjencinë Nacionale për Incizim dhe Kartografi (NGA), Agjencinë Informative të Mbrojtës (DIA) dhe Shërbimin Informativ i Armatës (ONI).

³³⁹<https://www.fbi.gov/>

³⁴⁰<http://www.hqmc.marines.mil/intelligence/>

³⁴¹<https://www.nga.mil/Pages/Default.aspx>

³⁴²<http://www.nro.gov/>

³⁴³<https://www.nsa.gov/>

³⁴⁴<http://www.oni.navy.mil/> [Qasja e fundit, Nëntor 2017]

6.12 Roli i agjencive inteligjente në shkëmbimin e informacionit

Roli i agjencive të inteligjencës në shkëmbim, marrje dhe dhënie të informacionit, është i një rëndësie të madhe dhe të patjetërsueshme në punën e agjencive të zbulimit.

Suksesi ynë në parandalimin e sulmeve terroriste në të ardhmen varet nga aftësitë tona për të mbledhur, analizuar, dhe të shkëmbejnë informata dhe të zbulimit në lidhje me ata që duan të sulmojnë na, taktikat që ata përdorin, dhe objektivat që ato synojnë të sulmojnë. Strategjia Nacionale për Luftimin e Terrorizmit, të lëshuar në shtator të vitit 2006, pranon se lufta kundër terrorit është një lloj të ndryshme të luftës, e cila kërkon një ndryshim paradigme dhe aplikimin e të gjitha elementeve i fuqisë sonë kombëtare dhe ndikimit. strukturat e inteligjencës dhe ndarjen e informacionit që pasi mundësoi fitoren e Luftës së Ftohtë tani kërkojnë fleksibilitet më të madh dhe elasticitetin për përballur me kërcënimet me të cilat përballlet kombin tonë nga një lëvizje terroriste transnacionale përcaktuar për të shkatërruar njerëzit tanë, liritë tona, dhe mënyrën tonë të jetës.³⁴⁵

Ekzistojnë tri parimet udhëzuese, që mëtojnë të trajtojnë komunikimin.

Ata që janë përgjegjës për luftimin e terrorizmit duhet të kenë akses në informacionin e duhur dhe të saktë nga agjencitë e inteligjencës në lidhje me ata që duan të na sulmojnë dhe objektivat, planet dhe aktivitetet e tyre që kanë ndërmend për të sulmuar.


Ky informacion ndërlidhë përpjekjet tona për:

- *Identifikimi i shpejtë si kërcënime të menjëhershme dhe afatgjata;*
- *Identifikimi i personave të përfshirë në aktivitete të lidhura me terrorizmin; dhe*
- *Zbatimi i informacionit të shtyrë dhe të bazuar në rrezik zbulimi, parandalimi, parandalimi, Përpjekjet përgjigje, mbrojtjes dhe menaxhimit të emergjencave, etj.*³⁴⁶

³⁴⁵ Më gjerësisht, National Strategy for Information Sharing, Successes and Challenges In Improving Terrorism-Related Information Sharing, [Online] Marrë nga: https://www.ise.gov/sites/default/files/nsis_book_0.pdf, fq. 1

³⁴⁶ Po aty, faqe,2

FIG. NR. 15 THEMELIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR NDARJEN E INFORMACIONIT



Foundations of the National Strategy for Information Sharing

Parimet e Strategjisë Kombëtare për shkëmbimin e informacionit³⁴⁷

- Shpërndarja në nivel federal
- Shpërndarja me shtetin, lokale dhe subjekteve etnike,
- Shpërndarja me sektorin privat.
- Shpërndarja e informacionit me partnerët e huaj
- Mbrojtja e Privatësisë së Informacionit dhe të drejtat e tjera ligjore.

³⁴⁷https://www.ise.gov/sites/default/files/nsis_book_0.pdf . Fq, 5

Edhe sipas autorit **Peter Gill**: “shpërndarja brenda komunitetit është një faktor i rëndësishëm në cilësinë e produkteve finale, por shpërndarja jashtë komunitetit është ajo që krijon besueshmëri dhe lëvërdi të inteligjencës.”³⁴⁸

6.13 Roli i shërbimeve të specializuar policore

Sikurse çdo polici në botë, sidomos ato polici të shteteve të cilat ballafaqohen me luftën kundër terrorizmit dhe aspekteve të ndërlidhura kriminale, janë detyruar që të formojnë njësi të specializuara dhe të trajtuara mirë që të kenë rezultat në luftën kundër terrorizmit dhe rritjen e kapaciteteve të inteligjencës policore, si mekanizma parandalues në luftimin e kriminalitetit.

DREJTORIA KUNDËR TERRORIZMIT³⁴⁹

Drejtoria Kundër Terrorizmit është Drejtori e specializuar në kuadër të Divizionit për Hetimin e Krimin, e cila është krijuar relativisht vonë (Tetor 2006), rreth të cilës është punuar shumë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të saj në burime njerëzore, procedura të punës, mjete dhe pajisje të domosdoshme si dhe në punë operacionale dhe hetime.

Vizioni i kësaj Drejtorie është ndërtimi i një shoqërie, që jeton në paqe dhe pa kërcënime nga Terrorizmi, ndërsa si Misioni i kësaj Drejtorie është të përcaktoj objektivat dhe prioritetet strategjike, me qëllim që të parandalojë dhe luftojë terrorizmin.

Objektivat kryesore të Drejtorisë kundër terrorizmit janë: të parandalojë dhe pamundësojë terroristeve që të rekrutojnë, planifikojnë të influencojnë dhe ndërtojnë legjitimitet brenda Kosovës, të cilat objektiva duhet të arrihet përmes të gjitha formave legale dhe etike të përcaktuara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe ato ndërkombëtare.

³⁴⁸Peter Gill, *Intelligence in an Insecure World*, co-author, Polity Press, 2nd edition

³⁴⁹Policia e Kosovës, Departamenti i Hetimeve, [Online] Marrë nga: <http://www.kosovopolic.com/sq/departamenti-i-hetimeve> {Qasja, Nëntor 2017}

Në kuadër të këtyre angazhimeve përfshihen: hetimet, mbledhja e inteligjencës, mirëmbajtja dhe analizimi i inteligjencës, shfrytëzimi i masave të fshehta të hetimit, kryerja e operacioneve klandestine etj.

Synimi i Drejtorisë kundër Terrorizmit, është parandalimi dhe luftimi i terrorizmit përmes ngritjes së kapaciteteve, bashkëpunimit, koordinimit dhe shfrytëzimit efikas të të gjitha agjencioneve dhe institucioneve vendore si dhe bashkëpunimit me institucionet tjera ndërkombëtare dhe legjitime, si dhe mbrojtja e qytetareve të Kosovës, pronës si dhe objekteve vitale nga të gjitha aktet e terrorizmit si dhe sjellja para drejtësisë e individëve apo grupeve përgjegjëse për kryerjen, ndihmën apo financimin apo planifikimin e akteve terroriste.

Drejtoria Kundër Terrorizmit është e ndarë dy (2) Sektorë:

- *Sektori i Inteligjencës dhe*
- *Sektori i Parandalimit dhe Hetimeve*

DREJTORIA PËR INTELIGJENCË DHE ANALIZË³⁵⁰

Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë, është Drejtori e veçantë në kuadër të Divizionit për Hetimin e Krimit, e cila është “Qendër e mbledhjes, koordinimit, drejtimit dhe planifikimit operacional të Inteligjencës Policore në kuadër të PK-së”, dhe si e tillë angazhohet në krijimin e një ambienti të sigurt në Kosovë, duke kontribuar në procesin e parandalimit të krimit, vlerësimeve strategjike lidhur me aktivitetet kriminale, identifikimin e faktorëve tensionues në shoqëri, si dhe asistimi në zbulimin e kryerësve të veprave të ndryshme penale dhe sjelljen e tyre para organeve të drejtësisë.

³⁵⁰ Po aty, [Online] Marrë nga: <http://www.kosovopolic.com/sq/departamenti-i-hetimeve>

Drejtoria për Inteligjencës dhe Analizë, është pika qendrore kompetente për mbledhje, analizë dhe shpërndarje të informatave dhe inteligjencës policore.

Veprimtaria e kësaj drejtorie ka për qëllim pro aktivitetin, përmes veprimit policor përpara se të ndodhë akti kriminal apo pasojat nga aktiviteti kriminal.

Misioni i Drejtorisë për Inteligjencë dhe Analizë, është që të mundësojë funksionimin e Policisë të udhëhequr nga inteligjenca dhe partneritet, në qasjen me orientim ndaj problemit, duke udhëhequr me procesin e inteligjencës në kuadër të PK-së ndërsa,

Vizioni i kësaj drejtorie është krijimi i një sistemi unifikues dhe efektivë i inteligjencës kriminale, me qëllim që PK-ja përmes inteligjencës të drejtohet në mënyrë më efektive dhe efikase në krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Objektivi kryesor i Drejtorisë për Inteligjencës dhe Analizë, është të fokusohet në mbledhjen e Inteligjencës, procedimin, vlerësimin, analizimin dhe shpërndarjen e inteligjencës si dhe koordinimin ndërmjet njësive, me qëllim të mënjanim të hetimeve të dyfishta, duke i konsoliduar informatat nga njësitë që janë në dispozicion dhe t'i jap kahe këtyre informatave për njësinë përgjegjëse për hetime kryesore, dhe dërgimi i informatave në njësinë përgjegjëse e cila është duke bërë hetimin për vazhdimin e hetimeve.

Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë është e ndarë tre (3) Sektorë:

- *Spektori i Analizës*
- *Spektori i Mbështetjes së Inteligjencës si dhe*
- *Spektori i Njësive Rajonale*

6.14 Roli i shërbimeve të specializuara ushtarake

Ushtritë e vendeve, apo koalicionet ushtarake, paktet ushtarake, posaçërisht NATO, kanë ndërmarrë shumë reforma në fushën e ofrimit të shërbimeve apo njësive të specializuar në luftën kundër terrorizmit dhe aspekteve të logjistikës bashkëkohore në sfondin e trendëve të teknologjisë.

Rasti i Shqipërisë³⁵¹; Zakonisht Forcat e Armatosura në luftën kundër terrorizmit, veprimet e tyre të armatosura në luftën kundër terrorizmit, bëjnë përshtatjen dhe përdorimin e aftësive të tyre për të zbuluar dhe vepruar në kohë ndaj veprimeve terroriste. Ky është një element thelbësor i sigurisë së Republikës të Shqipërisë, i sigurisë rajonale dhe të NATO-s.

Zbulimi ushtarak dhe informacioni (si pjesë aktive e strukturave të zbulimit dhe informacionit të përgjithshëm shtetëror) kanë detyrë të rëndësishme dhe me përgjegjësi në parandalimin e akteve terroriste. Kjo mundëson reagimin e duhur dhe në kohë ndaj tyre.

Ky rol është i jashtëzakonshëm, duke parë nevojën që ushtritë dhe forcat e tyre të jenë gjithnjë e më shumë në gjendje gatishmërie për intervenime ushtarake, në misione paqeruajtëse kudo në vatrat e krizave në botë.

NATO në kuadër të kapaciteteve të saja ka numër të mjaftueshëm të njësive dhe shërbimeve që luajnë një rol shumë aktiv në funksionimin e saj në të gjitha aspektet operacionale.

KOSOVA në kuadër të procesit të transformimit të FSK-së në FAK, Forca të Armatosura të Kosovës, do ti ndërmerr të gjitha masat që të përplotësojnë nevojat e saj për ofrimin dhe garantimin e mjedisit të sigurisë dhe mbrojtjes për qytetarët e Kosovës.

³⁵¹PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË LIGJ Nr. 9419, datë 20.5.2005 [Online] Marrë nga: <http://www.qbz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%209419%20Dat%C3%AB%2020-05-2005.htm> {Shikuar për herë të fundit, janar 2018}

*“Republika e Kosovës, është shteti i parë në rajon, i cili ka bërë
hapa të mëdhenj dhe sfidues përmes inteligjencës në Luftën
Kundër Terrorizmit”*

KAPITULLI I SHTATË

**BASHKËVEPRIMI I SHËRBIMEVE TË SIGURISË DHE INTELIGJENCËS NË LUFTËN KUNDËR
TERRORIZMIT BRENDIA SISTEMIT JURIDIK TË KOSOVËS DHE JURIDIKSIONIT
NDËRKOMBËTARË**

7.1 Rregullimi ligjor dhe bashkëveprimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në luftën Kundër terrorizmit.....	147
7.2 Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit.....	148
a. Parandalimi b. Ndjekja c. Mbrojtja d. Përgatitja dhe Reagimi	
7.3 Institucionet Republikës së Kosovës në luftën kundër terrorizmit.....	151
7.4 Koordinatori Nacional Kundër Terrorizmit	153
7.5 Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	153
7.6 Përgjimet ligjore (Dhoma Nationale e Interceptimeve).....	154
7.7 Ministria e Punëve të Brendshme	155
7.8 Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	155
7.9 Prokuroria dhe Gjykata	155
Inteligjenca dhe Kundërinteligenca, ligjet antiterroriste dhe zbatimi i tyre	
7.10 Legjislacioni i brendshëm- Korniza ligjore.....	155
7.11 Institucione të huaja që trajtojnë aspektet e sundimit të ligjit në Kosovë.....	156
7.12 Dokumente Strategjike të Republikës së Kosovës.....	157

KAPITULLI I SHTATË
BASHKËVEPRIMI I SHËRBIMEVE TË SIGURISË DHE INTELIGJENCËS
NË LUFTËN KUNDËR TERRORIZMIT BRENDË SISTEMIT JURIDIK TË KOSOVËS
DHE JURIDIKSIONIT NDËRKOMBËTARË

7.1 Rregullimi ligjor dhe bashkëveprimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në luftën Kundër terrorizmit

Kosova si shtet, mund të thuhet se ka përmbushë në tërësi arkitekturën e sigurisë, në këtë rast specifikisht legjislacionin e vet sa i përket parandalimit dhe luftimit të fenomenit të terrorizmit. Së fundmi ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm ligjor dhe mbi bazën e analizave të kryera më sipër, strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020 do të fokusohet në realizimin e katër objektivave strategjike dhe një numri më të madh të objektivave/masave specifike të cilat synohet arrihen për periudhën 2015-2020.

Këto objektiva strategjike dhe masa specifike të parapara me këtë strategji do të synohet të arrihen përmes aktiviteteve specifike të cilat do të jenë pjesë e planit të veprimit për implementimin e strategjisë 2015-2020. Arritja e këtyre objektivave strategjike do të ketë një ndërveprim edhe me programet ekzistuese duke përfshirë edhe strategjitë dhe politikat ekzistuese të Qeverisë si dhe planet përkatëse për implementimin e strategjive ekzistuese.

Kjo strategji do të fokusohet në katër objektiva strategjike si në vijim:

- Identifikimi i hershëm- i shkaqeve, faktorëve dhe grupeve të targetuara
- Parandalimi- i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm
- Intervenimi – me qëllim të parandalimit të rrezikut nga radikalizmi i dhunshëm
- De-radikalizimi dhe riintegrimi - i personave të radikalizuar³⁵²

³⁵²Për më tepër shih, Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020, fq 18

Si përfundim, mund të thuhet se të gjitha shtetet, kanë synim të arrinjë, që me masa ligjore, strategji të veçanta, plane vepruese kompaktibile dhe burime njerëzore të përgaditura mirë, të bëjnë vlerësimin dhe paralajmërimin e kërcënimit nga terrorizmi, duke qenë në gjendje të ruajnë sigurinë publike për qytetarët dhe sigurinë kombëtare prej sulmeve, që pothuajse shtetet kanë dështuar të jenë të mbrojtura plotësisht.

7.2 Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit

(a. Parandalimi b. Ndjekja c. Mbrojtja d. Përgatitja dhe Reagimi)

Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit³⁵³ plotëson dhe bashkërendohet në radhë të parë me Strategjinë e Sigurisë së Republikës së Kosovës, si dhe po ashtu me strategjitë e tjera siç janë:

i) Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës Kundër Krimin të Organizuar; ii) Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimin; iii) Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit; iv) Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Drogave; v) Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore; vi) Strategjia Nacionale për Sigurinë në Bashkësi etj.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton se “ *askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal* ”.³⁵⁴


Po ashtu, Strategjia e Sigurisë së Republikës së Kosovës përcakton vullnetin e Institucioneve të Republikës së Kosovës për Qeverisje të mirë dhe për bashkëpunim dhe qasje të unifikuar të institucioneve për tu ballafaquar me sfidat e sigurisë në Republikën e Kosovës³⁵⁵

³⁵³Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit 2012-2017, fq. 5-6

³⁵⁴Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 24 [Barazia para Ligjit], fq. 7

³⁵⁵ Kosova synon, që përmes këtyre gjashtë strategjive, që kanë për qëllim edhe fuqizimin e mekanizmave institucional të dedikuar për parandalim dhe luftim të terrorizmit, ngritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional në nivel vendi por edhe ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, të arrijë të parandalojë dhe ta luftoj këtë dukuri negative.

FIG. NR. 16 (ORGANOGRAMI I (MKMI) I NDARË NË DY NIVELE)³⁵⁶



Gjithashtu edhe Plani i veprimit për implementimin e strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020, është një tjetër mekanizëm që tregon se si Kosova ka marrë detyra dhe obligime sektoriale, që të përmbushë dhe arrijë rezultate të nevojshme karshi sfidave sipas parimit të identifikimit të hershëm – të shkaqeve, faktorëve dhe grupeve të targetuara.³⁵⁷

Kjo strukturë organizative e e ndarë në dy nivele: Nivelin strategjik, dhe nivelin operativ, përfshi Mekanizmat, Koordinimin, Monitorimin dhe të Implementimit, tregon për organizimin brenda institucional në Kosovë, në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

³⁵⁶ Marrë nga, Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit, 2012-2017, fq, 16

³⁵⁷ Plani i veprimit për implementimin e strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020, dokument 33 faqe, i politikave verpruse të qeverisë.

Bazuar në ligjet dhe mekanizmat e zbatimit ndërinstitucional, në sektorin e gjerë, që ndërlidhet me bashkëveprimin në aspektet e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit, Republika e Kosovës ka në zbatim një bazë të gjerë ligjore, e cila përfshinë, por nuk kufizohet në:

- **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**³⁵⁸;
- Ligji nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës³⁵⁹;
- Ligji nr.03/L –166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik³⁶⁰;
- Ligji nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit³⁶¹;
- Ligji nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike³⁶²;
- Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike³⁶³;
- Ligji nr.05/L-030 për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike³⁶⁴;
- Ligji nr.03/L -172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale³⁶⁵;
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë³⁶⁶;
- Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike³⁶⁷;
- Ligji nr. 03/L063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë³⁶⁸;
- Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale³⁶⁹;
- Ligji nr. 03/ L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare³⁷⁰;
- Ligji nr. 04/L-213 për Ndhimën Juridike Ndërkombëtare në Çështje Penale³⁷¹;
- Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare³⁷²;
- Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror³⁷³;
- Ligji nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare³⁷⁴;
- Ligji nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë³⁷⁵;
- Ligji nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike³⁷⁶;
- Ligji nr.04/L –004 për Shërbimet Private të Sigurisë³⁷⁷;
- Ligji nr.03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë³⁷⁸;
- Ligji nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës³⁷⁹;
- Ligji nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit³⁸⁰;
- Ligji nr.05/L-002 për Ndalimin e Bashkimit në Konflikte të Armatosura jashtë territorit të vendit³⁸¹;

³⁵⁸[Online] Marrë nga:<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=370>

³⁵⁹<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2521>

³⁶⁰<http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2682>

³⁶¹<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8669>

³⁶²<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2811>

³⁶³<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2851>

³⁶⁴<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10968>

³⁶⁵<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2676>

³⁶⁶<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>

³⁶⁷<http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2651>

³⁶⁸<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2538>

³⁶⁹<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>

³⁷⁰<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2674>

³⁷¹<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8871>

³⁷²<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2789>

³⁷³<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2801>

³⁷⁴<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2816>

³⁷⁵<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2781>

³⁷⁶<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8860>

³⁷⁷<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2741>

³⁷⁸<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2690>

³⁷⁹<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2523>

³⁸⁰<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>

³⁸¹<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10763> [Qasja e fundit, Shkurt 2017]

7.3 Institucionet Republikës së Kosovës në Luftën Kundër Terrorizmit

Duke u nisë nga fakti që terrorizmi global ka përfshi vende të shumta në botë, pashmangshëm edhe Republika e Kosovës, potencialisht do të mund të ishte cak i sulmeve të tilla, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë një varg masash lidhore dhe operacionale.

Qeveria e Republikës së Kosovës³⁸² ka për qëllim që të parandaloj dhe zvogëloj rrezikun nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Plani i veprimit i cili është pjesë e kësaj strategjie përmes objektivave specifike dhe aktiviteteve konkrete përmes tyre synohet që ndër të tjera të rritet vetëdija si në mesin e institucioneve po ashtu edhe të qytetarëve sa i përket rreziqeve që vijnë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Krahas ngritjes së vetëdijes edhe veprimet konkrete në adresimin e faktorëve shtytës dhe tërheqës zënë vend në kuadër të objektivave strategjike dhe specifike të kësaj strategjie.

Së fundmi, duke i parë të domosdoshme aspektet e deradikalizimit të pjesëtarëve që ishin apo ndihmuan indoktrinimin e përmasa të ekstremizmit dhe që për pasojë vuajnë dënim në burgjet e Kosovës, Ministria e Drejtësisë së bashku me BIRK – Bashkësinë Islame të Republikës së Kosovës, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit që ky institucion i fundit, të dërgoj disa imam me një mandat të caktuar, që të ligjërojnë në burgjet e Kosovës, atyre të burgosurve që besohet se janë të indoktrinuara fetarisht.³⁸³

Me këtë rast, Ministri Tahiri ka shprehur bindjen se organizimi i ligjëratave fetare për të burgosurit do të rrit vetëdijen lidhur me rreziqet e radikalizmi fetar.

"Përmes ofrimit dhe organizimit të ligjëratave fetare për të burgosurit në institucionet korrektuese, besojmë shumë se do të rritet vetëdija si në mesin e personave të privuar nga liria, që mbahen në institucionet korrektuese, ashtu edhe në institucionet e përfshira në zbatimin e këtij Memorandumi" ka theksuar Tahiri.

³⁸² Përmbledhje Ekzekutive nga Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 – 2020, Prishtinë, Shtator, 2015, faqe 5-6

³⁸³ Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, si dhe kryetari i Bashkësinë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnavë, kanë nënshkruar sot Marrëveshje Bashkëpunimi për realizimin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të personave të burgosur sipas legjislacionit në fuqi. [Online] Marrë nga: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,1857> Prishtinë, 11/05/2018 (Qasja e fundit 18. Maj 2018)

Ministri Tahiri po ashtu ka theksuar se idetë e radikalizmit kanë përfshirë gjithë botën, dhe Kosova nuk ka mbetur immune nga kjo dukuri. Megjithatë, sipas Ministrit, numri i pjesëmarrësve në konfliktet e huaja ka rënë dukshëm.

"Fatmirësisht ka rënë ndjeshëm numri i qytetarëve të Kosovës që janë pjesë e konflikteve të huaja, kjo falë edhe angazhimit institucional për të ndërmarrë masa konkrete në parandalimin e këtij fenomeni. Megjithatë, edhe ata që janë kthyer edhe ata që janë aktualisht në vuajtje të dënimit, në esencë janë qytetarë të Kosovës dhe meritojnë kujdesin tonë" ka thënë Ministri Tahiri.

Sipas Marrëveshjes, Bashkësia Islame e Kosovës angazhohet në sigurimin e ligjëratave fetare nga Lista e imamëve të BIK-ut e verifikuar në mënyrë të duhur, ndërsa Ministria e Drejtësisë siguron hapësirat për mbajtjen e ligjëratave si dhe bënë ofrimin e sigurisë për zyrtarët fetar gjatë vizitave të tyre në institucionet korrektuese.³⁸⁴

³⁸⁴ Tekste nga Marrëveshtja në mes të MD dhe BIK –ut të shpalosura gjatë konferencës për media. Prishtinë. 11.05.2018

7.4 Koordinator Nacional Kundër Terrorizmit

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe rëndësi në koordinimin e aktiviteteve në luftë kundër terrorizmit.

Akterët institucional për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit janë por nuk kufizohen vetëm në:

Koordinatori Nacional Kundër Terrorizmit – Koordinator Nacional është organ individual përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me luftën kundër terrorizmit.

Sekretariati i Koordinatorit Nacional Kundër Terrorizmit – Detyrë themelore dhe përgjegjësi e sekretariatit është mbledhja e informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të atyre informatave, si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional.

7.5 Agjencia e Kosovës për Inteligjencë

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë – është organ i cili mbledhë, analizon dhe shpërndan informacione me qëllim të parandalimit të aktiviteteve terroriste që zhvillohen në dëm të sigurisë së Republikës së Kosovës dhe sigurisë globale.

7.6 Përgjimet ligjore (Dhoma Nationale e Interceptimeve)³⁸⁵

Autoriteti se kush mund të urdhëroj përgjimin ligjor të telekomunikimeve në Kosovë është i shpërndarë në disa organe gjyqësore përbrenda strukturave vendore dhe ndërkombëtare. Sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, përgjimi ligjor i telekomunikimeve mund të bëhet nga gjykata e procedurës paraprake në bazë të kërkesës nga prokurori publik.³⁸⁶

³⁸⁵ Sqarim: Përshak të kompjesitetit të institucioneve ndërkombëtare të sundimit të ligjit, Kosova ende nuk e ka një “Dhomë Nationale të Interceptimeve ose Përgjimeve ligjore”, por siq e shihni në këtë përmbledhje, ky segment është i shpërndarë në disa institucione, vendore dhe atyre ndërkombëtare të sigurisë.

³⁸⁶ UNMIK, KPPP, Neni 258, Paragrafi (2); Nënparagrafi 4) dhe 5)

Gjithashtu, në raste kur duhet të përgjohet më shumë së një telefon apo pikë komunikuese, urdhri mund të jepet nga kolegji prej tre gjyqtarësh i gjykatës kompetente të qarkut.³⁸⁷ Përveç kësaj, ligji për AKI-në i jep gjykatësit të Gjykatës

Supreme të drejtën për t'i autorizuar punëtorët e AKI-së që të kryejnë vëzhgimin e telekomunikimeve siç parashihet me ligjin për AKI-në. Gjykata Supreme jep autorizimin “vetëm pas shqyrtimit të kërkesës më shkrim të bërë nën betim dhe të aprovuar nga drejtori i AKI-së apo zëvendës drejtori i AKI-së.”³⁸⁸

Përveç autoriteteve të strukturës vendore të sigurisë, EULEX-i është autoriteti tjetër në strukturën ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë që duhet të siguroj që veprat penale si, por jo të përkufizuara në krim të organizuar, korrupsion, dhe krime të luftës, të hetohen nga hetues ndërkombëtar.³⁸⁹

Edhe pse kjo lë të nënkuptoj që EULEX-i mund të urdhëroj përgjimin e telekomunikimeve, hulumtimi përgjatë këtij studimi nuk ka çuar deri tek ndonjë referencë të drejtpërdrejt lidhur me këtë çështje. Shpërndarja e autoritetit i cili mund të urdhëroj këtë masë të hetimit në organe të ndryshme mund të jetë e nevojshme, mirëpo mungesa e bashkëpunimit të duhur dhe mungesa e mekanizmave për shkëmbimin e informatave në mes të autoriteteve të ndryshme mund ta afektoj negativisht kualitetin dhe shpejtësinë e hetimeve. Duket se nuk ekzistojnë rregulla të qarta sa i përket bashkëpunimit ndërmjet IDS-ve përbrenda strukturës vendore të sigurisë (p.sh. përbrenda Policisë së Kosovës apo në mes të Policisë së Kosovës dhe AKI-së), si dhe në mes të IDS-ve vendore dhe atyre ndërkombëtare (p.sh. në mes të AKI-së dhe EULEX-it).³⁹⁰

³⁸⁷ UNMIK, KPPP, Neni 259, Paragrafi (6)

³⁸⁸ Republika e Kosovës, Ligji për AKI-në, Nr. 03/L-063, Neni 28, Paragrafi 28.1

³⁸⁹ Propozim Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, Aneksi IX, Neni 2, Paragrafi 2.3, Nënparagrafi (a)

³⁹⁰ QKSS.[Online] Marrë nga: http://www.qkss.org/repository/docs/Pergjimi_ligjor_i_telekomunikimeve_486450.pdf
Përgjimi Ligjor i Telekomunikimeve në Kosovë: Implikimet për Sigurinë (Dokument i publikuar nga QKSS)

7.7 Ministria e Punëve të Brendshme, është organ i qeverisë së epubikës së Kosovës që zhvillon politika lidhur me parandalimin dhe luftimin e terrorizmit duke i vënë në zbatim edhe Policinë, që është mekanizëm institucional në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila merret me parandalimin, ndjekjen dhe luftimin e terrorizmit.

7.8 Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës – përmes mekanizmave të saj ndihmon institucionet vendore në parandalimin e terrorizmit, ndërsa me njësitet e saj merr pjesë aktive në mbrojtje dhe reagim ndaj sulmeve të mundshëm terroriste.

7.9 Prokuroria dhe Gjykata

Prokuroritë dhe Gjykatat – Janë institucionet përgjegjëse për hetimin, ndjekjen penale të terroristëve, ndëshkimin adekuat të tyre, konfiskimin e pasurisë dhe aseteve të fituara me anë të aktiviteteve terroriste.

7.10 Legjislacioni i brendshme- Korniza Ligjore

Strategjia kombëtare kundër terrorizmit bazohet në legjislacionin në fuqi ku përfshihen por nuk kufizohen vetëm në:

Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe dy kodet, atë të Kodit Penal i Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, pastaj një varg ligjesh dhe masash ligjore të ndërlidhen me sundimin e ligjit dhe garantimin e sigurisë publike dhe nacionale të qytetarëve të Kosovës, si:

Ligji nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë; Ligji për Gjykatat; Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorinë e Shtetit; Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës; Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës; Ligji nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë; Ligji nr. 04/L-076 për Policinë; Ligji nr. 04/L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve; Ligji nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve; Kodi Drejtësisë për të Mitur; Kodi Doganor dhe i Akcizave; Ligji nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; Ligji nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare; Ligji nr. 03/L-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore; Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike; Ligji

nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit; Ligji nr. 03/L-231 për; Inspektoratin Policor të Kosovës; Ligji nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale; Ligji nr. 04/L-31 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale,; Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare; Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror; Ligji nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas; Ligji nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare; Ligji nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës,; Ligji nr. 04/L-57 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare; Ligji nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë; Ligji nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike,; Ligji nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike; Ligji për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Besueshmërisë; Ligji për Shërbimin në Forcën e Sigurisë.

Së fundmi në kuadër të shtimit të masave janë gjithnjë e më shumë është rritë interesimi që dy kodet, Kodi Penal i Kosovës dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, janë në procedurë të ndryshimit e plotësimit nga Ministria e Drejtësisë me qëllim të avancimit ligjor dhe shtimit të kompetencave të deklarim, sekuestrim të pasurisë dhe aspekte të tjera që ndërlidhen me sundimin dhe forcimin e ligjit. (Disa shpjegime epen edhe në të përditshmen Gazetën Zëri) ³⁹¹

7.11 Institucione të huaja që trajtojnë aspektet e sundimit të ligjit në Kosovë

ICITAP³⁹² – Ndhmon zhvillimin profesional dhe transparent të institucioneve për zbatim të ligjit me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, luftimit të korrupsionit si dhe për zvogëlimin e kërcënimit të terrorizmit.

EULEX³⁹³ – Është Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit. Synimi kryesor i tij është t'i ndihmojë dhe mbështesë autoritetet kosovare në fushën e sundimit të ligjit, posaçërisht në fushën e policisë, gjyqësisë dhe doganave.

OSBE³⁹⁴ – Monitorimin e sundimit të ligjit dhe zhvillimin e institucioneve të pavarura për sundim të ligjit, zhvillim të mëtutjeshëm të sektorit të sigurisë publike, përfshirë policinë,

³⁹¹ Zëri, gazetë ditore [Online] Marrë nga: <http://zeri.info/aktuale/178205/tahiri-ndryshimet-ne-kodin-penal-forcojne-luften-kunder-krimin/>, Publikuar, 25 DHJETOR 2017, koha 20 : 45

³⁹² ICITAP, [Online] Marrë nga: <https://www.justice.gov/criminal-icitap> (Qasja e fundit 19.05.2018)

³⁹³ EULEX, [Online] Marrë nga: <http://www.eulex-kosovo.eu/> (Parë për herë të fundit 19.05.2018)

³⁹⁴ OSCE, [Online] Marrë nga: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo> (Lexuar për herë të fundit 19.05.2018)

doganat dhe shërbimet korrektuese.

Rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, përveç institucioneve të lartcekura, luajnë edhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare prezente në Kosovë dhe jashtë saj.

7.12 Dokumentet Strategjike të Republikës së Kosovës

Republika e Kosovës ka hartuar shumë dokumente strategjike për fusha të ndryshme, ku Departamenti i Hetimeve³⁹⁵ është njëri nga akterët kryesorë në zbatimin e këtyre dokumenteve si:

-Plani Zhvillimor Strategjik 2016-2020

-Plani Vjetor i Punës së Policisë së Kosovës për vitin 2016

-Plani Vjetor i Departamentit të Hetimeve

- Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2015-2019

- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2012-2017

- Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Drogave 2012-2017

- Strategjia Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Terrorizmit 2012-2017

- Strategjia Nacionale kundër Korrupsionit 2013-2017

- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit 2013-2017

- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2020

- Strategjia kundër Falsifikimit dhe Piraterisë 2012-2016

- Strategjia për Siguri Kibernetike 2015-2018

- Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020

- Plani Strategjik për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Rreziqet në Internet 2015-2020

- Strategjia për Asistencë në Fushën e Sundimit të Ligjit 2016-2019

-Strategjia Shtetërore për Siguri Kibernetike-2016-2019

³⁹⁵ Depatamenti i Hetimeve i PK –së[Online] Marrë nga:<http://www.kosovopolic.com/sq/departamenti-i-hetimeve> [Qasja, Tetor, 2107]

*Pikëpamja tradicionale në shkencë dhe metodat inter-
disiplinore të hulumtimit janë dy komponentë komplementare
të njëra tjetrës. Puna shkencore mbetet e mangët pa këtë
korrelacion metodologjik!*

RAPORTI I HULUMTIMIT:

ANEKS I -Pyetësi.....	159
ANEKS II - Respondentët	163
ANEKS III - Interpretimi dhe analiza tabelore.....	168
ANEKS IV - Raporti i Përfundimtar.....	200

SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE

Konkluzione.....	213
Rekomandime.....	216
LITERATURA	217
Pasdedikim.....	225
Rikapitulim statistikor.....	225

ANEKS I - Pyetësi

UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY



FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE SHKENCAVE POLITIKE
FAKULTET ZA JAVNA ADMINISTRACIJA I POLITIKI NAUKI
PUBLIC ADMINISTRATION AND POLITICAL SCIENCES

Ky pyetësor i formatit me një opsion të përgjigjes, është ndërtuar për të realizuar matjen në mënyrë empirike të disa aspekteve rreth **“Kontekstit i Shërbimeve inteligjente në politikat bashkëkohore të sigurisë”**, me theks të veçantë në fushën e **shërbimeve inteligjente**. Realizimi është menduar të bëhet me disa kategori respondentësh si në vijim: *Staf akademik, përfshirë profesor të fushës; Ekspert të Shoqërisë Civile, Përgjegjës të Sektorit të Sigurisë dhe Inteligjencës; Komisionet Parlamentare në Republikën e Kosovës, Organizatat qeveritare dhe joqeveritare simotra, brenda dhe jashtë vendit*. Duhet të theksohet se pyetësi siguron **kofidencë** dhe **anonimitet** të plotë, dhe këto vlerësime do të përdoren vetëm për qëllime akademike të hulumtimit për tezën e doktoratës.

Data: ____/____/2015

Nr. Rendor _____

Pozita _____,

Institucioni: _____

***Ju lutem plotësoni njërin nga pesë (5) opsionet:**

1. Pajtohem *plotësisht*
2. Pajtohem
3. Nuk kam përgjigje
4. Nuk pajtohem
5. Nuk pajtohem *aspak*

1. **Aspekti i sigurisë dhe Inteligjencës, është i nxitur nga nevoja e krijimit të politikave dhe akterëve brenda shtetëror dhe jashtë shtetëror, si domosdoshmëri e ruajtjes së paqes në kontekstin bashkëkohorë të sigurisë.**

1. *Pajtohem plotësisht*; 2. *Pajtohem*; 3. *Nuk kam përgjigje*; 4. *Nuk pajtohem*; 5. *Nuk pajtohem aspak*;

2. **Harmonizimi i legjislationit të Unionit Evropian, që kërkohet për funksionimin e politikave të Sigurisë dhe praktikave të shërbimeve të inteligjencës, në parim ekziston si bazë ligjore tek ne?**

1. *Pajtohem plotësisht*; 2. *Pajtohem*; 3. *Nuk kam përgjigje*; 4. *Nuk pajtohem*; 5. *Nuk pajtohem aspak*;



3. **Sektori i sigurisë në Republikën e Kosovës e ka përmbyllë infrastrukturën ligjore. Mungesa e kuadrit është evidente?**

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

4. **Masat e kontrollit demokratik në parandalimin e tejkalimit të autorizimeve ligjore nga Agjencitë e Shërbimeve Inteligjente, duhet të jenë të sanksionuara me ligj.**

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

5. **Praktika e kontrollit demokratik të një Shërbimi Inteligjent duhet të bazohet në ligj, AKI, a është e sanksionuar mbi bazën e standardeve që kërkohen ?**

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

6. **Mendimi juaj, Shërbimin Inteligjent në një shtet demokratik e bën të suksesshëm dhe të besueshëm;? (mund të rrumbullakoni më shumë se një opsion)**

a) Metodologjia e Shërbimeve Inteligjente;

b) Kontrolli demokratik;

c) Pajisjet Teknike dhe Teknologjike;

d) Interesat gjeopolitike;

e); Aspekti financiar

f) Orientimi Strategjik i Politikave të Sigurisë Nacionale

g) Bashkëpunimi Ndërkombëtare

h) Të tjera: _____



7. Roli i dikurshëm i Shërbimeve inteligjente ishte në interes të kastave politike ?

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

8. Sot fushëveprimtaria e Shërbimeve Inteligjente në vendet demokratike bazohet vetëm në ligj. A duhet të mos tejkalohen autorizimet ligjore?

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

9. Ndikimi i përhapjes së terrorizmit në botë, ka bërë të ngritët gjithandej niveli për një vigjilencë gjithëpërfshirëse “nacionale dhe globale”, te të gjitha llojeve të shërbimeve Inteligjente. AKI –ja, a ka qenë në nivel të detyrës ?

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

10. Orientimet strategjike të një shteti, zakonisht varen prej politikave që ofrojnë Agjencitë e Zbulimit. Kosova a është duke ndërtuar këto koncepte për të ardhmen?

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

11. Politikat e Sigurisë dhe Inteligjencës, zakonisht krijohen mbi bazën e dokumenteve strategjike. A duhet të vazhdohet me këtë metodë?

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;



FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE SHKENCAVE POLITIKE
FAKULTET ZA JAVNA ADMINISTRACIJA I POLITIKI NAUKI
PUBLIC ADMINISTRATION AND POLITICAL SCIENCES

12. Aspekti i operacionalizimi funksional të AKI –së duhet të ndodhë sa më parë me njerëzit më profesional të rinj, të trajnuar mirë dhe të mbikëqyrret në mënyrë demokratike nga akterët që janë të përcaktuar me ligj.

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

13. Praktikat gjithëpërfshirëse në sfidat e luftës kundër terrorizmit dhe specifiku mbi mbikëqyrjen e demokratike parlamentare të shërbimeve inteligjente, janë të domosdoshme për AKI – në.

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

14. Roli i Shoqërisë Civile në monitorimin e funksionimit demokratik të Shërbimeve Inteligjente, është i rëndësishëm.

1. Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

15. Nevoja për informacion të “saktë” dhe të “shpejtë”, ka qenë gjithmonë detyra kryesore e Agjencive të Zbulimit; Teknologjia sot, ka lehtësua dhe ka dekonspirua informacionin?

Pajtohem plotësisht; 2. Pajtohem; 3. Nuk kam përgjigje; 4. Nuk pajtohem; 5. Nuk pajtohem aspak;

Komenti juaj:

Faleminderit për kohën e dedikuar!

Kandidati për Doktoratë

Mr. Sc. Bahri Gashi

ANEKS II - RESPONDENTËT

Realizimi i pyetësorit me respondentët, kryesisht: zyrtarë të lartë të institucione të Sigurisë, Personel të Agjencive të Sigurisë, Polici, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, FSK, dhe AKI, nga bota akademike, përkatësisht studiues dhe profesorë universitarë, njohës të fushës dhe analistë të fushës së sigurisë në Kosovë dhe rajon, është realizuar përmes sistemit të komunikimit elektronik, kryesisht pyetësi është dërguar [online] përmes E-Mailit, SMS – FaceBook, linku gjithashtu është dërguar edhe përmes Wiber –it, gjë që ka lehtësuar tej mase në kohë mundësin e marrjes së shpejt të rezultateve nga respondentët e përzgjedhur paraprakisht.

Respondentët / të pyeturit janë përgjigjur relativisht në një periudhë të shkurtë kohore, diku prej shumica e tyre i kanë dërguar përgjigjet e tyre kah fundi i vitit 2015, përkatësisht në muajt Nëntor dhe Dhjetor. Një ritëm i njëjtë i respondentëve, pothuajse ka vazhduar edhe në fillim vitin 2016, konkretisht në muajt Janar, Shkurt dhe Mars, e kështu me radhë, duke u përmbyllë me dy respondentët e fundit në Shkurt të vitit 2018.

Data

Jan 1978	1
Jul 1978	10
Aug 1978	25
Nov 2015	12 (2) 27
Dec 2015	9 (17) 10 (12) 11 (4) 12 (2) 13 (2) 14 (2) 15 19
Jan 2016	10 14 15
Feb 2016	29
Mar 2016	2
Jun 2016	25
Feb 2018	2

Nr. Rendor:

1, 001, 2, 327, 30, 10, 002, 09, 01, 0409, 7, 7777, 5, 1112111, 100203, 11, 192

Pozita:

Ligjërues; Profesor; Profesor; 1; Oficer për Strategji dhe Doktrina; Si dhe shef i sektorit për Transformim, modernizim dhe standardizim në Forca; Zyrtare për siguri; Ekspert i sigurisë; Zv kryesues; Kirurg Abdominal; Menaxhere e sigurisë; Oficer i lartë; Historian; Menaxher i Projekteve; Drejtor; zyrtar i integriteteve evropiane; n n; 3; Drejtoresh; Këshilltare shtetërore; A 3; Student; Drejtor; Zyrtar i Financave; KP; Dr. Ass; Menaxher; P; none; Major; shef G3/7 BRSH; Analist i sigurisë dhe Inteligjencës; Mjek; Administrate; Ligjërues i lendeve juridiko-politike; këshilltare; Vet punësuar; President; Zyrtar hetues policor; Agjent trafiku; Koordinator i Sektorit për Hulumtime të Opinioneve Publik; Hetues; zyrtar administrative; Rreshter; Shef.

Institucioni:

UP; MPB; Kolegji Iliria; Fakulteti i Shkencave Islame; MFSK; AAK; Ministria e Mbrojtjes; I pavarur; Dpms; Qendra Klinike Universitare e Kosovës; Banka; Organizata të Shoqërisë Civile; QAP; 1; komuna e Gjiçanit; n n; 4; Boost Global Innovation; Qeveria e R. Maqedonisë; ?; SIRAS ACADEMY; Kolegji ISPE; Telekom i Kosovës; none; Forca e Sigurisë së Kosovës; KDI; Shkolle e mesme; Spitali regjional; Asociacioni i Kriminologëve të Kosovës; Publik; UBT; mpb; Vet punësuar; KYATA; Universiteti i Prishtinës; Policia e Kosovës; Aeroporti ndërkombëtarë Prishtinë; SEEU; Institutin për Kriminologji dhe Kriminalistikë në Kosovë; Policia e Kosovës; IIA; Policia e R. Kosovës; Universiteti i Prishtinës; Sektori i sigurisë; Policia e Kosovës.³⁹⁶

³⁹⁶**Shënim:** Për të ruajtur origjinalitetin se si e kanë plotësuar respondentët pyetësori, përkatësisht kategoritë si: Nr. Rendor, Pozita dhe Institucioni, nuk është ndërhyrë fare në tekst, edhe pse janë të dukshme aspektet e lëshimeve gjuhësore.

Komentet e respondentëve;³⁹⁷

Komenti juaj: (Në versionin e tekstit të komenteve nuk është ndërhyrë në aspektin gjuhësor, si të tilla mbetën në versionin origjinal)

Suksese
<i>Agjencitë e Inteligjencën luajnë rol shumë të rëndësishme rëndësishëm, andaj funksionimi dhe organizimi i tyre ka një rëndësi të veçantë për të gjitha shtetet dhe paraqet një dukuri nga më komplekset...</i>
<i>1. konteksti i shtruarjes se pyetjeve jo korrekt.... 2. po te kisha pas mundësi ndërhyrjeje, pyetjet di i kisha strukturuar me ndryshe 3. e sugjestionojnë përgjigjen e ne disa raste e mohojnë përgjigjen ne kontekst</i>
Sukses
Mire
<i>Një teze shume interesante dhe e rrallë për shkencën. Kjo teze disertacioni të botohet sa më parë.</i>
<i>Pyetjet e juaja ne disa raste nuk korrespondojnë me nivelin dhe mundësinë e zgjedhjes se përgjigjeve, dmth Behet pyetja, përgjigja është pohuese ose mohuese dhe nuk jepet mundësia e Përgjigjes se sakte.</i>
<i>Kujtoj se formulimi i pyetjeve gjegjësisht pyetësori do duhej të ishte më specifik, pyetjet do duhej të jenë më të shkurtra dhe të ndara nga aspektet përmbajtjesore, sepse krijohet konfuzion here, herë me përgjigjet e ofruara</i>
<i>Kjo Agjenci ka nevojë për zgjerim me individ nga shoqëria civile. Dhe ka sukses me shume kur mediet kanë e qasje vetëm aq sa i duhet Agjencisë. Teknologjia shpesh po devijon realitetin duhet kontakt fizik për saktësi.</i>
<i>Ju përgëzoj për pyetësorin dhe ju uroj shumë suksese ...</i>
<i>E vlerësoj lartë këtë format pyetësori, gjithsesi pyetjet që keni përcaktua përbëjnë materien e kësaj çështje qe keni shtruar</i>
Me nderime N.L
Suksese. A.S.
suksese!
<i>gjithë te mirat, suksese..... Mënyra e përpilimit te pyetësorit mendoj se është de dikuar atyre te cilët sa do pak njohin qeshjet e sigurisë, në të kundërtën shpresoj se nuk do marrësh përgjigje profesionale por nga apetitet e njerëzve te cilët janë të prirë që të kenë informacione te cilat nuk kane të bëjnë fare me realitetin e kohës.</i>
Suksese!
<i>Teme e qëlluar sidomos tani ne trend me çështjen e sigurisë së kohës moderne bashkëkohore.</i>

³⁹⁷**Shënim:** Për të ruajtur origjinalitetit edhe komentet nuk është ndërhyrë fare në tekst, edhe pse janë të dukshme sapketet e lëshimeve gjuhësore.

-Tezë disertacioni-
KONTEKSTI I SHËRBIMEVE INTELIGJENTE NË POLITIKAT BASHKËKOHORE TË SIGURISË

<i>Disa nga pyetjet janë dizajnuar ne atë mënyrë qe prekin dy çështje njëherësh ...</i>
<i>Mendoj se këto përgjigje të këtyre pyetjeve nga ana ime janë përgjigje adekuate ashtu siç mendoj un..</i>
<i>respekt</i>
<i>Marrë parasysh pozitën strategjike të Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi, është nevojë e kohës që të kemi një shërbim inteligjent tejet efikas, të specializuar dhe larg kastave politike. Praktikant ndërkombëtare tregojnë se sa i rëndësishëm është informacioni i shpejtë i cili sigurohet nëpërmes shërbimi inteligjent dhe agjencive të zbulimit, në parandalimin e shumë tragjedi, respektivisht luftimin e tyre. Andaj, duke pasur parasysh avancimet teknike dhe teknologjike, rritjen e terrorizmit dhe shumë dukurive që mund të jenë fatale për shtetet, e sidomos për shtete me demokraci të re si rasti jonë, është shumë me rëndësi se çfarë institucioni po formojmë. Investimi në kuadro të specializuara dhe sidomos në teknologji është i domosdoshëm.</i>
<i>Ju përgëzoj për pyetësorin e drejte.</i>
<i>Qytetaria duhet ta ndihmoi shërbimin e inteligjencës dhe sigurisë ne vend.</i>
<i>Pyetja 8: AKI duhet ti tejkaloj autorizimet ligjore për ta mbrojtur interesin e shtetit dhe shoqërisë! Pyetja 14: Shoqëria civile nuk duhet te ketë rol monitorues ne AKI sepse kjo shoqëri civile mund ta komprometoj misionin e AKI për shkak te donacioneve qe merr nga burime te ndryshme qe mund te jen edhe te dyshuara.</i>
<i>Nuk kam koment.</i>
<i>Pyetjet te jen me te dhe te ndikojnë qartë në qëllimi të pyetësorit. Ju inkurajoj dhe shpresoj qe te jepni maksimumin ne fushën e sigurisë sot dhe nesër si Dr.</i>
<i>Kompliment për punën tuaj.</i>
<i>Shpresoj qe AKI te jetë një nga shërbimet inteligjente me te suksesshme në botë dhe te jetë me demokratikja ne bote,të gjithë ata qytetar që e donë lirinë të jenë të mbrojtur dhe të jetojnë te qet aty ku ata dëshirojnë. Urime dhe suksese ne pune dhe ne jetë ati që e ka formulua këtë pyetësor,Respekt</i>
<i>Ju dëshiroj suksese, pyetje shumë të qëlluara.</i>
<i>Pyetjet,besoj shume,inkurajojnë përgjigje prej te cilave mund te nxirren përfundime kreative dhe rekomandime shkencore te aplikueshme për sektorin tone te sigurisë,sidomos për inteligjencën. SUKSES! Behari</i>
<i>Shërbimet e inteligjencës ne planin global duhet te kenë edhe partnere një shërbim te ndonjë fuqie botërore.</i>
<i>Shërbimet inteligjente duhet te jene mbi shtetin, ato duhet te mbajnë lidhje te ngushte me krerët e opozitës në mënyrë që të denoncojnë lidhjet mafioze, korruptive, si dhe spiunet e huaj qe mund te jene ne radhët e qeverise (Check and balance princip), ndërsa përsa i përket fushës së anti terrorizmit, kundërspiunazhit, sabotazhit, subversionit dhe krimit te organizuar këto shërbime duhet te jene një krah i fuqishëm ne vendimmarrjen e presidentit te republikes si kryetar i këshillit te sigurisë kombëtare ashtu dhe te kryeministrit cilido qofte ai. Shërbimet inteligjente duhet te përfshihen vetëm ne veprimet anti-terror dhe jo kundra-terror. Fatkeqësisht shërbimet inteligjente te Shqipërisë dhe Kosovës nuk e kane asnjërën prej tyre. Te dy këto shërbime janë mbushur me njerëz servile, me emërime nepotike, me llumin e shoqërisë te cilët janë kthyer ne spiune te rëndomte për interesat diabolike ne luftën politike. Kjo gjë i ka bere shërbimet tona vulnerable ndaj shërbimeve inteligjente me qëndrime miqësore te cilët shfrytëzojnë rastin te marrin info se çfarë vërtet ndodh ne qeveri dhe për ato me qëndrime jo-miqësore qe kane vite qe vazhdojnë dhe do te vazhdojnë akoma te sabotojnë vendet tona persa kohe njerëzit e paaftë dhe jo patriot udhëheqin shtetet tona. Nuk dua te them kryetaret e shërbimeve janë injorante pasi nga kryetaret e qeverive janë te tille atëherë edhe kryetaret e</i>

<i>shërbimeve janë te tille pasi janë pasqyra e vërtete e qeverise dhe e shtetit. Me fal për radikalizmin qe po shfaq ne ketë koment por e vërteta e është kjo.</i>
<i>Suksese miku im</i>
<i>Profesionalizimi dhe profesionalizmi i shërbimeve të inteligjencës janë thelbësore për stabilitetin, sigurinë dhe imazhin e mirë ndërkombëtar të një vendi, shteti të ri, në tranzicion si Kosova.</i>
<i>Mendoj që pyetjet e ngritura nuk janë të ndërtuara ashtu si duhet-disa prej tyre Ju uroj shumë suksese</i>
<i>Mendoj se jam përgjigjur mbi bazën e bindjes logjike</i>
<i>Pajtohem plotësisht</i>
<i>Ne këtë kontekste duhet te ketë një kriterium multi profesionale sa i përket departamentit te sigurisë se shtetit , duke zgjedhure ekupe te shkolluara dhe me përvojë , ne mënyrë qe shteti te privohet nga çdo rrezik eventual , dhe për një siguri sa me efikase kundrejt qytetareve te Kosovës.</i>
<i>Te disa pyetje, kam përshtypjen se përsëriten (p.sh pyetja nr.4 dhe 5.)</i>
<i>Ky pyetësor është një ndër pyetësorët më profesional që kam hasur deri më tani, por e kam pak të vështirë për ta përcaktuar se cili është parametri matës tek përgjigjet opsionale të cilat janë dhënë, ngase ato janë përgjithësuese dhe nuk përmbajnë shpjegime se cili është niveli i vlerësimit në shifra numerike dhe se si mund të bëhet evaluimi i përgjigjeve gjatë procesit të analizës. Përndryshe e uroi autorin për punën e jashtëzakonshme dhe për kontributin që ky punim shkencorë do të jap në të ardhmen në lëmin e Shërbimeve Inteligjente e veçanërisht në profesionalizimin e AKI-së, në Kosovë.</i>
<i>Nuk kam diçka per te komentuar</i>
<i>Uroj që kjo tezë të ketë sukses!</i>
<i>Nuk kam koment!</i>
<i>Ne pyetjen numër 12 nuk kam informacion mbi profesionalizmin e shumicës se stafit por mendoj se AKI është institucion i ri dhe nuk e di sa kane pas raste dhe mundësi qe stafi te tregoj profesionalizmin e tij. Ndërsa ne pyetjen e 14 duke njohur rrethanat e vendeve ne tranzicion ku shoqëria civile financohet kryesisht nga Organizatat Ndërkombëtare nuk jam i sigurt se është ide e mire qe Shoqëria Civile te monitoroj funksionimin demokratik te Shërbimeve Inteligjente sidomos ne vendet ne tranzicion siç është Kosova.</i>
<i>Ne fushën e sigurisë duhet te përfshihen te rinj, profesionist, te mos politizohet. Një shtet është i fuqishëm nëse ka funksional sigurinë dhe inteligjencën.</i>
<i>Kërkohe me prioritet reformim i AKI dhe Institucioneve tjera te sigurisë si ajo e Policisë dhe tjera. Termi Inteligjencë te kuptohet si filozofi dhe jo emër shërbimi apo organizate. Te formohet Agjencia për Klasifikim te Informatës dhe Verifikim te Sigurisë si mjet për vënien në binar te shërbimeve inteligjente dhe ato te sigurisë në Republikën e Kosovës. Ps. Nga karriera ime në sferën e sigurisë ky pyetësor është nga ato me standardin me te lartë cilësor,përmbajtjesor dhe me objektiva te qarta.</i>

ANEKS III - INTERPRETIMI DHE ANALIZA TABELARE - PRELIMINARE

Interpretimi dhe shpalosja e rezultateve kuantitative³⁹⁸

Në këtë ANEKS si shtojcë e veçantë, do të nxjerrim rezultatet nga realizimi i pyetësorit elektronik dhe rezultatet e nxjerra, sipas programit SPSS (Statistical Package for the Social Science) dhe (Docs Google – Drive Software).³⁹⁹

Interpretimi dhe shpalosja e rezultateve nga pyetësori i ndërtuar, nga respondentët është kërkuar emri i institucionit ku punojnë dhe pozita të cilën e bartin, po ashtu është shënuar data e realizimit të pyetësorit dhe normalisht pyetësori ka qenë i koduar. Janë realizuar gjithsej 54 pyetësorë me respondentë e përzgjedhur;⁴⁰⁰ kryesisht me institucione, përkatësisht përgjegjësit dhe zyrtarët, me disa institucione në numër më të madh, me disa në numër më të vogël. Mos realizimi i njëjtë në numër i pyetësorëve me institucionet e lartshënuara ka ndodhur që për shkak të specifikave të pyetësorit ka ndodhë hezitimi për tu përgjigjur, në raste të caktuara. Edhe pse është treguar se qëllimi pyetësorit dhe specifikat e tij, ku është cekur edhe në pyetësorë se qëllimi i vlerësimeve do të përdoren vetëm për arsye hulumtuese shkencore për tezën e disertacionit.

Pyetësori si tërësi përmban gjithsej 15 konkludime dhe 1 pyetje. Vlerësimi i konkludimeve është bërë me metodën e shkallës Likert, duke e koduar pyetësorin.

Respondentët është dashur që të vlerësojnë konkludimin tonë me njërën nga pesë (5) mundësitë:

- 1. Pajtohem plotësisht**
- 2. Pajtohem**
- 3. Nuk kam përgjigje**
- 4. Nuk pajtohem**
- 5. Nuk pajtohem aspak**

³⁹⁸ Pyetësori është realizuar [online] përmes docsgoogle – drive software , përmes g-mail: bahri.m.gashi@gmail.com <https://docs.google.com/forms/d/1hHXunODiti20YdfmJCrSLkCQrXK25I3zO86MrDFU4d0/vi-ewanalytics>

³⁹⁹ <https://drive.google.com/drive/my-drive>

⁴⁰⁰ **Sqarim:** Pyetësori është realizuar me respondentë të kualifikuar, specifikisht me zyrtarë të lartë të institucioneve të Sigurisë dhe Inteligjencës, personel të agjencive të sigurisë; Policisë, Këshillit të Sigurisë së Kosovës, FSK, MM dhe AKI, nga bota akademike, përkatësisht studiues dhe profesor universitar, njohës dhe analistë të fushës së sigurisë në Kosovë dhe rajon. Mostra e shtresëzuar – stratifikuar, si (zgjidhje e qëllimshme), mjaftueshëm nënkupton kredibilitetin e respondentëve edhe pse në numër prej 54 sish, rrjedhimisht (i kufizuar, por i kualifikuar), ka synuar tre elemente kyçe të mostrës specifike; **Privilegjin intelektual, hapsirën urbane të komunikimit [online] dhe aspektin menaxherial**, që ka rezultuar në njohës të fushës. Duke i përzgjedhur me mjaft kujdes, pasë parasyshë specifikën e tematikës së trajtuar, respondentët e kualifikuar (Mostra specifike) nga pyetësori ka përmbyshtë synimet në konkludimet tona.

Siç u theksua edhe më lartë, pyetësi është i ndërtuar sipas modelit të konkludimeve dhe ka qenë menduar sipas atij koncepti që kemi pasur 15 pyetje më një mundësi zgjedhjeje, disa pyetje tematike, pyetja numër 6 ka pas më shumë se një opsion të përgjigjes, njëherit këto pyetje kanë qenë të atilla që ne kemi pritur përgjigjet sipas konceptimit të parashtruar.

Ky pyetësor është dizajnuar i atillë si format me një opsion të përgjegjës, është ndërtuar për të realizuar matjen në mënyrë empirike të disa aspekteve rreth pyetjeve të parashtruara, me theks të veçantë në fushën e shërbimeve inteligjente. Realizimi i këtij pyetësi ka prodhuar një rezultat të kompletuar dhe është realizuar me disa kategori respondentësh si në vijim: Staf akademik, përfshirë profesor të fushës; Ekspert të Shoqërisë Civile, Përgjegjës të Sektorit të Sigurisë dhe Inteligjencës; Komisionet Parlamantare në Republikën e Kosovës, Organizatat qeveritare dhe joqeveritare simorta, brenda dhe jashtë vendit. Duhet të theksohet se pyetësi ka siguruar kofidencë dhe anonimitet të plotë, dhe këto vlerësime janë përdorë vetëm për qëllime akademike të hulumtimit në tezën e doktoratës “Kontekstit i Shërbimeve inteligjente në politikat bashkëkohore të sigurisë”.

Në fund të pyetësit e kemi një pjesë të emërtuar si Komentet tuaja, ku këtë pjesë është lënë me qëllim që të ju japim hapësirë respondentëve të shënojnë ndonjë koment shtesë rreth pyetjeve të pyetësit, ndërtimit të pyetësit, vërejtjeve eventuale, kritikave, sugjerimeve etj .


Në vijim do të tregojmë rezultatet e secilit konkludim/pyetje, në formë tabelore, në formë grafikoni dhe me komente përcjellëse statistikore.

Rezultatet kryesisht do të paraqiten përmes diagramit rrethor - sipërfaqësor të njohura si histograme, apo rrethe sturkturale, apo diagrami tortë, përmes grafiteve statistikore, si një nga metodat më të përhapura në botë dhe praktikat e paraqitjeve të rezultateve preliminare dhe atyre përfundimtare statistikore të vlerave numerike.

Poashtu prezantimi i këtyre rezultateve do të bëhet edhe përmes formave të tjera të paraqitjeve përmes shtyllave të thjeshtëzuara, të njohura të njëfishta, dhe shtyllave të dyfishta me shënime numerike poshtë vijëzimeve tabelore.

Sa i përket rezultatit që kemi nxjerrë siq u tha më lartë nga realizimi i 54 pyetësorëve me: respondentët sipas një kategorie të Mostrës shtresëzuese, kryesisht të fushës së sigurisë dhe inteligjencës dhe botës akademike, pritjet e rezultutative për konkludimin e parë: ***“Aspekti i sigurisë dhe inteligjencës, është i nxitur nga nevoja e krijimit të politikave dhe akterëve brenda shtetëror dhe jashtë shtetëror, si domosdoshmëri e ruajtjes së paqes në kontekstin bashkëkohorë të sigurisë”*** rezultati më i dalluar është fokusuar në dy kategoritë e para të përgjigjeve dhe si rrejthojnë është arritë ky rezultat:

1. Aspekti i sigurisë dhe Inteligjencës, është i nxitur nga nevoja e krijimit të politikave dhe akterëve brenda shtetëror dhe jashtë shtetëror, si domosdoshmëri e ruajtjes së paqes në kontekstin bashkëkohorë të sigurisë.



Pajtohem plotësisht	31	57.4%
Pajtohem	23	42.6%
Nuk kam përgjigje	0	0%
Nuk pajtohem	0	0%
Nuk pajtohem aspak	0	0%

Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit të parë, variojnë rezultatin si në vijim:

❖ **Opsioni i parë (Pajtohem plotësisht)**

- ka marrë 31 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 57.4%;

❖ **Opsioni i dytë (Pajtohem)**


- ka marrë 23 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 42.6 %;

❖ **Opsioni i tretë (Nuk kam përgjigje)**

- ka marrë 0 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 0 %;
- ❖ **Opsioni i katërt** (*Nuk pajtohem*)
 - ka marrë 0 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 0 %;
- ❖ **Opsioni i pestë** (*Nuk pajtohem aspak*)
 - ka marrë 0 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 0 %.

Ky raport statistikor rezulton se respondentët pothuajse janë të ndarë në dy grupe sa i përket te *“Aspekti i sigurisë dhe inteligjencës, është i nxitur nga nevoja e krijimit të politikave dhe akterëve brendashtetror dhe jashtshtetror, si domosdoshmëri e ruajtjes së paqes në kontekstin bashkëkohorë të sigurisë”* edhe pse rezultati më i dalluar është fokusuar në dy kategoritë pajtueshmëria e respondentëve është pothuajse e barabartë me nuanca pak më të theksuara në opsionin e parë.

2- Harmonizimi i legjisllacionit me Unionin Evropian, që kërkohet për funksionimin e politikave të sigurisë dhe praktikave të shërbimeve të inteligjencës, në parim a ekziston si bazë ligjore tek ne.



Pajtohem plotësisht	7	13%
Pajtohem	32	59.3%
Nuk kam përgjigje	10	18.5%
Nuk pajtohem	5	9.3%
Nuk pajtohem aspak	0	0%

Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit të dytë, variojnë rezultatin si në vijim:

❖ **Opsioni i parë** (*Pajtohem plotësisht*)

- ka marrë 7 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 13%;

❖ **Opsioni i dytë** (*Pajtohem*)

- ka marrë 32 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehem 59.3 %;

❖ **Opsioni i tretë** (*Nuk kam përgjigje*)

- ka marrë 10 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 18.5 %;

❖ **Opsioni i katërt** (*Nuk pajtohem*)

- ka marrë 5 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 9.3 %;


❖ **Opsioni i pestë** (*Nuk pajtohem aspak*)

- ka marrë 0 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 0 %.

Edhe ky raport statistikor prodhon një rezultat se respondentësh pothuajse të ndryshëm nga i pari, meqë respondentët janë ndarë në më shumë grupe përgjigjesh.

Sa i përket përgjigjeve në konkludimin tone se “**Harmonizimi i legjislacionit me Unionin Evropian, që kërkohet për funksionimin e politikave të sigurisë dhe praktikave të shërbimeve të inteligjencës, në parim a ekziston si bazë ligjore tek ne**”, rezultati më i dalluar në logjikën racionale dhe domosdoshmërinë e respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, prej tyre 32 sish në total prej 59-3 % janë pajtuar se këndvështrimi i aspektit ligjor, i nxjerrë nga pyetja e dytë që iu është parashtruar respondentëve, sipas specifikave të modelit të Unionit Evropian është ndarë kryesisht në tri kategori përgjigjesh si peshë specifike kuantitative sasiore.

3. Sektori i sigurisë në Republikën e Kosovës e ka përmbyllë infrastrukturën ligjore. Mungesa e kuadrit është e evidente.



Pajtohem plotësisht	15	27.8%
Pajtohem	26	48.1%
Nuk kam përgjigje	6	11.1%
Nuk pajtohem	6	11.1%
Nuk pajtohem aspak	1	1.9%

Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludit të tretë, variojnë rezultatin si në vijim:

❖ **Opsioni i parë** (*Pajtohem plotësisht*)

- ka marrë 15 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 27%;

❖ **Opsioni i dytë** (*Pajtohem*)

- ka marrë 26 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet 48.1 %;

❖ **Opsioni i tretë** (*Nuk kam përgjigje*)

- ka marrë 6 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 11 %;

❖ **Opsioni i katërt** (*Nuk pajtohem*)

- ka marrë 6 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 11 %;


❖ **Opsioni i pestë** (*Nuk pajtohem aspak*)

- ka marrë 1 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 1.9 %.

Respondentët e kualifikuar kanë rezultuar përgjigje pothuajse të ndryshme nga dy konkludimet e para, meqë respondentët janë ndarë në më shumë grupe përgjigjesh. Këtu kemi marrë në të gjitha opsionet përgjigje, varësisht nga logjika e respondentëve në përgjigjet e tyre.

Përgjigjeve në konkludimin tonë se “**Sektori i sigurisë në Republikën e Kosovës e ka përmbyllë infrastrukturën ligjore. Mungesa e kuadrit është e evidente.**”, rezultati më i dalluar konsiston në domosdoshmërinë e respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, prej tyre 26 sish në total prej 48.1 % janë pajtuar në pyetjen e parashtruar. Përderisa janë pajtuar plotësisht rreth 27% dhe 48 % po ashtu kanë paraqitur pozicion të pajtueshmërisë, rezultati i kësaj pyetje në formë konkludimi del se 75 % e respondentëve janë pajtuar se Infrastruktura ligjore në sektorin e sigurisë është përmbyllë, dhe kanë lënë për të kuptuar nevojën për kuadër, burime njerëzore të cilët do të ishin krijuar kapacitetet zbatuese të kësaj infrastrukture ligjore.

4. Masat e kontrollit demokratik në parandalimin e tejkalimit të autorizimeve ligjore nga Agjencitë e Shërbimeve Inteligjente, duhet të jenë të sanksionuara me ligj.



Pajtohem plotësisht	36	66.7%
Pajtohem	15	27.8%
Nuk kam përgjigje	2	3.7%
Nuk pajtohem	0	0%
Nuk pajtohem aspak	1	1.9%


Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së katërt, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë** (*Pajtohem plotësisht*)
 - ka marrë 36 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 66%;
- ❖ **Opsioni i dytë** (*Pajtohem*)
 - ka marrë 15 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 27.8 %;
- ❖ **Opsioni i tretë** (*Nuk kam përgjigje*)
 - ka marrë 2 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 3.7 %;
- ❖ **Opsioni i katërt** (*Nuk pajtohem*)
 - ka marrë 0 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 0 %;
- ❖ **Opsioni i pestë** (*Nuk pajtohem aspak*)
 - ka marrë 1 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 1.9 %.

Edhe këtu respondentët kanë rezultuar përgjigje pothuajse të ndryshme, meqë respondentët janë ndarë në disa grupe përgjigjesh. Këtu kemi marrë përgjigje në katër opsione, varësisht nga mendimet e respondentëve janë dhënë përgjigjet e tyre.

Përgjigjeve në konkludimin tonë se “**Masat e kontrollit demokratik në parandalimin e tejkalimit të autorizimeve ligjore nga Agjencitë e Shërbimeve Inteligjente, duhet të jenë të sanksionuara me ligj**”, konkluzioni më i dalluar konsiston në domosdoshmërinë e respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, prej tyre 36 sish në total prej 66 % janë pajtuar në pyetjen e parashtruar. Përderisa janë pajtuar plotësisht rreth 15% dhe 27 % po ashtu kanë paraqitur pozicion të pajtueshmërisë shumica dërmuese, dhe, rezultati përfundimtar këtyre përgjigjeve në formë konkludimi kanë rezultuar me 93 % e respondentëve janë pajtuar se masat e kontrollit demokratik në parandalimin e tejkalimit të autorizimeve ligjore nga Agjencitë e Shërbimeve Inteligjente, duhet të jenë të sanksionuara me ligj dhe kanë lënë për të kuptuar domosdoshmërinë e zbatimit të këtyre masave ligjore.

5. Praktika e kontrollit demokratik të një Shërbimi Inteligjent duhet të bazohet në ligj, AKI është e sanksionuar mbi bazën e standardeve që kërkohen.



Pajtohem plotësisht	17	31.5%
Pajtohem	21	38.9%
Nuk kam përgjigje	13	24.1%
Nuk pajtohem	3	5.6%
Nuk pajtohem aspak	0	0%

Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë (Pajtohem plotësisht)**
 - ka marrë 17 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 31.5%;
- ❖ **Opsioni i dytë (Pajtohem)**
 - ka marrë 21 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 38.9 %;
- ❖ **Opsioni i tretë (Nuk kam përgjigje)**
 - ka marrë 13 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 24 %;
- ❖ **Opsioni i katërt (Nuk pajtohem)**
 - ka marrë 3 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 5.6 %;
- ❖ **Opsioni i pestë (Nuk pajtohem aspak)**
 - ka marrë 0 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 0 %.

Këtu respondentët kanë rezultuar përgjigje pothuajse të ndryshme, meqë respondentët janë ndarë në disa grupe përgjigjesh. Edhe këtu kemi marrë përgjigje në katër opsione, varësisht nga mendimet e respondentëve janë dhënë përgjigjet e tyre.

Përgjigjeve në konkludimin tonë se ***“Praktika e kontrollit demokratik të një Shërbimi Inteligjent duhet të bazohet në ligj, AKI është e sanksionuar mbi bazën e standardeve që kërkohen”*** konkluzioni më i dalluar konsiston në domosdoshmërinë e respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, prej tyre 31% janë pajtuar plotësisht në pyetjen e parashtruar. Përderisa janë pajtuar rreth 38% e respondentëve. Mund të thuhet se rezultati përfundimtar këtyre përgjigjeve në formë konkludimi kanë rezultuar me një shumicë të konsideruar prej 69 % e respondentëve janë pajtuar se praktikat e kontrollit demokratik duhet të gjejnë zbatueshmëri vetëm në ligj dhe të jenë të sanksionuara me ligj. Po ashtu standardet që kërkohen për zbatueshmërinë ligjore mbetet një tjetër pjesë e rëndësishme e përgjigjeve të tyre.

6. Mendimi juaj, Shërbimin Inteligjent në një shtet demokratik e bën të suksesshëm dhe të besueshëm. Përgjigje me më shumë se një opsion



Konkludimet e grumbulluara rreth konkludit të gjashtë, rezultatet me më shumë përgjigje si në vijim:

- ❖ **Konkludimi i parë (Metodologjia e Shërbimeve Inteligjente)**
 - ka marrë 30 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 55.6 %;
- ❖ **Konkludimi i dytë (Kontrolli demokratik)**
 - ka marrë 30 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 55.6 %;
- ❖ **Konkludimi i tretë (Pajisjet Teknike dhe Teknologjike)**
 - ka marrë 24 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 44.4 %;
- ❖ **Konkludimi i katërt (Interesat Gjeopolitike)**
 - ka marrë 13 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 24.1 %;
- ❖ **Konkludimi i pestë (Aspekti financiar)**
 - ka marrë 22 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 40.7 %
- ❖ **Konkludimi i gjashtë (Orientimi Strategjik i Politikave të Sigurisë Nacionale)**
 - ka marrë 29 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 53.7 %.
- ❖ **Konkludimi i shtatë (Bashkëpunimi Ndërkombëtar)**
 - ka marrë 30 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 55.6 %.
- ❖ **Konkludimi i tetë (Të tjera)**
 - ka marrë 6 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 11.1 %.

Në këtë Bar diagram, formati i pyetjeve dhe përgjigjeve u ka dhënë hapësirë respondentëve të kenë zgjedhur më shumë mundësi përgjigjesh të një natyre tjetër, pothuajse të ndryshme dhe unike, meqë respondentët kanë pasur më shumë mundësi tematike dhe variacione në përgjigje.


Këtu kemi marrë përgjigje në të gjitha konkludimet prej tetë sish opsione, varësisht nga mendimet e respondentëve janë dhënë përgjigjet e tyre sipas përqindjeve relative.

Përgjigjeve në konkludimin tonë se ***“Mendimi juaj, Shërbimin Inteligjent në një shtet demokratik e bën të suksesshëm dhe të besueshëm. Përgjigje me më shumë se një opsion”***

përgjigjet kanë konkluduar në një arsyeshmëri konstante në pothuajse të të gjitha pyetjeve, gjë që kanë rezultuar me përgjigje të qëndrueshme teorike.

Pothuajse janë pajtuar plotësisht mendimet se në pyetjen themelore me më shumë opsione të shtimit të variacioneve të nën pyetjeve kemi marrë rezultat të mjaftueshëm komulativ. Konkludimet në katër prej tyre kanë treguar pajtueshmëri sasiore në shumicën e bindjeve dhe shprehjen e mendimeve se Shërbimin e Inteligjent të një shteti demokratik e bën të besueshëm variacionet kanë sjell rezultat në mes të ***(Metodologjisë së Shërbimeve Inteligjente, Pajisjeve Teknike e Teknologjike; Kontrollit Demokratik, dhe para së gjithash; Orientimin Strategjik të Politikave të Sigurisë Nacionale)*** me masë të madhe të konkludimeve të respondentëve.

7. Roli i dikurshëm i Shërbimeve inteligjente ishte në interes të kastave politike.



Pajtohem plotësisht	29	53.7%
Pajtohem	17	31.5%
Nuk kam përgjigje	6	11.1%
Nuk pajtohem	2	3.7%
Nuk pajtohem aspak	0	0%


Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë** (*Pajtohem plotësisht*)
 - ka marrë 29 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 53.7%;
- ❖ **Opsioni i dytë** (*Pajtohem*)
 - ka marrë 17 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 31.5 %;
- ❖ **Opsioni i tretë** (*Nuk kam përgjigje*)
 - ka marrë 6 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 11 %;
- ❖ **Opsioni i katërt** (*Nuk pajtohem*)
 - ka marrë 2 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 3.7 %;
- ❖ **Opsioni i pestë** (*Nuk pajtohem aspak*)
 - ka marrë 0 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 0 %.

Edhe këtu respondentët kanë rezultuar me përgjigje variabile, meqë respondentët janë ndarë në disa grupe përgjigjesh. Në konkludimin e shtatë kemi marrë përgjigje në katër opsione, varësisht nga mendimet e respondentëve janë dhënë përgjigjet e tyre.

Përgjigjeve në konkludimin tonë se ***“Roli i dikurshëm i Shërbimeve inteligjente ishte në interes të kastave politike”*** konkluzioni më i dalluar konsiston në pajtueshmërinë e respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, prej tyre 53.7 % janë pajtuar plotësisht në pyetjen e parashtruar. Përderisa janë pajtuar rreth 31.5 % e respondentëve. Këtu mund të thuhet se rezultati përfundimtar këtyre përgjigjeve në formë konkludimi kanë rezultuar me një shumicë të konsideruar prej 84 % e respondentëve janë pajtuar se roli i dikurshëm i shërbimeve inteligjente ishte në interes të kastave politike. Po ashtu janë evidentuar edhe përgjigje dhe mendime të tjera të cilat kanë rezultuar me një përqindje më të vogël si shprehje rentabile sasiore.

8. Sot fushëveprimtaria e Shërbimeve Inteligjente në vendet demokratike bazohet vetëm në ligj. Duhet të mos tejkalohen autorizimet ligjore.



Pajtohem plotësisht	27	50%
Pajtohem	20	37%
Nuk kam përgjigje	0	0%
Nuk pajtohem	3	5.6%
Nuk pajtohem aspak	4	7.4%


Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë (Pajtohem plotësisht)**
 - ka marrë 27 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 50.%;
- ❖ **Opsioni i dytë (Pajtohem)**
 - ka marrë 20 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 37. %;
- ❖ **Opsioni i tretë (Nuk kam përgjigje)**
 - ka marrë 0 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 0 %;
- ❖ **Opsioni i katërt (Nuk pajtohem)**
 - ka marrë 3 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 5.6 %;
- ❖ **Opsioni i pestë (Nuk pajtohem aspak)**
 - ka marrë 4 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 7.4 %.

Respondentët kanë rezultuar me përgjigje variabile edhe në këtë konkludim, përkatësisht respondentët janë ndarë edhe këtu në disa grupe përgjigjesh, për kryesisht janë ndalur në dy opsionet e para. Këtu kemi marrë përgjigje në katër opsione, varësisht nga mendimet e respondentëve janë dhënë përgjigjet e tyre.

Në konkludimin tonë se ***“Sot fushëveprimtaria e Shërbimeve Inteligjente në vendet demokratike bazohet vetëm në ligj. Duhet të mos tejkalohen autorizimet ligjore”*** janë shfaqur dykonkluzione më të dalluara dhe që konsistojnë në pajtueshmërinë e respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, prej tyre 50 % janë pajtuar plotësisht në pyetjen e parashtruar. Përderisa janë pajtuar rreth 37 % e respondentëve, e që mund të thuhet se rezultati përfundimtar këtyre përgjigjeve në formë konkludimi me përgjigjet ***“PAJTOHEM PLOTËSISHT”*** dhe ***“PAJTOHEM”*** kanë rezultuar me një shumicë të konsideruar të respondentëve, që janë pajtuar se sot fushëveprimtaria e Shërbimeve Inteligjente në vendet demokratike bazohet vetëm në ligj dhe duhet të mos tejkalohen autorizimet ligjore është mendimi i shumicës së dërmuese të respondentëve prej 87%. Po ashtu janë shprehur edhe disa përgjigje të tjera të cilat kanë rezultuar me një përqindje më të vogël si mendime më pak vlerësuese.

9. Ndikimi i përhapjes së terrorizmit në botë, ka bërë të ngritët gjithandej niveli për një vigjilencë gjithëpërfshirëse “nacionale dhe globale”, të të gjitha llojeve të shërbimeve Inteligjente. AKI –ja, a ka qenë në nivel të detyrës.



Pajtohem plotësisht	5	9.3%
Pajtohem	17	31.5%
Nuk kam përgjigje	15	27.8%
Nuk pajtohem	15	27.8%
Nuk pajtohem aspak	2	3.7%


Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit të pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë (Pajtohem plotësisht)**
 - ka marrë 5 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 9.%;
- ❖ **Opsioni i dytë (Pajtohem)**
 - ka marrë 17 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 31.5 %;
- ❖ **Opsioni i tretë (Nuk kam përgjigje)**
 - ka marrë 15 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 27.8 %;
- ❖ **Opsioni i katërt (Nuk pajtohem)**
 - ka marrë 15 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 27.8 %;
- ❖ **Opsioni i pestë (Nuk pajtohem aspak)**
 - ka marrë 2 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 3.7 %.

Në konkludimin tonë të nëntë kemi përgjigje të plota nga respondentët, përkatësisht respondentët janë ndarë edhe këtu në pesë grupe përgjigjesh, duke u orientuar në tri opsione. Këtu kemi marrë përgjigje në të gjitha opsionet, varësisht nga mendimet e respondentëve janë dhënë përgjigjet e tyre.

Në konkludimin tonë se ***“Ndikimi i përhapjes së terrorizmit në botë, ka bërë të ngritët gjithandej niveli për një vigjilencë gjithëpërfshirëse “nacionale dhe globale”, të të gjitha llojeve të shërbimeve Inteligjente. AKI –ja, a ka qenë në nivel të detyrës”*** janë shfaqur tri konkluzione kryesore më të dalluara, e që konsistojnë në pajtueshmërinë e respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, prej tyre 31 % janë pajtuar në pyetjen e parashtruar. Përderisa nuk janë pajtuar 15% dhe po ashtu 15 % e respondentëve nuk kanë përgjigje fare, e që mund të thuhet se rezultati përfundimtar këtyre përgjigjeve në formë konkludimi me përgjigjet ***“ NUK PAJTOHEM, PAJTOHEM dhe NUK KAM PËRGJIGJIE”*** kanë rezultuar me një shumicë e thjeshtë të respondentëve, që janë pajtuar se ndikimi i përhapjes së terrorizmit në botë, ka bërë të ngritët gjithandej niveli për një vigjilencë gjithëpërfshirëse “nacionale dhe globale”, të të gjitha llojeve të shërbimeve Inteligjente. AKI –ja, a ka qenë në nivel të detyrës është mendimi i shumicës së respondentëve prej 61%. Po ashtu janë shprehur edhe disa përgjigje të tjera të cilat kanë rezultuar me një përqindje më të vogël si mendime të kundërta shprehimore.

10. Orientimet strategjike të një shteti, zakonisht varen prej politikave që ofrojnë Agjencitë e Zbulimit. Kosova a është duke ndërtuar këto koncepte për të ardhmen.



Pajtohem plotësisht	4	7.4%
Pajtohem	17	31.5%
Nuk kam përgjigje	17	31.5%
Nuk pajtohem	14	25.9%
Nuk pajtohem aspak	2	3.7%


Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë (Pajtohem plotësisht)**
 - ka marrë 4 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 7.4%;
- ❖ **Opsioni i dytë (Pajtohem)**
 - ka marrë 17 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 31.5 %;
- ❖ **Opsioni i tretë (Nuk kam përgjigje)**
 - ka marrë 17 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 31.5 %;
- ❖ **Opsioni i katërt (Nuk pajtohem)**
 - ka marrë 14 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 25.9 %;
- ❖ **Opsioni i pestë (Nuk pajtohem aspak)**
 - ka marrë 2 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 3.7 %.

Edhe në konkludimin tonë të dhjetë kemi përgjigje të plota në të gjitha opsionet nga respondentët, përkatësisht respondentët edhe këtu janë ndarë në pesë grupe përgjigjesh, duke u orientuar në tri opsione themelore. Këtu kemi marrë përgjigje në të gjitha opsionet, përkatësisht nga mendimet e respondentëve janë dhënë përgjigjet e tyre si në vijim:

Në konkludimin tonë se ***“Orientimet strategjike të një shteti, zakonisht varen prej politikave që ofrojnë Agjencitë e Zbulimit. Kosova a është duke ndërtuar këto koncepte për të ardhmen”*** janë shfaqur tri konkluzione kryesore më të dalluara, e që konsistojnë në pajtueshmërinë e respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, prej tyre 31 % janë pajtuar në pyetjen e parashtruar. Përderisa nuk janë pajtuar 25 % dhe po ashtu 31 % e respondentëve nuk kanë përgjigje fare, e që mund të thuhet se rezultati përfundimtar këtyre përgjigjeve në formë konkludimi me përgjigjet e tyre në opsionet ***“NUK PAJTOHEM, PAJTOHEM dhe NUK KAM PËRGJIGJIE”*** kanë rezultuar me një rezultat variabil në papajtueshmëri të respondentëve, që janë pajtuar se orientimet strategjike të një shteti, zakonisht varen prej politikave që ofrojnë Agjencitë e Zbulimit dhe se Kosova a është duke ndërtuar këto koncepte për të ardhmen, është mendimi i shumicës së respondentëve prej 56 % kanë shprehur skepticizëm dhe papajtueshmëri. Po ashtu janë shprehur edhe disa vlerësime pozitive prej tyre 31% janë pajtuar, po ashtu ka edhe përgjigje të tjera të cilat kanë rezultuar me një përqindje më të vogël si mendime të mos njohjes së fenomenit problemor.

11. Politikat e Sigurisë dhe Inteligjencës, zakonisht krijohen mbi bazën e dokumenteve strategjike. Duhet të vazhdohet me këtë metodë.



Pajtohem plotësisht	20	37%
Pajtohem	27	50%
Nuk kam përgjigje	5	9.3%
Nuk pajtohem	2	3.7%
Nuk pajtohem aspak	0	0%


Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë (Pajtohem plotësisht)**
 - ka marrë 20 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 37 %;
- ❖ **Opsioni i dytë (Pajtohem)**
 - ka marrë 27 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 50. %;
- ❖ **Opsioni i tretë (Nuk kam përgjigje)**
 - ka marrë 5 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 9.3 %;
- ❖ **Opsioni i katërt (Nuk pajtohem)**
 - ka marrë 2 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 3.7 %;
- ❖ **Opsioni i pestë (Nuk pajtohem aspak)**
 - ka marrë 0 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 0 %.

Në këtë konkludim kemi përgjigje të në katër opsionet nga respondentët, sikurse dhe nga praktika e lartëshunuara, respondentët edhe këtu janë ndarë në grupe përgjigjesh, duke u orientuar në dy opsione kryesore. Duke i parë përgjigjet në opsionet, përkatësisht mendimet e respondentëve kanë prodhura përgjigje me këtë rezultat të pajtueshmërisë si në vijim:

Në konkludimin tonë se ***“Politikat e Sigurisë dhe Inteligjencës, zakonisht krijohen mbi bazën e dokumenteve strategjike. Duhet të vazhdohet me këtë metodë ”***. Këtu janë shfaqur dy konkluzione kryesore më të dalluara, e që konsistojnë në pajtueshmërinë e këtij grupi të respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, prej tyre 37 % janë pajtuar plotësisht në pyetjen e parashtruar. Përderisa janë pajtuar 50 % e respondentëve, mund të thuhet se rezultati përfundimtar këtyre përgjigjeve në formë konkludimi me përgjigjet e tyre në dy opsionet ***“PAJTOHEM PLOTËSISHT dhe PAJTOHEM”*** kanë rezultuar me një rezultat postulati komulativ të papajtueshmërisë së respondentëve, që janë pajtuar Politikat e Sigurisë dhe Inteligjencës, zakonisht krijohen mbi bazën e dokumenteve strategjike dhe se, duhet të vazhdohet me këtë metodë, është mendimi i shumicës së respondentëve prej tyre si shprehje unanime 87 % kanë shprehur papajtueshmëri. Po ashtu janë shprehur edhe disa vlerësime të tjera, të cilat kanë rezultuar me një përqindje më të vogël si mendime të kundërta me konkludimin tonë.

12. Aspekti i operacionalizimit funksional të AKI –së duhet të ndodhë sa më parë me njerëzit më profesional të rinjë, të trajnuar mirë dhe të mbikëqyret në mënyrë demokratike nga akterët që janë të përcaktuar me ligj.



Pajtohem plotësisht	40	74.1%
Pajtohem	12	22.2%
Nuk kam përgjigje	2	3.7%
Nuk pajtohem	0	0%
Nuk pajtohem aspak	0	0%


Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë (Pajtohem plotësisht)**
 - ka marrë 40 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 74.1 %;
- ❖ **Opsioni i dytë (Pajtohem)**
 - ka marrë 12 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 22.2 %;
- ❖ **Opsioni i tretë (Nuk kam përgjigje)**
 - ka marrë 2 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 3.7 %;
- ❖ **Opsioni i katërt (Nuk pajtohem)**
 - ka marrë 0 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 0 %;
- ❖ **Opsioni i pestë (Nuk pajtohem aspak)**
 - ka marrë 0 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 0 %.

Respondentët kanë dhënë përgjigje vetëm në tri opsione, sikurse që e kemi parë nga praktika e mëhershme, këtu ka ndryshuar mënyra, ngase respondentët janë grumbulluar pothuajse vetëm në një grup përgjigjesh sasiore. Duke i parë përgjigjet se si kanë variuar, përkatësisht mendimet e respondentëve kanë prodhuan përgjigje me këtë rezultat të pajtueshmërisë një opsionale si në vijim:

Në konkludimin tonë se ***“Aspekti i operacionalizimit funksional të AKI –së duhet të ndodhë sa më parë me njerëzit më profesional të rinj, të trajnuar mirë dhe të mbikëqyret në mënyrë demokratike nga akterët që janë të përcaktuar me ligj”***. Këtu është i shfaqur konkluzioni kryesorë si më të dalluarit, e që konsiston në pajtueshmërinë e këtij grupi të respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, superior prej tyre 74.1 % janë pajtuar plotësisht në pyetjen e parashtruar. Përderisa janë pajtuar 22.2 % e respondentëve, mund të themi se rezultati përfundimtar këtyre përgjigjeve në formë konkludimi absolut me përgjigjet e tyre në dy opsionet ***“PAJTOHEM PLOTËSISHT dhe PAJTOHEM”*** kanë rezultuar me një rezultat superior komulativ të papajtueshmërisë së respondentëve, që janë pajtuar se aspekti i operacionalizimit funksional të AKI –së duhet të ndodhë sa më parë me njerëzit më profesional të rinj, të trajnuar mirë dhe të mbikëqyret në mënyrë demokratike nga akterët që janë të përcaktuar me ligj, është mendimi i shumicës së respondentëve prej tyre si shprehje unanime 96 % kanë shprehur papajtueshmëri. Në kategoritë e tjera të opsioneve përveç se në ***“NUK KAM PËRGJIGJIE”*** me 3.7 % vlerësime të tjera nuk janë shprehur, duke i dhënë mbështetje të plotë konkludimit tonë.

13. Praktikrat gjithëpërfshirëse në sfidat e luftës kundër terrorizmit dhe specifikisht mbi mbikëqyrjen e demokratike parlamentare të shërbimeve inteligjente, janë të domosdoshme për AKI –në.



Pajtohem plotësisht	31	57.4%
Pajtohem	23	42.6%
Nuk kam përgjigje	0	0%
Nuk pajtohem	0	0%
Nuk pajtohem aspak	0	0%

Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

❖ **Opsioni i parë** (*Pajtohem plotësisht*)

- ka marrë 31 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 57.4 %;

❖ **Opsioni i dytë** (*Pajtohem*)

- ka marrë 23 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 42.6 %;

❖ **Opsioni i tretë** (*Nuk kam përgjigje*)

- ka marrë 0 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 0 %;

❖ **Opsioni i katërt** (*Nuk pajtohem*)

- ka marrë 0 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 0 %;


❖ **Opsioni i pestë** (*Nuk pajtohem aspak*)

- ka marrë 0 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 0 %.

Përderisa kishim rezultat në tri e më shumë opsione, këtu respondentët e përzgjedhur kanë dhënë përgjigje vetëm në dy opsione nga pesë sish, sikurse që e kemi parë nga praktika e mëhershme, këtu ka ndryshuar mënyra, ngase respondentët janë grumbulluar pothuajse vetëm në një grup sasiore. Duke i parë përgjigjet se si kanë variuar, përkatësisht mendimet e respondentëve kanë prodhuar përgjigje me këtë rezultat edhe këtu të pajtueshmërisë një opsionale si në vijim:

Në konkludimin tonë se ***“Praktikat gjithëpërfshirëse në sfidat e luftës kundër terrorizmit dhe specifikisht mbi mbikëqyrjen e demokratike parlamentare të shërbimeve inteligjente, janë të domosdoshme për AKI –në”***. Këtu është i shfaqur konkluzioni kryesorë si më të dalluari, e që konsiston në pajtueshmërinë e këtij grupi të respondentëve të cilët me një përqindje të madhe, superior prej tyre 57.4 % janë pajtuar plotësisht në pyetjen e parashtruar. Përderisa janë pajtuar 42.6 % e respondentëve, mund të themi se ky rezultat përfundimtar i këtyre përgjigjeve në formë konkludimi absolut me përgjigjet unanime të tyre në dy opsionet ***“PAJTOHEM PLOTËSISHT dhe PAJTOHEM”*** kanë rezultuar me një rezultat superior komulativ të papajtueshmërisë së plotë të respondentëve, që janë pajtuar se praktikatat gjithëpërfshirëse në sfidat e luftës kundër terrorizmit dhe specifikisht mbi mbikëqyrjen e demokratike parlamentare të shërbimeve inteligjente, janë të domosdoshme për AKI –në , është mendimi i shumicës së respondentëve prej tyre si shprehje kuantitative me 99 % të rezultatit kanë shprehur papajtueshmëri unanime. Në kategoritë e tjera të opsioneve nuk ka pas rezultat fare, duke i dhënë po ashtu edhe këtu mbështetje të plotë konkludimit tonë.

14. Roli i Shoqërisë Civile në monitorimin e funksionimit demokratik të Shërbimeve Inteligjente, është i rëndësishëm.



Pajtohem plotësisht	21	38.9%
Pajtohem	13	24.1%
Nuk kam përgjigje	4	7.4%
Nuk pajtohem	9	16.7%
Nuk pajtohem aspak	7	13%


Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë (Pajtohem plotësisht)**
 - ka marrë 21 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 38.9 %;
- ❖ **Opsioni i dytë (Pajtohem)**
 - ka marrë 13 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 24.1 %;
- ❖ **Opsioni i tretë (Nuk kam përgjigje)**
 - ka marrë 4 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 7.4 %;
- ❖ **Opsioni i katërt (Nuk pajtohem)**
 - ka marrë 9 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 16.7 %;
- ❖ **Opsioni i pestë (Nuk pajtohem aspak)**
 - ka marrë 7 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 13 %.

Në konkludimin e katërmbëdhjetë kemi ndryshim, për dallim nga të kaluarat, sepse rezultati varion i shkapërderdhur në të gjitha opsionet, këtu respondentët e përzgjedhur kanë dhënë përgjigje të ndryshme në të gjitha opsionet, sikurse që e kemi parë nga praktikat e mëhershme. Duke i parë përgjigjet se si kanë variuar, përkatësisht mendimet e respondentëve kanë prodhuar këto përgjigje, duke i nxjerrë si grupim të dhënash në këtë rezultat si analizë statistikore numerike në vijim:

Në konkludimin tonë se ***“Roli i Shoqërisë Civile në monitorimin e funksionimit demokratik të Shërbimeve Inteligjente, është i rëndësishëm”***. Këtu janë shfaqur përgjigje të ndryshme nga grupi të respondentëve të cilët me një përqindje relative, prej tyre 38.9 .4 % janë pajtuar plotësisht në pyetjen e parashtruar, ndërsa janë pajtuar 24.1 % e respondentëve, poashtu kemi shtrirje edhe të rezultateve në kategoritë e tjera si: 7. 4% *nuk kam pas PËRGJIGJIE*, pastaj 16.7 *nuk janë PAJTUAR dhe 13 % nuk janë pajtuar ASPAK* . Pra këtu kemi rezultat të shkapërderdhur sasior – kuantitativ me shprehje mendimesh të ndryshme, por që përsëri ka dominuar papajtueshmëria e respondentëve, duke u pajtuar se roli i Shoqërisë Civile në monitorimin e funksionimit demokratik të Shërbimeve Inteligjente, është i rëndësishmen, dhe si i këtillë, është mendimi i shumicës kualitative të respondentëve prej tyre me 62 % të rezultatit kanë shprehur papajtueshmëri unanime. Në kategoritë e tjera të opsioneve nuk ka pas rezultat shumë të theksuar, e i cili është i evidentuar në tabelën dhe grafikonin shpjegues, duke i dhënë edhe këtu mbështetje të plotë konkludimit tonë.

15. Nevoja për informacion të “saktë” dhe të “shpejtë”, ka qenë gjithmonë detyra kryesore e Agjencive të Zbulimit; Teknologjia sot, e ka lehtësua dhe ka dekonspirua informacionin.



Pajtohem plotësisht	22	44.4%
Pajtohem	22	44.4%
Nuk kam përgjigje	4	7.4%
Nuk pajtohem	2	3.7%
Nuk pajtohem aspak	0	0%

Përgjigjet e grumbulluara rreth konkludimit së pestë, variojnë rezultatin si në vijim:

- ❖ **Opsioni i parë** (*Pajtohem plotësisht*)
 - ka marrë 22 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje është 44.4 %;
- ❖ **Opsioni i dytë** (*Pajtohem*)
 - ka marrë 22 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje rezultojnë 44.4 %;
- ❖ **Opsioni i tretë** (*Nuk kam përgjigje*)
 - ka marrë 4 përgjigje nga 54 respondentë e që në përqindje përkthehet në 7.4 %;
- ❖ **Opsioni i katërt** (*Nuk pajtohem*)
 - ka marrë 2 përgjigje nga 54 respondentë, në përqindje është 3.7 %;
- ❖ **Opsioni i pestë** (*Nuk pajtohem aspak*)
 - ka marrë 0 përgjigje nga 58 respondentë, e që në përqindje përkthehet si 0 %.

Në konkludimin e fundit, pra të pesëmbëdhjetë kemi rezultat kryesisht të grumbulluar në dy opsionet e para. Këtu respondentët e përzgjedhur kanë dhënë përgjigje të ndryshme, sikurse që e kemi parë nga praktikat e mëhershme, por është ruajtur logjika e konkludimeve, duke i parë përgjigjet se si kanë variuar, mendimet e respondentëve kanë prodhuar këto përgjigje, duke i nxjerrë si grupim të dhënash statistikore në vijim:

Në konkludimin tonë se ***“Nevoja për informacion të “saktë” dhe të “shpejtë”, ka qenë gjithmonë detyra kryesore e Agjencive të Zbulimit; Teknologjia sot, e ka lehtësua dhe ka dekonspirua informacionin ”.*** Këtu janë shfaqur përgjigje të grupuara në dy opsionet e para të respondentëve të cilët me një përqindje nomina identike, prej 44.4 % janë pajtuar plotësisht në pyetjen e parashtruar, ndërsa janë pajtuar 44.4 % e respondentëve, po ashtu kemi shtrirje edhe të rezultateve në kategoritë e tjera si: 7.4% *nuk kam pas PËRGJIGJIE*, pastaj 3.7 *nuk janë PAJTUAR dhe 0 % nuk janë pajtuar ASPAK* . Pra këtu kemi një rezultat sasior të grumbulluar pothuajse vetëm në dy opsionet e para me shprehje mendimesh të ndryshme, por që përsëri ka dominuar papajtueshmëria e respondentëve, duke u pajtuar se nevoja për informacion të “saktë” dhe të “shpejtë”, ka qenë gjithmonë detyra kryesore e Agjencive të Zbulimit; Teknologjia sot, e ka lehtësua dhe ka dekonspirua informacionin, si i tillë, është mendimi i shumicës kualitative të respondentëve prej tyre me 88 % të rezultatit kanë shprehur papajtueshmëri unanime. Në kategoritë e tjera të opsioneve nuk ka pas rezultat shumë të theksuar, përveçse në opsionin *nuk kam PËRGJIGJIE 7.4 % dhe nuk PAJTOHEM 3.7 %* të cilët po ashtu janë evidentuar në tabelën dhe grafikun shpjegues, duke i dhënë edhe këtu mbështetje të plotë konkludimit tonë.

ANEKS IV

Raport përfundimtar

Si zakonisht, pjesa përfundimtare e këtij disertacioni të doktoratës, e cila është e mbështetur në hulumtim shkencor, i realizuar përmes pyetësorit, sipas nxjerrjes së rezultateve të konkluduara, mbetet pjesa thelbësore, e cila natyrshëm është mbështetur edhe me pjesët paraprake teorike e komperative të shtjellimit të kësaj teze të disertacionit.

Në kuadër të këtij raporti përfundimtar, mund të themi se pikëpamja shkencore e bazuar nga metodat si: Vrojtimi statistikor, përmbledhja dhe grumbullimi i të dhënave, analiza statistikore dhe interpretimi, kanë ardhur si rezultat i mundësisë së ofruar nga programi SPSS (Statistical Package for the Social Science)⁴⁰¹, nga i cili janë futur të gjitha të dhënat kryesore, janë sistemuar në formë të informatës së përgjithshme shpjeguese, më pastaj renditja e pyetje / konkludimeve të paraqitura dhe u janë dërguar në formë elektronike respondentëve, të cilët pas plotësimit të pyetësorit, programi SPSS në mënyrë automatike ka bërë identifikimin, grumbullimin, klasifikimin, analizimin dhe sistemimin e të dhënave në formë statistikore përmes digarmeve dhe tabelave numerike, të nxjerra sipas numrit të përgjigjeve dhe përqindjeve sipas rubrikës së opsioneve.


Edhe në këtë raport përfundimtar do të kemi paraqitje grafike të dhënave kualitative, përmes (Diagramit Tortë), (Bar Diagramit) (Histogramit të frekuencave dhe qendrave të ndryshme), (Organizimi i të dhënave numerike sisteme), (Distributimit dhe analizave statistikore) etj që kanë treguar rezultat përmbledhës në totalin e përpunuar me përqindje laksative numerike.

Konteksti, rrjedhimisht mënyra e realizimit të hulumtimit përmes këtij sistemi të avancuar teknik dhe teknologjik, ka lehtësuar tej mase fushë veprimtarinë hulumtuese, duke bërë mbajtjet dhe nxjerrjen të dhënave me mundësi shumë të vogël të gabimeve.

⁴⁰¹ **Definition** - What does Statistical Package for the Social Sciences (SPSS) mean? The Statistical Package for the Social Sciences (SPSS) is a software package used in statistical analysis of data. It was developed by SPSS Inc. and acquired by IBM in 2009. In 2014, the software was officially renamed IBM SPSS Statistics.
[Online] Marrë nga:
http://www.optiontrain.com/SPSS%2019.php?gclid=EAIaIQobChMIjuu7xbq32wIVRDobCh1Udw4iEAAYASAAEgIFcPD_BwE {Qasja e fundit, Janar 2018}

Para së gjithash, kjo metodë e avancuar për realizim të pyetësorëve me respondentët e përzgjedhur ka treguar një efikasitet shumë produktiv, gjë që ka bërë të mundur në mënyrë shumë precize dhe gjithëpërfshirëse të kategorizoj, sistemoj dhe nxjerrë të gjitha të dhënat që ofron sistemi (Docs Google – Drive Software)⁴⁰²


Hulumtimi mbi studimin lidhur me formulimin e pyetjeve mjaftë specifike dhe përmbajtjesore, arriti të marrë formë dhe strukturë funksionale gjatë hulumtimit, duke ndjekur me një zellshmëri praktikatat e një hulumtimi gjithëpërfshirës studimor, është arritur rezultat, konsideroj i mjaftueshëm gjatë kësaj faze të studimeve të disertacionit:



Konteksti teorik: Aspekti i sigurisë dhe Inteligjencës, është i nxitur nga nevoja e krijimit të politikave dhe akterëve brenda shtetëror dhe jashtë shtetëror, si domosdoshmëri e ruajtjes së paqes në kontekstin bashkëkohorë të sigurisë;


Ka rezultuar me 57.10%, duke u pajtuar plotësisht dhe 42.90% duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 99% të përgjigjeve të respondentëve.

⁴⁰² Sistemi i Google Dive: [Online] Marrë nga: <https://drive.google.com/drive/my-drive> /<https://www.google.com/docs/about/> {Qasja, Janar 2018}




Konteksti i kuadrit ligjor: Harmonizimi i legjislacionit me Unionin Evropian, që kërkohet për funksionimin e politikave të sigurisë dhe praktikave të shërbimeve të inteligjencës, në parim a ekziston si bazë ligjore tek ne;


Ka rezultuar me 14.30%, duke u pajtuar plotësisht dhe 57.10% duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 71 % të përgjigjeve të respondentëve.




Konteksti i burimeve njerëzore: Sektori i sigurisë në Republikën e Kosovës e ka përmbyllë infrastrukturën ligjore. Mungesa e kuadrit është e evidentë; Ka rezultuar me 28.60%, duke u pajtuar plotësisht dhe 44.90% duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 72 % të përgjigjeve të respondentëve.



Konteksti i kontrollit demokratik: Masat e kontrollit demokratik në parandalimin e tejkalimit të autorizimeve ligjore nga Agjencitë e Shërbimeve Inteligjente, duhet të jenë të sanksionuara me ligj; Ka rezultuar me 67.30%, duke u pajtuar plotësisht dhe 26.50% duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 93 % të përgjigjeve të respondentëve.




Konteksti sanksionimit ligjor: Praktika e kontrollit demokratik të një Shërbimi Inteligent duhet të bazohet në ligj, AKI është e sanksionuar mbi bazën e standardeve që kërkohen;
 Ka rezultuar me 26.50%, duke u pajtuar plotësisht dhe 40.80% duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 66 % të përgjigjeve të respondentëve.




Konteksti i besueshmërisë: Mendimi juaj, Shërbimin Inteligjent në një shtet demokratik e bën të suksesshëm dhe të besueshëm. Përgjigje me më shumë se një opsion;
 Ky rezultat ka treguar lojalitet, logjikë racionale dhe vëmendje të theksuar dhe është vërtetuar konkludimi ynë si i bazuar me rezultat mbi 50 % në shumicën e përgjigjeve të respondentëve.

Metodologjia e Shërbimeve Inteligjente	30	55.6%
Kontrolli demokratik	30	55.6%
Pajisjet Teknike dhe Teknologjike	24	44.4%
Interesat gjeopolitike	13	24.1%
Aspekti financiar	22	40.7%
Orientimi Strategjik i Politikave të Sigurisë Nacionale	29	53.7%
Bashkëpunimi Ndërkombëtare	30	55.6%
Të tjera	6	11.1%




Konteksti i keqpërdorimit: Roli i dikurshëm i Shërbimeve inteligjente ishte në interes të kastave politike:

Ka rezultuar me 53.10%, duke u pajtuar plotësisht dhe 30.60% duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 83 % të përgjigjeve të respondentëve.




Konteksti i fushëveprimtarisë Sot fushëveprimtaria e Shërbimeve Inteligjente në vendet demokratike bazohet vetëm në ligj. Duhet të mos tejkalohen autorizimet ligjore:


Ka rezultuar me 51 %, duke u pajtuar plotësisht dhe 35 % duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 86 % të përgjigjeve të respondentëve.




Konteksti i përhapjes së terrorizmit: Ndikimi i përhapjes së terrorizmit në botë, ka bërë të ngritët gjithandej niveli për një vigjilencë gjithëpërfshirëse “nacionale dhe globale”, të të gjitha llojeve të shërbimeve Inteligjente. AKI ja, a qenë në nivel të detyrës;
 Ka rezultuar me 10 %, duke u pajtuar plotësisht dhe 33 % duke u pajtuar, është vërtetuar pjesërisht konkludimi ynë si bazuar me rezultat 43 % të përgjigjeve të respondentëve.




Konteksti i orientimit strategjik: Orientimet strategjike të një shteti, zakonisht varen prej politikave që ofrojnë Agjencitë e zbulimit. Kosova është duke ndërtuar këto koncepte për të ardhmen;
 Ka rezultuar me 33 %, duke u pajtuar plotësisht dhe 29 % duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 62 % të përgjigjeve të respondentëve.



Konteksti doktrinar: Politikat e Sigurisë dhe Inteligjencës, zakonisht krijohen mbi bazën e dokumenteve strategjike. Duhet të vazhdohet me këtë metodë;
 Ka rezultuar me vetëm 33%, pozitivitet, duke u shprehur me negativitet, shumica janë pajtuar.
 Konkludimi ynë si bazuar me rezultat 92 % të përgjigjeve të respondentëve.




Konteksti funksional i AKI –së Aspekti i operacionalizimit funksional të AKI –së duhet të ndodhë sa më parë me njerëzit më profesional të rinj, të trajnuar mirë dhe të mbikëqyret në mënyrë demokratike nga akterët që janë të përcaktuar me ligj;
 Ka rezultuar me 76 %, duke u pajtuar plotësisht dhe 22 % duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 98 % të përgjigjeve të respondentëve.



Konteksti karshi sfidave të terrorizmit dhe monitorimit:


Praktikat gjithëpërfshirëse në sfidat e luftës kundër terrorizmit dhe specifiku mbi mbikëqyrjen demokratike parlamentare të shërbimeve inteligjente, janë të domosdoshme për AKI –në;

Ka rezultuar me 57 %, duke u pajtuar plotësisht dhe 43 % duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 100 % të përgjigjeve të respondentëve.



Konteksti i Shoqërisë Civile: Roli i Shoqërisë Civile në monitorimin e funksionimit demokratik të Shërbimeve Inteligjente, është i rëndësishëm;

Ka rezultuar me 37 %, duke u pajtuar plotësisht dhe 27 % duke u pajtuar, është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar me rezultat 64 % të përgjigjeve të respondentëve.



Konteksti teknologjik i informacionit: Nevoja për informacion të “saktë” dhe të “shpejtë”, ka qenë gjithmonë detyra kryesore e Agjencive të Zbulimit; Teknologjia sot, e ka lehtësua dhe ka dekonspirua informacionin;

Ka rezultuar me 43 %, duket se nuk janë pajtuar aspak, ndërsa 45 % duket se nuk janë pajtuar, kështu që është vërtetuar konkludimi ynë si bazuar në kontekstin negativ me rezultat 88 % të përgjigjeve të respondentëve .

Shikuar në përgjithësi, ky hulumtim i realizuar ka synuar të jap shpjegime të rëndësishme, në disa prej konteksteve dhe specifikave të këtij hulumtimi të tezës së disertacionit:

Duke i analizuar veç e veç disa nga specifikat e konteksteve të shërbimeve inteligjente, që janë pjesë përbërëse e konkludimeve në hulumtimin tonë si vijon:

Konteksti teorik; Kontekstin e kuadrit ligjor; Kontekstin e burimeve njerëzore; Kontekstin e kontrollit demokratik; Kontekstin e sanksioneve ligjore; Kontekstin e besueshmërisë; Kontekstin e keqpërdorimit; Konteksti i fushëveprimtarisë; Konteksti i përhapjes së terrorizmit; Konteksti i orientimit strategjik; Konteksti doktrinar; Konteksti funksional i AKI –së; Konteksti karshi sfidave të terrorizmit dhe monitorimi; Konteksti i Shoqërisë Civile dhe Konteksti teknologjik i informacionit;

Sfondi i këtij hulumtimit përmes këtij sistemi ishte me objektivë të qartë duke nxjerrë atë lloj konkludimi që ne veç kishim parashikuar për mes pyetësorit elektronik, nga i cili morëm të dhëna shumë të çmuara, të cilat u vendosën në mënyrë automatike- sistimore sipas programit.

Arsyetimi i hulumtimit, që në fillim të kësaj teze të disertacionit ishte planifikuar, ne kishim ngritur tezat kryesore dhe ato ndihmëse, me qëllim primar vërtetimin e tyre gjatë procesit mjaftë të mundimshëm kërkimor. Një studim i tillë i përmasave të një doktrate, kur kihet parasysh fusha e studimit, si një nga fushat e pakta të hulumtuara dhe të studiuara nga studiuesit, sidomos ballkanas dhe veçanërisht shqipfolës, ishte mjaftë e mundimshme për faktin e mangësive të shumta në burime primare dhe sekondare.

Formulimi i problemit gjatë ndërtimit të pyetësorit, rrjedhimisht konkludimeve, morri jashtëzakonisht një kohë, derisa u harmonizua aspekti i ngritjes së hipotezës kryesore, hipotezave ndihmëse dhe aplikimit të metodologjisë kërkimore të kombinuar.

Objektivat e parashtruar si materie shqyrtuese e hulumtuese ishin të qarta dhe mirë të planifikuara si strukturë e formësuar që në nisje edhe pse fillimit ishin disa përtej tyre abstrakte, ato po arrinin të merrnin formë dhe përmbajte dinamike nga domethënia e studimit, qëllimet dhe përkufizimet teorike.

Hulumtimi ynë ishte i bazuar në burimet e të dhënave dhe metodat e mbledhjes së tyre, nga ku janë arritur rezultate valide preliminare dhe përfundimtare të vërtetuara nga mbledhja e të dhënave sekondare të disponueshme, si dhe besueshmëria e burimeve në aplikimin e të dhënave për qëllimin specifik të këtij studimi.

Metoda e komunikimit, trajtimi adekuat, pastaj mbledhja e të dhënave primare dhe arritja e objektivitetit të strukturuar, duke qartësuar objektivat e ngritura, mostra shtresëzuese, kërkimi logjik për vërtetimin e konkludimeve tona, duke përfillë qartësisht elementët si: *Unikaliteti i hulumtimit; Qëllimi i hulumtimit; Përfitimi nga hulumtimi; Vlerat teorike e hulumtimit dhe Vlerat*

praktike e hulumtimit kanë vënë në dispozicion të plotë rezultatin statistikor të vërtetimit përfundimtar.

Rezultatet kërkimore, që kryesisht janë paraqitur përmes formave kompjuterike të diagramit rrethor (sipërfaqësor) të njohura si histograme, apo rrethe strukturale, apo diagrami tortë, përmes grafikeve statistikore, si një nga metodat më të përhapura në lëmin e interperimit dhe analizimit të paraqitjeve të rezultateve preliminare dhe atyre përfundimtare statistikore të vlerave numerike si paraqitje grafike e të dhënave kualitative, përmes Diagramit Tortë; Bar Diagramit; Histogramit të frekuencave dhe qendrave të ndryshme; Organizimi të të dhënave numerike sistemore; Distribrimi dhe analiza statistikore si koncept bazë; etj, kanë treguar rezultat përmblendhës në totalin e përpunuar dhe prezantimit e analizës në përqindje të vlerave numerike.

Në fund fare prezantimi i këtyre rezultateve i bërë përmes formave të paraqitjeve të shtyllave të thjeshtëzuara, të njohura si të njëfishta, dhe shtyllave të dyfishta me shënime numerike poshtë vijëzimeve tabelore ka nxjerrë mbledhjen e fakteve dhe të opinioneve që janë paraqitur në formë numerike – statistikore. Rrjedhimisht, konteksti dhe mënyra e realizimit të këtij hulumtimi, përmes këtij sistemi të avancuar teknik, ka lehtësuar tej mase aktivitetin hulumtues, duke bërë matjet dhe nxjerrjen e variablave kuantitative (sasiore numerike) të të dhënave me mundësi shumë të vogël të gabimeve gjatë procesit të administrimit. Me anë të këtyre statistikave ne kemi përfituar pritjet dhe prognozat e vërtetuara gjatë këtij hulumtimi.

SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE

(Konkluzione)

Trajtimi dhe studimi i këtyre problematikave apo fenomeneve të aspekteve të inteligjencës në temën tonë me tezë; *‘Konteksti i shërbimeve inteligjente në politikat e bashkëkohore të Sigurisë’* gjatë këtij punimi të disertacionit, i fokusuar thellë si studim specifik në sektorin e shërbimeve të inteligjencës, ishte një fushë relativisht e vështirë për hulumtim, studim dhe me pak rezultate paraprake studimore, sidomos në gjuhën shqipe. Fare jo e lehtë si në studimet tona në përgjithësi dhe në shkencat tjera.

Ky studim që në vete ishte mjaftë kompleks, u realizua me një maturi shkencore dhe pasion metodik, duke arritur që materia në fjalë të trajtohet sa më mirë dhe të argumentohen hipotezat e ngritura për vërtetimin e tezës dhe hipotezës kryesore duke respektuar kritere struktë të metodologjisë së kërkimit shkencorë duke ruajtur thellësisht organikën dhe karakterin hulumtues të këtij disertacioni.

Aspektet e ligjshmërisë, mbikëqyrja demokratike e shërbimeve të Inteligjencës dhe këndvështrim krahasimor, ishte boshti kryesor i kësaj teze të disertacionit, duke përfshi trajtime të veçanta të aspekteve të funksionimit në konceptin gjithëpërfshirës të sigurisë, si një rol dhe faktor kyç në një shoqëri dhe shtet në shoqëritë bashkëkohore.

Konteksti i ndërlikueshmërisë midis kontrollit - mbikëqyrjes demokratike dhe natyrës së punës sekrete të shërbimeve inteligjente si i tillë do të mbetet ndoshta përgjithmonë një **“luftë e heshtur”** apo **“perde e hekurt”**, me gjasë do ti duhet kohë epokash demokracisë për ta fituar. Kjo për faktin siç është thënë edhe më parë; *“Qëllimi i demokracisë është transperenca dhe informimi sa më i plotë ndaj opinionit publik, ndërsa natyra e punës së shërbimeve inteligjente është fshehtësia, pra puna sekrete”*.

Praktikat ndërkombëtare që njohim ne sot dhe që kanë në fokus sensibilizimin dhe standardizimin për një kontroll dhe mbikëqyrje të komunitetit inteligjent, përkatësisht vuarjën e tyre brenda sistemit ligjor të kontrollit demokratik nuk do të mund të arrijnë rezultat pa njohjen mirëfillazi të demokracisë dhe specifikave ligjore që karakterizohen këto shërbime në shoqëritë bashkëkohore.

Me të vërtetë është e vështirë arritja e këtij objekti në demokracitë e brishta, nëse nuk kihen parasysh praktikat dhe standardet e rregullimit demokratik, natyrisht po aq i rëndësishëm është edhe roli i tyre kur kihen parasysh sfidat e kërcënimit të përhershëm ndaj sigurisë në kontekstin bashkëkohorë.

Në këtë pikëtakim në shqyrtimet përfundimtare të këtij punimi kemi rikapituluar disa dimensione bazë të këtij hulumtimi, si:

- *Këndvështrimi teorik si njohje bazike e të kuptuarit të Shërbimeve Inteligjente;*
- *Aspektet historike;*
- *Njohjet teorike;*
- *Njohje të shërbimeve nga rajoni;*
- *Krahasimi në nivel ndërkombëtarë;*
- *Komperacioni si metodë krahasimi i Shërbimeve Inteligjente;*
- *Kuadri ligjor i rregullimit të AKI –së;*
- *Mbikëqyrja dhe kontrolli demokratik i shërbimeve inteligjente globale;*
- *Studim me fokus të veçantë AKI –në;*
- *Kundërinteligenca e Shërbimeve Inteligjente;*
- *Sfidat që ballafaqohet sot komuniteti inteligjent në shek. 21.*
- *Bashkërendimi i aspektet të inteligjencës në luftën kundër terrorizmit,*
- *Konteksti i inteligjencës kibernetike, etj.*

Këto përpjekje serioze që gjatë gjithë hulumtimit dhe gjetjeve janë dokumentuar dhe vërtetuar me mjaftë korrektësi. Arritjet si bazë të mirë shkencore që të dalim me disa përfundime që në të ardhmen mund të shërbejnë si rekomandime gjithëpërfshirëse për këtë fushë specifike në përgjithësi e për AKI –së në veçanti si një agjenci e re dhe sfidat që aktorëve kryesorë të saj në fushën e komunikimit inteligjent dhe kundërinteligjencë, të profesionalizimit të vazhdueshëm për të ofruar performancën e nivelit të duhur në ofrimin e mjedisit të sigurt në parandalimin e hershëm, mision ky që ka Agjencia e Kosovës për Inteligjencë në Republikën e Kosovës.

Kjo tezë disertacioni, përgjithësisht ka provuar të argumentojë konceptet bashkëkohore të politikave të Sigurisë dhe Inteligjencës, njëherësh praktikën më të mira, lidhur me kuadrin ligjor dhe mbikëqyrjen demokratike të shërbimeve inteligjente, si konkluzione;

- *Parasëgjithash, aspektet krahasuese - komparative të teorive dhe koncepteve që bëjnë të mundur njohjen e veprimtarisë së shërbimeve të inteligjencës në shoqëritë demokratike janë arritur së trajtuar me mjaft korrektësi.*
- *Praktikat më të mira të mbikëqyrjes, operacionalizimi funksional dhe kontrollit demokratik, ndaj shërbimeve të inteligjencës në mos tejkalimin e autorizimeve ligjore, poashtu.*
- *Është analizuar i plotë interpretimi juridik, gjegjësisht karakteri gjithëpërfshirës brenda kornizës ligjore, respektivisht të tri shtyllat kryesore të AKI - së.*
- *Trajtimi i sfidave të komunitetit inteligjent në shek. XXI në aspektet të inteligjencës në luftën kundër terrorizmit dhe konteksti i inteligjencës kibernetike.*

Gjithashtu ky studim në thelb përmbajtësor, ka arrit të argumentoj tri hipotezat kryesore të parashtruara të cilat gjatë hulumtimit dhe paraqitjes së argumenteve ka arritur ti vërtetoj plotësisht si të sakta e të mbështetura edhe me hipotezat ndihmëse, e atë veçantë, po ashtu.

Në fund, duke i trajtuar përfundimet të dala nga shqyrtimet e këtij hulumtimi, konsiderojmë të jenë rekomandime të qëndrueshme shkencore dhe orientuese për njërin nga faktorët kryesorë të zbatimit të politikave të sigurisë në Republikën e Kosovës siç është në këtë rast, AKI – ja dhe institucionet nacionale të sigurisë, trajtuar me plotë sfida të natyrshme, por edhe me performancë në rritje në aspektin funksional dhe operacional pas krijimit një dekadë⁴⁰³ më parë dhe si rezultat i këtyre analizave të mësipërme mund të dalim edhe me disa rekomandime si;

⁴⁰³ AKI është themeluar me 04 Shkurt 2009

(Rekomandime)

- Edhe pse AKI pothuajse ka përmbyllë të gjitha fazat e konsolidimit dhe aktualisht janë në rrjedha normale të funksionimit ajo akoma duhet të plotësoj rrisë disa nga kapacitetet specifike me staf sa më profesional dhe regrutim sipas nevojës.
- AKI duhet sa më parë të rris numrin e punëtorëve deri në 550 - 700 staf të përhershëm dhe personel të trajnuar mirë për tu përballur me sfidat e inteligjencës.
- Transparenca në përzgjedhje duhet të vazhdoj dhe sa më larg infiltrimeve të politikës dhe ish agjentëve të shërbimeve inegzistente;
- Të implementohen memorandumet e bashkëpunimit në mes të AKI –së, KSK –së, PK –së, FSK-së dhe Doganave etj në shkëmbimin e informacioneve në kohë të duhur;
- Të përmbyllën marrëveshjet e memorandumeve të bashkëpunimit me Agjencitë simotra partnere;
- Të rritet niveli i partneritetit dhe kooperimit me agjencitë simotra (sidomos me Shqipërinë, Kroacinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe vendet tjera në rajon;
- Me interes strategjik të kooprohet me shërbimet partnere të shteteve si Turqia, ShBA-ja, Izraeli, Gjermania dhe Anglia dhe përgjithësisht me komunitetin inteligjent evropian.
- Të rritet niveli i komunikimit në adresë me publikun dhe bashkëpunimi sidomos me shoqërinë civile.
- Të mos harrohet asnjëherë mbikëqyrja dhe kontrolli demokratik nga akterët që janë të përcaktuar me ligj.

Në fund, normalizimi funksional, kapacitetet fillestare, sfidat e konsolidimit, AKI –së i shtrohen në analizë dhe detyrë, veprimi në aktivitete të Kundërinteligjencës si masa shumë domethënëse, edhe rritja e kapaciteteve, si; profesionalizmi, transparenca, kontrolli demokratik i brendshëm apo nga jashtë, komunikimi, shkëmbimi i informacioneve inteligjente bilaterale dhe multilaterale, sfidat e rajonit, lufta kundër terrorizmit trasnacional, Inteligjenca Kibertetike, mundësia e faktorizimit inteligjent si dhe faktorët global që në një apo mënyrë tjetër janë të ndërlidhura edhe me punën e të gjitha shërbimeve inteligjente dhe po ashtu edhe të AKI-së, e që do të jetë sfidë e së tashmes dhe të ardhmen në rrafshin nacional dhe kontekstin bashkëkohorë të sigurisë.

LITERATURA

- Ali Khan, “A Theory of International Terrorism: Understanding Islamic Militancy”, “Developments in International Law Series, Vol. 56”, Leiden -Boston: Martinus Nijhoff Publishers, 2006.
- Abazoviq, Dr. Mirsad, SIGURIA NACIONALLE , FSK/S – 05/06 PRISHTINË 2006
- ALDO MUSCI / MARCO MINICANGELI, Të fshehtat e MOSADIT (Historia e një prej shërbimeve sekrete më të frikshme të botës), Shtëpia Botuese, Bota Shqiptare, Tiranë 2005
- Alex Schmid & Albert Jongman, “Political Terrorism: A New Guide to Actors, Authors, Concepts, Data Bases, Theories and Literatures”, US: Transaction Publishers, 2005
- Buzan Barry and Herring Eric, The Arms dynamic in World Politics. Lynne Rienner Publishers, Londër, 1998
- Born Hans dhe Leigh Ian, Kontrollueshmëria e shërbimeve të fshehta
- Brian Jenkins, “The Study of Terrorism: Definitional Problems”, RAND Corporation, Desember, 1980.
- Brain M. Jenkins “International Terrorism: A New Mode of Conflict” Crescent Publishers, 1975
- Caparini Marina “Controlling and Overseeing Intelligence Services in Democratic States,” in Democratic Control of Intelligence Services: Containing Rogue Elephant, ed. Hans Born and Marina Caparini (England: Ashgate, 2007)
- Colins Alan “Studime bashkëkohore të sigurisë” përkthim nga Enri Hide, Tiranë
- Qehaja Ramadan, Çështjet e Sigurisë Nacionale të Kosovës, Prishtinë, 2004.
- Duro Ilo – Hysa Ramazan, Fjalor Shqip – Anglisht / Albanian – English DICTINATRY, Botuar, Rilindja, redaktor Nazmi Rrahmani, Prishtinë 1988
- Loch Johnson, “Bricks and Mortar for a Theory of Intelligence,” Comparative Strategy. 22, no. 1 (2003)
- Robert A. Morey, PhD “ The Islamic Invasion, Christian Scholars Press, 2011
- Michael Warner, “Sources and Methods for the Study of Intelligence,” in Handbook of Intelligence Studies, ed. Lock K. Johnson (London and New York: Routledge, 2007)

- Mellon Jérôme Të kuptuarit e SHËRBIMEVE INFORMATIVE Një mjet referimi për ata që dëshirojnë të mësojnë më shumë për natyrën dhe rolin e shërbimeve informative në kontekstin evropian të shekullit 21. Dhjetor 2006
- MARTIN C. DAVID **KGB** kundër **CIA**, Mizoria e Pasqyrave, Shtëpia Botuese ONURFI, përktheu Ardian Klosi, Botim i dytë 2007
- MUSCI ALDO / MINICANGELI MARCO, Të fshehtat e MOSADIT (Historia e një prej shërbimeve sekrete më të frikshme të botës), Shtëpia botuese, Bota Shqiptare, Tiranë 2005
- Masllesha Ramo : Teoritë dhe Sistemet e Sigurisë, Version PDF.
- Mervyn Hiskett, "Some to Mecca turn to Pray", The Claridge Press, St Albans, 1993
- JAN van HELSING, Shoqëritë sekrete dhe fuqia e tyre botërore, përktheu, Enkelajd Musabelliu, Plejad
- Christopher Coker, "Terrorism". Originally published, New York, Wallto, October 1986
- Duvenage, Petrus C. "Counterintelligence," in Prunckun, Hank (ed.), Intelligence and Private Investigation: Developing Sophisticated Methods for Conducting Inquiries. Springfield, IL: Charles C Thomas Publisher Ltd, 2013
- Henry Dr. (Hank) Prunckun, is Associate Professor of Intelligence Analysis at the Australian Graduate School of Policing and Security. Salus Journal Issue 2, Number 2, 2014
- Ehrman, John "Toward a Theory of Counterintelligence: What are We Talking About
- Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe 32.000 fjalë, Rilindja, redaksia e botimeve, Prishtinë 1983
- Viktor Ostrovski dhe Hoy Claire, Në rrjetën e Mosadit,përktheu; Robert Kosova dhe Xhilda Roko, Plejad, Tiranë, 2005
- Viktor Kaparov, Historia Botërore e Spiunazhit, përktheu nga origjinali; Vladimir Bregu Plejad, Tiranë, 2010
- Walter Laqueur, A World of Secrets: The Uses and Limits of Intelligence (New York: Basic Books, 1985)
- Warner Michael , "Sources and Methods for the Study of Intelligence," in Handbook of Intelligence Studies, ed. Lock K. Johnson (London and New York: Routledge, 2007)
- When We Talk About Counterintelligence?" in Studies in Intelligence, Vol. 53, No. 2, 2009

- Peter Dr. Gill is Honorary Senior Research Fellow at the University of Liverpool, UK. He was previously Research Professor in Intelligence Studies at the University of Salford. He is the author of Policing Politics, London: Cass, 1994
- Steven Boraz and Thomas Bruneau, "Best Practices: Balancing Democracy and Effectiveness," in Reforming Intelligence: Obstacles to Democratic Control and Effectiveness, ed. Thomas Bruneau and Steven Boraz (Austin, Texas: University of Texas Press, 2007)

Burime sekondare

Qendra për studime në fushën e politikave të sigurisë

- **DICAF**, Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura.
- Parliamentary Oversight of Intelligence Services, DCAF Backgrounder, 2006
- Të kuptuarit e mbikëqyrjes së inteligjencës Aidan Wills Geneva Centre for the Democratic Control of DCAF Armed Forces (DCAF 2006)
- Prof. Wolfgang Krieger: German intelligence and Parliamentary oversight INTELLIGENCE & DEMOCRACIES IN CONFLICT AND PEACE KAS/BESA INTERNATIONAL CONFERENCE BAR-ILAN UNIVERSITY, OCTOBER 18–19, 2009
- **GAP** Institutit për Studime të Avancuara / www.institutigap.org2009/ Qeveria i ndan buxhet Agjencionit për Inteligjencë
- **QKSS**, "Vlerësimi i sektorit të sigurisë në Republikën e Kosovës, Perspektiva e shoqërisë civile" Prishtinë 2009
- **QKSS** – Hulumtim periodik me temë: „Qeverisja e Agjencisë së Inteligjencës në Kosovë“ / Florian Qehaja / PRISHTINË / PRILL 2012

Burime zyrtare korrespondente, ligjeve dhe agjencie të shërbimeve të inteligjencës

- <http://www.fas.org/irp/world/index.html> (World Intelligence and Security Agencies (FAS))
- <http://www.cia.gov/offices-of-cia/>
- <http://www.scribd.com/doc/23958185/A-Study-Into-the-Size-of-the-World-s-Intelligence-Industry>
- <http://www.cia.gov/about-cia/cia-vision-mission-values/index.html>
- <http://www.cia.gov/news-information/cia-the-war-on-terrorism/index.html>
- <http://www.agentura.ru/english/>
- http://www.en.wikipedia.org/wiki/National_security.
- <http://intelligent-systems.com.ar/intsys/whaisint.htm>
- <http://www.mi6.gov.uk/output/history-of-sis.html>
- <http://www.topspysecrets.com/mossad-history.html>
- <http://www.mossad.gov.il/default.aspx>
- <http://www.fjalori-anglisht-shqip.com/>
- <http://gjeopolitika.wordpress.com>
- <http://www.institutigap.org>
- <http://mf.rks-gov.net/ministriaefinancave/buxhetiqendrore.aspx>
- <http://www.telegrafi.com/lajme/aki-eshte-kudo-2-21262.html>
- <http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=104855>
- <http://zhurnal.mk/al/cont.asp?k=21208120405&s=27209153635&ID=141209161052>
- http://www.transborderviolence.net/&files/Political_Control_over_Civilian_Intelligence_Organizations.pdf
- <http://kosovapress.com/?cid=1,92,147642>
- http://www.ia.gov.mk/alban/ar_a.htm
- <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=370>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2521>
- <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2682>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8669>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2811>

- <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2851>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10968>
- <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2676>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>
- <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2651>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2538>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8867>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2674>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8871>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2789>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2801>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2816>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2781>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8860>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2741>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2690>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2523>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540>
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10763>
- <https://www.cia.gov/index.html>
- <https://www.airforce.com/>
- <http://www.goarmy.com/>
- <http://www.gocoastguard.com/>
- <http://www.dia.mil/>
- <http://energy.gov/>
- <https://www.dhs.gov/>
- <http://www.state.gov/>
- <https://www.treasury.gov/Pages/default.aspx>
- <https://www.dea.gov/index.shtml>
- <https://www.fbi.gov/>

- <http://www.hqmc.marines.mil/intelligence/>
- <https://www.nga.mil/Pages/Default.aspx>
- <http://www.nro.gov/>
- <https://www.nsa.gov/>
- <http://www.oni.navy.mil/>

Burime elektronike dhe informacione të korresponduara me tezë;

- **Sfidat përballë intelgjencës kosovare** - Iliria News / 06/02/2009 23:13:32 ... Kushtetuta e Kosovës parasheh që Agjencia e Kosovës për Intelgjencë të zbulojë, ...www.ina-online.net/Default.aspx?...3 – Këshillit të Sigurisë së Kosovës www.qkss.org/.../Keshilli%20i%20Sigurise%20se%20Kosoves%20-%20QKSS.pdf
- **MBIKËQYRJA PARLAMENTARE E SEKTORIT TË SIGURISË DHE ÇËSHTJET GJINORE** www.osce.org/item/29669.html?ch=1036&lc=SQ –
- **Politika dhe funksionalizimi i AKI-së** - Radio Evropa e Lirë © 2009 www.evropaelire.org/forum/56858.html?
- **STRATEGJIA E SIGURISË KOMBETARE** www.mod.gov.al/botime/.../strategjia%20e%20sigurise%20kombetare.
- **Kërkohet raport me shkrim për shpenzimet e AKI-së**, Prishtinë, (Kosovapress) 23 Maj 2012 17:34
- **GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS** www.gazetazyrtare.com
- Gazeta e përditshme “Kosova Sot, e hënë 19 prill. 2010 / “ Kosova me afër 400 - 500 agjentë brenda vitit”

Legjislacioni i Kosovës në fushën e sigurisë, gjyqësisë dhe të intelgjencës;

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, datë 15.06.2008 – Prishtinë www.kuvendikosoves.org
- Ligji Nr. 03/ L-050 13 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës
 - Ligji nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Intelgjencë;
 - Ligji për Gjykatat; Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorinë e Shtetit;
 - Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
 - Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

- Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë;
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë;
- Ligji nr. 04/L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;
- Ligji nr. 04/L-043 për Mbrojtjen e Informatorëve;
- Kodi Drejtësisë për të Mitur;
- Kodi Doganor dhe i Akcizave;
- Ligji nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
- Ligji nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare;
- Ligji nr. 03/L-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore;
- Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike;
- Ligji nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
- Ligji nr. 03/L-231 për; Inspektoratin Policor të Kosovës;
- Ligji nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale;
- Ligji nr. 04/L-31 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale,;
- Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare;
- Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
- Ligji nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë;
- Ligji nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike,;
- Ligji nr. 04/L-094 për Shërbimet e Shoqërisë Informatike;
- Ligji për Klasifikimin e Informacionit dhe Verifikimin e Besueshmërisë;
- Ligji për Shërbimin në Forcën e Sigurisë.

Dokumente strategjike të Republikës së Kosovës;

- Plan i Zhvillimor Strategjik 2016-2020
- Plan i Vjetor i Punës së Policisë së Kosovës për vitin 2016
- Plan i Vjetor i Departamentit të Hetimeve
- Strategjia Nacionale dhe Plan i Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2015-2019
- Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2012-2017
- Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit kundër Drogave 2012-2017
- Strategjia Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Terrorizmit 2012-2017
- Strategjia Nacionale kundër Korrupsionit 2013-2017
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit 2013-2017
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2020
- Strategjia kundër Falsifikimit dhe Piraterisë 2012-2016
- Strategjia për Siguri Kibernetike 2015-2018
- Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020
- Plan Strategjik për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Rreziqet në Internet 2015-2020
- Strategjia për Asistencë në Fushën e Sundimit të Ligjit 2016-2019
- Strategjia Shtetërore për Siguri Kibernetike-2016-2019

PASDEDIKIM:

*Kombi ynë duhet të forcojë aftësitë inteligjente të shërbimeve
tona të specializuara kundër inteligjente, që të mos na
përsëritet HISTORIA e dhimbshme qindra vjeçare.*

Rikapitulim statistikor

1. Abstrakt – 1 (në tre gjuhë)
 2. Akronime – 118
 3. Kapituj – 7
 4. Aneke – 4
 5. Figura – 13
 6. Tabela – 3
 7. Mendime autoriale – 9
 8. Autor të huaj – 44
 9. Fusnota – 403
 10. Burime – 153
 11. Faqe – 225
 12. Fjalë – 59626
-